



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE



**PRIRJE  
FJALËFORMUESE  
E NGJYRESA  
LIGJËRIMORE NË  
KRIJIMTARINË  
E SHKRIMTARIT  
MARTIN CAMAJ**

**Doktorante**

**Ma. Aida URUÇI**

**Udhëheqës shkencor**

**Prof. dr. Artan HAXHI**

**Tiranë, 2013**

# DISERTACION

Përgatitur nga: Aida URUÇI  
Për marrjen e gradës shkencore “Doktor”  
Specialiteti: Gjuhësi

Prirje fjalëformuese dhe ngjyresa ligjërimore  
në krijimtarinë e shkrimtarit  
Martin Camaj.

Udhëheqës shkencor:  
Prof. dr. Artan Haxhi

Mbrohet më -----, -----, 2013 para jurisë:

1. Prof. dr. .... Kryetar
2. Prof. dr. .... Anëtar
3. Prof. as. .... Anëtar
4. Prof. as ..... Anëtar
5. Prof. as. .... Anëtar

## PASQYRA E LËNDËS

Hyrje

Kreu I

1. Figura e Martin Camajt .....12
  - 1.1. Martin Camaj, figurë poliedrike e letrave shqipe. (Jeta dhe vepra) .....12
  - 1.2. Vendi i M. Camajt në letërsinë e re shqiptare .....14
  - 1.3. Gjuhëtari e filologu, kontributi i tij në gjuhën shqipe .....16
  - 1.4. Vlerësimet e bëra nga studiues dhe kritikë për M. Camajn .....21

Kreu II

2. Sistemi fjalëformues në gjuhën shqipe .....23
  - 2.1. Studimet kryesore në fushë të fjalëformimit .....23
  - 2.2. Fjalëformimi në krijimet e M. Camajt .....25

Kreu III

3. Formimi i fjalëve me prejardhje. Formimi parashtesore. Sindajshtesat .....27
  - 3.1. Formimi i fjalëve me prejardhje parashtesore .....27
    - 3.1.1. Formimi i fjalëve me parashtesën a- .....27
    - 3.1.2. Formimi i fjalëve me parashtesën ç- .....28
    - 3.1.3. Formimi i fjalëve me parashtesën dis- .....29
    - 3.1.4. Formimi i fjalëve me parashtesën lë- .....29
    - 3.1.5. Formimi i fjalëve me parashtesën mbas- .....29
    - 3.1.6. Formimi i fjalëve me parashtesën mos- .....30
    - 3.1.7. Formimi i fjalëve me parashtesën nën- .....31
    - 3.1.8. Formimi i fjalëve me parashtesën pa- .....32
    - 3.1.9. Formimi i fjalëve me parashtesën para- .....42
    - 3.1.10. Formimi i fjalëve me parashtesën për- .....42
    - 3.1.11. Formimi i fjalëve me parashtesën s- .....57
    - 3.1.12. Formimi i fjalëve me parashtesën stër- .....57
    - 3.1.13. Formimi i fjalëve me parashtesën sh- .....59
    - 3.1.14. Formimi i fjalëve me parashtesën shpër- .....61
    - 3.1.15. Formimi i fjalëve me parashtesën xh- .....63
    - 3.1.16. Formimi i fjalëve me parashtesën z- .....63

3.1.17. Formimi i fjalëve me parashtesën zh-	63
3.1.2. Formimi i fjalëve me prejardhje prapashtesore	67
3.1.2.1. Formimi i fjalëve me prapashtesën –ac	67
3.1.2.2. Formimi i fjalëve me prapashtesën –acak	68
3.1.2.3. Formimi i fjalëve me prapashtesën –ak	68
3.1.2.4. Formimi i fjalëve me prapashtesën –an	69
3.1.2.5. Formimi i fjalëve me prapashtesën –ar, -ar (e)	69
3.1.2.6. Formimi i fjalëve me prapashtesën –as	70
3.1.2.7. Formimi i fjalëve me prapashtesën –ash	76
3.1.2.8. Formimi i fjalëve me prapashtesën –esh	76
3.1.2.9. Formimi i fjalëve me prapashtesën –ës	77
3.1.2.10. Formimi i fjalëve me prapashtesën –ësi	78
3.1.2.11. Formimi i fjalëve me prapashtesën –i	80
3.1.2.12. Formimi i fjalëve me prapashtesën –im	82
3.1.2.13. Formimi i fjalëve me prapashtesën –isht	88
3.1.2.14. Formimi i fjalëve me prapashtesat: –je	92
3.1.2.15. Formimi i fjalëve me prapashtesën –o	95
3.1.2.16. Formimi i fjalëve me prapashtesën –or, or(e)	100
3.1.2.17. Formimi i fjalëve me prapashtesën –osh	101
3.1.2.18. Formimi i fjalëve me prapashtesën –shëm	101
3.1.2.19. Formimi i fjalëve me prapashtesën –tar	115
3.1.2.20. Formimi i fjalëve me prapashtesën –th, –thi, -z,- z(ë)	118
3.1.2.21. Formimi i fjalëve me prapashtesën –s	120
3.1.3. Formimi i fjalëve me parashteso-prapashtesim	124
3.1.4. Problemi i sindajshtesave në gjuhësinë shqiptare	126
3.1.4.1. Formimet me sindajshtesën krye-	127
3.1.4.2. Formimet me sindajshtesën bashkë-	128
3.1.4.3. Formimet me sindajshtesën gjysmë-	129
3.1.4.4. Formimet me sindajshtesën drejt-	129
3.1.4.5. Formimet me sindajshtesën vetë-	130
3.1.5. Formimi i fjalëve me mënyrat e përziera	130
3.1.5.1. Formimi i fjalëve me kompozim dhe ndajshtesim	130
3.1.5.2. Formimi i fjalëve me nyjëzim dhe prapashtesim	133
3.1.5.3. Formimi i fjalëve me nyjëzim dhe përngjitje	137

## Kreu IV

4. Formimi i fjalëve të përbëra .....	139
4.1. Kompozitat emërore .....	139
4.1.1. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+emër prejfoljorë vepruesi .....	140
4.1.2. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+emër .....	141
4.1.3. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema ndajfolje+emër .....	143
4.1.4. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema folje+emër .....	144
4.2. Kompozitat mbiemërore .....	145
4.2.1. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+emër .....	145
4.2.2. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+mbiemër .....	146
4.2.3. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+emër prejfoljorë vepruesi .....	152
4.2.4. Formimi i fjalëve të përbëra nga emër+pjesore .....	153
4.2.5. Formimi i fjalëve të përbëra nga emër+ndajfolje .....	156
4.2.6. Formimi i fjalëve të përbëra nga numëror a përemër i pacaktuar+mbiemër .....	157
4.2.7. Formimi i fjalëve të përbëra nga pjesore+ndajfolje .....	158

## Kreu V

5. Formimi i fjalëve me përngjitje .....	161
5.1. Veçori të përgjithshme të fjalëve të përngjitura .....	161
5.1.1. Formimi i emrave .....	162
5.1.2. Formimi i përemrave .....	163
5.1.3. Formimi i ndajfoljeve .....	164
5.1.4. Formimi i lidhëzave .....	172

## Kreu VI

6. Ngjyresat ligjërimore në veprat e M.Camajt .....	174
6.1. Ngjyresat ligjërimore në fushë të leksikologjisë .....	175
6.2. Ngjyresat ligjërimore në fushë të morfologjisë .....	203
6.3. Ngjyresat ligjërimore në fushë të sintaksës .....	206

Kreu VII

7. Përfundime .....	228
Bibliografi .....	237
Fjalorë .....	240
Letërsi e vjelë .....	241

## HYRJJE

M. Camaj është një nga figurat e shquara të letërsisë shqiptare, i cili la pas vepra letrare, por edhe shkencore, pasi ai krahas shkrimtarisë është marrë edhe me gjuhësi.<sup>1</sup> Vëmendje më e madhe i është kushtuar veprës së gjerë letrare e plot larmi, ndërsa studime të mirëfillta gjuhësore e sidomos në rrafshin fjalëformues vetëm sa janë cekur pak. Për këtë arsye bashkë me udhëheqësin e temës Prof. dr. A. Haxhin menduam të thellohem kryesisht në lëmë të fjalëformimit, duke sjellë një kontribut sado modest e jo shterues në kuadër të formimit të fjalëve dhe ngjyresave ligjërimore tek krijimtaria letrare e Camajt.

*Arsyet pse u zgjodh kjo temë janë disa:*

1. *Së pari*, për vlerat gjuhësore që mbart vepra letrare e M. Camajt.
2. *Së dyti*, studime të mirëfillta gjuhësore e sidomos në rrafshin fjalëformues në krijimtarinë letrare të Camajt janë të pakta e ato vetëm sa janë prekur nga gjuhëtarë, si: K. Topalli,<sup>2</sup> T. Osmani,<sup>3</sup> V. Memishaj<sup>4</sup> etj. Ndërkohë, në vitin 1999, për tekstin gjuhësor dhe shprehësinë e tij është mbrojtur një tezë doktrate në Universitetin e Tiranës, nga prof. dr. T. Topalli.
3. *Së treti*, M. Camaj madje ai bëri përpjekje për krijimin e fjalëve të reja, mbështetur në mjetet fjalëformuese të shqipes.
4. *Së katërti*, vepra letrare e tij përfshin një pasuri të madhe leksikore, ku ai risolli fjalë të autorëve të vjetër e të arbërishtes, leksema të harruara ndër mote, gërshetoi fjalë të dialektit të gegërishtes me ato të standardit, të cilat gjuhëtari e shkrimtari i nxjerr me ngjyrimet stili në kontekstet e përdorura.

*Qëllimi* i punës sonë është të trajtohen dy çështje:

1. Sistemi fjalëformues në veprat letrare të Camajt, duke u përpjekur të veçojmë ato leksema që ka të ngjarë të jenë krijime të autorit.
2. Ngjyresat ligjërimore që krijohen si rezultat i përdorimit të një leksiku të pasur. Për të arritur këto qëllime janë shfrytëzuar një sërë fjalorësh të gjuhës shqipe, si:

---

1 "Il Messale" di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi"; "Fjalëformimi i shqipes. Mënyrat e formimit të emrave të vjetër."; "Albanian Grammar with Exercises. Chrestomathy and Glossaries"; "Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell'Italia meridional"; "Zhvillimet fonetike në Mal të Zi dhe në të folurat e Shqipërisë Veriore"; "Fjalët bjeshkë e vërrë" etj.

2 K. Topalli, *Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, Simpoziumi "Martin Camaj, Tradita dhe bashkohësia", Shkodër, 1994.

3 T. Osmani, *Çështje të leksikut dhe të fjalëformimit në faqet e një reviste*, në "Gjuha dhe shkrimtari", Shkodër, 2001.

4 V. Memishaj, *Martin Camaj dhe leksiku i munguar*, Studime për fjalën shqipe, Tiranë, 2011.

1. Fjalori i Shoqërisë “*Bashkimi*”,<sup>5</sup> 2. Fjalori i Gazullit,<sup>6</sup> 3. Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954,<sup>7</sup> 4. FGJSSH (1980),<sup>8</sup> 5. FGJSSH (2006)<sup>9</sup> e 6. Fjalori i gjuhës shqipe i M. Elezit.<sup>10</sup> Shpesh këto krahasime dalin përtej tyre, duke marrë në shqyrtim edhe leksikun e autorëve të vjetër.<sup>11</sup> Kemi vjelë leksema dhe fraza nga seria e veprave letrare të botuara në vitin 1996 dhe 2010. Për përgatitjen e kësaj teze doktrate janë shfrytëzuar literaturat e mundshme të botuara rreth kësaj problematike.

### *Metodologjia e ndjekur.*

Pasi kemi grumbulluar materialin në skedarë, leksemat janë klasifikuar sipas mënyrës së fjalëformimit. Më pas, secila prej tyre është analizuar sipas temës fjalëformuese. Jemi munduar që tek secili tip fjalëformimi të veçojmë ato fjalë që mund të jenë krijime të Camajt, duke bërë krahasime e përqaasje me fjalorët e mësipërm. Vlen të theksohet, që është e pamundur përcaktimi i origjinalitetit të fjalëve të krijuara nga Camaj. Në radhitjen e fjalëve, kemi listuar të parat ato leksema që ka mundësi të jenë krijime të autorit, më pas ato që janë të ngjyrosura stilistikisht, në fund përdorimet e trajtave dialektore e ato të standardit. Përveç kësaj, jemi ndalur edhe tek ngjyresat ligjërimore që përftohen në krijimtarinë letrare të autorit, si rezultat i pasqyrimin dhe shfrytëzimit të një leksiku të pasur.

Tek hyrja e punimit argumentohet qëllimi i përzgjedhjes së kësaj teme, objekti i saj dhe metodologjia e ndjekur.

Në kreun e parë flitet për figurën poliedrike të letrave shqipe M. Camajn, duke u ndalur tek jeta e krijimtaria letrare, ku vihet re gërshetimi i punës së shkrimtarit me atë të gjuhëtarit. Çështja e fundit e trajtuar në këtë kapitull janë vlerësimet e bëra për Camajn (duke u ndalur më tepër tek ato që vlerësojnë punën e tij si gjuhëtar.)

Kreu i dytë ka si qëllim një paraqitje të shkurtër të studimeve në fushë të fjalëformimit. Më pas kalohet tek metodologjia e ndjekur në trajtimin e sistemit fjalëformues në veprat e Camajt. Në këtë kre jemi ndalur tek formimi i fjalëve me prejardhje parashtesore. Denduri më të madhe përdorimi kemi ndeshur tek leksemat e formuara me anë të formantit *për-* e

5 *Fjaluer i Ri i Shqypes përbâam prei Shocniet t' Bashkimit*, Shkodër, 1908; Prishtinë, 1978.

6 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010.

7 *Fjalor i gjuhës shqipe*, GA, Tiranë, 1954.

8 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.

9 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

10 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.

11 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe* I, II, III, IV, USH, Shkodër, 1996, 1998, 2000, 2002.



pa-.

Mënyra më prodhimtare në gjuhën shqipe është formimi prapashtesor, dukuri që vihet re edhe në krijimtarinë e Camajt. Kjo mënyrë fjalëformimi është trajtuar tek kreu i tretë, ku vendin kryesor e zënë formimet me ndajshitesën *-shëm*, dukuri kjo dikur e gegërishtes, sot e mbarë shqipes. Tek Camaj ky formant shquhet për prodhimtarinë e mbiemrave dhe të ndajfoljeve. Në këtë kapitull janë trajtuar edhe mënyrat e përziera.

Kreu i katërt ka si objekt studimi një tjetër mënyrë fjalëformimi mjaft prodhimtare si në krijimtarinë letrare të Camajt, po ashtu edhe në mbarë shqipen: kompozimin, ku vihet re denduria e përdorimit e leksemave përcaktore. Fjalët e përbëra janë analizuar sipas temave fjalëformuese.

Një problem mjaft i rrahur në gjuhësinë shqiptare është edhe ai i sindajshitesave. Edhe tek Camaj kemi ndeshur fjalë të krijuara me këtë mënyrë fjalëformimi (ndonëse janë të pakta).

Duke kaluar nga njëra mënyrë fjalëformimi tek tjetra denduria e përdorimit bie, por vlen të theksohet që Camaj përpiqet të sjellë sadopak vulën e tij tek secili tip fjalëformues. Përngjitja si një lloj i veçantë në sistemin fjalëformues del e pasqyruar tek kreu i pestë, kryesisht me formimet emërore, përemërore, ndajfoljore e lidhëzore.

Ajo që e bën të veçantë Camajn, është përdorimi i një leksiku të pasur: shfrytëzimi i leksikut të autorëve të vjetër e të arbëreshëve, risjellja e fjalëve “plaka”, prurjet e shumta nga dialekti i gegërishtes e bëjnë shkrimtarin stilist të përkryer të fjalës shqipe.

Në krijimtarinë e tij shkrihen natyrshëm trajtat dialektore me ato të standardit, pasi Camaj është vlerësuar si shkrimtari e gjuhëtari që bëri përpjekje për një gegërishte standardizuese. Këto janë disa nga elementet janë shqyrtuar në kapitullin e gjashtë.

Përfundimet trajtohen në kreun e shtatë, çfarë ne arritëm gjatë kësaj pune: së pari, prirjen e Camajt për krijimin e fjalëve shqipe duke ndjekur të njëjtin sistem fjalëformues, me atë të shqipes standarde, së dyti, ngjyresat ligjërimore që krijoi ky mjeshtër i gjuhës.

Dua të shpreh mirënjohjen për udhëheqësin tim shkencor prof. dr. A. Haxhin, i cili më drejtoi për realizimin e kësaj teme disertacioni. Ai më orientoi drejt materialeve shkencore që më duheshin për realizimin e plotë të këtij punimi.

Falënderoj departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Historisë e Filologjisë në Tiranë, për mundësinë e ndjekjes së këtij programi studimesh dhe miratimin e kësaj teme doktorale. Një falënderim i veçantë shkon edhe për pedagogët e Universitetit të Tiranës për ndihmën e pakursyer dhe dashamirësinë ndaj kërkesave tona.

Dua të falënderoj përzemërsisht, gjithashtu punonjësit shkencor të Institutit Albanologjik të Shkodrës Prof. dr. T.Osmani dhe Prof. dr. T.Topalli për këshillat e orientimet në disa çështje të trajtuara në këtë tezë, si dhe dekanen e Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës, Prof. as. dr. Mimoza Priku, për këshillat profesionale, për shtysën dhe kurajon e dhënë për përfundimin e kësaj teme doktorale.



*Të dashtun miq e vëllazën Shqiptarë, intelektualë, artistë dhe mbarë populli shqiptarë, përshëndetjet e mija ju janë drejtue të gjithëve.*

*Gëzohem pa masë se keni vendosë të vlerësoni veprën time: ky vlerësim na afron.*

*Batë burrninë të më shtini në rreshtin tuej. Ndonëse të ndamë për një gjysmë shekulli, unë jam i jueji e ju jeni të mijt.*

**7 mars 1992**

**Martin Camaj**

## KREU I

### 1. FIGURA E MARTIN CAMAJT

#### 1.1. Martin Camaj, figurë poliedrike e letrave shqipe, jeta dhe vepra

M. Camaj, kjo figurë poliedrike e letrave shqipe, sa shkrimtar aq edhe gjuhëtar, hartues tekstesh për gjuhën shqipe, studiues e hulumtues i dialekteve arbëreshe të Italisë e më gjerë, zë një vend të veçantë në letërsinë bashkëkohore e në kulturën kombëtare shqiptare.

Ai është një nga figurat e shquara të letërsisë shqiptare, i cili la pas vepra me vlera të veçanta letrare, por edhe shkencore, pasi ai krahas shkrimtarisë është marrë edhe me gjuhësi. Ndonëse u largua nga Shqipëria qysh në moshë të re dhe gati gjithë jetën e kaloi në emigracion, ai e adhuronte këtë gjuhë me lirinë e bukuritë së saj. Martin Camaj siç është shprehur vetë, *ka qenë i dashuruar me gjuhën shqipe dhe shfrytëzoi në shkallën më të lartë e të mundshme cilësitë dhe pasuritë e saj shprehëse, mori me vete “memorien” e etnikumit të vet, mori onomastikën e Temalit të tij të paharrueshëm.*

Martin Camaj lindi me 21 korrik 1925 në Temal të Dukagjinit, në një zonë topografisht e gjeografisht të egër, rrethuar gjithandej me male të larta. Ai e përshkruan kështu vendlindjen e vet: *“Kam lindë në një vis të egër ‘ku s’ka shkel kurrë kamba e kalit’, kaq i thyeshëm ashtë ky vend”*.<sup>12</sup> Camaj mori edukatë klasike në Kolegjën Saveriane të Shkodrës, të drejtuar nga etërit jezuitë. Do të punojë si mësues në vitet 1946-1948, në zonën e thellë të Prekalit, derisa vendos të largohet njëherë e përgjithmonë nga dheu i të parëve, të cilin nuk ngurron ta kujtojë më vonë si *“bota e vjetër për mos me i thanë vendlindje”*.<sup>13</sup> Më pas do ta shohim në shkollën fillore “Mahmut Lekiq” në katundin shqiptar të Tuzit në Mal të Zi.<sup>14</sup> Mbas pak kohësh, për shkak të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, ai arratiset nga vendi për në Jugosllavi, ku ia del të regjistrohet si student në Universitetin e Beogradit. Atje studion italianistikë, romanistikë, teori letërsie, gjuhë klasike dhe sllavistikë, një botë e re kjo për një intelektual si ai, të edukuar në Shkodër. Largohet nga Jugosllavia në verën e vitit 1956. Shkon në Romë, ku ndjek rrethet letrare të këtij qyteti... Atje nën kujdesin e Koliqit bëhet kryeredaktor i revistës “Shêjzat”

12 B. Demiraj, *Jeta akademike e Martin Camajt*, në Konferencën Shkencore “Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu”, *Studime shqiptare 17*, Shkodër, 2011, f. 244.

13 Po aty. AMM: MCB 125: Camaj drejtuar A. N. Berishës (12.05.1985).

14 Po aty. Me rastin e festimit jubilar të 100-vjetorit, në dhjetor 2007, kjo shkollë e nderon Camajn (pas vdekjes) me diplomën e “Mirënjohjes” (dokumenti original - AFC).

(1957-1975) dhe eksploron së afërmi botën arbëreshe. Gjithsesi qëndrimi i Camajt në Romë dhe aktivizimi i tij si lektor pranë katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe nuk do të vijojë më gjatë se fundi i vitit 1960. Pasi po atë vit ai u ftua të linte Romën e miqtë e tij dhe shkon në Gjermani për të marrë përsipër lektoratin e gjuhës shqipe e të letërsisë shqiptare në Universitetin e Mynihut. Atje M. Camaj eci e përparoi dukshëm edhe më tej në karrierën e tij shkencore, dhe në vitin 1965 mbron në gjermanisht doktoratin me temë: "Fjalëformimi i shqipes. Mënyrat e formimit të emrave të vjetër."

Në vitin 1971, Camaj emërohet "Profesor" për albanologjinë në këtë universitet, duke përfaqësuar për një kohë të gjatë të vetmen degë mësimore dhe kërkimore albanologjike, ku ishte e mundur edhe mbrojtja e doktoratave nga fusha e studimit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë shqiptare. Synimi kryesor i Camajt ishte konsolidimi i degës si qendër e re studimesh shkencore-universitare. Për këtë qendër albanologjike pati interesim edhe nga albanologë të vendeve të ndryshme, të cilët erdhën të thellonin njohuritë e tyre ose të punonin pranë kësaj qendre, si: F. Altimari, G. Bevington, Z. Mirdita, A. Berisha, L. Mulaku etj., që të gjithë ithtarë e nxënës të Martin Camajt dhe që, pikërisht prej ndikimit të tij, do të bëheshin gjurmues e studiues të dalluar të shqipes së diasporës arbëreshe të Italisë. Në verën e vitit 1990 bursanti i dikurshëm shqiptar përfundon karrierën e tij akademike si profesor ordinar në një universitet evropian perëndimor, duke lënë pas një traditë të mirë universitare dhe një qendër të mirëfilltë të kërkimit shkencor në lëmin e albanologjisë.<sup>15</sup> Personaliteti dhe përgatitja e lartë shkencore e Martin Camajt i dha emër asaj katedre. "Albanologjia në Universitetin e Mynihut, thekson studiuesi Emil Lafe, u ngrit në nivelin e një specialisti të kompletuar dhe ky universitet ka qenë për mjaft kohë i vetmi në Evropën Perëndimore ku mund të fitoheshin tituj pasuniversitar në albanologji."

Bardhyl Demiraj, pasardhësi i Camajt në katedrën e Albanologjisë së Mynihut, dikur në varrimin e tij pati thënë se: "Camaj ishte një Akademi shqiptare në mërgim, një akademi alternative që mendohej të mbushte gjithë atë zbrazëti që linin mistifikimet, gënjeshtret dhe heshtjet e Akademisë së RPSSH dhe të krahinës Autonome të Kosovës. Këtë punë ai e pat nisur që në Romë me revistën "Shëjzat" që e drejtoi së bashku me Ernest Koliqin, një enciklopedi e vërtetë e botës shqiptare."<sup>16</sup>

15 B. Demiraj, *Jeta akademike e Martin Camajt*, në Konferencën Shkencore "Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu", *Studime shqiptare* 17, Shkodër, 2011, f. 254.

16 B. Demiraj, *Albanologjia dhe gjuha shqipe*, www.Forumishqiptar.com.

## 1.2. VENDI I M. CAMAJT NË LETËRSINË BASHKËKOHORE SHQIPTARE

Martin Camaj, është mjeshtër i shkrimit letrar, në poezi dhe prozë, në dramë dhe studime të ndryshme. Shkrimtari përpiqet që të eksplorojë me anë të fjalës së magjishme pothuajse të gjitha gjinitë letrare duke filluar me krijimet e para në poezi, për të vazhduar me prozën, bën përpjekje që të shkruajë një madrigale, e në fund kemi dramatikën.

Poezia e Camajt është e veçantë për stilin e ngjeshur e plot imagjinatë saqë të duket se ka marrë jetë nga traditat gojore të Dukagjinit, madje siç shprehet shkrimtari A. Pipa: “Ai ka guxuar të ‘sfitojë’ poetikën e së fundmes, karakteristikë e poezisë së mësuar, me poetikën e tij të së pafundmes, karakteristikë e poezisë gojore”.<sup>17</sup>

Në Veprën Letrare 3 në pasthënie të librit shkruhet: “Poezinë e Martin Camajt e karakterizon themeli i saj natyralist, ku kujtesa antike ndërthuret me ndodhitë e jetës së përditshme. Me vargjet e tij Martin Camaj na shfaqet si poeti shqiptar më evropian me rrënjët të ngulura thellë në kujtesën e një toke të pasur me mite e legjenda. Poezia e tij është një muzikë sugjestive e nëndheshme që ballafaqohet me modulet dhe mënyrat shprehëse të lirizmit evropian e perëndimor, pranë poetëve të mëdhenj të shekullit tonë.”<sup>18</sup>

Vëllimi i parë poetik i Camajt titullohet “Një fyell ndër male”, që e botoi në Prishtinë në vitin 1953 dhe shënon fillimin e paraqitjes së autorit në lëmin e poezisë. Në këtë vëllim ndjehet akoma e freskët brenga për dheun e braktisur, e ai vuan prej pamundësisë për ta parë dhe prekur edhe njëherë të vetme. Një vit më pas botoi përsëri në Prishtinë, në vitin 1954, vëllimin e dytë “Kanga e Vërrinit”. Sipas disa studiuesve kjo fazë e krijimtarisë së Camajt “la gjurmë në orientimin e traditës së re poetike ndër shqiptarët e Kosovës”. Camaj botoi në Romë më 1964 vëllimin “Legjenda” e më pas në vitin 1967 botoi në Mynih librin me poezi “Lirika mes dy moteve” që shënon njërin nga librat e fillimit të pjekurisë së krijimtarisë në lëvrimin e poezisë.<sup>19</sup> Po në këtë vit botoi vëllimin “Poezi” të shkruar gjatë periudhës 1953-1967. Në vitin 1978 botoi në Mynih vëllimin: “Njeriu më vete e me të tjerë”. Kemi edhe tekstet: “Nema”, “Buelli” e “Palimpsest” të cilat komunikojnë me poezinë bashkëkohore europiane.<sup>20</sup> B. Gjoka studiuesi i krijimtarisë letrare të Camajt, thekson se: “Teksti “Nema” ka në epiqendër nemën, padyshim si një vlerë shpirtërore, që e bart dhe e përçon poezia e kultivuar. Pjesa e dytë e këtij libri është “Buelli”. Kjo

17 A. Pipa, revista “Kritikë”, Tiranë, 1944.

18 M. Camaj, *Vepra Letrare 3*, (pasthënia) “Apollonia”, 1996, (Il Mattino, 11.4.91).

19 B. Gjoka, *Martin Camaj. Shkrimtaria e tij*, Tiranë, 2010, f. 155.

20 Po aty, f. 188.

shënon një nivel tjetër të shkrimit poetik, sepse bart një dyfishim të kumtit të poetit, më i ngjeshur poetikisht...Teknika e shkrimit hermetik të poezisë duket tek “Palimpsest” si një shkrim-mbishkrim.”<sup>21</sup> Camaj botoi një pjesë të vjershave të tij edhe në gjuhë të huaj, duke parapëlqyer botimet dygjuhëshe, si: “Poesie” (shqip-italisht, Palermo 1985); “Gedichte” - “Poezi” (shqip-gjermanisht, Mynih 1991). “Poezia e Camajt edhe pse e shkruar në mërgim dhe pa shumë shpresë për t’u lejuar të njihej prej bashkatdhetarëve të vet, pavarësisht prej prirjes për të shqiptuar dhimbje e përjetime të përbotshme, mbetet fund e krye poezi që i drejtohet gjithnjë lexuesit shqiptar si lexues i parë.”<sup>22</sup>

Personaliteti krijues i M. Camajt shfaqet në shkallë të lartë përkryerjeje në prozë. Rreth viteve 1956-1958 shkroi librin “Djella”, që përfaqëson njërin nga kryeveprat e Camajt për natyrën e gërshetimit të prozës e poezisë. Rreth këtij teksti, E. Koliqi shprehet: “Natyrisht edhe proza, shpesh, ndihet se asht mbarsue me poezi”<sup>23</sup>. Vlen të theksohet përpjekja që bëri Camaj në prozën poetike “Dranja” (Mynih 1981) në mënyrë që *gjuha t’i përshtatet lakueshëm çdo situatë*. “Dranja” është ndërtuar në një varg rrëfimesh, të cilat nuk kanë lidhje kushtëzuese me njëra-tjetrën, dhe mund të lexohen secila më vete. Shkrimtari A. Pipa për këtë vepër pohon: “Kjo është një ese për “Dranjen” e quajtur si vepra më origjinale dhe më përfaqësuese e poetit.”<sup>24</sup> Ndërsa A. Klosi, botuesi i një pjese të korpusit të veprës së shkrimtarit në Shqipëri, shënon faktin se *shqipja e Camajt në prozë është një muzikë e gjallë prej fillimi në fund (Dranja) është në të vërtetë një himn për mundësitë e gjuhës shqipe të veriut...*<sup>25</sup>

Camaj është edhe autor i pesë teksteve me novela të përfshira në vëllimin “Shkundullima”, botuar në Mynih 1981. Për të kuptuar magjinë e shkrimit të novelave prej tij, po sjellim edhe shënimin e shkrimtarit të hedhur në fillim të këtij cikli, ku ai pohon: “Pesë novelat e vëllimit “Shkundullima” janë zgjedhë prej shumë shkrimesh tjera të pabotueme simbas disa cilësish të përbashkëta, por edhe ndryshimesh...Ngjyra të përbashkëta janë kataklizmat natyrore, si **shkundullima** (tërmeti), **rrungaja** apo rrëzuesja e borës që trandin një vend, ashtu si dhe vdekja ose prania e saj: mbarë këto dukuni i ndërrojnë faqe dheut e shoqnisë.”<sup>26</sup>

Studiuesi Shaban Sinani në parathënie të vëllimit të tretë nënvizon: “Shkundullima” është një vepër ku pesë novelat i bashkon mbi të gjitha fakti që vendlindja është metonimi

21 Po aty, f. 193.

22 Sh. Sinani, Çështje të stilit në ligjërimin e Martin Camajt, në “Studime filologjike”, 1-2, 2007, f.32.

23 E. Koliqi, *Kritikë dhe Estetikë*, Apollonia, Fier, 1999, f. 140.

24 A. Pipa, *Poezia dhe poetika e Camajt*, në “Gazeta shqiptare”, 1 korrik 2012, f. 24-25.

25 M. Camaj, *Veptra letrare I*, Tiranë, 1996, f. 37.

26 M. Camaj, *Veptra letrare 4*, (parathënie), Tiranë, 1996, f. 5.

*e atdheut. Alternimi i mjedisit, prej ishujve etnografikë të Shqipërisë mbi Drin tek ishujt etnokulturorë në Italinë e Jugut, nga vendlindja te bota arbëreshe, është zgjidhje e qëllimshme e shkrimtarit për të kapërthyer Shqipërinë dhe shqiptarët nga skaji në skaj, por me një mbikalim elegant të emrit të saj.”<sup>27</sup>*

Në vitin 1987 Camaj botoi në Mynih romanin “Karpa”, aty mbizotërojnë ngjyresat fantastike të ikjes nga realiteti, madje për të mbërritur në një të ardhme që i kapërcen tre shekujt, në vitin 2338. Ndërsa romani “Rrathë” është ndërtuar si një triologji, në tri pjesë, secila me titull më vete: “Rrathë uji”, “Rrathë zjarmi”, “Rrathë gjaku”. Është e vetmja vepër ku shkrimtari i afrohet tërthorazi realitetit të kohës së re. Ky roman është padyshim një prej kryeveprave të Camajt, e përpunimi për 15 vjet, është një tregues i qartë i latimit të këtij teksti.

Pjesë me vlerë në krijimtarinë letrare të Camajt, është edhe dramaturgjia, përkatësisht me dramën “Loja e mbasdrekës” dhe “Kandili argjandit”. Në dramën “Loja e mbasdrekës” thelbi i saj është raporti mes ligjeve të pashkruara tradicionale, të kodifikuara në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe ligjeve të ndryshueshme të pushtetit. Kurse tek drama tjetër kemi paraqitjen e traumave të shkaktuara menjëherë pas ngritjes së qeverisë komuniste, përmes reformave shtetëzuese dhe shpronësuese.

### **1.3. GJUHËTARI DHE FILOLOGU, KONTRIBUTI I TIJ NË GJUHËN SHQIPE**

Kontributi gjuhësor i M. Camajt shtrihet në disa fusha, duke nisur me historinë e gjuhës, fokusuar kryesisht në studimin e autorëve të vjetër. Ndhimesë të veçantë në këtë fushë është studimi “Il Messale” di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi”, botuar në revistën “Shêjzat” (1960), i cili është një studim serioz dhe origjinal në drejtim të ndriçimit të problemeve themelore që paraqet për gjuhëtarët, filologët dhe studiuesit e historisë e letërsisë së shkruar shqipe libri i shkruar prej Gjon Buzukut (1555). Camaj zgjodhi si temë studimore “Mesharin” e Gjon Buzukut, pikërisht për mundësitë përfaqëse e krahasuese, si vepra e parë e dokumentuar me shkrim në gjuhën shqipe. Ky punim monografik përmban 90 faqe dhe është shkruar italisht. Aty autori ka trajtuar mjaft probleme drejtshkrimore, fonetike, morfologjike, leksikore të shqipes. Monografia mbyllet me përfundimet e tij, me pjesë nga “Meshari”, duke e krahasuar me Budin e

---

27 M. Camaj, *Vëllimi III* (Parathënie), Tiranë, 2010, f. 12.



Bogdanin dhe këngë popullore e rapsodi të Triepshit, të mbledhura me 1955, si dhe bibliografinë dhe treguesin e fjalëve.

Në vitin 1966 mbron në gjermanisht doktoratën me temë: "Fjalëformimi i shqipes. Mënyrat e formimit të emrave të vjetër."<sup>28</sup> Aty autori trajton disa probleme të fjalëformimit të shqipes, kryesisht në rrafshin diakronik. Monografia ndahet në tri pjesë: 1. Historia e kërkimit. 2. Fjalëformimi i brendshëm. 3. Fjalëformimi i jashtëm. Kjo monografi mbyllet me përfundimet, literaturën, treguesin e emrave. Monografia "Fjalëformimi shqip" ishte një hap i rëndësishëm përpara në fushën e studimeve historike gjuhësore të gjuhës shqipe. Ndhimesën e Camajt për fjalëformimin e shqipes e ka vlerësuar edhe I. Ajeti, i cili shprehet: "Zbërthimi a veçimi i materialit gjuhësor që Camaj e heton në veprën e tij të zënë ngoje paraqet punë shumë të vështirë, ajo kërkon njohje të thellë të problemeve të fonetikës historike të gjuhës shqipe, pastaj zotërimin e problematikës fonetike të gjuhëve indoevropiane, e këtu brenda edhe problemet e etimologjisë së gjuhës shqipe, me një fjalë, duhej të zotëroheshin problemet e gramatikës historike të shqipes."<sup>29</sup>

Studiuesi Herman Ölberg duke vlerësuar punimin e Camajt shkruan: "Kushdo që është i vetëdijshëm, që ky libër, në hapësirën gjermanishtfolëse, qysh prej vdekjes tragjike të Norbert Joklit, paraqet përsëri studimin e parë indoevropian të shqipes, do të marrë këtë vepër në dorë, me interesim të madh, duke parë se është një përpjekje për të çuar më tej fjetet e shkollës vjeneze, nga e cila ka dalë edhe E. Çabej." (Herman Ölberg, 1966)<sup>30</sup>

M. Camaj duke qenë lektor i shqipes dha ndihmesën e tij të çmueshme edhe në fushën e gramatikës, duke bërë botime të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, ku mund të përmendim, ndër të tjera: *Libri i mësimin të gjuhës shqipe në gjermanisht* (1969)<sup>31</sup>. Ky libër shërbeu si mjet ndihmës për përvetsimin e shqipes për studentët që mësonin gjuhën shqipe në Universitetin e Mynihut, por edhe për shqiptarët e diasporës, për arbëreshët e të gjithë të huajt që donin të mësonin shqipen. E për të vazhduar me "Albanian Grammar with Exercises. Chrestomathy and Glossaries", që është botuar në anglisht 1984, pra "Gramatika shqipe", me ushtrime, krestomaci dhe fjalor. M. Camaj gramatikën e ndan në tri pjesë: Fonologji, morfologji dhe sintaksë. Autori në këtë vepër përpiket të japë vlerat e veçanta dhe pasurinë që ka gjuha shqipe, ku pasqyron edhe tri variantet e shqipes

28 Albanische Wortbildung. Die Bildungsweise der wteren Nomina, Wiesbaden, 1966.

29 I. Ajeti, Martin Camaj, *Albanische Wortbildung. Die Bildungsweise der älteren Nomina, Vargu i edicionit: Albanische Forschungen, vëll. 6, Wiesbaden, 1966, - "Gjurmime albanologjike", Prishtinë, 1968, 1, f. 241.*

30 A. Haxhi, T. Topalli, *Leksikon. Gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë*, Fiorentia, Shkodër, 2012, f.116.

31 Lehrbuch der albanischen Sprache, 1969.

(gegërishten, toskërishten, arbërishten). Gramatika e Camajt ka në mbyllje një fjalorth shqip-anglisht prej më shumë se 2000 fjalësh dhe anglisht-shqip me mbi 1000 fjalë.

Me *Albanian Grammar* M. Camaj nxori në dritë një vepër monumentale, e cila për sa i përket konceptimit të saj si një metodë mësimore, përbën një risi të mirëfilltë. “Në kuadrin e përplasjeve dhe kontrasteve të pandërprera mbi shqipen standarde gramatika në fjalë mund të luajë në një farë mënyre një rol udhërrëfyes, për arsye se në të mishërohet botëkuptimi se “uniteti” i gjuhës shqipe - që në të shihet në dimensionin e saj historik, pra nga një pikënisje krejt e ndryshme nga ajo që niset normëzimi gjuhësor - nuk do të thotë eliminim i varieteteve, por zgjerim i njohurive mbi shumëllojshmërinë historike dhe dialektore të saj.”<sup>32</sup> Kjo gramatikë është konsideruar nga studiuesit si një ndër veprat më të rëndësishme në rrafshin gjuhësor “si një model për gegërishten letrare, por me prirje për afruese me toskërishten”.<sup>33</sup>

Pra, gjuha e Martin Camajt mund të shihet këtu edhe në një aspekt tjetër që është përpjekja për një kodifikim në lëmin e drejtshkrimit e të gramatikës. “Gjuha e Camajt, për nga drejtshkrimi e trajtat gramatikore, është një gegërishte letrare e kodifikuar me prirje afrimi ndër dialektor.”<sup>34</sup> Ndërsa Joakim Lankshi, një ish-student dhe përkthyes i veprave të Camajt, pohon: “Duhet theksue se lufta e Camajt për gegërishten nuk ishte një luftë qorre, për gegërishten e kohës së Fishtës. Camaj angazhohej për parimin jo të divergjencës, por të konvergencës së gegërishtes me “gjuhën e njësuar”.<sup>35</sup> Kurse studiuesi Sh. Sinani në parathënien e vëllimit të tretë shkruan “...themelues i një stili ligjërimi më vete, mbështetur mbi dialektin dhe me gjuhën letrare të njësuar si tentim; dialektore po, por as si gegërishtja tradicionale, as si ajo e autorëve shqiptarë të Kosovës, gegërishte po, por as si e shkollës jezuite, as si e shkollës françeskane; me prirje të dukshme drejt njësimi, por për shkak të njohjes së një realiteti, jo për ndonjë bindje të dukshme shkencore..”<sup>36</sup> Në lidhje më këtë problem vetë **Camaj** shprehet: “Besoj se tue ecë krahas gegërishtja e tosknishtja e shkrueme letrare, si dy motra të mira, pa ia pré rrugën njana-tjetrës, kanë vijue mâ me fryt të gjëjnë pikat e përbashkëta.”

Studiuesit A.Haxhi dhe T.Topalli mendojnë, se është edhe një tjetër vepër gjuhësore e panjohur, në dorëshkrim e M. Camajt është ajo me titull: “Fjalor i gjuhës shqipe per pilue

32 Walter Breu / Hans-Jürgen Sasse, *Vepra shkencore e Martin Camajt në fushën e gjuhësisë*, Hylli i dritës, Vjeti XXVIII, Nr. 3(258), Shkodër, 2008, f. 93.

33 T. Osmani, *Martin Camaj dhe gramatika e shqipes. Pikëpamje për gjuhën letrare shqipe*, në “Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor” 3, Shkodër, 2009, f. 240.

34 K. Topalli, *Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, Simpoziumi “Martin Camaj, Tradita dhe bashkohësia”, Shkodër, 1994, f. 88.

35 J. Lankshi, *Revista Mehr Licht!*, nr. 29, Tiranë, 2006.

36 M Camaj, *Vëllimi III*, Onufri, 2012, f. 8.

nga Kostandin Kristoforidhi me germa greqisht”, trasliterate në germa shqipe nga M. Camaj. Në faqen II, majtas, libri mban shënimin: *Këtë kopje ma fali transliteruesi me datë 29 korrik 1955, në Beograd. Pronë e Sitki Imamit, ish diplomat, shok dhe mik i autorit. Libri ka 638 faqe dhe një shtojcë me titull: Fjalët e huaja në shqip, prej 23 faqesh.*<sup>37</sup>

Martin Camaj është autor i disa monografive, studimeve, artikujve dhe i recensioneve të shumta për vepra gjuhësore me rëndësi. Vepra gjuhësore e tij dëshmon për studimin e thelluar që ai i bëri gjuhës shqipe, për njohjen e thellë që kishte ai për historinë e shqipes dhe dialektet e saj, po edhe erudicionin e madh si njeri i letrave dhe gjuhëtar me formim të sigurtë. Punimet e tij i përkasin fushave të ndryshme të shqipes, por më shumë ai u pykëzua në hulumtime rreth shqipes së moçme, kryesisht punime për gjuhën e shkruar dhe për historinë e gjuhës shqipe, si dhe për dialektologjinë e veçanërisht për të folmet e diasporës arbëreshe të Italisë. Ai hartoi monografi të plota për disa prej ngulimeve më interesante si: *Greçi në Avelino*<sup>38</sup> (Kjo monografi vlerësohet si një nga punimet më të mira dialektologjike të autorit dhe pa dyshim si njëra nga studimet më të rëndësishme prej pionieri në dialektologjinë arbëreshe.), *Shën-Kostandini Arbëresh në anët e Potencës*<sup>39</sup>, *“E folmja shqipe e Falkonarës në krahinën e Kozencës”*, studim i botuar në gjermanisht në vitin 1977, e sa e sa artikuj e studime për të folmet e veçanta botuar në organe të ndryshme.

Camaj ka bërë edhe disa vëzhgime me karakter sociolinguistik për çështje që lidhen me probleme të dygjuhësisë (bilinguizmi) arbërisht-italisht, diglosisë e shumëgjuhësisë (plurilinguizmi), duke iu referuar më shumë kontekstit gjuhësor arbëresh. (“Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell’Italia meridional”<sup>40</sup>, “Aspetti del plurilinguismo presso gli arbëresh d’America”<sup>41</sup>).

Përveç studimeve e monografive Martin Camaj ka botuar edhe një sërë artikujsh për problemet gjuhësore, të cilat janë kryesisht referime e kumtesa të mbajtura në konferenca shkencore në Evropë dhe në Amerikë. Këto punime me karakter gjuhësor të Camajt nuk i gjejmë vetëm në revistën “Shêjzat”<sup>42</sup> (Camaj me nismën dhe punën e Koliqit, për disa vjet

37 A. Haxhi, T. Topalli, *Leksikon. Gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë*, Fiorentia, Shkodër, 2012, f.119.

38 *La parlata Albanese di Greci in province di Avelino*, Firenze, 1971.

39 *La parlata arbëreshedi San Costantino Albanese in provincial di Potenza*, Calabria, Rende, 1991.

40 *Bilinguismo e diglosia in Italia*, Atti del Convengo del Centro Studi per la Dialektologia italiana, Pacini, Pisa, 1974, pp. 5-13.

41 “Zjarri”, 1986, pp. 18-20, 1989, pp. 36-47.

42 “Ndër fletët e “Nëntorit”, revistë letrare-artistike, shoqërore-politike nr. 8, Tiranë, 1957, nr. 3-4, f. 102-105.

“Nji shikim poezis së vjetit 1957 në Shqipni, 1958, f. 406-407.

“Tonin Miloti: “Zanusha”, poemë, Tiranë, 1958”, 1958, 9-10, f. 342.

radhazi, do të jetë “krahu i djathtë “ i Koliqit, madje shpejt ai do të bëhej dhe kryeredaktor i revistës “Shêjzat” (Le Plejadi), një nga organet më të sukseshme me karakter kulturor, shkencor dhe letrar që dilte në vitet ’60 në Itali.), por edhe në organe të tjera, si “Zjarri”, “Dielli”, “Südost-Forschungen” etj. Ja disa prej tyre: “Zhvillimet fonetike në Mal të Zi dhe në të folurat e Shqipërisë Veriore”<sup>43</sup>, “Çështje të pazgjidhura të shqipes” York 1990, “Fjalët bjeshkë e vërrri”, Boston, 1981, “Una frase in Arbëresh dell’anno 1483”, në “Zjarri”, 1979 etj.

Martin Camaj dha ndihmesën e tij edhe me një varg recencionesh, që ai ka shkruar për vepra të ndryshme gjuhësore të studiuesve dhe të dijetarëve, qofshin këta shqiptarë ose të huaj. Ai ka recensionuar punime të Idriz Ajetit, Karl Gurakuqit, Norbert Joklit, Karlo Tagliavinit, Antonio Guzzetës etj.

Me të drejtë Camaj është konsideruar “*në të gjithë këto vite një pikë e sigurtë referimi për të gjithë studiuesit e huaj të albanologjisë e intelektualët shqiptarë të diasporës*”<sup>44</sup>.

Si përfundim, mund të themi që Camaj dha një shembull të shkëlqyer të bashkimit të punës së shkrimtarit e gjuhëtarit krijues. “*Nga kjo anë, vepra e tij ka nevojë të studiohet, jo vetëm për mendimet, idetë e forcën e fjalës, por edhe në aspektin gjuhësor, për fjalët e reja që krijoi e për fjalët e vjetra që futi në përdorim, për shprehjet popullore që mblodhi e përdori apo i krijoi vetë, për ndërtimin e frazës etj.*”<sup>45</sup>

#### **1.4. VLERËSIMET E BËRA NGA STUDIUES DHE KRITIKË PËR M. CAMAJN**

Figura e M. Camajt si gjuhëtar dhe si shkrimtar do të vlerësohet pas shumë vitesh nga studiues të ndryshëm, pasi vepra e tij - si prurje gjuhe e veçantë - u njoh dhe u vu në kontakt me studimet shqiptare, jo gjatë krijimit të saj, por vetëm pasi ai e kishte mbyllur si cikël shkrimtarie.

*“M. Camaj, ky intelektual i formuar shkrimtar dhe gjuhëtar, albanolog, me dëshira të gjithanshme për të kontribuar në zhvillimin e kulturës shqiptare, radhitet në plejadën*

“Rreth prozës së sotshme në Shqipëri”, 1960, f. 291-299.

“Pikëpamje rreth periodizimit të letërsisë shqipe”, 1966, f. 265-272.etj.

43 Lautliche Parallelen Wicklungen in Mountenegricshen und nordalbanischen Mundarten, München, 1966.

44 F. Altimari, “Profilo bio-bibliografico di Martin Camaj, insigne figura dell’albanistica e della letteratura Albanese contemporanea”, *Albanica*, nr.2, 1991.

45 K. Topalli, *Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, Simpoziumi “Martin Camaj, Tradita dhe bashkohësia”, Shkodër, 1994, f. 90.

*më të zgjedhur të shkrimtarëve dhe të gjuhëtarëve tanë... Në veprën e tij është bashkuar njohja e thelluar e shqipes, me punën e tij prej gjuhëtari, që për cilësinë e thellësinë e saj, mund të krahasohet vetëm me atë të Çabejt,- shprehet gjuhëtari K. Topalli.”<sup>46</sup>*

Miku i tij E. Koliqi pohon: “*Edhe asht për t’u mrekullue s’pari dhe mandej për t’u gzue, tue pasun para sysh pasurimin motivesh e trajtash të letërsisë sonë, për mënyrën se si ky pinjuell malesh, sigurisht i pari i sojit të tij qi xen me shkrue e me këndue, din të harmonizojë në shkrime primitivitetin ruejtë në plotsin ma të pëlleshme me një zotnim të mjeteve ma të rafinueme t’artit letrar modern”*.<sup>47</sup>

Gjuhëtari V. Memisha e vlerëson veprën letrare të Camajt edhe për përmasën e vetë gjuhësore të spikatur, sepse ai pandërprerë u shqua për kërkim dhe krijim gjuhësor, duke u vetjakësuar me vlera e prurje të shumta.<sup>48</sup>

Në studimin monografik “Camaj i paskajuar”<sup>49</sup> studiuesi Sh. Sinani shpreh disa mendime lidhur me gjuhën e përdorur në krijimtarinë letrare të Camajt. Ai mendon, se:

1. Gjuha e njësuar shqipe është për të një stil ligjërimit i edukuar përmes shkollimit dhe leximeve, jo gjuhë e vetvetishme e katundit, familjes, gjinisë;
2. Gegërishtja, si njëri prej dialekteve formues të shqipes letrare, është e pamjaftueshme për të për t’u shprehur dhe për të mbajtur lidhjet me lexuesin; por dhe një përgjegjësi për të që ta trashëgojë si gjuhë amtare e si gjuhë letërsie;
3. Nuk identifikohen shenja të ndonjë ndikimi modelues të mënyrës së të menduarit dhe shqiptuarit të tij në letërsi prej një gjuhe tjetër, jo amtare, që i kishte gjuhë shkolle e pune (serbisht, italisht, gjermanisht);
4. Zgjedhja e autorit është mbështetje në dialektin e përvetësuar si gjuhë amtare, por jo deri në kufizim; një hap drejt gjuhës letrare, por pa shformime në psikologjinë e gjuhës shqipe prej ndikimeve të jashtme; përvetsime prej një dialekti tjetër të shqipes historike që ai njohu së afërmi si arbërishtja dhe prej leksikut të letërsisë së vjetër humaniste të klerikëve të veriut.

46 K. Topalli, *Vëpra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, Simpoziumi “Martin Camaj, Tradita dhe bashkohësia”, Shkodër, 1994, f. 85.

47 M. Camaj, *Vëpra letrare I*, Shtëpia botuese “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 139.

48 V. Memishaj, *Martin Camaj dhe leksiku i munguar*, në “Studime për fjalën shqipe”, Tiranë, 2011, f. 100.

49 Sh. Sinani, *Camaj i paskajuar. Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt*, Tiranë, 2011, f. 96.

Kurse B. Gjoka në veprën “ Martin Camaj shkrimtaria e tij”, nënvizon faktin se “të gjitha tekstet letrare/joletrare, gjuhësore/studimore të gjitha papërfundim i realizoi në dialektin e gegnishtes, por edhe me dromca të prekshme dhe leksik të rimarrë të arbërishtes, duke shënuar kështu të vetmin rast në letrat shqipe të periudhës bashkëkohore, që eci pandërprerje në ligjërimin letrar, si dhe në ligjëratat e ndryshme gjuhësore dhe studimore, vetëm në hullinë e ligjërimin të variantit letrar të gegnishtes, të çelur prej Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit etj...duke shënuar një rast unik dhe jetik”.<sup>50</sup>

---

50 B. Gjoka, *Martin Camaj shkrimtaria e tij*, Tiranë, 2010, f. 13.

## KREU II

### SISTEMI FJALËFORMUES NË GJUHËN SHQIPE

#### 2.1 STUDIMET KRYESORE NË FUSHË TË FJALËFORMIMIT TË SHQIPES

Studimet për fjalëformimin janë relativisht të hershme. Ato nisin kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore e zënë fill me J. G. Hahni me veprën “*Beitrage zu einer Grammatik des toskischen Dialektes. Albanesishe Studien.*”<sup>51</sup> Autori ka vënë në dukje formimet me prapashtesat *-es, -e, -shte* si dhe emrat me prapashtesat e zvoglimit e të përkëdhelisë: *-zë, -osh, -ec* p.sh.: *mbyllës, dorezë, djalosh* etj. Dh. Kamarda në veprën “*Saggio di gramatologia comparata sulla lingua Albanese*”,<sup>52</sup> trajtoi gjerësisht formimin e emrave me prapashtesat: *-as, -an, -ak, -im, -sina, -ore, -tar, -i, -si* etj. A. Dozoni<sup>53</sup> i ka kushtuar vëmendje të veçantë fjalëformimit të shqipes. Ai ka dhënë disa prapashtesa si: *-es, -ore, -im, -pe, -ar, -tar, -ak, -as* etj., duke treguar në disa raste kuptimin që mbartin ato e duke dhënë ndonjëherë edhe shndërrimin gramatikor që fiton fjala me prapashtesë. S. Frashëri në Gramatikën e tij<sup>54</sup> jep vetëm disa prapashtesa zvogëluese ose përkëdheljeje, si: *-th, -zë, -çe, -ko* etj. që u përkasin emrave si, p.sh. *birth, birko, birçe, zoçkë* etj. Gj. Pekmezi në veprën “*Grammatik des albanesische Sprache*”<sup>55</sup>, ka dhënë disa prapashtesa që shërbejnë për të formuar emra, si: *-tar, -ar, -or, -es, -ak, -ash* etj. p.sh.: *dhënës, demtar, rosak, besnik, bukurosh* etj. Edhe në “Gramatikën” e G. Weigandit 1913, një kapitull më vete zë formimi e emrave, ku ai bën një klasifikim semantik të tyre, e vë në dukje një numër të mirë të prapashtesave, si: *-as, -an, -i, -si, -ri, -ore, -tore* etj. si, p.sh.: *elbasanas, shkodran, urtësi, lepur* etj. N. Gazulli në Fjalorthin e tij<sup>56</sup>, jep rreth 60 prapashtesa e mbi 140 prapashtesa, si: *-i, -ti, -si, -shi, -mi, -tuer, -es, -as, -ak* etj. p.sh.: *dhandërr, tregti, popullsi, fjaluer, korrik, kafshatë* etj. Kurse K.Cipo tek “Gramatika Shqipe”, Tiranë 1949, analizoi disa prapashtesa, si: *ri-, stër-, mbi-, prapa-, para-* si : *rilindje, stërnip, parafjalë* etj. Gjithashtu ka trajtuar disa prapashtesa si : *- ishte, -ore, -im, -je, -tar, -ar, -as, -an, -sor*

51 J. G. Hahn, *Beitrage zu einer Grammatik des toskischen Dialektes. Albanesishe Studien*, Jena, 1854.

52 Dh. Camarda, *Saggio di gramatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864, f.157-168.

53 A. Doston, *Manuel de la langue shqipe an albanese*, Paris, 1879.

54 S. Frashëri, *Shkronjëto e gjuhës shqipe*, Bukuresht, 1886.

55 Gj. Pekmezi, *Grammatik des albanesische Sprache*, Wien, 1908.

56 N. Gazulli, *Fjalë të rralla të Veriut të Shqipnisë*, Tiranë, 1941.

etj. Studimi më i arrirë në fushën e fjalëformimit të shqipes është punimi i dy gjuhëtarëve A. Xhuvanit dhe E. Çabejt “*Parashtesat e gjuhës shqipe dhe prapashtesat e gjuhës shqipe*”, botuar për herë të parë në B.Sh.4.1956 dhe në “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme ” 1975, “*të parin studim që është hartuar deri më sot përreth parashtesave e prapashtesave të gjuhës shqipe*”<sup>57</sup>. Në parathënie të dy autorët shprehen: “*Ky proces nuk ka marrë fund, ai po vazhdon edhe sot e gjithë ditën. Ka raste ku shihet edhe sot se si disa fjalë si grup me përhapjen e formës së tyre po bëhen model për formim fjalësh të reja e kështu shkas për lindjen e një prapashtese të re.*”<sup>58</sup>

Parashtesat që ata dallojnë janë : *a-*, *kundër-*, *m(e) -*, *mi-*, *ri-* etj. Ndërsa prapashtesat na dalin në një numër më të madh, 168 të tilla, si : *- as*, *-acak*, *-ak*, *-ar*, *-as*, *-or*, *-ore*, *-at*, *-shte*, *-shti*, *-tar*, *-shti*, *-tar* etj.

Në vitin 1960 do të hartohet nga Sh. Demiraj teksti “*Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*” në dy pjesë. Në pjesën e parë, në kreun e emrit, autori ndalet tek emrat e prejardhur të formuar me anë të parashtesave: *stër-*, *nën-*, *mos-*, *pa-*, *mbi-*, *për-*; si edhe me anë të prapashtesave: *-ar*, *-as*, *-an*, *-ore*, *-i*, *-n*, *-si* etj. Një ndihmesë të veçantë kanë dhënë edhe tre vëllimet: “*Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe.*” (I, II, Tiranë, 1972, III, 1989), ku gjuhëtari A. Kostallari<sup>59</sup> ka shtjelluar me hollësi arsyet e fjalëformimit të mjeteve fjalëformuese të shqipes, ai shprehet, se: “*Janë gjallëruar kërkimet në fushën e formimit të fjalëve, ku krahas punimeve përgjithësuese mbi parashtesat e prapashtesat e shqipes, janë bërë studime të veçanta mbi derivacionin afiskal dhe mbi kompozitat e shqipes.*”<sup>60</sup>

Ndihmesë kanë dhënë gjuhëtarët F. Agalliu e E. Lafë, që në veprën “*Gramatikë e gjuhës shqipe*”,<sup>61</sup> kanë studiuar strukturat morfologjike e fjalës dhe mjaft probleme të formimeve me parashtesa dhe prapashtesa në shqipen e sotme. Studiuesi J. Thomai në veprën: “*Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*”, (Tiranë, 1989) bëri një studim të thelluar për prejardhjen e fjalës. Probleme të formimit të emrave janë trajtuar edhe nga gjuhëtari E. Hysa në librin “*Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*”.<sup>62</sup>

Ndërsa nga gramatikat e shqipes, të botuara nga të huaj dallohet ajo e Henri

57 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 421.

58 Po aty, f. 423.

59 A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria Shkencat shoqërore, 1962.

60 A. Kostallari, *Gjendja e studimeve albanologjike në Shqipëri. Probleme dhe detyra të reja*, në “Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 1965, f. 43.

61 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e Gjuhes shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002.

62 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.



Buasenit.<sup>63</sup> Autori ka parë në mënyrë të hollësishme prapashtesat, duke i shtjelluar sipas kriterit semantik. Ku dallon parashtesat: *mbi-*, *ndër-*, *pre-*, *ri-* siparashtesat: *auto-*, *filo-*, *gjeo-*, *hidro-* etj. Ndërsa prapashtesa dalloi: *-aje*, *-ore*, *-i*, *-ak*, *-es*, *-th*, *-me*, *-si*, *-ina* etj.

## 2.2. FJALËFORMIMI NË KRIJIMET E M. CAMAJT

Fjalëformimi në krijimtarinë e Camajt na paraqitet i larmishëm, kjo për vetë faktin, se Martin Camaj shquhej jo vetëm si një nga shkrimtarët e mëdhenj të letërsisë shqiptare, por edhe si një gjuhëtar i zoti. Me të drejtë studiuesi V. Memisha, shkruan: “*Vepra e M. Camajt ndër të tjera ka edhe përmasën e vetë gjuhësore të spikatur, sepse ai pandërprerë u shqua për kërkim e krijim gjuhësor, duke u vetjakësuar me vlera e prurje të shumta.*”<sup>64</sup>

Edhe më parë janë bërë përpjekje për t’u marrë me leksikun e fjalëformimitin e veprës së M. Camaj,<sup>65</sup> si: K. Topalli, T. Osmani, V. Memisha, K. Petriti, A. Klosi, A. Berisha etj., por puna në këtë lëmë është vetëm në fillesat e veta, prandaj në këtë punim doktrate jemi përqendruar kryesisht në disa çështje të fjalëformimit në krijimtarinë e Camajt, duke analizuar edhe nuancat ligjërimore që ka krijuar ky stilist i gjuhës.

“*Martin Camaj vepron me gjuhën në mënyrë gati të padukshme, ai arrin të gërshetojë atë që gjen në popull dhe në krijimtarinë paravajtëse të traditës letrare, në këtë rast veriperëndimore e pikërisht të Shkodrës*”<sup>66</sup>, por edhe krijon, hulumton çfarë mungon dhe sipas rastit, u drejtohet mjeteve fjalëformuese dhe i shton leksemat e ditura që ose mbajnë vulën e tij, ose janë të ngjyrosura stilistikisht prej tij.

Vepra letrare e Camajt ka një pasuri të madhe gjuhësore, të krijuar me mjete të shumta fjalëformuese. Kjo gjë provon njohjen e mirë të elementeve gjuhësore të shqipes, por edhe mundësitë e gjera fjalëformuese të saj. Shkrimtari e ka pasuruar ligjërimin e veprave të tij më shumë duke aktivizuar leksema nga gurra popullore, por edhe duke krijuar, saqë është i vështirë përcaktimi se çfarë ka krijuar vetë e çfarë ka marrë ai nga ligjërimet popullore. Në krijimtarinë letrare të Camajt dalin pothuajse të gjitha ato

63 H. Boissin, *Grammaire de l'albanias moderne*, 1975.

64 V. Memishaj, *Martin Camaj dhe leksiku i munguar*, në “Studime për fjalën shqipe”, Tiranë, 2011, f. 100.

65 Po aty. Veçojmë këtu T. Osmani, *Çështje të leksikut dhe të fjalëformimit në faqet e një reviste*, në “Gjuha dhe shkrimtari”, Shkodër, 2001; M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, por edhe K. Petriti, A. Klosi, Berisha etj., që janë marrë me studimin shkencor të veprës së tij letrare.

66 Po aty, A. Dodi, *Gjuha letrare shqipe përballë rreziqeve që e kërcënojnë*, në Letërsia shqipe dhe gjuha letrare, Prishtinë, 1998, f. 233. Autori pohon, se: “*pasuria gjuhësore e gegërishtes, leksiku, disa elemente të nënsistemeve të tjera, pas rivlerësimit të mjaft shkrimtarëve të shquar që kanë shkruar në gegërishte, duhet të zënë vend më të gjerë në gjuhën standard dhe të bëhet pasuri e përbashkët e shqipes*”.

ndajshitesa që njihen e që përdoren pa ngurrim gjithandej në ligjërimet e folura e në shkrimtarinë e sotme e të mëparshme, si: *për-*, *pa-* (parashtesat më të përdorura), *mos-*, *nën-*, *ndër-*, *para-*, *stër-* e më pak të përdorura *sh-*, *s-*, *zh-*, *ç-* e parashtesat e huaja *a-* e *dis-*, të cilat shkrimtari i ka tretur mirë në indin e veprave të tij e disa prej tyre kanë ngjyrimet të forta shprehëse - emocionuese.

Më poshtë po marrim në shqyrtim formime të tilla të vjela në veprat e Camajt, duke ndjekur disa kritere:

*Së pari*, ndajshitesat janë renditur sipas rendit alfabetik. Në fillim të çdo formimi kemi trajtuar ato leksema që kemi menduar, se ka të ngjarë të jenë krijime të Camajt.

*Së dyti*, për të vënë re përpjekjen e autorit për neologjizma, kemi bërë krahasimin e disa leksemave në fjalorë të ndryshëm. Për këtë qëllim çdo fjalë (që mendohet të jetë ndërtim i autorit) është krahasuar me këta fjalorë: 1. Fjalori i Shoqërisë “*Bashkimi*”; 2. Fjalori i Gazullit, *Fjalë të rralla të Veriut të Shqipnisë*; 3. Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954; 4. FGJSSH (1980); 5. FGJSSH (2006) e 6. Fjalori i M. Elezit. Shpesh këto krahasime dalin përtej tyre, duke marrë në shqyrtim edhe leksikon e autorëve të vjetër.<sup>67</sup>

“*Një pjesë e mirë e këtyre fjalëve s’kanë hyrë në fjalorin e shqipes së sotshme për arsye se trajta gege i ka vetëpërrjashtuar, një pjesë tjetër të madhe Camaj e njeh nga tradita letrare e gegnishtes, (çka tregon se hartuesit e fjalorit të shqipes së sotshme kanë lënë pa vjelur një pasuri të konsiderueshme siç e dëshmon ndër të tjerë edhe Fjalori Gjermanisht -Shqip i Amalie von Godin-it); ndërsa një pjesë tjetër padyshim e ka marrë me vete qysh nga fëminia dhe rinia e parë në Dukagjin dhe Shkodër,- shprehet studiuesi A. Klosi.*”<sup>68</sup>

*Së treti*, gjatë trajtimit të këtyre fjalëve sipas tipit të fjalëformimit, kemi pasqyruar aty ku është e nevojshme edhe nuancat stilistikore. Në glosat që paraqesin përftesa e nuanca ligjërimore të veçanta i janë bërë edhe shënime me karakter stilistikor.

67 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe* I, II, III, IV, USH, Shkodër, 1996, 1998, 2000, 2002.

68 M. Camaj, *Vepra letrare I*, Apollonia, Tiranë, 1996, f. 22.

## KREU III

### FORMIMI I FJALËVE ME PREJARDHJE FORMIMI PARASHTESORE. SINDAJSHTESAT

#### 3.1. FORMIMI I FJALËVE ME PREJARDHJE PARASHTESORE

Parashtesimi është një tip i veçantë i formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, por në krahasim me prapashtesimin ai zë një vend më të vogël. *“Parashtesimi dallohet nga prapashtesimi jo vetëm nga pikëpamja sasiore, po edhe nga pikëpamja cilësore, pasi parashtesim, në pjesën dërmuese të rasteve është neutral nga pikëpamja gramatikore, ndërsa prapashtesimi është i lidhur drejtpërdrejt me një formëzim të caktuar gramatikor.”*<sup>69</sup>

Në krijimtarinë letrare të Camajt fjalët me formim parashtesor janë më të kufizuara se ato me formim prapashtesor, dukuri kjo e mbarë shqipes. Autori ka përdorur një sërë ndajshtesash, si: *për-, pa-* (parashtesat më të përdorura), *mos-, nën-, ndër-, para-, stër- sh-, s-, zh-, ç-*, e më pak të përdorura parashtesat e huaja *a- e dis-*, për ndërtimin e leksemave emërore, mbiemërore e foljore.

##### 3.1.1. Formimi i fjalëve me parashtesën a-

Në krijimtarinë letrare të M. Camajt vëmë re pak elemente fjalëformuese të huaja, pasi, siç shprehet studiuesi Y. Çiraku: *“Ai kishte një dashuri të jashtëzakonshme për gjuhën shqipe. Ndjente dhimbje të madhe kur një fjalë e gjuhës shqipe zhdukej dhe zëvendësohej kot me një fjalë të huaj gjoja moderne. Martin Camaj e thoshte qartas dhe publikisht: “Kur vdes një fjalë në gjuhën shqipe vdes diçka në trupin tim”. Pra dashuria e tij për gjuhën shqipe ishte absolute.”*<sup>70</sup>

Por tendecat e futjes së këtyre elementeve në ligjërim nuk mungojnë edhe tek ai.

*“Parashtesa a- në gjuhën e shkrimit ka hyrë me burim prej greqishtes, me funksion privativ, në fjalë të marra gati së jashtmi, si: afazi, apolitik, ateist, ateizëm.”*<sup>71</sup>

Në materialin që kemi vjelë tek veprat e Camajt kjo prapashtesë nuk rezulton

69 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 40.

70 Y. Çiraku, *Martin Camaj si përcjellës dhe krijues i një tradite*, në “Shqyrtime kritike nga historia e letërsisë shqipe”, Tiranë 2011, f. 121.

71 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, fq. 366.

produktive, atë e kemi ndeshur kryesisht në fjalët, si: *ateistë, amoralë*.

**ateist** (...*lutu për pabestarët, për ateistët...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1966, f. 84).

Në këtë rast leksema me parashtesën *a-* ndihmon në përftimin e sinonimisë kontesktuale.

**amoral** (...*kjo që thoni ju ashtë amoralë...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1966, f. 108).

Ndajshitesa *a-* i jep fjalë së dhënë kuptim antonimik.

### 3.1.2. Formimi i fjalëve me parashtesën ç-

“Ndajshitesa **ç-** përdoret para zanoreve dhe bashtingëlloreve sonante *-l, -m, -n, -r, -rr*. *Kjo ndajshitesë na del përpara më shumë si një variant dialektorë e shpeshherë ekspresiv i sh-së.*”<sup>72</sup> Studiuesit shqiptarë mendojnë, se “*me anë të kësaj parashtese nga tema zakonisht foljore, janë krijuar folje të prejardhura me kuptim të kundërt me atë të temës fjalëformuese*”.<sup>73</sup> Një veçori e punës së këtij shkrimtari është edhe përdorimi i disa trajtave. Pasi dihet që “*parashtesa ç- për arsye fonetike alternohet me sh- e zh- dhe përdoren kështu në tri variante sipas kriterit drejtshkrimor*”.<sup>74</sup> Kjo ndajshitesë na del e përdorur në leksemat: *e çkujdesshme, çlirohet, çthurje, çrranjos* etj.

**çliroj** (...*mund të çlirohet ma lehtë nga parandija e ogurit të zi...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 98).

**çthurje** (...*acarohet në vete gjithashtu hutohet me orë e orë ndër thurje e çthurje ngjarjesh...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 70).

Një veçori e gjuhës së Camajt është edhe ndërtimi i çifteve antonimike, për rritjen e shprehësisë. Në këtë kontekst autori ka përdorur variantin dialektor, pasi në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 kemi trajtën: *shthurje*.

**çrranjos** (...*që don çrranjosë fare...*) (“Loja e mbasdrekës”, *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f.57).

### 3.1.3. Formimi i fjalëve me parashtesën dis-

*Ndajshitesa dis-*, edhe kjo ka një përdorim të kufizuar. Me anë të kësaj parashtese formohen emra nga tema fjalëformuese emërore, me kuptim antonimik, si:

**disharmoni** (...*prej harmonisë apo disharmonisë së ngjyrave të teshave, apo rreshtimit*

72 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 368.

73 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 350.

74 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 62-73.

*të çaklave tek vetja që kishte përballë, nxirrte sheje për të zbulue zejen e tyne ...)*  
("Gjon Gazulli", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 268).

Parashtesa *dis-* ndihmon për të krijuar antoniminë, si një figurë me forcë të madhe shprehëse.

#### **3.1.4. Formimi i fjalëve me parashtesën lë-**

**Parashtesa lë-** zakonisht mund të bashkohet me rrënjë të lira (*lëvar/ var*) apo edhe me rrënjë të lidhura, si *lëkund* (-*kund krahas. shkund*). Studiuesit janë shprehur se sidomos tek folja kjo parashtesë "*modifikon kuptimisht temën fjalëformuese, për të treguar pakësim ose lehtësim të veprimi*"<sup>75</sup> Këtë ndajshitesë e kemi ndeshur në ndërtimin: *lëverdhet*, si p.sh.:

**lëverdhet** (...në tjetrën mbi det **lëverdhet** reja e shprishun si dromëza kulloshtre...) ("Dranja", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 16).

#### **3.1.5. Formimi i fjalëve me parashtesën mbas-**

"**Parashtesa mbas-** është produktive në gjuhën popullore, kurse në atë të shkrimit është e rrallë. Kjo ndajshitesë tregon idenë e një gjëje, të një kohe a të një veprimi që gjindet a që ndodh pas një tjetri."<sup>76</sup> Ndërtimet me ndajshitesën mbas- janë tepër të pakta në krijimtarinë e Camajt, atë e gjejmë të përdorur tek leksemat: *mbasdarke, mbasdore*, në standard kemi fjalët: *pasdarke e pasdore*.

**mbasdarke** (...shtinte kajzit e pishës në zjarm, *mbasdarke*...) ("Pishtarët e natës", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 47).

**mbasdore** (...i lanun fare *mbasdore* prej trashëguesvet...) ("Shkundullima", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 99).

#### **3.1.6. Formimi i fjalëve me parashtesën mos-**

Në lidhje me këtë formant janë hedhur mendime të ndryshme nga gjuhëtarët: Xhuvani - Çabej, M. Samara e E. Hysa.

"**Ndajshitesa mos-**, theksojnë Xhuvani e Çabej,- *ka kuptim privativ ashtu si parashtesa pa-*, por ajo është e rrallë në gjuhën popullore. Në gjuhën e shkrimit kjo parashtesë është bërë shumë produktive, duke modifikuar disi funksionin e saj në *krahasim me atë të gjuhës popullore*."<sup>77</sup>

Studiuesi M. Samara, pohon se "*fjalët antonimike me këtë parashtesë shënojnë*

75 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008, f. 160.

76 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në "Vepra I", Tiranë, 1980, f. 395.

77 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në "Vepra I", Tiranë, 1980, fq. 386.

*zakonisht mungesën e realizimit të procesit të veprimit ose mungesën e rezultatit të veprimit, të shënuar nga tema fjalëformuese (pa parashtesë), e cila në këtë rast përputhet me fjalën përgjegjëse antonimike”.*<sup>78</sup>

Ndërsa E. Hysa, shpreh këtë mendim për parashtesën **mos-**: “*Parashtesa mos- u paravihet zakonisht emrave prejfoljorë të veprimit të prejardhur ose të përbërë nga prapashtesa -im ose -je dhe u jep një kuptim të kundërt. Ky tip fjalëformimi është më fort i gjuhës letrare të shkruar, në stilin e letërsisë politike, shoqërore dhe shkencore. Në gjuhën e folur e sidomos në gjuhën e popullit ajo del përgjithësisht më rrallë.*”<sup>79</sup> Sipas gjuhëtarit V. Memishaj, i cili ka studiuar formimet me këtë ndajshesë kryesisht në shqipen standarde shprehet, se: “*Grupi i emrave me mos-nuk është veçori e gjuhës së folur, por asaj së shkruar. Këtë e tregon edhe lënda leksikore që pasqyrohet në fjalorët e shumtë dialektorë të botuar këta 70-80 vjetët e fundit*”.<sup>80</sup>

Në krijimtarinë e Camajt, kjo ndajshesë nuk paraqitet prodhimtare, atë e kemi ndeshur në ndërtimet, si p.sh.: *mosbesim, moskuptim, mospërfillje, mospërdorim, mospranim etj.* Fjalë të tilla me këtë parashtesë, semantikisht kanë një kuptim sintetizues, karakteristik në letërsinë artistike, përkundrajt të shprehurit me perifraza p.sh. *moskuptim/* “mungesë të kuptuari” apo *mosbesim /* ”mungesë besimi” etj.

**moskuptim** (...*mori me u acarue për moskuptimin tim...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f.124).

Në këtë shembull Camaj e ka shfrytëzuar parashtesën për nuanca fonostilistikore duke i dhënë asaj përveç kuptimit mohues edhe vlerë intensive.

**mospërfillje** (...*për të huajin ato fjalë qenë prapim, mospërfillje...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 246).

Këtu ndërtimi me ndajshesë ka ndihmuar në formimin e një shkallëzimi në rritje. (...*nisi të shfaqë mospërfillje...*) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 247); (...*nga kjo rrethanë zë fill ma së pari edhe mospërfillja e bashkëkohësve të tij...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 264).

**mosbesim** (...*të mos shikojnë ma me mosbesim...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 108).

“*Parashtesa mos- bashkohet kryesisht me tema fjalëformuese emërore e mjaft rrallë*

78 M. Samara, *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1985, f. 113.

79 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshesë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 82.

80 V. Memishaj, *Emrat me parashtesën mos- në shqipen standarde*, në “Studime për fjalën shqipe”, Tiranë, 2011, f.73.

me disa tema mbiemërore. Me pjesë të tjera të ligjëratës ajo nuk bashkohet.”<sup>81</sup> Camaj përpiqet të krijojë fjalë të reja duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes. Ai ia paravendos këtë parashtesë një teme ndajfoljore për qëllime stilistikore.

**mosbesueshëm** (...”Hëh!” Bani Loshi **mosbesueshëm**, tue shtrydhë gishtat mbrenda dorashkave...) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 202).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006, kemi të listëzuara këto përdorime, si: mosbesim (si emër); i besueshëm: njeri i besueshëm, mosbesues: shikim mosbesues (si mbiemra), ndërsa tek Fjalori i M. Elezit del e dhënë trajta ndajfoljore: besueshëm: foli besueshëm. Leksema *mosbesueshëm*, nuk del e pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim e mund të jetë krijim i autorit. Ky ndërtim mbart jo vetëm sintetizim, por shërben për të dhënë edhe nuanca të veshura me ngjyrim emocional.

### 3.1.7. Formimi i fjalëve me parashtesën nën-

“Parashtesa nën- është me origjinë parafjalore. Ndërtimet me anë të kësaj ndajshqiptese nuk janë shumë të gjalla në gjuhën e folur popullore, por kanë filluar të bëhen prodhuese në gjuhën e shkrimit sipas gjedheve së gjuhëve të huaja, si: nëndetse, nëndrejtor etj. Këto ndërtime kanë kuptime a funksione të kundërta dhe luajnë rolin kryesor për kundërvënien e kuptimeve të fjalëve përkatëse me temë të njëjtë. Ato mund të formojnë fjalë antonime folje, emra e mbiemra.”<sup>82</sup>

Kjo parashtesë tek krijimtaria e Camajt del e pasqyruar në pak ndërtime, si p.sh.: nënkryetar, nënvetëdije etj.<sup>83</sup>

### 3.1.8. Formimi i fjalëve me parashtesën pa-

“Lidhur me etimologjinë e elementit pa- në funksion parashtese A. Xhuvani - E. Çabej kanë vënë në dukje që kjo lidhet me sanskritishten *apa* e me greqishten *άπο*, latinishten *po-* në *positus*. Në këtë mënyrë ajo del si autoktone shqipe, e krahasueshme me parashtesën që ka të njëjtën rrënjë e të njëjtin funksion në gjuhët motra indoevropiane. Kjo parashtesë ndeshet e përdorur në disa fjalë të gjuhës popullore, kurse në gjuhë të shkrimit është bërë produktive, duke iu ngjitur emrave, mbiemrave, ndajfoljeve. Me folje parashtesa pa- nuk bashkohet, përveç ndonjë rase të veçantë.”<sup>84</sup>

81 E. Hysa, *Parashtesat me kuptim mohues në gjuhën shqipe*, në “Studime filologjike”, Viti XXXI (XV), nr. 4, Tiranë, 1997, f. 121.

82 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, fq. 390.

83 (...në **nënvëtdije** ndalej...Shkundullima, f. 103); (...për t’iu shmangë **nënkuptimit** të pangjashëm...Shkundullima, f.133).

84 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, fq. 392.

a) Parashitesa **pa-** vendoset zakonisht para *temave emërore të parme*, duke i dhënë fjalës kuptim mohues. “Ky lloj formimi është karakteristik për gjuhën popullore”.<sup>85</sup> Gjuhëtarët Xhuvani e Çabej për këtë mënyrë fjalëformimi shprehen, se: “*Fjalët e këtij tipi përdoren rregullisht në trajtë të shquar të prirë zakonisht nga një parafjalë.*”<sup>86</sup> Në krijimtarinë e Camajt vihet re ndërtimi: **pakujdes** që është në trajtën e pashquar e mund të jenë ndikim nga të folurit e gjallë.

**pakujdes** (...*nuk qenkej faji i tij që shtëpia e etënve kishte shkue në atë gradë për pakujdes...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 99).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 e 2006 kemi përdorimet emërore, si: *pakujdesi, -a*, e si mbiemër: *i pakujdes, i pakujdesshëm*.

b) Ndajshitesa **pa-** bashkohet edhe me *tema emërore të prejardhura me prapashtesat -i, -(ë)ri, -(ë)ni* (si variant dialektor), *-(ë)si* duke na dhënë emra, si: *panjerëzi, paurti, paburrni, pafajni, pafajsi, paturpësi, padrejtësi etj.*

**panjerëzi** (...*Anmik i Lekës, anmik i Shtjefnit! Pse nuk ka ardhë me u afrue e ma na thanë një fjalë për krye shëndosh? Panjerëzi i thonë kësaj! Apo ka ardhë me pa çudi me sy...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 95).

Tek Fjalori i gjuhës shqipe të vitit 1954 kemi të listëzuara përdorimet, si: mbiemër: *i panjerëzishëm e i panjerëzi*, në Fjalorin e 1980 e 2006 kemi të zgjeruar këtë çerdhe fjalëformuese edhe me ndajfoljen: *panjerzisht*. Kjo leksemë mund të ekzistojë në ligjërimin e vendlindjes së shkrimtarit.

**paurti** (...*iu duk paurti t’ia lëndojë plakut e vetes varrën e vjetër...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 225).

**paburrni** (...*qenkej paburrni të spiunojë të jatin...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 33).

**pafajni** (...*kujtova se kisha humbë edhe unë diçka, pafajninë* e një poeti naiv...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f.132).

Një leksemë e tillë del e përdorur edhe tek shkrimtari Gj. Fishta.<sup>87</sup>

**pafajsi** (...*me petkun e pafajsisë* në shtat...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 84).

Camaj arrin të përdorë në kontekste të ndryshme leksema sinonimike (pafajni-pafajsi), të cilat marrin vlerë brenda atij konteksti.

85 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 80.

86 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, fq. 393.

87 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f.1040. “...nji fjalë të vetme për pafajni...” (Gj. Fishta, *Vepra letrare*, 9).



**pazotasi** (...ka shkrintarë që kujtohen për këtë **pazotasi** mbas shtrimjes në letër të faqeve të para...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 86).

Fjalori i vitit 1954 e FGJSSH (2006) pasqyrohen ndërtimet: ef. *pazotësi-a*, mb. *pazoti (i)*, *pazonja (e)*.

**paturpësi** (...tue u zgërdhi me **paturpësi**...) (“Rrungaaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 63).

**padrejtësi** (...bota e mitit ngjan të jetë një model se si duhet të jetë jeta e vërtetë ku flitet *haptas për të drejtën e padrejtësinë* ...) (“Palimspesht”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.178).

Në krijimtarinë e Camajt jo rrallë gjejmë të përdorura çiftet antonimike, të cilat i shërbejnë autorit për të dhënë më qartë, më plotë dhe më intensive thënien.

\* Një fjalë që ka paraqitur interes është : **pabestar** - ët. Leksemën bestar si fjalë arkaike e kemi të pasqyruar që tek Kanuni i Skënderbeut,<sup>88</sup> e më pas në fjalorët e tjerë. Ndërtimin me parashtesën pa- nuk e kemi të dhënë në fjalorët e marrë për krahasim e ka të ngjarë të jetë formim i autorit.

**pabestar** (...Ti, Dorë, me petkun e pafajsisë në shtatat, lutu për **pabestarët**, për ateistët, për skeptikët!...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 84).

Shkrimtari përpiket të rikrijojë ndërgjegjshëm gjuhën “e vjetëruar” për efekte stilistikore. Brenda një konteksti të ngushtë autori arrin të gërshetojë elemente të traditës, me elemente të huaja, me qëllim që mendimi të jetë më i ngarkuar.

c) Tek veprat letrare të autorit kemi ndeshur raste të pakta të ndërtimit të emrave me temë fjalëformuese një emër të formuar me *prapashtesat -im ose -je*. Veçojmë leksemat: **papajtim**, **papërndalje**, **palëvizja** të cilat i gjejmë të pasqyruara në fjalorë të formimit me parashtesën mos-: *mospapajtim*, *moslëvizje*, pasi dihet, se: “Është pranuar si normë krijimi i emrave me kuptim antonimik me anë të parashtesës mos- nga emra të formuar me ndajshtesa (*prapashtesa*) -im e -je, që në shqipen bashkëkohore janë vepruese dhe tepër prodhimtare.”<sup>89</sup>

Ka të ngjarë që këto leksema të jenë krijime të Camajt duke u mbështetur në traditën popullore.

**papajtim** (...edhe unë, për shembull, e kam fitue tepër vonë vetëdijen e një fshehtësie të tillë, **papajtimin** e zanit me shenjat apo çka janë shkrojat e një libri të lashtë që në të vërtetë e përjetësojnë zanin e shuem para sa e sa shekujsh...) (“Palimspesht”, në

88 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 196. “ (Bestarët) mbeten dorxanë të shtëpisë së vramit deri në ditën e fundit të kuvendit (besës)” (Kanuni i Skanderbegut).

89 *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976, f. 206.

*Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.178).

Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954 e FGJSSH (2006) ka të pasqyruar përdorimet: i *papajtueshëm* - e *papajtueshme*. Kjo parashtesë në disa raste është analoge me parashtesën mos-, pasi në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006<sup>90</sup> kemi lemën: *mospajtim*.

Camaj e ka ndërtuar këtë leksemë, jo se nuk e njeh gjedhin fjalëformues të shqipes, por shpesh për të thyer korniza, ose për të shprehur efekte emocionale, ai përpiket të krijojë forma të reja fjalësh duke shfrytëzuar mjetet e saj.

**papërndalje** (...*fuqia vepruese e tij zgjohej e nganjëherë kalonte edhe në papërndalje e agresivitet...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 131).

Në fjalorët e marrë për krahasim ne kemi të pasqyruar ndërtimet: *ndal*, *ndalje*, kurse këtë leksemë nuk e kemi të dhënë. Camaj diti të përdorë me mjeshtri fjalët e gjuhës amtare, ai arriti të krijojë fjalë të reja që e pasurojnë shqipen me njësi leksikore e semantike. Ndërtimit *ndalje* duke i shtuar parashtesën *për-* ia përfocojmë më tepër kuptimin, ndërsa mbivendosja e parashtesës *pa-* i jep fjalës kuptim antonimik. Gjithashtu Camaj arriti të ndërtojë edhe mbiemrin: *i papërndalshëm*, i cili përfshihet tek mënyrat e përziera, por do të pasqyrohet këtu për të vërtetuar edhe një herë aftësinë krijuese të autorit.

**i papërndalshëm** (...*ndjekë nga malli i papërndalshëm për ajrin e naltësive...*) (“*Karpa*”, Romë, 1978, f. 80)

**palëvizja** (...*palëvizja ishte rranjosë aq thellë në miset e fytyrave e deri në palcën e eshtrave...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 94).

Shkrimtarët shpesh për të krijuar neologjizma, ose për të krijuar efekte stilistikore ndërtojnë fjalë që bien ndesh me normën. Një dukuri e tillë ka ndodhur edhe tek kjo leksemë, pasi Camaj parapëlqen ndërtimin me ndajshitesën *pa-*, pasi në gjuhën letrare ne kemi ndërtimin *moslëvizje*.

ç) Parashtesa *pa-* bashkohet dendur me ***mbiemra*** të parmë. Nga temat e parme mbiemërore: *i keq*, *i qartë*, *i bukur*, *i drejtë* kemi ndërtimet: *i pakeq*, *e paqartë*, *e pabukur*, *e padrejtë*, duam të veçojmë ndërtimin ***i pakeq*** që s’del i pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim, por M. Elezi shprehet, se *një ndërtim i tillë haset i përdorur kryesisht nga Camaj*<sup>91</sup> e mund të jetë një krijim i autorit.

**i pakeq** (...*kërkonte me mende të vet arsytën e gazit të pakeq...*) (“Shkundullima”, në

90 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 645.

91 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1043.

*Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 129); (...qe, tash rrin në fund të shtratit dhe më vëren me atë shprehje **të pakeq** dhe me sy femne së pjekun...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 92); (...Daku në atë rast, sigurisht, s’do të kishte marrë asnjë fjalë për gaz **të pakeq**; do të ishte ngatërrue me njerëz...) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 193).

Puna e shkrimtarit bashkohet shpeshherë me atë të gjuhëtarit, krijimi i mbiemrit *i pakeq*, merr vlerën e një epiteti metaforik kur përdoret nga dora e stilistit. Kjo është një përftesë e rrallë në gjuhën shqipe, e cila shërben për të dhënë një gjendje të caktuar psikologjike të personazhit.

Tek Camajt shkrihen natyrshëm trajtat dialektore me ato të standardit, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën, si p.sh.:

**e paqartë** (...atyne skajeve **të paqarta**...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 137); **e pabukur** (...s’i dukej gja **e pabukur**...) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 190); (...kur i tingëlloi si lojë **e pabukur** thirrja e grues...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 248); **e padrejtë** (...sa **e padrejta** i ashtë ba burrit tim...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 11) etj.  
d) “Kjo ndajshitesë, - pohon gjuhëtari E. Hysa, - bashkohet edhe me mbiemra të formuar nga nyjzëzimi i pjesores. Ajo formon kështu një mbiemër të ri me kuptim mohues.”<sup>92</sup>

Autori arriti të shpalosë aftësinë e tij krijuese në mjaft fjalë të reja të krijuara prej tij sipas gjedheve të shqipes. Pasi, siç shprehet gjuhëtari Xh. Lloshi: “Shkrimtarët kanë ndjeshmëri ndaj mundësive potenciale të sistemit të gjuhës, ndaj së resë në gjuhë dhe e mishërojnë atë në krijimtari.”<sup>93</sup> Edhe Camaj e pasuroi gjuhën e veprave të veta me ndërtimin e çifte antonimike, si: ***i thirrun- e pathirrun, i grishun - i pagrishun***, të cilat janë trajta dialektore të sjella nga shkrimtari për qëllime stilistikore.

**i pathirrun** (...sosja e tij zgjoi te të gjithë, njoftë e panjofhtë, kureshtinë ta shihnin edhe një herë, sadopak për së vdekuni, mbasi gjallë nuk u kishte takue ta ndeshnin, andej rrodhën në drekët e malësorit ***i thirrun e pathirrun***...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 87).

Në Fjalorin e vitit 1954 e FGjSSH (2006) kemi të shënuar këto lema: *thërras, thirrun, thirrje dhe e thirrura*. Ndërtimin me parashtesën pa- nuk e kemi të pasqyruar

92 E. Hysa, *Parashtesat me kuptim mohues në gjuhën shqipe*, në “Studime filologjike”, Viti XXXI (XV), nr. 4, Tiranë, 1997, f. 107.

93 Xh. Lloshi, *Tipare të sistemit stilistik në gjuhën e sotme shqipe*, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, Tiranë, 1988, f. 180-181.

në fjalorët e marrë për krahasim, por ajo gjen përdorim në krijimet popullore.<sup>94</sup> Vepra e Camajt është dëshmi e gjallë e njohjes së thellë të thesarit popullor, këtë e dëshmon edhe leksiku i tij, që është nga më të pasurit me fjalë e shprehje të gurrës popullore. Ngarkesë të fortë emocionale këtij konteksti i jep jo vetëm përdorimi i çifteve antonimike, por edhe përdorimi i leksemave: sosja (kuptimin - vdekje), rrodhën (kuptimin - vërshoj).

**i pagrishun** (...*andej edhe kjo një nderë e madhe për ne, kolegumin tonë që, njëzani, korp i vetëm, u thotë atyne: mirëse vini të grishun e të pagrishun, njëheri...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 287).

Fjalori i Gazullit nuk e ka të pasqyruar këtë leksemë, ndërsa Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954 ka trajtën foljore: *grish*, ftoj në një gëzim, me të njëjtin kuptim e kemi të përdorur edhe tek Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006, por me një zgjerim të çerdhes fjalëformuese, si emër e si mbiemër: *grishje*: grishje për dasmë, fjalë grishëse, ose *grishës*, *grishtar*. Rigjallërimi i fjalëve “të rralla” është realizuar nga Camaj edhe tek çiftet antonimike, ato janë risjellë me qëllim që mendimi të jetë më i plotë dhe më intensiv.

**i paqenun** (...*Iu zhdërvillue goja. Tregonte ngjarje e rrethana të qena e të paqena...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 118).

Në FGJSSH (2006) kemi formën *qenë* pjes. e jam, *qenësi*, -a f. libr. 1. Të qenët. 2. Thelbi i diçkaje. Trajtat: *paqenësi* (emër), *i paqenshëm* (mbiemër) i gjejmë të përdorura edhe në Kosovë.<sup>95</sup>

**i pazbutun** (...*Atëherë isha mësues katundi / e shkruasha për nxansen teme t'sëmundë / si mbas tingullit t'zhurmës së murrllanit / që ulej mbi shakën e tërbueme tue vjellë / gjak e qelb buzë Kirit. / E më përlyente fëmijit. / Varg **i pazbutun!** \ Dardhë e egër në shkamb...*) (“Vargje të shpërndame”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f.153).

Leksema mbiemërore *i zbutur* na del i dhënë në fjalorët standardizues me kuptimet: 1. Që nuk është zbutur ende (kafshët); 2. Për bimët e pemës, që s'janë përmirësuar me anë të shartimit. Camaj arrin të krijojë një përftesë mjaft interesante e cila merr vlera stilistikore vetëm kur përdoret në vargjet e tij.

**i pakëputun** (...*mbas hamendjes së Currit, vargu **i pakëputun** i gjaqeve...*) (“Djella”, në

94 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1069. “Mirë janë veshë e mirë janë mathë / e t'pathirrun krushq kanë ra...(EL, Martesa...” “Un i pathirrun u kam ardhë në shpi...” (EL, Musa Qesexhi).

95 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1056. 1. “...që kur ke zbritur në tokë nga paqenësia...” (J. Gërvalla, Rrotull). 2. Tokë e paqenshme. Burrë i paqenshëm. (Kosovë).

*Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 87).

Khs. FGJSSH (2006) *i pakëputur* mbiemër.

**i palamë e i pandërruem** (...e ju kurrë s'ma keni zanë në gojë se ai atje, vetëm, e në moshë e shkon motin ***i palamë e i pandërruem***, si njeri i egër...) ("Pishtarët e natës", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 44).

Khs. FGJSSH (2006): *i palarë e i pandërrueshëm* si mbiemra. Autori për të forcuar kuptimin antonimik të leksemave arrin të përdorë brenda një konteksti të ngushtë fjalë të formuara me të njëjtin mjet fjalëformues.

**i palatuem** (...gjeta pjesën ***e palatueme***, *t'ashpër e të shëmtueme* të vetes...) ("Djella", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f.70).

Ngarkesë shprehëse nuk mbart vetëm ndërtimi i mbiemrit *i palatuem*, por edhe vargu i epiteteve që vijnë pas.

**i padiktuem** (...në derën tjetër gjysmë-çelë duket dhe ***e padiktueme*** përgjon...) ("Kandili i argjandit", në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 94).

Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954 ka të pasqyruar ndërtimin mbiemëror: *i padiktueshëm, e padiktueshme*, FGJSSH 1980 e 2006 ka të listëzuar përdorimet, si *folje: diktoj* e si *emër: diktim, diktues*. Në fjalorin e M. Elezit kemi të pasqyruar formën ndajfoljore: padiktueshëm.<sup>96</sup>

Me anë të kësaj ndajshese kemi mjaft ndërtime ku Camaj ruan gjuhën e autorëve të Veriut, si një pasardhës i denjë i tyre.<sup>97</sup>

96 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1038. "...të gjeja atë mikrobin që më ishte future e padiktueshëm..." (J. Buxholli, Shënimet...).

97 (...pra, mendimi i ***pathanë*** plotësisht, shkelej prej tjetrit, kështu ndërgjuesi birrte fillin e arsyetimit të blesit... Pishtarët e natës, f.59); (...qetësia ***e paturbullueme*** prej asnjë tingulli rrezatonte prapim...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 247). Khs. me FGJSSH (2006) ku kemi përdorimet si: mbiemër, i turbulluar, ditë e turbullt, turbulluese - element turbullues. (...peshën e dëshireve ***të pashfryeme***...Loja e mbasdrekës, f. 42). Khs. me FGJSSH (2006) ku kemi vetëm përdorimin si mbiemër: i shfryrë: top i shfryrë. (...pela ***e pambathun***, me atë krahatatë Vitoit...Shkundullima, f.149). Në Fjalorë kemi të përdorur vetëm trajtën mbiemërore: i, e mbathur: fëmijë të mbathur. (...në fund e dorëzova shëndosh , ***të pacënuem***...Palimspesht, f. 179). Khs. FGJSSH (2006) pacenuar (i,e) mbiemër. (...dashnore e lilit ***të paqelun***...Loja e mbasdrekës, f. 60). Në FGJSSH (2006) kemi përdorimin si mbiemër: i paçelur. (...i veshë me lëkurë delje të vjetër e të tymosun, ngjyrë-gëshenje si lesh nënbarkje berry ***të paqethun*** me vjet...Pishtarët e natës, f.12). Khs. FGJSSH (2006) paqethur (i,e) mbiemër. (...a jam artist apo dashnor i fshehtë i një fshatareje të pagdhendun...Djella, f. 91). Khs. FGJSSH (2006) i pagdhendur - mbiemër: (...marrja udhë me një plak ***të panjoftun*** qenkej diçka ndjellakeqe ...Djella, f. 117). Në FGJSSH (2006) kemi: i panjohur - mbiemër; (...e paqa në qafë tanë botën ***e pamatun***...Djella, f. 66). Në FGJSSH (2006) i pamatur - mbiemër; (...bahej pjesë ***e pandame*** e rrjedhës gjurmuese... Palimspesht, f. 179). Në FGJSSH (2006) kemi i pandarë - mbiemër; (...parzmin e leshtë ***të pambuluem***...Pishtarët e natës, f. 53). Në FGJSSH (2006) i pambuluar- mbiemër; (...nëpër flokë e faqe ***të parrume***...Pishtarët e natës, f. 74). Khs. FGJSSH (2006) i parruar- mbiemër; (...hap një regjistër ***të pashkruem***...Loja e mbasdrekës, f. 48). Në FGJSSH (2006) i pashkruar- mbiemër; (...mëkati gabime në rrethana ***të pakontrollueme*** prej askuj ...Djella, f.53). Në FGJSSH (2006) i pakontrolluar - mbiemër; (...pasuri ***e patunshme***

dh) “Parashtesa pa- bashkohet me mbiemra të nyjshëm të formuar nga një temë foljore me prapashtesën -shëm.”<sup>98</sup> Në fillim duam të veçojmë ndërtimet: **i papashëm** e **i pambërritshëm**, të cilat ose janë të mbledhura nga goja e popullit, ose janë të formuara nga vetë autori, kështu që përcaktimi nëse janë krijime të Camajt na paraqitet i vështirë.

**i pambërritshëm** (...merrnin pamjen e ishullit të pambërritshëm...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 33).

Në FGJSSH të vitit 1980 e 2006 kemi trajtën mbiemërore: *i paarritshëm*.

**i papashëm** (...ndonjë za shpirtnësh të papashëm...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 20).

Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1980 e 2006 ka të pasqyruar lemën: *i paparë, si mbiemër*.

**i papërtueshëm** (...shkurtim rruge për kambësorë të lehtë e të papërtueshëm që s’u merren mendët në greminë, fare **i papërshtatur** për të huejt **e pamësuem**...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 14).

Në fjalorët normativë kemi të pasqyruar lemat mbiemërore: *i pamësuar, i papërshtatur, i papërtueshëm*. Një dukuri stilistike që e ndeshim edhe në këtë mënyrë fjalëformimi është përdorimi i parashtesës pa- në disa fjalë brenda një konteksti, me qëllim që të rritet theksueshëm shprehësia antonimike e fjalëve të ndërtuara.

**i pashueshëm** (...na lente me një et të pashueshëm në zgur...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 127).

Khs. FGJSSH (2006) *pashuar (i,e) mbiemër*. Përpyekja e Camajt për t’ju afruar standardit shfaqet natyrshëm me larminë e leksemave që ai përdori, si: *të palejueshëm, i pangopshëm, të pangishme, i papërsëritshëm, i pavdekshëm, e papritun, e palodhshme etj.*<sup>99</sup>

ç) Gjatë vjeljes së materialit kemi ndeshur edhe ndërtime **ndajfoljore**, të cilat “mund të jenë të motivueshme nga dy tema fjalëformuese të ndryshme dhe në mjaft raste, duke u nisur vetëm nga struktura, është e vështirë të përcaktohet me saktësi se nga

---

dhe e funshme e etërve...Kandili i argjandit, f.119). Khs. FGJSSH (2006) i patundur- mbiemër etj.

98 E. Hysa, *Parashtesat me kuptim mohues në gjuhën shqipe*, në “Studime filologjike”, Viti XXXI (XV), nr. 4, Tiranë, 1997, f. 110.

99 (...si vesin ma të palejueshëm...Pishtarët e natës, f. 26); (...kur barku i rritet e i bahet rrëshiq i pangopshëm e i andshëm për dardha të egra...Dranja, f. 12); (...të femrës së re e të pangishme...Pishtarët e natës, f. 44); (...një za i pashoq e i papërsëritshëm...Nema, f. 132); (...askush nuk ashtë i pavdekshëm, vetëm i trashëgueshëm...Palimspesht, f. 178); (...ky ishte një shenj / si alfa ose ypsilon, / e paprituna, / një dangë e bardhë në terr...Nema, f. 123); (...prej punës së palodhshme...Pishtarët e natës, f. 87) etj.

*cila temë është formuar fjala e dhënë*”.<sup>100</sup>

Leksemat ndajfoljore: **pamjeshtrisht**, **pakujtueshëm** të ndërtuara me ndajshitesën pa- nuk i kemi të pasqyruar në fjalorë, por aty kemi ndërtimin: ndajfoljor- *mjeshtrisht* dhe mbiemrin- i pakujtueshëm. Ka shumë mundësi që këto dy fjalë të jenë formime të Camajt.

**pamjeshtrisht** (...*të shkyeme e të arnueme pamjeshtrisht nga duart e veta ...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 286).

**pakujtueshëm** (...*shumë vjet ma vonë, pakujtueshëm, iu dha të vizatojë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 24).

\* “*Në gjuhën popullore janë formuar kompozita me këtë parashtesë, futur midis dy elementesh të kompozimit, si infiks.*”<sup>101</sup> Një dukuri e tillë vihet re edhe tek Camaj në shembullin e dhënë më poshtë:

**mjekër-pakrehun** (...*sa peta e tanë zgjatet për dikund rrugimi mjekër-pakrehun plak dhe i shkujdesun me qafë të vjedhun atleti...*) (“Vargje të shpërndame”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 158).

Në FGJSSH (2006) me mbiemrin *i pakrehur* kemi ndërtimin: *flokëpakrehur*, ndërsa kompozitat e ndërtuara me fjalën mjekër janë: *mjekërbardhë*, *mjekërcjap*, *mjekërgjatë*, *mjekërthinjur*, *mjekërzi*. Camaj për ndërtimin e kësaj lekseme ndoshta është mbështetur në formimet e mësipërme. Kompozitën mjekër-pakrehun nuk e kemi të pasqyruar në fjalorë e ka të ngjarë të jetë një formimi i autorit duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes.

---

100 Akademi e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 53.

101 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “*Vepra I*”, Tiranë, 1980, f. 393.

**Formimet me anë të ndajshesës pa-**

Formohen emra nga tema emërore të parme e të prejardhura me prapashtesat: - *i*, -*(ë)ri*, -*(ë)ni* (dialektore), -*(ë)si*, -*im*, -*je*:

- ***papajtim, papërndalje, palëvizja***, pakujdes, panjerëzi, paurti, paturpësi etj.

Formohen mbiemra nga tema mbiemërore të parme dhe nga nyjzimi i pjesoreve:

- ***i pakeq, i papashëm, i pambërritshëm***, i pabukur, e padrejtë, e pathirrun, e paqenë, i pazbutun, i palarë, e palatueme etj.

Formohen ndajfolje nga tema ndajfoljore. (Raste të rralla.)

- ***pamjeshtrisht, pakujtueshëm***



### 3.1.9. Formimi i fjalëve me parashtesën para-

*“Ndajshtesa para- u ngjitet pak fjalëve të gjuhës popullore, kurse në gjuhë të shkrimit është bërë produktive më tepër me anë përkthimesh, kalkesh, sipas gjedhes së gjuhëve të huaja.”*<sup>102</sup>

Kjo parashtesë i është paravendosur temave emërore ose foljore, duke ndërtuar emrave e (pak) mbiemrave, të cilat janë pjesë e ligjërit të gjuhës shqipe.<sup>103</sup> Në këtë grup po veçojmë leksemën **parahymje**, e cila është përdorur me kuptim të ri leksikor: “nisje, fillim i një mendimi”, kjo fjalë mund të jetë krijim i shkrimtarit.

**parahymje** (...*posaçe ky tregim për Nikën ishte me randësi, një parahymje për t’i zbulue të shoqes një fshehtësi që askush nga familja s’e dinte ...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 42).

Nga tema foljore *ndiej* kemi ndërtimin *parandiej*:

**parandiej** (...*askush nuk e parandiente...Shkundullima*, f. 93), e më pas kemi përdorimin emëror *parandija* (...*mund të çlirohet ma lehtë nga parandija e ogurit të zi...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 98); (...*ndoshta me paramendim të keq...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 7).

### 3.1.10. Formimi i fjalëve me parashtesën për-

*Ndajshtesa për-* është shumë prodhimtare në gjuhën shqipe. Një dukuri të tillë e vëmë re edhe në krijimtarinë e Camajt. Autori arrin ta pasurojë fjalësin e tij me njësi leksikore që nuk përdoren ose përdoren mjaft rrallë edhe në të folmet geqe. Ato sot mund t’i shohim si fjalë të rralla e shumë prej tyre mund t’i marrim edhe si fjalë të vjetëruara, por që sjellin vlera të reja semantike. Nuk mungojnë edhe leksemat që janë sjellë së pari në prozën e tij nga letërsia paravajtëse. Vlen të theksojmë se përcaktimi nëse është fjalë e re, pra nëse është krijuar nga autori del mjaft i vështirë. *“Parashtesa për- sipas Pedersenit e Joklit është autoktone në gjuhën shqipe. Ajo u ngjitet emrave, mbiemrave, ndajfoljeve e foljeve, duke u dhënë kuptime të ndryshme. Funksionin intensiv të kësaj parashtese në shqipe e gjejmë te foljet.”*<sup>104</sup>

a) Kjo ndajshtesë nënvizon gjuhëtari E. Hysa: *“Vendoset para temave emërore,*

102 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 394.

103 (...*po arsyeya e gjithë këtij zhgarkimi do lypë në parahistorinë e racës...Dranja*, f. 12); (...*askush nuk e parandiente...Shkundullima*, f. 93); (...*mund të çlirohet ma lehtë nga parandija e ogurit të zi...Shkundullima*, f.98); (...*janë paragjykimet, bile mistifikime...Shkundullima*, f. 143), (...*model i vjeter i paraluftës...Katundi me gjuhë të fshehtë*, f. 233); (...*ndoshta me paramendim të keq...Loja e mbasdrekës*, f.7); (...*ndaj dijetari paraardhës në këtë Institut...Palimspesht*, f. 201). (Në këtë rast e kemi të përdorur si mbiemër.)

104 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 395.

*duke e saktësuar dhe përcaktuar më qartë, kuptimin që ka tema fjalëformuese.*”<sup>105</sup>

Ky formant tek Camaj shërben për të krijuar pak *emra* zakonisht nga tema emërore, si: *përkënaqësi, përmbrenca, përdhimbje*.

Autori, si një mjeshtrë i gjuhës shqipe, merr një lemë e duke përdorur elemente të ndryshme fjalëformuese e zgjeron përdorimin e saj në kontekste të ndryshme. Kështu, duke shfrytëzuar lemën foljore **kënaq**, kemi ndërtimet, si: *përkënaqem (folje), përkënaqje (emër), përkënaqësi (emër), i përkënaqur (mbiemër)*. Formën mbiemërore *i përkënaqshim* dhe atë foljore *përkënaqunë* e hasim të përdorur që tek Pjetër Budi.<sup>106</sup> Por si folje kalimtare *përkënaq* del e përdorur në të folmen e Plavës e Gucisë, si: I gëzoi e i përkënaqi të tanët.<sup>107</sup> Përdorimet si folje joveprore (*përkënaqem*), si emër (*përkënaqësi*) e si mbiemër (*i përkënaqur*) nuk dalin të pasqyruara në Fjalorin e Gazullit, në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954, në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi”, në FGJSSH (1980) e në FGJSSH (2006), por M. Elezi shënon se “*këto fjalë gjenden të përdorura kryesisht tek krijimtaria e M. Camajt*”.<sup>108</sup>

Po ilustruam me shembull përdorimin emërore: *përkënaqësi*.

**përkënaqësi** (...*heroi vdes vetëm për të gjallnue kujtesë e se përkënaqësia e të gjallit qenka Vetëdija...*) (“Djella”, në *Vepra I*, Tiranë, 1996, f. 136)

Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 2006 kemi përdorimet emërore: *kënaqje e kënaqësi*, por ndërtimin e lartpërmendur nuk e kemi të pasqyruar e mund të themi që është përpjekje e autorit për ndërtimin e fjalëve të reja me anë të parashtesës *për-*, një veçori kjo e stilit të tij. Formimet me këtë ndajshitesë Camaj i shfrytëzon për të ndërtuar nuanca intensive të një ndjenje në këtë rast. Edhe sema *gjallë*, dhe pranëvënia e foljes (*gjallue*) me mbiemrin e emëruar (*të gjallit*) ka shërbyer për një rimarrje të saj me klasa të ndryshme fjalësh, duke formuar një përsëritje stilistike mjaft dinamike e aspak monotone.

Camaj shpesh ka riaktivizuar fjalë nga fondi i autorëve të vjetër. Studiuesi i veprave të tij, Hans-Joachim Lanksch shprehet: “*Hir të shuem dhe një element hermetik e merr gjuha poetike e Camajt me përdorimin e leksemave të rralla nga thesari i*

105 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 75.

106 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1998, f. 264. *përkënaqshim*, i mb. “*sā i amblë e i përkënaqshim ashtë*” R 327. *Përkënaqunë fol.* “*erdh me e amblëtueam e me e përkënaqunë*” S183.

107 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1101.

108 Po aty, f. 1101.

letërsisë së vjetër shqipe dhe nga idioma shqipe e arbëreshëve t'Italisë.”<sup>109</sup> Kështu vepron autori me fjalë si:

**përmbrenca** (...ndër parzmat e hollë tejshiheshin **përmbrenca**...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 99).

Këtë leksemë e gjejmë të përdorur që tek Buzuku.<sup>110</sup> Ndërsa tek Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi” kemi variantin: *permrënts*, sot në standard (FGJSSH, 2006) gjejmë të përdorur lemën përbrendëse (-t), të *brendshmet*. Në kontekstin e dhënë vendosja njëra pas tjetrës e dy leksemave: *tejshiheshin e përmbrenca* të krijojnë nuancën e një largësie, po edhe të një depërtimi në thellësi, nisur edhe nga elementet *tej-* dhe *për-*.

Leksemat *përdhimje* e *përvuajtje* vijnë nga tema të emrave prejfoljorë me *prapashtesën -je*.

**përdhimje** (...*burrneshë, na kemi ardhë këtu krye-shëndoshë me të shprehë si njerëz të civilizuem përdhimjet tona*...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 70); (...*për t’i shprehë Bjeshkës përdhimjet që të mbli dhemi krye më krye* ...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 71).

Lema *përdhimbje* nuk del e pasqyruar në Fjalorin e Gazullit, në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954, në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi”, në FGJSSH (1980) e në FGJSSH (2006),<sup>111</sup> por ajo ndeshet e përdorur në të folmen e Plavës e të Gucisë.<sup>112</sup> Ky element i etnografisë së të folurit është përdorur nga Camaj edhe stilistikisht. Në shembullin e dytë autori ka përdorur fonemën: *dh* e grupin *mb*, të cilat prodhojnë atmosferë zëshmimi e krijojnë një përjetim të veçantë emocional tek lexuesi.

Në lidhje me pranueshmërinë e papranueshmërinë, marrëdhëniet normative-jonormative e shmangieve të ndryshme ligjërimore si në trajta morfologjike, gjedhe fjalëformuese e ndërtime sintaksore Xh. Lloshi shkruan: “*Është e drejtë që gjuha letrare e përjashton nga norma p.sh. shtresën e mjeteve krahinore, por kjo ndjell në kujtesë një mjedis, një mendësi, një shkallë kulture, veçantitë e jetës e të dokeve etj., dhe me këto shoqërime jashtëgjuhësore i jep dorë autorit për shprehësi, për të sjellë informacion plotësues, për të arritur qëllimet e veta.*”<sup>113</sup> Ndaj Camaj për të qenë sa

109 Hans-Joachim Lanksch, art. Cit., (Martin Camaj, ende i pazbuluem”).

110 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I, Shkodër, 2000, f. 408. “endë përbrendësat të mi përtij shpirt tëh dërejte”.

111 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 691. (Në standard përdoret leksema: ngushëllim.)

112 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1091. Përdhimbje, -a, f.sh. -e, -et (prej për+dhimbje). Kryeshëndosh, ngushëllim. Shkoi për përdhimbje (Plavë, Guci).

113 Xh. Lloshi, *Çështje të stilistikës dhe kultura e gjuhës*, në “Shqipja gjuhë e hapur dhe dinamike”,

më afër personazheve të vet dhe mjedisit ku ato luajnë, përdor fjalët e përmendura më sipër.

b) Me anë të parashtesës *për-* formohen ***mbiemra***, që kanë kuptim përforcues e ndonjëherë krahasues. “*Kjo ndajshtesë mbartet nga klasa e foljeve që shërbejnë si temë fjalëformuese, e ato na paraqiten si mbiemra prejfoljorë të formuar me paranyjëzim.*”<sup>114</sup> Fjalët e dhëna më poshtë nuk i kemi të pasqyruara në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi”, Fjalorin e Gazullit, në Fjalorin e vitit 1954, në FGJSSH (1980) e në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 dhe mund të themi që ka të ngjarë të jenë fjalë të ndërtruara nga autori, ose të rimarra nga tradita paravajtëse, ose trajta dialektore, si p.sh.: ***e përfrigueshme, e përndalun, i përkënaqun, e përllagun, të përllagshtë, e përdhunshme, i përngeshëm, i*** përmoçëm (në FGJSSH, 1980 kemi përdorimin mbiemëror: ***i*** përmoçshëm), ***të përmoçun***. Në të gjitha këto formime parashtesa *për-* përgjithësisht përdoret me kuptim përforcimi. Specifika e ligjërimit artistik tek krijimtaria e Camajt është se ai nuk mund të kufizohet vetëm në figurat, prandaj ngjyresat stilistike mund të krijohen jo vetëm përmes përmbajtjes leksikore, por shpesh edhe me mjete tingullore, me elemente që lidhen me fonostilistikën, duke u interesuar më shumë për funksionin poetik të gjuhës. Simbolizmin fonetik Camaj e krijon përmes përsëritjes të një foneme të vetme, por shpesh edhe të grupeve fonemave, si në shembullin e mëposhtëm:

***i përfrigueshëm*** (...*Përse kaq ngut? A e di ndokush se kush ashtë? Qenka aq e përfrigueshme* fytyra e tij, *përfytyrimi i* të cilës do t’u kishte turbullue edhe *gjumin?*...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 97). (...*Dita u sos në një hije. E hija ngrohet mbas flakës së kandrave ndejë në karrigë të gdhendun në embleme të përfrikshme...*) (“Pleqnime më vete”, f. 257).

Ndajshtesa *për-* tek leksema e *përfrigueshme* intensifikon në shkallë më të lartë tekstin, duke shprehur intensifikim të cilësisë. Këtë fjalë e gjejmë të përdorur në letërsinë artistike nga shkrimtari i njohur Gj. Fishta.<sup>115</sup>

***i përndalun*** (...*Kjo ashtë fjala e fundit e prokurorit dhe dëshmitarit më një! Ndëgjohet një lloj gazi, i përndalun, por askush nuk e hap gojën. Nuk dal këtu, ballë jush, të mbroj gjaksorët e Përronit të Mbyllë...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f.

---

Tiranë, 2011, f. 272.

114 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.186.

115 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1093. “...me uturimë / t’ përfrigueshme, i shakullonte...” (GJ. Fishta, Lahuta e malcisë).

65); (...*Fuqi e përndalun*...) (“Buelli”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 154).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe 2006 kemi të paraqitur vetëm formën mbiemërore: *i, e ndalur*, me kuptimin që është ndalur, që nuk punon më: me zemër të ndalur.<sup>116</sup> Gazi, fuqia mund të ndalen, mund t’i frenojmë ndjenjat, por kur autori e përdor ndërtimin me anë të ndajshesës për-: *i përndalun*, të duket sikur është e detyrueshme të ndalësh diçka të nisur, pra jemi të detyruar të ndalim një veprim të tillë. Në këtë rast kuptimi i kalon caqet e reales, e cila shprehet stilistikisht me anë të antonimisë *ndëgjohet-askush nuk e hap gojën*.

Martin Camaj përpiket jo vetëm të ndërtojë fjalë të reja, por t’u japë atyre edhe ngarkesë emocionale. Në lidhje me këto vlera stilistike gjuhëtari J. Thomaj shkruan: “*Fjalët, shprehjet e kuptimeve me ngjyrimë emocionuese, si edhe mundësitë e ngjyrimëve të tjera që ka shqipja, përbëjnë një nga vlerat më të çmueshme që shërbejnë për të rritur forcën shprehëse e ndikuese të ligjëritimit. Kjo vlerë ka nevojë të zbulohet si në gjuhën e popullit, ashtu edhe në gjuhën e shkruar, veçanërisht në letërsinë artistike...*”<sup>117</sup>

Puna me gjuhën e ka bërë Camajn mjeshtër të fjalës artistike. Kjo bëhet më e qartë edhe nga shembujt në vazhdim.

**i përलगun** (...*si delshin prej puseve të Lumit, të përलगun nën diell*...) (“Legjenda”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 152).

Mbiemri *i përलगun* del i përdorur jo vetëm nga M. Camaj, por edhe nga M. Elezi me formën: *i përलगur*.<sup>118</sup> Kjo parashtesë vendoset edhe para leksemave me dallime të vogla kuptimore e formale, duke mos rënë në përsëritje. Duke u shoqëruar me këtë ndajshesë fjalët vishen edhe me nuanca të reja semantike. Kështu formimet: *i përलगun* (që vjen nga tema *i lagur* (*i lagët*) dhe ka kuptimin: që ka ujë a lagështirë; i njomur: flokë të lagët) dhe *i përлагshtë* (që vjen nga tema mbiemërore *i lagësht* dhe ka kuptimin që ka lagështirë: ajër i lagësht), nuk mund të përdoren në vend të njëra-tjetrës, pasi kuptimisht ata janë të dallueshëm edhe në kontekstin ku përdoren.

**i përлагshtë** (...*natyra përmbas qelqeve të përлагshtë dhe të përlyhem dukej si kuadër impresionisti*...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 60).

Një dukuri stilistike që e ndeshim në gjuhën e Camajt është grumbullimi i fjalëve me të njëjtën parashtesë brenda një konteksti të ngushtë. Gjithashtu mund të themi

116 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 659.

117 J. Thomaj, *Rreth vlerave të fjalëve në gjuhën shqipe*, në “Gjuha jonë”, nr.2, 1989, f. 10.

118 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f.1104. “Një sy i pafjetur, i përmalluar e i përलगur prej një loti të dënuar diku...” (M. Elezi, (Pa) koka).

se në këtë rast e në ndonjë tjetër, sidomos në klasën e mbiemrave, parashtesa përndihmon semantikisht në krijimin e shkallës sipërore të mbiemrit, p.sh.: *i përlagshtë* - “shumë i lagësht” ose *të përmoçëm* - “shumë të lashtë”, si: (...*në plasaritjen e gurëve të përmoçëm*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 103).

**i përdhunuem** (...*Vitoit, vajza e pëllasit i mbeti në përfytyrime do kohë me parzëm pak të shpërvjelun, si martire e përdhunueme dhe e përgjakun ashtu si paraqiten ndër freska kishash të vogla në fshate të lëshueme të rrethinës* ...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 101).

Përjasjen e dy mbiemrave *e përdhunueme*, *e përgjakun* Camaj e ka shfrytëzuar për të krijuar sinoniminë kontekstuale. Disa herë lema e zgjedhur nga Camaj bëhet pjesë e një figure stilistikore p.sh. mbiemri e përdhunshme është pjesë e një krahasimi.

**i përdhunshëm** (...*do të kishte qenë një ujë si ndalje e përdhunshme*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 65).

Në Fjalorin e “Bashkimit” kemi përdorimin si mbiemër: *perdhunshem, (i,e), persh. Vergognoso, a.*,<sup>119</sup> Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 ka të shënuar përdorimet mbiemërore: *e përdhunët, i,e përdhunuar*, ndërsa tek Fjalori i M. Elezit kemi përdorimin *përdhunshëm* si ndajfolje.<sup>120</sup>

**i përngeshëm** (...*ia kishte lakmi treguesve të përngeshëm e pa të keq të cilët përkënaqeshin*...) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 168); (...*gjurmues poetë, të gjithë njerëz 'përngeshëm*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 203); (...*Homeri i përngeshëm u kull kujtueshëm e tha: \ Uliksi e Itaka pa grue - dy krena binjokë dhie \ me një bri të thyeme: punë e pakryeme*...) (“Njeriu më vete me të tjerë”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 181).

Trajta mbiemërore *i ngeshëm* del e përdorur në FGJSSH (2006): *njerëz të ngeshëm, kohë e ngeshme*, ndërsa ndërtimi me ndajshitesën *për-* nuk del i dhënë në fjalorët e marrë në shqyrtim e mund të themi që ndoshta është një krijim i autorit për efekte stilistikore.

**i përmotun** (...*anat e thyeme të gurve të përmotun*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 146).

Në FGJSSH (2006) kemi përdorimin: *përmotsh/ëm (i), -me (e) mb. bised. i përvitshëm*.

**i përmoçëm** (...*në plasaritjen e gurëve të përmoçëm*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*,

119 *Fjaluer i Ri i Shqypes përbâam prei Shocniet t' Bashkimit*, Shkodër, 1908; Prishtinë, 1978, f. 331.

120 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1104. “Këto dyer kanë qenë të mbyllura përdhunshëm.” (M. Elezi, Publicistikë).

Tiranë, 1996, f. 103).

Shkrimtari përpiqet të luajë me elementet fjalëformues të shqipes, duke i dhënë së njëjtës fjalë ndajshitesa të ndryshme që nuk dalin të pasqyruara me një formë të tillë në fjalorë.

Ndërtimet me ndajshitesën për- në klasën e mbiemrave janë stilistikisht më të fuqishme sidomos në poezi, si p.sh.

**i përmykun** (...në shtëpinë e lashtë e të lëshueme \ erëtim ngjyre rraqesh të **përmykuna** \ i mori pafajninë \ petkut të vjetër të nusicë...) (“Njeriu me vete e te tjerë”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f. 229).

**i përvluem** (...e ka mallkue gjaku **i përvluem** në hekur...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra* 5, Tiranë, 1996, f. 10).

Si formë mbiemërore: *i përvëluam* dhe me formë foljore: *përvëluem* e hasim të përdorur që tek autorët e vjetër<sup>121</sup>. Në Fjalorin e “Bashkimit” kemi trajtën: *pervluem* (pervluem), (i, e, t’), persh. Bollito, scottato- a, bollimento, scottatura<sup>122</sup>, ndërsa në FGJSSH (2006) kemi formimin: *i përvëluar*. Mbiemri *i përvluem* është përdorur si pjesë e metaforave.

**i përlyem** (...disi të **përlyem** me lot shkëlqyes që digjeshin...) (“Djella”, në *Vepra* 1, Tiranë, 1996, f. 120); (...të **përlyeme** prej djersësh gjaku...) (“Njeriu me vete e me tjerë”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f. 196); (...Zeka **i përlyem** në gjak qysh në *rininë e parë*...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra* 5, Tiranë, 1996, f. 47). Khs. me FGJSSH (2006): *i përlyer*.

Në shembullin e cituar mbiemri me kuptim intensiv ndiqet nga një lloj oksimoroni, gjë që e bën frazën e Camajt stilistikisht mjaft interesante, por edhe të thellë semantikisht.

**i përkënaqun** (...kur trillonte apo e zbukuronte fjalën qeshte nën mustak **i përkënaqun** se po më bante kubël, po më çonkej në krue e më kthente pa pi...) (“Djella”, në *Vepra* 1, Tiranë, 1996, f. 118).

**i përthamë** (...përshutë derku të **përthame** në erën e malit...) (“Shkundullima”, në *Vepra* 4, Tiranë, 1996, f.120). Khs. me FGJSSH (2006): *i, e përtharë etj*.

Me këtë ndajshitesë janë formuar edhe një varg leksemash të tjera, si: *i përbotun, i përnximë, i përblozun, i përbrendshëm, i përkujdesun, i përthimë, i përmykun, i përndjekur, i përvajshëm etj*.

121 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1998, f. 266.

122 *Fjaluer i Ri i Shqypes përbâam prei Shocniët t' Bashkimit*, Shkodër, 1908; Prishtinë, 1978, f. 344.

c) Me parashtesën *për-* në krijimtarinë e Camajt janë formuar *folje* zakonisht nga *tema foljore*. “Kjo parashtesë u paravihet temave foljore duke u dhënë atyre një *kuptim intensiv, përforcues, përsëritës e në mjaft raste ngjyrime të reja kuptimore*.”<sup>123</sup>

Temat fjalëformuese të foljeve me parashtesën *për-*, mund të jenë tema foljesh të parme ose jo të parme, kryesisht të gurrës së shqipes. “Këto tema fjalëformuese, nga pikëpamja fonemore dhe gramatikore, mund të jenë të çdo tipi. Ato mund të fillojnë me zanore ose bashkëtingëllore dhe mund t’u përkasin të gjitha zgjedhimeve.”<sup>124</sup>

Veçori e punës së këtij gjuhëtari, siç e thamë edhe më sipër, është përdorimi i një fjale të zgjedhur si mbartëse e nuancës bazë kuptimore, në forma të ndryshme.

**përkënaqej** (...Të bijtë thanë se ajo kishte dalë mendësh. Ata vunë re se edhe plaku **përkënaqej tejet** me gruen e pjekun, si të mos kishte pasë mjaft punë me femna gjatë jetës...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 44).

Intensiteti në shkallën më të lartë tek kjo leksemë jepet mes dy mjeteve, parashtesës *për-* nga njëra anë dhe ndajfoljes *tejet*, në anën tjetër.

(...nëse i delte mbarë puna, **përkënaqej** në vete për duresën që paska pasë ende nuk e kishin fitue kthjellësinë e duhun...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 267); (...**përkënaqesha** në vete jo aq sa qitsha në letër vargje mbas vargjesh, po sepse ato mbëshin nga ndiesi që ushqesha për Djellën...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 91).

Trajta përfaqësuese e kësaj foljeje dhe ndërtimi foljor me formantin *për-*: *përkënaq* i kemi të përdorura që tek Bardhi, por tek Camaj e ndeshim edhe si folje joveprore (përkënaqem). M. Elezi shprehet se, *ky formim del i pasqyruara kryesisht te krijimtaria e Camajt*.<sup>125</sup> Përdorimi i ndajshtesës *për-* i jep fjalës nuanca të holla stilistikore.

Në krijimtarinë e këtij shkrimtari siç e thamë edhe më lart nuk janë të pakta as krijimet vetjake e përftesat shprehëse, të cilat autori i krijoi me shumë mjeshtri. Kështu foljet: **përvështirësoj**, **përndal** nuk i kemi të pasqyruara në Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e vitit 1954, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH (1980 e 2006) e me shumë mundësi mund të jenë krijime të Camaj, të cilat ai i përdor kryesisht për qëllime stilistikore.

Formimet me parashtesën **për-**, sidomos tek klasa e foljeve, si: *përkënaqem*,

123 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.349.

124 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008, f. 126.

125 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1101.



përvështirësohej, përbluaj, përnjësoj, përpushem (përpiqem), përdihem, përmbuj, përbind, përdjeg etj., stilistikisht përdoren me kuptim përforcues, me idenë e një veprimi të zgjatur, por ndonjëherë krijojnë edhe nuanca të reja semantike.

**përvështirësohej** (...shqarri atypëraty, **përvështirësohej** prej tymit...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 77).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 kemi foljen *vështirësoj*, me kuptimin: iu vështirësua frymëmarrja, ndërsa ndërtimi me ndajshitesën *për-* nuk del i pasqyruar as në fjalorët e lartpërmendur. Në këtë shembull Camaj shfrytëzon mjete sinkretike, si më të fuqishme stilistikisht për të dhënë intensitetin e një veprimi (*përvështirësohej* krahas. *vështirësohej shumë*).

Nga folja *ndal* kemi përdorimin: *përndal* (folje), që është e ndërtuar nga parashtesa *për-* + foljen *ndal* e ka kuptimin “me u ndalë ngadalë”, por edhe si mbiemër: *e përndalun*. Këtë fjalë të prejardhura nuk e kemi të pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim dhe mund të themi që është krijim i autorit, ose është fjalë që gjallëron në vendlindjen e autorit në Prekal.

**përndal** (...Nika u **përndal** e s'i tha atij s'i binte ma ndërmend qysh ku ajo s'kishte vu kambë në atë vend...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 38); (...u **përndal** dhe heshti...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 119); (...gjama i vetmi kor i lashtë në malësinë e gurit **përndalet** hallakatshëm shpatijeve...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 94).

Në krijimtarinë e Camajt gjejmë të përdorura formime që janë të shoqëruara në bashkëvajtje me foljen primitive nga kanë dalë, duke krijuar çifte sinonimike, si: *falë e përfalë, u dogjën dhe u përdogjën, djegë e përdjegë*. Ndërtimi me ndajshitesën *për-* i jep fjalës nuancë përforcimi, si p.sh.:

**përfalë** (...burrneshë, na kemi ardhë këtu krye-shëndoshë me të shprehë si njerëz ty mbasi të jem **falë e përfalë** me të gjithë...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 92).

**përdjegë** (...Udhëtari, njeri i thjeshtë, as tepër i urtë, as poet, ndezi zjarmin e fikun në hinin **djegë e përdjegë** në votër...) (“Pleqnimi më vete”, f. 258); (...si **u dogjën dhe u përdogjën** sa herë në cikun e fjes së bungut... ) (“Dranja”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 78).

“Gjuha, - shprehet studiuesi Xh. Lloshi, - është një visar, një repertor mundësisht, dhe se zgjedhjen e përcakton mënyra e ndërthurjes së elementeve gjuhësore.”<sup>126</sup>

126 Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 45.

Edhe Camaj në veprat e tij u përpoq t'i përzgjedhë fjalët me qëllim që t'i përdorë në kontekste të ndryshme e t'u japë kuptime të reja. Kjo gjë del mjaft qartë në shembujt e mëposhtëm, ku folja *përpyjek* është përdorur me kuptimin “me u rrit”, kurse ndërtimi emëror me formantin -je: *përpyjekje*, ka kuptimin “takim, lidhje”.

**përpyjekë** (...mbasi ajo **përpyjeku** shtatin për blerim...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.15); (...**përpyjekjen** e trupit për burrë e kish përfytyrue si valë ndjesish të buta...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 83).

Autori është i vetëdijshëm se nuk është e mjaftueshme vetëm të gjendet fjala e të futet në përdorim, por ai në mënyrë të vetëvetishme përpiket të rikrijojë ndërgjegjshëm gjuhën “e vjetëruar” duke bërë përpyjekje për risjelljen e këtyre leksemave. Në krijimtarinë e këtij autori kemi ndeshur gjithashtu edhe ndërtime që kanë sot një përdorim më të gjerë.<sup>127</sup>

Në veprat letrare të Camajt parashtesa *për-* u vendoset temave foljore të parme. “Kjo ndajshitesë u jep foljeve të prejardhura një kuptim më intensiv se veprimi i shprehur nga tema fjalëformuese. Në raste të tilla kuptimi i foljes së prejardhur nuk largohet shumë nga ai i temës fjalëformuese.”<sup>128</sup> Në shembujt e mëposhtëm formanti *për-* ka shërbyer për t'i dhënë fjalës kuptimin e afërsisë a të krahasimit.

**përngjaj** (...**përngjante** një monedhe me dyfaqe...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 174); (...i recitonte tue ia **përngja** zanit të gjysheve...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 137); (...i **përngjan** timtës ma të vogël të minutit...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.62).

Me kuptim intensiv e kemi në rastet:

**përthithë** (...që vinin me i **përthithë** të mbramen forcë burrnore...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 79).

**përvloj** (...nalt në brija u kënaq ai fis tue kundruie dritën e anijeve si digjen e përvlohen në ranë...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.20).

Në këtë kontekst Camaj ka krijuar një çift sinonimik.

**përfol** (...u **përfol** edhe ndër të ardhurit...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.127); (...kryekreje shkaku i arit e si **përflitet**...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 132);(...nuk i kanë **përfolë** në familje...) (“Shkundullima”, në *Vepra*

127 (...ashtu në kambë, **përjetonte** efektin e kundërshtimit të vet dhe qetësohej...Pishtarët e natës, f. 13); (...unë si njeri dashuninë e **përjetosha** ndryshe...Djella, f. 79); (...**përjetonin** ditët më të bukura të jetës...Pishtarët e natës, f. 79); (...këtu **përputhen** kohët në një fjalë...Palimspesht, f. 193); (...në këtë vend koha, koha **përputhet** për kohë përkueshëm, pa u vra aspak sendi për send...Dranja, f.23) etj.

128 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 349.

4, Tiranë, 1996, f.107) etj.

“Kjo parashtesë përveç kuptimit intensiv i jep fjalës edhe ngjyrim stilistikor, duke u larguar në disa raste edhe nga kuptimi i foljes që ka shëbyer si temës fjalëformuese.”<sup>129</sup>

Një dukuri të tillë e hasim edhe në shembujt e mëposhtëm ku foljen: *përvodh* - *përvidhej* e kemi të pasqyruar që tek Fjalori i Gazullit si folje: me përvjedhë një send; u përvodh nëpër gjind.<sup>130</sup> Në Fjalorin e vitit 2006 kemi ndërtimet: *përvidhem* si folje me kuptimin “iku diku a largohem nga një vend fshehurazi”; “*i shmangem tinëz dikujt a diçkaje; vidhem*”; *përvjedhje* si emër; *përvjedhtas, përvjedhurazi* si ndajfolje, me kuptimin “fshehtas”. Camaj një foljeje të tillë i jep ngjyrim stilistik.

**përvidhej** (...herë mbas here *përvidhej* kah shqimthi...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.58); **përvidhet** (...ai *përvidhet* si cub, gjithkah...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 184); (...mandej gjindej atje, tue *përvjedhë* mbas brigjesh e lisash si cub...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 184); (...vrojti në katër anët për t’iu *përvjedhë* shikimit të fqijve...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 248); **përvjedhë** (...tue u *përvjedhë* si gja e egër shkurreve...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 13).

Autori arriti të rigjallëronte fjalët “e harruara” ndër mote, për këtë arsye ai ka shfrytëzuar shpesh edhe leksikun e autorëve të vjetër. Një rast të ngjashëm përbën edhe folja *përlavdoj*, e cila është përdorur që nga Buzuku e më tej, Budi, Bogdani, Kuvendi i Arbënit e deri në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006.

**përlëvdue** (...donte me e *përlëvdue* Nikën...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 29); (...Ka ma i thashë unë” e vijova tue i *përlavdue* fshatarsinë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 98).

Në Fjalorin e “Bashkimit” kemi trajtën: perlevdue (m’u), ftper. (Bog). Gloriarsi, vantarsi.<sup>131</sup> Kjo fjalë del e pasqyruar edhe në krijimtarinë e mikut të tij E. Koliqi.<sup>132</sup> Studiuesja Xh. Alimhilli pohon, se “*parashtesa për- semnatikisht është vështruar tek klasa e foljeve edhe si një mjet për të shprehur idenë e një veprimi çastësor*”<sup>133</sup>, si p.sh.: **përçmoj** (...ai e *përçmonte* Nikën...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 27); (...tue *përçmue* vetveten time...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996,

129 Po aty, f. 349.

130 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010, f. 316.

131 *Fjaluer i Ri i Shqypes përbâam prei Shocniet t’ Bashkimit*, Shkodër, 1908; Prishtinë, 1978, f. 337.

132 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, “Ringjalle tue përlavdue motin në të cilin na gëzuem e vujejtëm...” (E. Koliqi, Pasqyrat e Narçizit), Tiranë, 2007, f. 1104.

133 Gj. Alimhilli, *Klasifikimi foljor sipas mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe*, Cosenza, 2009, f. 38.

f. 115).

Folja **përligj** në krijimtarinë e Camajt ka këto kuptime, si:

1. Nxjerr dikë të pafajshëm p.sh.:

**përligjë** (...*Kjo punë s' durohet ma! - Thoshte Lena para të bijve, tue përligjë andjen e vonueme për burrë në fshehtësinë e zemrës së vet si detyrë e afrim i familjes me vjete të përçame...Pishtarët e natës*, f. 44); (...*Të bijtë, pos Palit, kujtuen keq, kinse e ama po dashka me e përligjë punën përse ajo paska mbetë aq gjatë në Fundinë...Pishtarët e natës*, f. 82); (...*këtë ndjenje kundrejt tyne, marrë veçmas e bashkë, e përligji i hueji në vete tue arsyetue se dashke me përjetue fillikat vetminë në shtator, buzë detit...*) ("Katundi me gjuhë të fshehtë", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 232);

2. Provoj se jam i denjë për diçka p.sh.:

**përligjë** (...*"Nuk pendohem pa ia mbërrit qëllimit. Të pendohem para kohe, ashtë njënjë si me hjekë dorë prej teje."* Pushtimi i vajzës **përligjite** në gjykimin e tij edhe rrëmbimin e trashëguem andej qafës së malit...*Rrungaja në mars*, f. 196); (...*Qëndrim i çuditshëm përmes të cilit, ndoshta Vitoi qëllimonte me përligjë dështimin e vet; njëlloj si të donte me thanë: unë pajtohem me rrethanën e fatin tim që paskam pasë të luej një rol të caktuem në katundin tim që nuk do të zgjaste ma tepër se një vjetë...*) ("Shkundullima", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 156).

**përlyej** (...*E përsëriti edhe para të shoqes bindjen se sëmundja zhvillohej ma së pari në dhe, dheu ia ngjiste bimës të ligën e bima, tue dalë përjashta, përlyente shtazë e njerëz. Gjithçka delte prej zemrës së dheut, e mira dhe e keqja...*) ("Pishtarët e natës", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 42).

Autori përdor përsëritjen duke rimarrë trajta të ndryshme të së njëjtës fjalë (*dhe/dheu/dheut*), ai gjithashtu përsëriti lema të ndërtuara me të njëjtin mjet fjalëformues, dhe të gjitha këto i ka vendosur jo në funksion të një situatë intensive, por të antonimisë (*e mira-e keqja*).

**përlyhej** (...*Por s' do harrue se edhe veshja të gënjen shpesh se kë ke përballë, dhe se nga një imtësi në atë dolamë të kushtueshme të shtegtarit që nuk e njeh, nga një sumbull - le të jetë kjo arit të kulluet - e qepun jo simbas shijes së zgjedhun, e zbulove nëse bartësi ashtë zot i derës bujare, ose edhepse prindësh të vorfën, i ritun për së mbari, me zemër ma të ambël se fjalën në gojë, apo krejt ndryshe, don me thanë, skuth shtiratës, shpirtlig, mos me iu varë strajca as prej një skarthi, i trenët e plot të zeza që as arra e mbyllun në lëvozhgë mos me iu marrë dore sepse përlyhesh asi...*) ("Gjon Gazulli", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 270).

Kësaj folje ia rrisin vlerën përdorimi i sinonimisë, mbiemrat metaforikë, njësitë frazeologjike, por edhe shprehjet popullore.

**përlyhej** (...*Punë e pabukur kjo? Po, por për t'u mbrojtë nga i ligu, përlyhet shpesh petku i pafajnisë, ashtu si thartohet edhe vena e re para se të ulet në katoje të nëndheshme...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.39).

**përbluej** (...*për të vëzhgu nëse ajo përbluente në tru të veta shllim të tilla...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 238); (...*Dhe ndonëse ishte andej qafash, Jerës ia ndinte zemra se një ditë, sado vonë dotë shkonte, do të kish kapërcye majen dhe do të ishte ndeshë sy më sy me djalin e huej. Ajo, ndër këso rastesh, përbluente në vete thanjën se mali për mal piqet, por njerëzit, po!...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 164).

Leksema “përblue” nga ana semantike është e njëjtë me fjalën “blue”, por shkrimtari ka vendosur ta përforcojë atë semantikisht e stilistikisht me anë të parashtesës për-, e cila shërben gjithashtu edhe për të zgjeruar përmasën e kuptimit të saj. Intensitetet krijojnë edhe rimarrjet e fjalëve e ndajshitesave (*qafash-rastesh, sy më sy, mali me mal*).

Nuanca të holla ligjërimore krijojnë edhe ndërtime të tjera me këto parashtesa.<sup>134</sup> Camaj përmes këtyre ndërtimeve përpiket të krijojë një stil vetjak, e me të drejtë gjuhëtari Gj. Shkurtaç, shprehet: “*Stili i një shkrimtari paraqet një sistem të mënyrave të shprehjes që del nga zgjedhja e përdorimit të elementeve të gjuhës. Megjithatë, në dallim nga stilet funksionale, kjo zgjedhje dhe ky përdorim përcaktohen jo vetëm nga domosdoshmëria e dhënies së një vështrimi (kuptimi) të caktuar, por edhe nga prirja për ta veshur mendimin me një formë sa më origjinale, efektive dhe estetike*”.<sup>135</sup>

d) Me anë të parashtesës për- Camaj arrin të formojë edhe **ndajfolje**, të cilat i shërbejnë për të krijuar ngjyresa të veçanta kuptimore e stilistikore. Kjo ndajshitesë i është paravendosur temave ndajfoljore dhe i jep leksemës së krijuar një kuptim intensiv, si: *përngeshëm-krahas.ngeshëm, përngadalë-ngadalë, përpishëm-pishëm* etj.

Ndajfoljet **përngadalë, përngeshëm** nuk i kemi të pasqyruara në fjalorët e marrë për krahasim e me shumë mundësi janë krijime të autorit. Temat fjalëformuese të këtyre

134 përdredhë (...*tue u përdredhë majë gishtave si pula e dreqit...Dranja*, f.59); përpriu (...*përpriu njomëzën e frymës së detit...Dranja*, f.59) etj.

135 Gj. Shkurtaç, *Ndikim gjuhësor i letërsisë në jetën e shoqërisë*, në “Pesha e fjalës shqipe”, Tiranë, 2009, f. 15.

fjalëve janë të pasqyruara në Fjalorë si ndajfolje: *ngadalë* (ecte ngadalë), *ngeshëm* (flisnin ngeshëm). Camaj në analogji me modelet e gjuhës popullore përpiket të krijojë fjalë të reja, por edhe t’u japë atyre ngjyrim stilistikor me vlerë përforcuese.

**përngadalë** (...*kisha një copë akulli në kurm që duhej shkri përngadalë para flakadanit...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 105); (...*tue e paraftyrue atë si njeri të vetëm që e bren sëmundja përngadalë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.72).

**përngeshëm** (...*flitnin përngeshëm dhe, të ditun ashtu si ishin, u kish hije kuvendi...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 74); (...*sillej përngeshëm me foshjtë e mjaltit...*) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.189); (...*në kohë të lirë e shtrinte kuvendin përngeshëm...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 89).

**përbujshëm** (...*Ndamja e Barnatarit prej Agripës ngjau përbujshëm...*) (“Karpa”, Mynih, 1978, f. 6).

Ndërtimet ndajfoljore, si: *përjashta*, *përmbrenda* i gjejmë të përdorura që tek Buzuku.<sup>136</sup>


**përjashta** (...*varret janë mbyllë përjashta...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 65).

**përmbrenda** (...*t’u lidhim kryet problemeve tona këtu përmbrenda...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 120); (...*njeriu ndërron fëtyrë vetëm përmbrenda...Loja mbasdrekës...përmbrenda atij avulli...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 79).

---

136 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I, Shkodër, 2000, f. 409. Përmbrenda “për enbrenda nah kemi” XLV,I.”; “nah përjashtënah njohm” XXXVII,IV.”

Formimet me anë të parashtesës për-



### 3.1.11. Formimi i fjalëve me parashtesën s-

“*Ndajshtesa s-* del edhe me alomorfin z-. Përdorimi i saj është i kushtëzuar fonetiki. Trajtimi i s- e z- si alomorfe është i përligjur, sepse ato janë të afërta fonetiki, kryejnë të njëjtin funksion në planin kuptimor dhe përdorimi i tyre kushtëzohet fonetiki. Pra, nuk mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën.”<sup>137</sup>

Gjuhëtarët A. Xhuvani e E. Çabej për këtë ndajshtesë, shprehen se “ajo u ngjitet emrave, mbiemrave, foljeve dhe ndajfoljeve, pa ndonjë kuptim të caktuar, ose me funksione të ndryshme, ajo bashkohet vetëm me tema fjalëformuese që fillojnë me bashtingëllore të pazëshme”.<sup>138</sup>

Në veprën e Camajt kjo parashtesë nuk ka përdorim të gjerë, atë e hasim në ato leksema që janë të mbarë shqipes, si:

**smirë** (...u kish *lakmi*, ndoshta edhe **smirë**...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.27); (...ngjallte *kureshti*, e mandej **smirë**...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 101).

Nga tema foljore *kuq* kemi ndërtimin e emrit *skuqje* (kjo leksemë përfshihet tek formimi me prapashtesën -je, por u trajtua këtu për të treguar larminë e përdorimit të fjalëve) dhe të mbiemrit *i skuqur*, që përdoren me mjeshtëri nga autori.

**skuqje** (...mes dy nëndhësive që mbulojnë **skuqjen** e mollzave...) (Lirika midis dy moteve, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 92); **i skuqun** (...ashtu të farkohem në jetën reale si hekuri **i skuqun** në ujë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 99).

### 3.1.12. Formimi i fjalëve me parashtesën stër-

“*Ndajshtesa stër-* u ngjitet emrave e foljeve me funksione të ndryshme, ose sot pa ndonjë funksion të caktuar. Sipas G. Meyerit e Weigandit kjo parashtesë ka rrjedhur nga lat. *extra* a nga it. *stra-*. E asaj gurre është edhe parashtesa rumune *stra-*, si p.sh. në bat: *strabat*, nepot: *stranepot* (khs. *stërnip*). Kjo ndajshtesë u ngjitet emrave e foljeve, me funksione të ndryshme, ose sot pa ndonjë funksion të caktuar.”<sup>139</sup>

Studiuesja L. Buxheli, për fjalët e formuara me anë të kësaj parashtese, pohon se “ky formant zakonisht u mbivendoset temave foljore dhe semantiki ajo “shpreh ngjyrimin e zmadhimit, të teprisë”.<sup>140</sup>

Tek Camaj me anë të kësaj ndajshtese duam të veçojmë ndërtimet: **i stërpjekun** dhe

137 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008, f. 136.

138 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 402.

139 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 405.

140 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008, f. 140.



*të stërkallëzue*, që vijnë nga tema të mbiemrave prejfoljorë. Këto leksema nuk i kemi të listëzuara tek Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi”, te Fjalori i gjuhës shqipe të viti 1954, tek Fjalorët e 1980 e 2006. Ndërsa tek Gazulli si folje stërpjek e hasim me formën sinonimike rrpjek: e stërpoqa mishin. Camaj arriti ta pasuronte leksikon e veprave të tij me rigjallërimin e fjalëve e shprehjeve dialektore, të cilat janë tepër të hijshme e tingëlluese.

**i stërkallëzuem** (...si të më kishte *kallëzue* një përrallë të lashtë, ***të stërkallëzue*** kushdi saherë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 99).

Për të arritur shprehësinë autori përdor formime në bashkëvajtje me fjalët nga të cilat kanë dalë, ku mbiemri më ndajshitesën stër- merr ngjyresën stilistikore.

**i stërpjekun** (...ashtu si bie prej peme një fryt ***i stërpjekun***...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 70).

**i stërdëshmuem** (...Shpikje ishte kjo, eksperiment i provuem e ***i stërdëshmuem***..) (“Karpa”, Mynih, 1978, f. 26).

Në shqipen standarde me anë të ndajshitesës stër- “*formohen edhe mbiemra të cilët kanë kuptimin e shkallës sipërore të temës fjalëformuese*”.<sup>141</sup> Kështu kemi ndërtimet, si: *i stërlashtë*, *i stërhollë* etj., të cilat përveç kuptimit të teprimit a zmadhimit, zakonisht tek Camaj vjen e përshkallëzohet edhe me nuanca keqësuese, p.sh.

**i stërlashtë** (...normë rituale e ***stërlashtë***...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 94)

**i stërholluem** (...shumica e gjurmuesve në sallën e posaçme të librave të lashtë e të inkunabullave ishin murgj të vjetër, pos disave, fytyrë-imët, hije bujare hebrejsh ***të stërholluem*** shpirtnisht prej dijes...) (“Palimpsest”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 179); (...mandej, ngutshëm e këputi kuvendin e ***stërhollë*** dhe shtoi, gjithnjë tue u shfajsue...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 276); (...rrudhte buzët e qiste jashtë ***majën e gjuhës të stërhollë*** si me dashtë të përmbahet të mos i kërcejnë edhe ma tepër dreqnit e t’i hyjë Vitoit në shputa derisa t’i plasë faqja...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 105).

Në të tre shembujt e mësipërm mbiemri *i stërhollë* bëhet pjesë e figuracionit, duke rritur shprehësinë brenda kontekstit ku ato përdoren.

Shkrimtari ndajshitesën stër- zakonisht ia mbivendos temave foljore duke i dhënë fjalës një kuptim zmadhimi a teprie. Si karakteristikë të këtyre formimeve mund të përmendim faktin, se: “*në pjesën më të madhe të tyre ruhet edhe sot e gjithë ditën me*

141 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 186.

përdorim të mëvetësishëm edhe primitivi i tyre, folja që shërben si temë prodhuese: stërfalem (falem), stërholloj (holloj)”<sup>142</sup> Kjo parashtesë, shprehet gjuhëtarja L. Buxheli: “U jep foljeve dhe ngjyrimet të tjera kuptimore dytësore, si ai intensiv ose i përsëritur etj., të cilat gërshetohen me kuptimin e pare.”<sup>143</sup> Ndërsa studiuesi S. Riza duke iu referuar foljeve të tilla, si: u stërfalun, u stërkequn, stërmundur etj., të ndërtuara më këtë ndajshitesë pohon, se: “Parashtesëzim foljesh me parashtesën stër- që tregon qoftë përsëritjet më se të tepërta të të njëjtit veprim qoftë shpënie e tij përtej kufirit më të skajshëm”<sup>144</sup> Le të shohim disa shembuj nga krijimtaria e Camajt:

**stërhollue** (...pa i stërhollue fort mendimet...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 59); (...ai ma i moshuemi i Arrasve ndrydhej e shtrydhej në vete e i hidhte shikime pyetëse Kolës i cili, nga ana tjetër, përpiqej me e zhdërvillue thanjen e Nikës me fjalë e arsyetime të kajshme për vesh të shitësve, pa i **stërhollue** fort mendimet e të vëllatë nga droja se ky po i këcen e i thotë, jo ashtu po kështu desha me thanë unë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 59).

**stërhollim** (...ndërsa stërhollimi i tepërt përse fajtori e bani...) (“Loja e mbasadrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 53).

Kjo lemë sipas mënyrës së fjalëformimit përfshihet tek ndërtimet prapashtesore, por vlerat stilistikore i fiton me anë të parashtesës stër-, e cila i jep fjalës një kuptim zmadhimi, me hollësira tepër të imëta e të ngatërruara.

### 3.1.13. Formimi i fjalëve me parashtesën sh-

“**Parashtesa sh-** u ngjitet emrave, mbiemrave, foljeve e ndajfoljeve, me funksione të ndryshme, ose pa ndonjë funksion të dukshëm.”<sup>145</sup> Parashtesa sh- në krahasim me parashtesat e tjera ç-, zh-, na paraqitet më prodhimtare tek Camaj. Me këtë ndajshitesë janë formuar pak mbiemra të nyjshëm, ku duam të veçojmë mbiemrin i *shzemruem*, të cilin nuk e kemi të pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim. Ndërtimi i kësaj lekseme me anë të formantit sh- ia shton akoma më shumë kuptimin antonimik fjalës.

**i shzemruem** (...Edhe për Currin, kur e përfytyrosha si dashnor të Djellës, kisha ndjenja nënvleftësimi. Heronjtë e romancës sime të parë! Thosha fare **i shzemruem**. Ishte

142 A. Dhrimo, *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, në “Për shqipen dhe shqiptarët” 1, Tiranë, 2008, f. 359.

143 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008, f. 140.

144 S. Riza, *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë, 1994, f. 296.

145 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 450.

*xhelozit, kjo?...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 91).

*Kjo ndajshitesë, -siç shprehet studiuesesja L. Buxheli, - me vlerë intensive është më tepër karakteristike e ligjërit.*<sup>146</sup> Një dukuri e tillë është vënë re edhe në krijimtarinë e Camajt, pasi në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 kemi të pasqyruar lemën: *i shqetësuar*.

**i shqetë** (...*Pendohej se nuk i kish*te thanë haptazi se ai, Johannes Gasulius, ishte **i shqetë** sepse vuente nga malli për dhena të largëta, sa idetë mbas të cilave ngante natë e dit, *tash* sa vjet...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 263).

Me këtë ndajshitesë janë formuar folje kryesisht nga tema foljore dhe më pak nga emrat. “*Kjo parashtesë u jep foljeve të prejardhura një kuptim të kundërt me atë të temës fjalëformuese.*”<sup>147</sup> Studiuesi A. Dhrimo për ndërtimin e këtyre foljeve me anë të ndajshitesës sh- mendon, se “*karakteristike e këtyre foljeve është se veç nuancës së re kuptimore që kanë fituar “u është shtuar edhe vlera intensive e veprimt*”.<sup>148</sup>

**shpaloi** (...*Flora historinë e katundit e lidhi edhe me atë të familjes së vet. Për ilustrim, shpaloi* para syve të burrit të huej albume fotosh familjare, ku spikatnin veshjet vendase, vërtë të bukura, sidomos ato të grave për dit kremtje...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 244); (... *atë mbrame kur zbërtheu nyje pecash e shpaloi një rrogacë lëkure*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 43).

Në Fjalorin e vitit 1954 e 2006, kemi të pasqyruar trajtën foljore *shpalos*. çliroj.

**shliroj** (...*kush* na **shliro**n prej ngjyrës së zezë...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 9); (...*u mungon vullneti të shlirohen* ndijash të tilla...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 70).

Kjo parashtesë tek Camaj ndërton edhe të ashtuquajturat kuazihomonime, si p.sh. (...*Matesh e shmatesh* si pulë që don me fluturue në tra...) (“Rrunga në mars”, *Vepra 4*, f. 209); (...*ai ma i moshuemi i Arrasve ndrydhej e shtrydhej* në vete e i hidhte shikime pyetëse Kolës...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 61); (...*tue këqurë në lumë nësa ban punë dore, / arno sharno, një ti - një uji*...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 190) etj.

Gërshetimi i trajtave të gegërishtes me ato të standardit shfaqet natyrshëm edhe tek kjo mënyrë fjalëformimi, si p.sh.: *shpuploj, shpaguaj, shfajsoj, shpërrallime etj.*<sup>149</sup>

146 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008, f. 150.

147 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 350.

148 A. Dhrimo, *Aspekti dhe mënyrat e veprimt foljor në gjuhën shqipe*, në “Për shqipen dhe shqiptarët” 1, Tiranë, 2008, f. 361.

149 (...*e shpuplonte shpendin, e dlipte dhe e shtinte në hell*...Pishtarët e natës, f. 82); (...*fryma e egërsinës*

### 3.1.14. Formimi i fjalëve me parashtesën shpër-

Në lidhje me këtë ndajshitesë ka pasur mendime të ndryshme. Studiuesit Xhuvani e Çabej mendonin, se “shpër- është një parashtesë e përngjitur, që ‘ka dalë nga bashkimi i dy parashtesave sh- e për-, të cilat historikisht duke u përdorë në të njëjtën kohë, u shndërruan në një parashtesë të vetme, që sot ka ruajtur të dy funksionet: edhe funksionin intensiv (përforcues) të parashtesës për-, edhe funksionin antonimik. Ajo u ngjitet disa foljeve duke u dhënë një kuptim intensiv ose kuptimin e një përhapjeje a shtrembërimi, ose për të treguar një veprim të përkundërt.”<sup>150</sup> Ndërsa në “Fonetika dhe gramatika e gjuhës shqipe II”, shtrohet mendimi, se “parashtesa shpër- del e formuar relativisht vonë; në plan sinkronik ajo është parashtesë e thjeshtë, me të cilën janë formuar një varg fjalësh, të cilat hyjnë nga kuptimi në marrëdhënie kundërvënie ose antonimike me fjalët pa parashtesë”.<sup>151</sup>

Kjo parashtesë,- shton studiuesi M. Samara,- paraqet nuanca intensiteti në rastet kur brenda kontekstit takohen fjalë të krijuara me parashtesat për-/shpër-. Kemi një varg çiftesh antonimike, që kanë kundërvënie të karakterit sinonimik, por shkalla e kundërvënies së tyre nuk është plotësisht e njëjtë; kundërvënia midis fjalëve në çiftin përgojim - shpërgojim, është më e fortë, më e skajshme, se kundërvënia midis kuptimeve të fjalëve në çiftin gojoj - përgojim.<sup>152</sup> Le të shohim disa ndërtime të përdorura në krijimtarinë e Camajt.

**përgojim** (...Përkundra, atje nalt një motiv **përgojimi** tirret e merr trajta të qarta në rrethana vetmie ku një njeri i vetëm e peshon atë nga të gjitha anët, e tëhollon e kullon çdo gjasë e mundësi se ngjarja paska lindë e qenka zhvillue kështu e kështu...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 17).

Vlerën shprehëse të fjalës: *përgojim* ia rrisin edhe përdorimi i foljeve: *tirret*, *tëhollon* e *kullon*.

**shpërgojim** (...*shpërgojimet* delnin e zhvilloheshin ndryshe prej atyne që mbijnë ndër vende të thukëta banesash ku gjindja shkon e vjen tue u ndeshë disa herë në ditë dhe secili i shton thanjes një fjalë ashtë se, tue i shtue secili ngjarjes diçka çka i bie ndërmend, e paqenuna bahet e qenun mbrenda njëzet e katër orëve...) (“Pishtarët e

---

*shpaguhet*...Pishtarët e natës, f. 87); (...vetëm një gja të **shfajson** para meje...Rrunga në mars, f. 194); (...nëse kishte ndonjë fije të vërtetë në ato **shpërrallime**...Shkundullima, f. 109).

150 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 408.

151 Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, *Fonetika dhe gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1976, f. 36.

152 M. Samara, *Vëzhgime për antonimet me parashtesën shpër- në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1989, f. 311.

natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 17).

Për të arritur qëllimet e veta artistike autori ka futur në përdorim edhe thënie nga ligjërimi popullor.

**shpërndamje** (...e posaçme në këtë **shpërndamje** fjale ashtë se, tue i shtue secili ngjarjes diçka çka i bie ndërmend, e paqenuna bahet e qenun mbrenda njëzet e katër orëve...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 17).

**shpërndaj** (...këto sende që **shpërndave** nëpër kurt...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 59).

**shpërvilej** (...ndiqnin si **shpërvilej** bora...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 172). (E përdorur si folje); Në këto raste parashtesa sh- i është paravendosur një ndajstese tjetër duke krijuar ndërtime me vlera të forta intensive (krah. *përndamje-shpërndamje*) hiperkarakterizuese ose përsëritëse të kësaj vlere.<sup>153</sup>

Sipas studiuesit M. Samara,<sup>154</sup> *parashtesa shpër- ka funksion kundërshtues e privues dhe duke iu ngjitur temave foljore, u jep atyre kuptim të përkundërt. Ky kuptim del më i qartë sidomos kur brenda kontekstit jepet edhe folja që ka shërbyer si temë fjalëfomuese, si p.sh. (...lante e **shpërlante** tesha...)* (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 18).

Me anë të kësaj ndajstese janë formuar mbiemrat, si: *i shpërndamë, i shpërvjelun, i shpërngulun*.

**i shpërndam** (...ujë **i shpërndamë** si ajri...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 25). Khs. FGJSSH (2006) *i shpërndarë*.

**i shpërvjelun** (...me parzëm pak **të shpërvjelun**, si martire e përdhunueme dhe e përgjakun...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 101). Në FGJSSH (2006) *i shpërveshur si mbiemër e shpërvesh si folje*. Në këtë shembull Camaj ka pranëvënë dy parashtesa me vlerë intensive duke e rritur edhe më tepër shkallën shprehëse.

**i shpërngulun** (...banorët e saj ishin **të shpërngulun**...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 65). Khs. FGJSSH (2006) *i shpërngulur* etj.

**i shpërpjesëtuem** (...tue e shikue ashtu të hallakatun, fare kurm grueje **të shpërpjesëtuem**...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 121).

### 3.1.15. Formimi i fjalëve me parashtesën xh-

“**Parashtesa xh-** përdoret në vend të ç-së, përpara një bashtingëlloreje të zëshme,

153 A. Dhimo, *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, në “Për shqipen dhe shqiptarët” 1, Tiranë, 2008, f. 361.

154 M. Samara, *Vëzhgime për antonimet me parashtesa në gjuhën shqipe*, në “Studime filologjike”, nr.1, Tiranë, 1965.

si në *xhvat*, *xhvesh* etj. Ajo alternon me *zh-* në. Trajta historike e mirëfilltë e këtyre formanteve është *sh-*.”<sup>155</sup>

Ndërtimet e këtij grupi janë të pakta, si: *xhvesh*, ku autori ruan variantin dialektor të gegërishtes, pasi në standard kemi formimin: *zhvesh*.

**xhveshej** (...*Nika xhveshej, lente teshat në këtë anë të lumit...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 66); (...*pa xhveshë* këmishën e gjatë...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.189).

### 3.1.16. Formimi i fjalëve me parashtesën z-

“**Parashtesa z-** u ngjitet emrave, mbiemrave dhe foljeve, me funksione të ndryshme, ose pa ndonjë funksion të dukshëm.”<sup>156</sup> Trajta *z-* përdoret para bashtingëlloreve të zëshme. Një tipar karakteristik i alomorfit *z-*, që e dallon atë nga alomorfi *s-*, është se *z-* formon edhe folje të prejardhura me rrënjë të lidhur. Dukuri që e gjejmë të pasqyruar edhe në krijimtarinë e Camajt, pasi atë e kemi hasur tek ndërtimi i fjalës *zgur* si folje e si emër. Në Fjalorin e Gazullit e Fjalorin e vitit 1954 kemi trajtën emërore: *zguer-zgori, zgavr, golle*, ndërsa në Fjalorin e M. Elezit kemi përdorimet, si *emër, si mbiemër e si ndajfolje*.<sup>157</sup>

**zguroj** (...*duket si lis i fuqishëm që nis të zgurohet...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 82).

**zguresh** (...*tue mbajtë ndër duer gjahun e vrave:mëllinja, shepka e piktha trazuesa zguresh...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 140).

### 3.1.17. Formimi i fjalëve me parashtesën zh-

“**Ndajshtesa zh-** u ngjitet disa emrave dhe foljeve, me funksione të ndryshme. *Parashtesa zh-* shumë herë është një variacion i *sh-* së e i ç *-së* e *xh-së*.”<sup>158</sup> Me këtë ndajshtesë janë formuar zakonisht folje nga tema fjalëformuese foljore, si: *zhdukeshin, zhzemrue*.

**zhdukej** (...*zhdukeshin pa fjalë për dere, ngutshëm...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 96); (...*ashtë panjerëzi me e lëshue tryezën e me u zhdukë* kështu...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 39).

Një nga tiparet e gjuhës e stilit të Camajt është edhe përdorimi i disa parashtesave

155 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f.413.

156 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 413.

157 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1625.

158 A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 415.

në fjalë ku zakonisht nuk pritet një gjë e tillë, duke rritur forcën shprehëse. Këto kompleksje vlerash intensive e shohim edhe në shembullin e mëposhtëm, ku përdorimi i dy bashtingëlloreve z, zh krijojnë atmosferë zëshmimi. Autori shfrytëzon maksimalisht mundësitë e formave tingëllore për të krijuar një përjetim të veçantë emocional tek lexuesi.

**zhzemroj** (...për këtë u kujtue njeriu i huaj dhe u **zhzemrue**...) (“Katundi me gjuhë fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 247)..

Foljet me parashtesën zh- janë folje edhe me rrënjë të lidhura. Rrënjët e këtyre foljeve nuk kanë përdorim të mëvetësishëm. Lidhur me këtë dukuri gjuhëtari E. Hysa, pohon: “Zbërthimi dhe analiza e këtyre njësive bëhet e mundur në bazë të opozicioneve binare të dy njësive me kuptim të kundërt antonimik...Në këtë mënyrë, bëhet e mundur të dallohet që në të dy gjymtyrët e pozicionit ka nga një parashtesë të lirë dhe nga një temë të lidhur, e cila është e dallueshme vetëm në sajë të këtyre opozicioneve.”<sup>159</sup>

Folje me rrënjë të lidhur na dalin edhe me alomorfin zh-, ku brenda një konteksti të ngushtë kjo parashtesë krijon antinomi të plotë, si në shembujt:

(...vrapoja **andërr** e **zhgjandër**..) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 29); (...**dukja** e **zhdukja** e pishtarëve...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.46).

\* \* \*

M. Camaj, ashtu siç e kemi shprehur edhe më lart të mahnit me artin e tij të shkruarit. Ai në krijimtarinë e tij u mbështet fort në leksikun popullor, e shfrytëzoi si atë edhe të shqipes letrare e të dialekteve, veçanërisht ai njeh dhe përdor mjaft fjalë e shprehje nga e folmja e vendlindjes. Në shumicën e rasteve u jep fjalëve kuptim të ri leksikor. Shkrimtari jo vetëm gjallëroi e përdori fjalë të bukura popullore, por edhe krijoi, disa nga ato gjithmonë sipas modelit të shqipes. Vlen të theksohet se në veprat letrare të këtij shkrimtari parashtesat *për-* dhe *pa-* kanë qenë më prodhimtare në formimin e *emrave*, *mbiemrave* dhe *ndajfoljeve*. Më pas kemi përdorimin e formanteve: *stër-*, *shpër-*, *mos-*, *nën*, *para-*, *sh-*, *zh-*, *ç-*, *s-* dhe më pak ndajshitesat me prejardhje të huaj *a-* e *dis*.

Më poshtë po paraqesim ato leksema që mendojmë se ka shumë mundësi të jenë ndërtime të autorit të formuara me anë të parashtesave. Me anë të ndajshitesës **për-**, si


159 E. Hysa, *Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*, në “Studime filologjike”, nr. 3, Tiranë, 1973, f.98.

parashtesa më e përdorur në krijimtarinë e Camajt, mendojmë që autori ka formuar leksemat: *përqumështi, përkënaqësi, i përkënaqur, e përndalun, përkënaqem, përndal, përvështirësoj, përngeshëm, përngadalë, përpishëm.*

Leksemat: *pabestar, papajtim, papërndalje, palëvizja, e pakeq, i papashëm, i pambërritshëm, pamjeshtrisht, pakujtueshëm,* ka të ngjarë që të jenë formime të Camajt, me anë të formantit **pa-**. Autori përpiqet të krijojë fjalë të reja edhe me anë të ndajshtesave të tjera, si: *mosbesueshëm, nënkuptueshëm, e çshkujdeshme, i shzemruem, i stërpjekun, të stërkallëzue.*



**Paraqitja skematike e parashtesave sipas dendurisë së përdorimit**



### 3.1.2. Formimi i fjalëve me prejardhje prapashtesore

“Gjuha me thesarin e saj gjithmonë ka “mjete” për të përcaktuar individualitetin e artistit.”<sup>160</sup> Është pikërisht shkrimtari e gjuhëtari M. Camaj, që diti të shfrytëzojë në maksimum mundësitë e mjetet shprehëse të shqipes.

Mjeshtria e këtij artisti të penës duket sidomos në krijimet gjuhësore e përftesat shprehëse, ku ai u mbështet në gjuhën popullore e shfrytëzoi ato elemente që janë prodhimtare në gjuhën shqipe. Fjalët e prejardhura të formuara me prapashtesa janë të shumta duke ndjekur kështu prirjen e përgjithshme të shqipes.

Numri i ndajshesave të përdorura është relativisht i madh, por vetëm disa prej tyre marrin kuptim përforcues ekspresiv, të cilat të tërheqin vëmendjen me dendurinë ose me rolin stilistik që Camaj u jep në kontekste të ndryshme.

Prapashtesat *-shëm*, *-as e -isht* janë më të përdorurat në veprat e Camajt, ato shërbejnë për të ndërtuar *ndajfolje e mbiemra*, ndajshesat *-ar*, *-tar*, *-i* janë më të shumta te *emrat*, prapashtesa *-im* tek *emrat abstraktë*, ndajshesa *-o* tek *foljet* etj.

Autori ka përzgjedhur dhe përdorur prapashtesa që mbartin dhe shprehin ngjyrimet të ndryshme kuptimore, ku ndonjëra prej tyre ka fituar edhe vlera stilistikore. Me fjalët që po analizojmë, ashtu siç kemi theksuar edhe tek formimi prapashtesor, jo të gjitha janë krijime të shkrimtarit Martin Camaj, ndonjëra prej tyre ndeshet edhe në autorë të tjerë paraardhës, bashkëkohës, por nuk mungojnë edhe leksema nga autorët e vjetër.

Në krijimtarinë letrare të Camajt përdorim më të paktë kanë ndërtimet me ndajshesat: *-ac*, *-acak*, *-ak*, *-an*, *-ash* të cilat veç kuptimit zvogëlues a zmadhues kanë edhe kuptimim pejorativ.

#### 3.1.2.1. Formimi i fjalëve me prapashtesën -ac

**Prapashtesa -ac** ka kuptim keqësues më të fortë se prapashtesa -ak, atë e gjejmë të përdorur tek leksemat:

**përtac** (...breznitë e hershme **përtace** kishin qitë fjalën se edhe po t'i bahej mudi, *Fundina qenka tokë rrabe*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 14).

**shurdhac** (...nuk të bahet me besue se ashtë **shurdhac** e i pagojë...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 14).

---

160 E. Sepir, *Gjuha - Hyrje në studimin e ligjëritimit*, Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 249.

### 3.1.2.2. Formimi i fjalëve me prapashtesën -acak

*Ndajshtesa -acak* nuk ka një shtrirje të gjerë në krijimtarinë e Camajt. Gjuhëtarët A. Xhuvani - E. Çabej, mendojnë se “*mbiemrat e formuar me prapashtesën -ak vijnë nga tema fjalëformuese që mbarojnë me -ac. Nga ana tjetër gjuhëtarët pohojnë, që bashkëvajtja e vazhdueshme e këtyre dy prapashtesave ka bërë që ato të ndjehen si një prapashtesë e vetme fjalëformuese e të formohen fjalë të reja.*”<sup>161</sup> Kjo ndajshtesë tek Camaj u është pasvendosur temave foljore: *endem, vij* duke dhënë lemat: *endacak, erdhacak*.

**endacak** (...*krizma e hapave t'endacakut natën e ditën për vapë...*) (“Lirika midis dy moteve” në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f.85).

**erdhacak** (...*erdhacaku vetëm ndezi zjarmin e u ndry mbrendë...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 158).

Edhe në këto ndërtime kjo prapashtesë ka kuptim keqësues, përbuzës.

### 3.1.2.3. Formimi i fjalëve me prapashtesën -ak

Me anë të *prapashtesës -ak*, në krijimtarinë e Camajt krijohen mbiemra prej temash foljore ose mbiemërore, si: *spjerrak, pjellak*. Kuptimi i fjalëve të formuara me këtë prapashtesë, siç vërejnë A. Xhuvani e E. Çabej, “*mund të jenë pejorative ose jo*”.<sup>162</sup>

**spjerrak** (...*filozofi që vinte prej anës së vjetër të Alpeve ishte një spjerrak burri, me kocka të mëdhenj...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 257).

Autori këtë leksemë e ka dhënë me kuptimin : *burrë shtatlartë*.

Nga tema foljore *pjell* kemi formimin *pjellak* me kuptim përqeshës:

**pjellak** (...*Prespa grue e gjanë pjellake./ Prespa grue lehonë...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1* Tiranë, 1996, f. 188).

Ndajshtesa -ak rrallë u shtohet temave emërore për të krijuar emra, në këto raste kuptimi përqeshës është i zbehur, si p.sh.:

**pusak** (...*për mos me shkelë në pusakët e shumë të ujit nëpër rrugë...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 60).

Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1980 e 2006 ka të listëzuar këto formime: *pus, pusi, pusingritës, pusizënë*. Futja në leksik e lemës *pusak* do të zgjeronte çerdhen fjalëformuese të saj.

161 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 427.

162 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 431.

#### 3.1.2.4. Formimi i fjalëve me prapashtesën -an

“Prapashtesa -an është pak prodhimtare në krijimin e mbiemrave. Me këtë prapashtesë janë formuar disa mbiemra cilësor kryesisht me kuptim pejorativ nga tema emërore.”<sup>163</sup>

Me kuptim keqësues tek Camaj është përdorur leksema *shkjepan*, ndërsa tek fjala *breshkan* kemi ndërtimin e një emri sipas origjinës nga vjen.

**shkjepan** (... *vetëm një verë ka moti e unë kisha një mik që më theu krah e kambë në besë e më la shkjepan...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 10).

**breshkan** (...*kur gruaja ik andej, breshkanit i shkëlqen dheu përpara si argjend i vjetër...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 33).

#### 3.1.2.5. Formimi i fjalëve me prapashtesën -ar, -are

“Prapashtesa -ar, fem. -are është e vjetër në gjuhën shqipe, ajo del që tek libri i *Buzukut*.”<sup>164</sup> “Letërar - i -e. ital. lettero. lat. Littera: “thotë shenjti doktuor me gjithë tëh tjerëtë leterarë” XXVI,I.”<sup>165</sup> Për sa i përket përhapjes dhe burimit të saj, A. Xhuvani - E. Çabej, pohojnë se: “Nga gjuhët ballkanike këtë prapashtesë e kanë serbo - kroatishja, bullgarishtja, rumanishtja e greqishtja e re, në shumë emra prej emrash e foljesh.”<sup>166</sup>

Gjuhëtari E. Hysa duke trajtuar këtë formim të emrave nënvizon faktin, se “ato tregojnë origjinën, duke shënuar banorin e një fshati, të një krahine a të një qyteti, ose shënojnë mjeshtrinë e një personi, i cili merret me atë që tregon tema fjalëformuese”.<sup>167</sup> Me anë të kësaj prapashtese Camaj ka krijuar emra që bashkohen me tema fjalëformuese emërore, të pammë, si: **hekurar**, **katundar**, **mesjetar**, **shkollar**, **letrar**, **dijetar**, **shortar**, **gënjeshhtar** <sup>168</sup>etj.

Tek këto ndërtime veçojmë fjalën **hekurar** që do të thotë “ai që punon hekurin, ai që bën punimin e hekurit”. Kjo është një leksemë dialektore, sot ajo është zëvendësuar me fjalën *farkëtar*.

163 A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 3, 1972, f. 59.

164 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 159. Shih L. Xoxe, *Rreth formimit të fjalëve te Gjon Buzuku*, (temë diplomë, dorëshkrim), Tiranë, 1978.

165 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I, Shkodër, 2000, f. 358.

166 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 444.

167 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 159.

168 (...*as po di di me i rregullue ti, shkollare si je...*Rrungaja në mars, f. 170); (...**shkollari** ushtronte qëllimisht duresë ...Rrungaja në mars, f. 211); (...*për të mos ia pa kurrë sytë asaj katundareje ogurzeze...*Rrungaja në mars, f. 223); (...shumë **kureshtare** Lena me ditë imtësitë...Pishtarët e natës, f.42) etj.

**hekurar** (...për të pre qymen me to, si hekurar i vërtetë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 49).

Në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e në Fjalorin e vitit 1954 kemi të listuar disa lema, si p.sh.: hekuraqe, hekurimtë, hekurinat, hekurishte, hekuros, i, e hekurt etj. Fjalori i gjuhës shqipe (2006) krahas këtyre përdorimeve ka edhe trajtën emërore: hekurtar me kuptimin farkëtar. Kjo leksemë mund të shihet si një variant i dytë dialektor, që ruhet vetëm në të folmen e vendlindjes së autorit.

Në krijimtarinë e Camajt formimet mbiemërore janë më të pakta. Ata formohen nga tema emërore dhe kanë kuptim përkatësor. Lidhur me këtë dukuri studiuesi A. Dhrimo shprehet, se “Një pjesë e mirë e këtyre ndërtimeve janë të gurrës popullore e disa të tjera janë formime të gjuhës letrare, më fort sipas modeleve të huaja.”<sup>169</sup>

**kreckar** (...dhe anzë asht vajza kreckare / e egër e me trajtat e anzës / së egër në drunin e kreckës...) (“Lirika mes dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 95).

Kreckare ka kuptimin e një vajze krenare, kryelartë.

### 3.1.2.6. Formimi i fjalëve me prapashtesën -as

Për këtë ndajshitesë A. Xhuvani - E. Çabej pohojnë, se “-as formon emra të prejardhur dhe etnika e është identike me -ës si: vendas e vendës, Beratas e Beratës.”<sup>170</sup>

a) Me këtë prapashtesë në krijimtarinë e Camajt janë formuar pak **emra** të prejardhur prej emrash, si: *dheas*, *dukagjinas*, *dorëras* etj.<sup>171</sup>

**dheas** (...që kishin plaçkitë e vra **dheasit**...) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 175); (...dëshmoi se skota e Dranjes, atje, nuk ishte erdhacake, por **dhease**...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.25); (...u përgjigj **dheasi** pacaktueshëm...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 102).

Fjalën *dheas* autori e fut në veprat e tij për të shprehur ndjenjën e fuqishme të tërheqjes, të tokës e dheut të të parëve, e për të na thënë se *dhease* (tokësore) është edhe krejt krijimtaria e tij.

b) Përdorim më të dendur ka kjo ndajshitesë në formimin e **ndajfoljeve** të mënyrës nga tema të ndryshme emërore, foljore, mbiemërore e ndajfoljore.<sup>172</sup>

169 A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 3, 1972, f. 60. Ja disa shembuj: (...shkova me gjetë botën **polare**...Nema, f. 111); (...bjerraditës shekujsh **mesjetarë**...Njeriu me vete e me tjerë, f. 184); (...lidhjet **familjare** e humbën fare drejtpeshimin...Pishtarët e natës, f. 44) etj.

170 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 447.

171 (...je i **dukagjinas** - i thanë-...Dranja, f.24); (...secili e lodhte mendën t’i bjerë në të se kush paska qenë **dorëras**...Pishtarët e natës, f. 88).

172 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 446.

Në krijimtarinë e Camajt kemi ndërtimin e *ndajfoljeve* më tepër nga *tema mbiemërore e foljore*. Shkrimtari duke shfrytëzuar lemat: *i vutë, i thukët, trashaman, kryeneç, i rrebët, i saktë, i thatë e i mangët* bëri përpjekje për të dhënë forma të reja *ndajfoljore*, si: *vutas, thuktas, kryeneças, trashamanas, rrebtas e mangtas* të cilat disa nuk dalin të pasqyruara në Fjalorët e marrë në krahasim me një formë të tillë. Disa nga këto ndërtime janë fjalë që gjenden të përdorura në autorët paravajtës, ose janë forma dialektore që gjallojnë në vendlindjen e Camajt. Përcaktimi nëse janë neologjizma të autorit edhe këtu paraqitet mjaft i vështirë.

**kryeneças** (...*ju kapeni kryeneças për tezën se fytyra juej e njohun prej meje paska humbë si sëpata pa bisht në pyll...*) ("Gjon Gazulli", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 279); (...*por vijnë të shkruejnë kryeneças deri në fund...*) ("Djella", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 86).

Fjalori i vitit 1954 e Fjalorët normativ të vitit 1980 e 2006 ka të pasqyruar format: mbiemërore: *kryeneç*: kokëfortë e emërore *kryeneçësi*: të qenët kryeneç. Po t'i referohemi Fjalorit të M. Elezit, autori shprehet, se *kjo fjalë del e pasqyruar kryesisht tek krijimtaria e M. Camajt*.<sup>173</sup> Përpjekja e autorit për ndërtimin e formave të reja duke shfrytëzuar lemat e shqipes vihet re dukshëm edhe tek ndërtimet me prapashtesën -as.

**rrebtas** (...*Gjaku sytë Vocit ia zuni, / e kap shpatën e varun n'lis. / Spata Pepës i ndodh për bri / e kur ia ngjiti e shtërngoi / sa e vogël iu ba n'dorë. / Kur ai rrebtas suell / pikë pikë shpatën t'vllat ia bani / e tehin ia ngul në krahnuer / e pa frymë e lëshoi n'ujë...*) ("Legjenda", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 173).

Camaj për të arritur shprehësinë e duhur përdor edhe elemente të fonostilistikës, siç është ndërrimi i bashtingëllores së shurdhët **p** me atë shpërthyes **b**.

**trashamanas** (...*Curri atë natë kishte punë njerëz të tjerë, me Djellën që i zgërdhihej trashamanas e mandej humbte në terr kah Ndërsana e vet, te njerëzit e saj që vëreshin malësorin e dalun vendit të vet me katër palë sy...*) ("Djella", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 84).

Tek Fjalori i vitit 1954 kemi trajtën emërore: *trashaman* e atë *ndajfoljore*: *trashamançe*, kurse në FGJSSH (1980) e (2006) kemi mbiemrin *trashaman*: *njeri trashaman*, e trajtën emërore *trashamanësi*: të qenët i trashë nga mendja. Forma *trashamanas* shprehet M. Elezi gjendet e përdorur kryesisht në veprat e M. Camajt.<sup>174</sup>

173 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 753.

174 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1483.

**thuktas** (...retë zenin **thuktas** shtegun e qiellit e nuk lëviznin...) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 202).

Fjalori i Gazullit ka përdorimin e trajtës emërore: *thuk-u*.<sup>175</sup> Ndërsa në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 kemi edhe trajtën mbiemërore *i, e thukët, i rrasët i ngjeshur mirë*, FGJSSH i vitit 1980 e 2006 pasqyrojnë trajtën mbiemërore e ndajfoljore: *i, e thukshëm* (mb.) dhe *thukshëm* (nd.) me ndajshitesën -shëm, Fjalori i M. Elezit ka të shënuar trajtën emërore e mbiemërore të përdorur nga E. Koliqi.<sup>176</sup> Camaj për ndërtimin e kësaj ndajfolje parapëlqen trajtën me prapashtesën -as, e cila fiton edhe një kuptim intensiv përforcues.

**thatas** (...vërejtji Marku **thatas**. - Ndoshta prej dhimbës së madhe...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 86).

Fjalori i vitit 1954 ka të listëzuara këto përdorime: *thatanik* (mbiemër), *thatik, thatim, thatinë e thatiq* si emra e si mbiemra, ndërsa FGJSSH (2006) e zgjeron këtë çerdhe fjalëformuese edhe me leksemat: *thatuc e thatuk*, të përdorura si emra e si mbiemra, por ndërtimin me ndajshitesën -as, nuk e gjejmë të përdorur. Autori me anë të kësaj prapashtese është përpjekur t’i japë fjalës vlerë artistike e figurative me anë të kuptimit intensiv përforcues që ajo mbart, por edhe të pasurojë leksikun e shqipes me anë të lemës: *thatas*.

**mangëtas** (...a e njeh mire apo **mangëtas** gjendjen aktuale në Karpë...) (“Karpa”, Romë, 1987, f. 35).

Camaj këtë fjalë e ka përdorur me kuptimin - jo i plotë.

**saktas** (...më kujtohet **prekja e gjarpnit të fshehun në fier, saktas** ndija e të ftohtit të një lëkure të lëmuet...) (“Palimspesht”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 177); (...**qenkej saktas e sëmunë**...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 83).

Në FGJSSH (2006) nga mbiemri **i, e saktë** kemi ndërtimet: *saktësi*, -a (emër) saktësia e veprimeve; *saktësisht* (ndajfolje) *foli saktësisht, saktësoj* (folje) e *saktësoi kohën; saktësim* (emër) *kërkoi saktësim*. Kjo ndajfolje është një fjalë dialektore, e futur në përdorim vonë. Leksema saktas në këtë rast zëvendëson togun: me saktësi që përdoret në ligjërimin e sotëm.

**vutas** (...faqja e malit që kishte lanë përmbas përkulej prej aty ku qëndronte deri në

175 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010, f. 440. Jë shëndoshë e bâ si thuk: si top (SHK.)

176 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1526.” 1. Thuktësi, -a f. nj. (prej thukët). Të qenët i thukët. “...thuktësinë e heshtjes zotnuese” (E. Koliqi, Shija...) 2. Thukur (i,e) mb.. i ngjeshur, i rrasur. “...mbas një majeje kodre mbulue me kaçuba të thukuna...” (E. Koliqi, Pasqyrat e Narçizit).”

*katund, buzë lumit, vutas, ashtu si lakohet korpi i njeriut në karrige për të fjetë pakëz...*) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 174).

Fjalori i Gazullit shënon trajtën mbiemërore *i vûtë* - i, 1. *vend i vûtë*: i fushët, plantë, ndërsa FGJSSH (2006) e zgjeron kuptimin e kësaj fjale: 1. *shtëpi e vutë*. 2. fig. i bindur, kokulur; i butë: djalë i vutë; fjalë të vuta. Këtë ndërtim ndajfoljor e gjejmë të pasqyruar te Camaj e në krijimtarinë e Gj. Fishtës.<sup>177</sup>

**fshehtas** (...*me të huejt takohej fshehtas*...) (“Karpa”, Romë, 1987, f. 72).

c) Me anë të kësaj ndajshese autori ka formuar **ndajfolje** zakonisht nga *tema foljore*, si: *deshtas, ndamas, ngjitas, haptas, befas, falas, ndejas, vjedhas, rrëshqitas* etj. Po të bëjmë një krahasim me standardin kemi pjesoret: *ngjitur e hapur*, ku ndajfoljet preferohen të ardhura nga pjesoret, ndërsa Camaj parapëlqen përdorimet me ndajshesën -as (tipar i gegërishtes) si, p.sh.:

**ngulmas** (...*tue i vrojtë ti ngulmas kishe ndie afshin e ngrohtë / si me qenë tue dalë vera e dheut nën libra*...) (“Palimspesht”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 201).

Kjo ndajshesë i jep fjalës një kuptim intensiv përforcues, me një ngjyrim të tillë e ndeshim edhe në shkrimtarë të tjerë, por me ndajshesë të tjera.<sup>178</sup> Në Fjalorin e vitit 1954 kemi të shënuara fjalët e prejardhura: *i, e ngulmët* (mb.); *ngulmim* (em.); *ngulmoj* (fol.); *i ngulshëm* (mb.), te Fjalori i Gazullit hasim përdorimin emëror: *ngulim* e trajtat ndajfoljore: *ngulshëm, ngulas*, FGJSSH (2006) pasqyron trajtat: *i, e ngulmët* (mb.); *ngulmues* (mb.); *i, e ngulshëm* (mb.); *ngultas* (ndajf.) beson (shpreson) *ngultas*, (me ngulm), kurse M. Elezi në fjalorin e tij shprehet, se *kjo ndajfolje del e përdorur kryesisht nga M. Camaj*.<sup>179</sup>

**ngultas** (...*kujtimi i saj i zente frymën, andaj përfytyronte ngultas lagështinën e anijeve mes fortunës së detit*...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 289).

“*Prapashtesa -as ka si variant të saj ndajshesën -azi, kuptimi që fitohet nga këto prapashtesa në shumicën e rasteve është i njëjtë*.”<sup>180</sup> Një variant sinonimik të kësaj lekseme e gjejmë të përdorur tek krijimtaria e I. Kadaresë: “Ajo më vështroi ngultazi.”<sup>181</sup> Në FGJSSH (2006) kemi përdorimin: *ngultas*: vështronte ngultas. Të

177 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1594. “Vutas ndajf. (prej vutë). Jo shumë pjerrët, butë. Brika çohet vutas përpjetë.”

178 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1005. “1. Ngulshëm “...mundohej ngulshëm t’i shporrte prej kreje” (A. Demaqi, Në flakë). 2. ngulmënisht “ishte ngulmënisht i vendosur...” (E. Koliqi, Shija...” 3. Ngulmueshëm “...të trokiturat u përsëritën ngulmueshëm...” (A. Tufa, Fabula Rosa).

179 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1005.

180 E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, SF, 1, Tiranë, 1970, f. 116.

181 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1005.



dyja fjalët kanë të njëjtën mënyrë formimi, por janë të përdorura me nuanca të ndryshme kuptimore, ku ndajfolja ngulmas përdoret me kuptim më përforcues, më ngulmues, që ngulitet aq shumë në mendje saqë është e vështirë të largohet.

**deshtas** (...*ma vonë do t'i shkoj mendja se do të kishte ba mirë sikur deshtas të ishte mbyttë në lumë atë mëngjes...*) (“Karpa”, Romë, 1987, f. 22).

Këtë leksemë autori e ka përdorur me kuptim të ri leksikor - me qëllim.

**ndamas** (...*një cope dhe ndamas, mbi të...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.102); (...*marrë ndamas, mund të duronte...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 232); (...*merrnin ma së pari ndamas në shqyrtim idenë në vetë...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 266); (...*jemi largue andej ndamas, secili për një rrugë...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 103).

**ngjitas** (...*E andej bregut majet / Ecin ngjitas me te / Si shumë re që mësyjnë detin...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 160); **haptas** (... - *Skënderbeu foli haptas / “I kam njoftë të dy”...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 168).

ç) Nga tema ndajfoljore kemi ndërtimet **ndajfoljore**, si: *keqas, lartas, shkurtas* etj., të cilat janë të pasqyruara edhe në standard, gjë që vërteton përpjekjet e Camajit për një afrim ndërdialektor. Në këtë grup duam të veçojmë ndajfoljet: *fshehtas, ftohtas, pjerrëtas tërthoras, lehtas, qartas, shpejtas* etj.,<sup>182</sup> për të cilat gjuhëtari E. Hysa, shprehet se “është vështirë të përcaktohet nëse prapashtesa u është ngjitur temave mbiemërore apo ndajfoljore, por duke u nisur edhe nga kuptimi pak a shumë intensiv e përforcues që ka prapashtesa kur bashkohet me këto tema, mendojmë se është më e arsyeshme të pranohet që ajo u është ngjitur jo temave mbiemërore po temave ndajfoljore”.<sup>183</sup>

Ashtu siç e theksuam më lart prapashtesa **-azi** është variante me ndajshitesën **-as**, prandaj ato do të trajtohen së bashku. Ndajfoljet që po paraqesim janë të pasqyruar si variante sinonimike në FGJSSH (2006), pra me ndajshitesat **-as** e **-az**, **-azi**: *largazi* [në fjalorë normativ *larg, largas (largazi)*], *tërthoraz, tërthorazi* [në fjalorë *tërthoras (tërthorazi)*], *drejtazi* [në fjalorë (*drejtas*)], *rrethazi* [në fjalorë (*rrethas*)]. Arsyeja e

182 (...*qan fshehtas* për vëllan...Kandili i argjandit, f. 83); (...*fliste nynyrueshëm, ftohtas...*Rrungaja në mars, f. 208); (...*zbuloi se vendbanimi shtrihet pjerrëtas një rrafshine...*Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 236). *tërthoras* (...*më shikon tërthoras...*Dranja, f.35); *lehtas* (...*të mos dilnin aq lehtas jashtë...*Dranja, f.50); *veçmas* (...*marrë veçmas e bashkë...*Katundi me gjuhë të fshehtë, f.232); (...*mue më kanë dhanë me ngranë veçmas...*Loja e mbasdrekës, f. 60); *qartas* (...*u ndame për atë mbrame qartas...*Djella, f. 98); *shpejtas* (...*ti e di gjyshja ashtë verbu para një vjetit, ma priti shpejtas tue u ngrit në kambë...*Djella, f. 102).

183 E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, SF, 1, Tiranë, 1970, f.115.


përdorimit të trajtave me prapashtesën -azi mund të jetë veçori e stilit të autorit për t'i dhënë fjalës ngjyrim stilistikor.

**largaz** (...tërfatni në të, tue i ndejë **largazi** si një gjarpni nën gurë...) (“Dranja”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f. 18).

**tërthoraz** (...ngjarja e kësaj drame mbështet **tërthorazi** në një zezonë gjakmarrje të pashembull...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra* 5, Tiranë, 1996, f. 7); (...pikzimi **tërthoraz** me gisht në buzë...) (“Nema”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f. 135); **drejtazi** (...andrra nuk zgjidhet kurrë **drejtazi**...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra* 4, Tiranë, 1996, f. 26); **rrethazi** (...tue këqyrë **rrethazi**...) (“Shkundullima”, në *Vepra* 4, Tiranë, 1996, f. 105) etj.

Tabela nr. 3

### Formimet ndajfoljore me anë të ndajshtesës -as



### 3.1.2.7. Formimi i fjalëve me prapashtesën -ash

Ndajshtesa **-ash** i është vendosur temës emërore *gojë* duke na krijuar emrin *gojash* me kuptim përqeshës:

**gojash** (...*unë jam gojash e mund të më shpëtojë e flas si ma i miri hekurar...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 63).

### 3.1.2.8. Formimi i fjalëve me prapashtesën -esh

Camaj përdor prapashtesën **-esh** për krijimin e emrave: *nipesh e zotesh*.

**nipesh** (...*Nji rreze m'nxeu në këtë tokë si dielli / Nji burrë që m'dhanë për fat. / Un e nipsha maje gishtash përjashta dolëm / Nësa gjyshja, përmallue në kujtime, / Flitte me vete nën za, e ngrata...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 233).

Për të krijuar një sinonimi me fjalën “mbesë”, autori formon një neologjizëm “nipeshë” (mbesë), e cila e çon plakën në kujtime rinie, kur ishte e njomë si kalliri “shtalp/b” i grurit dhe provon dashurinë e ngrohtë si dielli.

**zotesh** (...*në midis, ende si në mote të lashta, shkëlqente tempulli i zoteshës...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 25).

**hyllesh** (...*Dranja e more me ikë tue iu përkund atij përpara, jo me atë hijeshi hylleshe ashtu si e lypte vendi...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 25).

### 3.1.2.9. Formimi i fjalëve me prapashtesën -(ë)s

Studiuesi E. Hysa duke trajtuar formimet e emrave me prapashtesën -(ë)s shënon, se: “Ajo bashkohet më dendur me tema të pjesores së gegërishtes me -ue ose -ye, temë që si e tillë (si temë fjalëformuese) është përgjithësuar edhe në gjuhën letrare. Kjo prapashtesë del edhe me formën -(ë)se që rrjedh nga (ë)s+ e si prapashtesë mocioni”.<sup>184</sup> Ndërsa gjuhëtarët Xhuvani e Çabej, pohojnë: “Ndajshtesa -(ë)s është bërë produktive në gjuhë të shkrimit, duke formuar me të emra vepronjës e mbiemra.”<sup>185</sup>

a) “Me këtë ndajshtesë, - shprehet A. Dhrimo, - formohen mbiemra që tregojnë marrëdhënien e sendit të karakterizuar ndaj një veprimi të shprehur nga tema prodhuese.”<sup>186</sup> Camaj me anë të kësaj ndajshtese formon **mbiemra** prej *temash foljore* me kuptime të ndryshme, si: *shtiratës, vjedhës, shtymës, shpikës, mbytës,*

184 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 155.

185 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 478.

186 A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 3, Tiranë, 1972, f. 61.

*dhënës etj.*, tek këto ndërtime po veçojmë leksemën *shtiratës*, e cila nuk del e pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim.

**shtiratës** (...e zbulove nëse bartësi ashtë zot i derës bujare, ose edhepse prindësh të vorfën, i rritun për së mbari, me zemër ma të ambël se fjalën në gojë, apo krejt ndryshe, don me thanë, skuf **shtiratës**, shpirtlig, mos me iu varëstrajca as prej një skarthi, i trenët e plot të zeza që as arra e mbyllun në lëvozhgë mos me iu marrë dore sepse përlyhesh asi ...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 270).

Në Fjalorin e vitit 1954 kemi lemat: *i shtirun* e *shtiracak* (si mbiemra), tek FGJSSH (2006) janë të listuar këto ndërtime: *i, e shtirur, shtirak e shtiracak* (mbiemra) e *shtiranak e shtirësi* (si emra). Camaj duke ndjekur modelet e fjalëformimit të gjuhës shqipe arrin që të ndërtojë leksemën *shtiratës*, me ndajshitesën -ës, por duke ruajtur anën kuptimore të saj. Krahasuar me lemën “i shtirun”, përcaktori mbiemëror “shtiratës”, vënë në përdorim nga shkrimtari ynë, jep idenë e zmadhimit, larg së zakonshmes si cilësi që mbart mbiemri “i shtirur”. Brenda një konteksti të shkurtë autori ka arritë të përdorë një varg mbiemrash e shprehjesh popullore që i shërbejnë për portretizimin e personazhit të tij.

Ndërsa tek lemat: *vjedhës, shtymës, shpikës, mbytës, dhënës*<sup>187</sup> etj., ndajshitesa -ës u është ngjitur temave të plota të pjesores. Ndërtime të tilla i hasim edhe në ligjërimin e sotëm, si forma të standardit.

b) Me anë të kësaj prapashtese formohen pak “*emra prej një teme të shkurtuar të pjesores së foljeve me bashtingëllore me ndihmën e prapashtesës -ës*”.<sup>188</sup> Forma të tilla janë të mbarë shqipes.<sup>189</sup>

c) Një numër emrash janë formuar me ndihmën e prapashtesës -(ë)s nga tema emërore, si: *katundës, vendës, ndihmës* etj., po veçojmë trajtën dialektore: *katundës* e cila del e pasqyruar tek Fjalori i vitit 1954 me kuptimin fshatar, ndërsa në FGJSSH (2006) ndeshim leksemën: *katundar* si emër e si mbiemër, me ndajshitesën -ar.

187 (...tue i lëshue herë mbas here një sy **vjedhës** të shoqes, buzagaz...Pishtarët e natës, f. 48); (...as me pas Flora njëqind duer **shtymëse**...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 247); (...trilli **shpikës** i mendjes...Rrunggaja në mars, f. 272); (...kakofoimi e acartë dhe **mbytëse** e çdo shije mirëtingllimi...Rrunggaja në mars, f. 286); (...zyrash **mbikëqyrëse** të administratës...Shkundullima, f. 132); (...për me u dhanë randësi fjalëve të veta, kinse të urta e me vend, por në të vërtetë të mprehta si thika e përçamëse si plumbi...Loja e mbasdrekes, f. 11); (...shndërrohen në landë **djegëse**...Nema, f. 137).

188 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 156.

189 (...mbasi në asnjë gur vorri tek na ndër male nuk gjen emën të shkruem, më duhej një **përcjellës**...Palimspesht, f. 178); (...**përcjellësi**, tue u çue edhe ai për të shkue me fjetë në stallë te kalë, e këshilloi dijetarin ...Rrunggaja në mars, f. 274); (...Lena paska qenë **bartësja** e pishtarëve...Pishtarët e natës, f.52); (...Poli dhe Ndreu, si **përkrahës** të Skanderbegut merreshin me diplomati...Gjon Gazulli, f. 264); (...se je **lypës** gjaku...Legjenda, f. 169); (...**prishësi** i paqes në katund...Shkundullima, f. 94).

**katundës** (...ndejeti larg çdo kuvendi të gjatë me **katundës**...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 193); (...*Lumm kush e ka kronin si unë! / -tha katundësi i ri. / Lum kush e ka ! ...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 184). (Katundës është përdorur si emër.)

Me mënyrën me konversion kemi kalimin e këtij emri në mbiemër: (...*dukej as me qenë grue katundëse e lëngueshme që çohet në spital...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 117).

### 3.1.2.10. Formimi i fjalëve me prapashtesën -(ë)si

“Prapashtesa -(ë)si është e vjetër, ajo gjindet që te *Buzuku e te Budi*, p.sh. gjakësi. Kjo prapashtesë është një zgjerim i emrave vepronjës më -ës me anë të prapashtesës -i, si grykësi nga grykës, gjakësi nga gjakës, veçse si një zhvillim i brendshëm i shqipes. Me këtë prapashtesë formohen emra abstraktë e kolektivë, prej emrash e mbiemrash. Prapashtesa -(ë)si paraqitet në gjuhën e sotme shqipe në dy variante, që janë të kushtëzuara fonetikisht: në variantin -si dhe -(ë)si.”<sup>190</sup> Në tekstin “Drejtshkrim i gjuhës shqipe” nënvizohet fakti, se “duhet të kemi kujdes se te varianti -(ë)si, kemi prapashtesën -si dhe zanoren mbështetëse ë, e cila del midis temave që mbarojnë me bashtingëllore të ndryshme, veç bashtingëlloreve r, l, ll”.<sup>191</sup> a) “Temat mbiemërore përbëjnë numrin më të madh të temave fjalëformuese, për krijimin e këtyre fjalëve- pohon gjuhëtari E. Hysa”.<sup>192</sup> Edhe tek Camaj janë formuar emra nga tema zakonisht mbiemërore të parme ose të prejardhura. Nga temat: *i idhët, i kthjellët, i imët, i naltë* etj., kemi ndërtimet si: *idhtësi, kthjelltësi, naltësi, cektësi, thjeshtësi, kaltërsi, bardhësi* etj.

**idhtësi** (...*Ajo, aty për aty, do ta kishte marrë vesh, a ishin shpifje ose fjalë të sakta ato që kalonin gojë më gojë. Maje gjuhës e kishte pyetjen. Kur e përpiu fjalën teposhtë, Lena ndjeu në zgrof idhtësi dhe tha vetëm kaq: "Si lang verri janë të idhëta, or burrë, fjalët e botës!"*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 41).

Trashëgimi i fondit të leksikut të vjetër shfaqet natyrshëm në çdo moment, autori di t’i përdorë fjalët në çastet kur ajo mbart mbi vete edhe ngarkesë emocionale. Në kuptimin e përgjithshëm idhtësi ka kuptimin: shije e hidhur; të përzier, por këtu ajo merr ngjyrim stilisikor, me kuptimin që ndjeu diçka të keqe brenda vetes. Kjo fjalë

190 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 146.

191 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 44-45.

192 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 147.

gjendet e përdorur edhe në krijimtarinë e Q. Sakajevës<sup>193</sup>, por me kuptim tjetër, fjalë të liga. Në Fjalorin e vitit 1954 janë të listuara disa trajta të ndryshme emërore, mbiemërore e ndajfoljore.<sup>194</sup> Në standard kemi trajtën emërore: *idhtinë*.

*Tek ndërtimet: kthejllësi e naltësi* kemi të ruajtura variantet dialektore, pasi në standard kemi përdorimet: *kthjelltësi, lartësi*. (...*ndihet i him / në kthejllësinë e idhtë...*) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 129); (...*ende nuk e kishin fitue kthjellësinë e duhun...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 267); (...*tue kundrue nga një naltësi...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 112).

Camaj shquhet si shkrimtari verior që u përpoq me veprat e tij të ndërtojë një gegërishte letrare, në ndërtimet: *imtësi, cektësi, thjeshtësi, kaltërsi, bardhësi, rëndësi, lashtësi, egërsi*, etj., ai ruan zanoren -ë si në standard dhe nuk shkon nga dialekti.<sup>195</sup>

b) Nga tema fjalëformuese emërore të parme ose jo të parme kemi ndërtimin e emrave. “Numrin më të madh të tyre e përbëjnë ata emra që janë formuar nga tema emërore të parme”.<sup>196</sup> Me anë të kësaj ndajshtese kemi përdorimin e këtyre lemave, si: *pikatësi, hyllësi, gjaksi, popullsi, rastësi, fajësi, malësi* etj. Tek këto ndërtime duam të veçojmë fjalën: *pikatësi*, e cila nuk del e pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim e ka të ngjarë të jetë ndërtim i autorit, duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes, ose mund të jetë një formë dialektore.

**pikatësi** (...*kreshtat që xhvesheshin papritmas tregonin me qartë se kurrë pikatësinë e egër, gërryemjet anash, thekësue edhe prej borës së mbetun...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 214).

Në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” kjo lemë nuk del e pasqyruar, ndërsa në Fjalorin e Gazullit e Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 janë listëzuar përdorimet: *pikatë v. as. djal i pikatun; pikatshëm* (i) adv. mbeshenueshëm. Te Fjalori i gjuhës shqipe (2006) ndeshim trajtën foljore pikas: *zbuloj dikë që kërkon të fshihet*. Në këtë kontekst kjo lemë emërore ka kuptimin: shquarje, dallim.

193 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 607. “Çfarë përjargie e idhtësie kulloi nga goja e disa politikanëve...” (Q. Sakajeva, Qendërcikloni).”

194 Fjalor i gjuhës shqipe, *Fjalori i '54*, Tiranë : Çabej, 2005, f. 178. “idhnak, idhnitar, i idhnuem (mbiemra); idhni, idhnim, idhtinë (emra) ; idhnueshëm, idhshëm (ndajfolje) etj.”

195 (...*u shpëtojnë imtësitë e përditës...*Rrungaja në mars, f. 281); (...*gjyqtar dhe ndëgjues marrim shkas nga kjo imtësi të tregohemi njerëzor...*Loja e mbasdrekës, f. 50); (...*cektësia qiti kudo krye ...Shkundullima*, f. 126); (...*me atë thjeshtësi të kërthinit të unshëm...*Shkundullima, f. 115); (...*e kaltërsia e sferave të nalta përshëndesin bardhësinë e dritës...*Djella 49); (...*me u përshkue nëpër shpeshësinë e kallamave...*Djella, f. 99) etj.

196 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 148.

**hyllësi** (...*feksi i kohës, kataklizmat e jashtme, ndërrimet në sistemet e hyllësisë që ai kishte ndjekë në rininë e parë...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 288). Shfrytëzimi i leksikut të autorëve të vjetër shfaqet tek leksema *hyllësi*, e cila na del e pasqyruar tek Fjalori i vitit 1954, sot në standard kemi përdorimin e emrit *yyjësi*: *yjësia* e Luanit.

c) Nuk mungojnë formimet e *emrave nga tema foljore*, si: **njohësi**, *hapësi*, *ndjesi*, *ngutësi*, *varësi* etj.

**njohësi** (...*kishte njohësi për llojet e ndryshme të gurit...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 21); (...*do të kish nisë një njohësi e re...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 231).

Te Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 kemi ndërtimet, si: *njohëse*: ekspeditë *njohëse* (mbiemër), e si emër: *njohëse: njohëse e folklorit*, si emër del edhe në Fjalorin e vitit 1954.

**hapësi** (...*hapësia e dheut, ndërkaq, iu ngushtue humanistit tonë...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.272).

Në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e Fjalorin e vitit 1954 hasim trajtën emërore: *hapsinë*, në standard përdoret leksema: *hapësirë*.

### 3.1.2.11. Formimi i fjalëve me prapashtesën -i

“**Prapashtesa -i**, është një prapashtesë e vjetër në gjuhën shqipe. Në shqipen e shkruar ajo dokumentohet që në veprën e *Buzukut*”.<sup>197</sup> Gjuhëtarët Xhuvani e Çabej, pohojnë se “*Prapashtesa -i është origjinale në shqipe, sepse lidhet me indoeuropianishten -ija, nga e cila u reduktua e doli -ijë e pastaj u bë -i. Me këtë prapashtesë formohen prej emrash, mbiemrash, foljesh e ndajfoljesh emra abstraktë e kolektivë të gjinisë femërore*”.<sup>198</sup>

a) Në materialin e vjelë prapashtesa -i bashkohet zakonisht me *tema fjalëformuese emërore të parme ose të prejardhura* duke formuar **emra**, si psh.:

**kureshti** (...*zgjoi te të gjithë, njoftë e panjofhtë, kureshtinë ta shihnin...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 87); (...*ngjallte kureshti, e mandej smirë...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 101); (...*i shtymë nga kureshtia...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 244); (...*prej kureshtisë që e kapi...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 119).

197 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I, Shkodër, 2000, f. 214. “anëmiqia LXXXVII (LXXXVII),III; begati XL, III; dhuni XII, II etj.

198 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 484.

**shorti** (...e kapi **shortia** e heshtjes dhe e pages...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 245);

**dhelpe** (...tue mbajtë një vesh hapët edhe kah **dhelpe** lindore...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 29). (Në standard kemi formën dhelpe.)

**ndërtimtari** (...e paska kapë tërbimi i **ndërtimtarisë**...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 102).

Me formantin -i janë formuar emrat përmbledhës: *punëtori e mashkulli*, të cilat janë leksema karakteristike të leksikut popullorë, por edhe të letërsisë artistike.

**punëtori** (...doni me u shtie dreqin **punëtorisë**...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 137).

**mashkulli** (...**mashkullia** na doli fare prej gjaqesh të vjetra e të reja...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 87).

b) “Prapashtesa -i bashkohet me temave fjalëformuese mbiemërore. Ajo u shtohet zakonisht temave mbiemërore që mbarojnë me bashtingëlloren -r, një numër i mirë i të cilave janë mbiemra prejjesorë, ose me bashtingëllore të tjera si -t e -l”.<sup>199</sup>

Gjuhëtari Camaj duke njohur rregullat e fjalëformimit të shqipes, arriti të krijojë fjalë të reja, nga tema mbiemërore *i thatë* ka formuar leksemën emërore *thati*, e cila nuk del e pasqyruar në Fjalorët e marrë në krahasim.

**thati** (...Mbyllni sytë, njerëzi! Mendoni vdekjen: ajo ashtë kërcimtare e pashoqe. Dallgët e jetës bien mbas ritmit të lëvizjeve të saj; sa herë që dora e saj përkulet kah toka, këput një bimë njerëzore dhe kalon mandej e qetë dhe e madhnueshme si ta kishte ujitë e shpëtue nga **thatia** e përjetshme...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 84).

Roli i shkrimtarit shfaqet natyrshëm ai fjalën që krijon e vendos në atë kontekst që ajo të fitojë ngjyrim stilistikor.

Tek krijimtaria e Camajt kemi mjaft fjalë të ndërtuara me këtë prapashtesë që përdoren në gjuhën letrare.<sup>200</sup>

c) “Ndajshtesa -i bashkohet kryesisht me temën e kohës së tashme të disa foljeve të zgjedhimit të parë në -oj dhe me temën e përgjithshme të ndonjë foljeje me

199 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Tiranë, 2002, f.139.

200 (...këtij, tha ai, i mungon vetëm /**urtia** e tigrin...Buelli, f. 158); (...do t’i ishte dukë **ligështi**...Pishtarët e natës, f. 41); (...si **ligështi** e diçka si shej të keq...Pishtarët e natës, f. 78); (...ndjenjë dyshimi e **pabesie** ndaj të shoqit...Pishtarët e natës, f. 44); (...**plogështia** i ishte futë në palcë...Pishtarët e natës, f. 74)



*bashtingëllore.*”<sup>201</sup> Ky tip fjalëformimi është pak prodhimtar në krijimtarinë e Camajt, si p.sh.:

**mrekulli** (...zente fill **mrekullia** e zgjimit ...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 111)

**idhni** (...mund t’u falej ndonjë e metë, si **idhnia** e gjaku i nxehtë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 29).

Në Fjalorin e vitit 1954 kjo fjalë del e pasqyruar, ndërsa në FGJSSH (2006) nuk e kemi te dhënë. Kjo leksemë dialektore ka dalë nga përdorimi, sot ne kemi gje gjegjësën e saj *zemërim*. Këtë trajtë e gjejmë të përdorur tek miku i tij E. Koliqi.<sup>202</sup> Shfrytëzimi i këtyre fjalëve dialektore e kanë ndihmuar Camajn për të përcaktuar ngjyrimin e një kohe të caktuar.

### 3.1.2.12. Formimi i fjalëve me prapashtesën -im

“**Prapashtesa -im** dokumentohet në gjuhën shqipe që nga shekulli XV. Sipas studiuesit Sh. Demiraj, kjo ndajshitesë haset që tek autorët e vjetër: te Buzuku dalin 13 emra prejfoljorë me prapashtesën -im, të përdorura gjithsej 94 herë, në të tri veprat e Budit gjejmë 25 emra prejfoljorë me këtë prapashtesë, të përdorur gjithsej 233 herë, në Fjalorin latinisht - shqip të Bardhit - 27 emra me -im të përdorur gjithsej 51 herë, në veprën e Bogdanit - 59 emra të tillë të përdorur gjithsej 203 herë.”<sup>203</sup>

Studiuesi shqiptar E. Hysa për lidhjen e kësaj ndajshitesë me temën fjalëformuese, thekson, se “*prapashtesa -im bashkohet me tema foljore të kohës së tashme të mënyrës dëftore, pra ajo bashkohet kryesisht me tema foljore që mbarojnë me -o dhe mjaft rrallë dhe me tema foljore me fundore të tjera*”.<sup>204</sup>

a) Me një mendim të tillë bashkohen edhe gjuhëtarët Xhuvani e Çabej, ata theksojnë, se “*nga foljet me temë në -o, me ndihmën e prapashtesës -im, janë formuar një numër i madh emrash veprimi e denduria e përdorimit është aq e madhe sa mund të thuhet që nga çdo folje me temë në -o ekziston mundësia të formohet një emër foljor veprimi me prapashtesën -im*”.<sup>205</sup>

201 L. Buxheli, *Emrat foljorë me prapashtesat -esë, -më, -imë, -atë, -i*, SF, 1, 1984, F. 110.

202 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 606. “...ku shfryen e fisnikohet idhnia e zemrës së turbullueme” (E. Koliqi, Arti...)”

203 Sh. Demiraj, Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe, f. 205, 206, 207, 208.

204 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 110.

205 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 492 dhe *Gramatika e gjuhës shqipe, I, Morfologjia*, Tiranë, 2002, f. 141.

Veprat e Camajt kanë një pasuri të madhe gjuhësore të ndërtuar me anë të kësaj ndajshese. Camaj duke mos harruar të qenit gjuhëtar, shfrytëzon mundësitë e gjëra fjalëformuese të mbarë shqipes në krijimin e lemave të reja. Por duam të theksojmë, se është i vështirë përcaktimi se çka ka krijuar vetë e çka marrë ai nga ligjërimi popullor. Në fillim po veçojmë ato ndërtime që s’na kanë dalë të pasqyruara në fjalorët që kemi marrë për krahasim, si: **gjinim, gjygjim, erëtim, flakim**.

“*Emrat e veprimit më -im që kanë si temë fjalëformuese temën e kohës së tashme janë formuar nga folje të zgjedhimit të parë.*”<sup>206</sup> Tek ndërtimi i emrit *gjinimi* kemi vënë re se tema foljore *gjin* që mund të mendojmë se ka ardhur kjo fjalë nuk del e dhënë në fjalorë, po ashtu edhe fjala e prejardhura me ndajshesën -im, kështu ne mund të themi që është përpjekje e autorit për ndërtimin e fjalëve të reja, duke shfrytëzuar fondin e pasur leksikor të shqipes. Ky ndërtim na paraqitet si rast i izoluar.

**gjinim** (...*kushtet jetësore ndër to ishin të vështira, si gjinimi gjashtëmujor...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.77)

**gjugjim** (...*natyrisht se ashtë një lojë, po due me thanë, jo gjugjim i vërtetë...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 41); (...*Ma leni mue fajin! Bjeshkë, grue fisnike deri në fund, po të rrëfej se aty kah gjysma e gjugjimit kam ndëgjue se yt shoq e kishte vështirë të merrte frymë...*) (Loja e mbasdrekës, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 73).

Camaj në krijimtarinë e tij shfrytëzoi mjaft fjalë të gurrës popullore, madje vepra e tij është cilësuar si “*dëshmi e gjallë e njohjes së thellë të thesarit popullor dhe të punës së tij të pareshtur në lëmin e gjuhës.*”<sup>207</sup>

**gjykim** (...*edhe shfajsimi më i plotë për atë nuk do të ishte gjykim i mirë...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 47); **gjykim** (...e kulloi **gjykimin** e vet...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 54); (...*pushtimi i vajzës për ligjite në gjykimin e tij...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 196).

**erëtim** (...*një erëtim rraqesh e të motnueme...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 141 ); (...*në gjysmëterr, përzihej eratim trumze me avull që lëshonte në vapë statuja e grues me gjymtyrë foshnje...*) (“Dranja”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 107). Në fjalorin e Gazullit kemi të pasqyruar fjalën: *erue* “me lëshue erë, me i dhanë erë”, ndërsa për foljen *eratue* ka dhënë kuptimin *me bekue*, duke u larguar nga kuptimi

206 L. Buxheli, *Emrat e veprimit me prapashtesat -im dhe -je në gjuhën letrare shqipe*, SF, 4, Tiranë, 1981, f. 56.

207 K. Topalli, *Vepra e Camajt në aspektin gjuhësor*, në “Tradita dhe e sotmja”, Shkodër, 1994, f. 86.

“lëshon erë” dhe sqaron se ndoshta mund të jetë forma *me uratue*.<sup>208</sup>Në Fjalorin e vitit 2002 kemi lemat: *erëmon, erëshëm, erëtoj e erëzoj* me kuptimin ”mbush me erë”, kurse FGJSHS (2006)<sup>209</sup> e zgjeron çerdhen leksikore me lemën *erëtim* me të njëjtin kuptim. Tek Camaj kjo fjalë veç kuptimit “kundërmon” ka edhe nuancën semantike “mban erë të mirë” e cila zgjeron nuancën kuptimore të kësaj leme edhe në standard. Shkrimtari me dorën e tij prej gjuhëtari e shkrimtari arrin të përdorë lemat: *eraton* (folje), *erëtim* (emër) e i erandshëm (mbiemër).

**flakim** (...një **flakim** peshe larg dhe përpara...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 19).

Trajta foljore nga ka ardhur kjo lemë del e pasqyruar që në Fjalorin e vitit 1954: flakoj, ndërsa Fjalori i 2006-ës e zgjeron çerdhen leksikore me lemat: *flakëroj, flakërimë*.<sup>210</sup>Camaj duke njohur mirë mënyrat e fjalëformimit të shqipes ka ndërtuar lemën *flakim*, mbi bazë të trajtës foljore *flako*.

**gazullim** (...mes **gazullimit** të përgjithshëm...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5* Tiranë, 1996, f. 12).

Kjo fjalë del e pasqyruar në Fjalorin e vitit 1954 me trajtën emërore: *gazëllim* e *ngazëllim* e atë foljore: *gazëlloj - ngazëlloj*, ndërsa FGJSSH (2006) nuk e ka të pasqyruar. Ndoshta kjo leksemë mund të afrohet me fjalën “gazmend” (gëzim), që ka shtrirje në gegërishten veriore dhe që e përdorin pothuajse të gjithë shkrimtarët e veriut. Çabej shprehet, se është refleks i latinishtes popullore \*gaudimentum, pranë gaudiominium.<sup>211</sup> Fjalën *gazmend* e përdor edhe Kadareja: ”midis gazmendit...tjetri kishte pyetur”, shprehen studiuesit T. Çausi e Gj. Shkurtaj.<sup>212</sup>

**heshtim** (...**heshtimi** mishnohet në kambët e merimangave...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 144).

Emrin prejfoljor *heshtim* të ndërtuar me ndajshtesën -im e kemi ndeshur që tek Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi” me formën heshtim-it, *silenzio*,<sup>213</sup> më pas te Fjalori i vitit 1954: heshtim “heshtje”,<sup>214</sup> në Fjalorin e Gazullit<sup>215</sup> kemi foljen heshtue: “mos me folë”, ndërsa lemën *heshtim* nuk e ka të pasqyruar. Trajtën foljore: *heshto*

208 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010, f. 124.

209 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 433.

210 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 280.

211 E. Çabej, *Studime gjuhësore*, I, f. 206.

212 T. Çausi - Gj. Shkurtaj, *Kadareja dhe fjala shqipe*, Tetovë, 2004, f. 99.

213 *Fjaluer i Ri i Shqypes përbâam prei Shocniet t' Bashkimit*, Shkodër, 1908; Prishtinë, 1978, f. 159.

214 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010, f. 160.

215 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010, f. 85.

shprehet M. Elezit e gjejmë të përdorur edhe tek GJ. Fishta dhe I. Kadare.<sup>216</sup> Në FGJSSH (2006) kjo lemë nuk del e pasqyruar, por aty kemi të listëzuara ndërtimet: hesht (folje), heshtje (emër), i heshtur (mbiemër).<sup>217</sup> Kjo lemë dialektore duke qenë pjesë e një leksiku pasiv ka arritur që të gjallërohet nga figura të shquara siç është Kadareja. Ai duke pasë si bazë lemën *hesht* krijon fjalët: *heshtues e heshtueshëm*.<sup>218</sup> Pena e artistit shfaqet kudo natyrshëm e me trajta të larmishme, në të njëjtin kontekst autori arrin të përdorë si fjalët: *përgojim e shpërgojim*, por duke u dhënë nuanca të ndryshme ligjërimore e duke përforcuar shkallën e thënies.

**shpërgojim, përgojim** (...*Shpërgojimet delnin e zhvilloheshin ndryshe prej atyne që mbijn ndër vende të thukëta banesash ku gjindja shkon e vjen tue u ndeshë disa herë në ditë dhe secili i shton thanjes një fjalë ose një shej me sy e duer... Përkundra, atje nalt, një motiv **përgojimi** tirret e merr trajta të qarta në rrethana vetmie ku një njeri i vetëm e peshon atë nga të gjitha anët...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 17); (...*me i lanë këto kuvende e **shpërgojime**...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f.119).

**përlavdim** (...*Mblodhi pesë gishtat e dorës dhe e tundi **përpara** si krye kukullue, në shej **përlavdimi**...*) (“Karpa”, Romë, 1987, f. 46.)

Kuptimi intensiv i këtij emri përforcohet në këtë rast edhe nga prezenca e ndajfoljes: përpara.

**lulim** (...*në **lulimin** e mbramë drandofillja ndrroi bulzën...*) (“Vargje të shpërndame”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 160).

Kjo fjalë sot ka një përdorim të pakët, pasi është zëvendësuar me fjalën: lulëzim.

**baglim** (...*çka hanin për t’i ndjekë mandej edhe në kohën e dejes në **baglimin** që lenin në shtigje të rralla...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 43).

Te Fjalori i vitit 1954 hasim fjalët: *bagël* (emër), *bagëlit* si folje, ndërsa në Fjalorin e M. Elezit kemi të dhënë trajtën foljore: baglo e formimin me prapashtesën -im: baglim.<sup>219</sup>

**lajmim** (...*asaj i tingëlloi në vesh si **lajmim**...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 134).

Në fjalorët normativë ne kemi përdorimet: lajmërim që formohet nga lajmëro, ndërsa kjo fjalë ndërtohet nga termi i shkurtuar i kohës së tashme lajmo + ndajshitesën -im.

216 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 579.

217 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 382.

218 T. Çausi - Gj. Shkurtaç, *Kadareja dhe fjala shqipe*, Tiranë, 2004, f. 107.

219 Mehmet Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f.168.

Në lemat *ulurim e shmallim* autori parapëlqen ndërtimet dialektore me ndajshitesën -im, ndërsa në standard kemi përdorimet me prapashtesën -je: *uluritje e shmallje*.

**ulurim** (...*jam zgjue prej ulurimit* të zanit tim...) ("Djella", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 108).

**shmallim** (...*dashnija e dy palë duerve / me gishta të kapërthyem / a shmallim i peshqve*...) ("Legjenda", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 188).

Kështu në krijimtarinë e tij ne gjejmë të gërshetuara fjalët dialektore<sup>220</sup> me ato që i përkasin ligjërimin të gjuhës shqipe.<sup>221</sup>

**kundrim** (...*për të mundë të thellohem në kundrimin e fushës*...) ("Djella", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 60). Sot ne përdorim emrin: vështrim.

**mungullim** (...*mungullimi i gjithë atij blerimi*...Djella, f. 99), në Fjalorin e vitit 1954 e FGJSSH (2006) kemi ndërtimin mungullim, por sot përdoret varianti bulëzim.

**rrugim** (...*sa peta e tanë gjatet për dikund rrugimi / mjekër-pakrehun plak / dhe i shkujdesun me qafë të vjedhun / atleti*...) ("Vargje të shpërndame", në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 158).

Këtë fjalë e hasim si folje dialektore gjë gjallon tek shqiptarët e Malit të Zi: rrugoj, me rrugue.

Pjesa më e madhe e ndërtimeve me ndajshitesën -im janë në numrin njëjës pasi dihet, që: "Një nga tiparet themelore gramatikore të këtyre emrave, që është i lidhur ngushtësisht me kuptimin, është mospërdorimi i tyre në numrin shumës, kur kanë vlerën e një emri veprimi."<sup>222</sup> Megjithatë, ka raste kur emrat foljorë me -im emërtojnë veprime dhe në numrin shumës, të cilët kushtëzohen nga qëllimi i

220 (...nga thellësia e nëntokës erdhi një shkulum ere, si të ishte hapë dritarja për të hy në dhomë fryma e keqe. "Gjamimi i ujit!"- pëshpëriti Nika...Pishtarët e natës, f. 61); (...trandej si dheu mbas gjamimit të motit...Pishtarët e natës, f. 71); (...kishin ndëgjue vetëm gjamimin e dridhjen e tokës...Rrungoja në mars, f. 221); (...ky **prapim** ia shtini Vitoit zekthat...Shkundullima, f. 106); (...për të huajin ato fjalë qenë **prapim**, mospërfillje...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 246); (...në qelq e kullueme zbardhet / dhe flutur / nis **flatrimin** lakmueshëm...Nema, f. 114); (...ato, mbas **miqasimit** ishin prishë...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 231); (...jo me ia lanë pezull **pleqnimin**...Loja e mbasdrekës, f. 66); (...**mishnimi** i qetësisë bie zakonisht...Shkundullima, f. 145); (...nuk mban **idhnim** kurrfare...Kandili i argjandit, f. 83) etj.

221 (...shkaku i **përçmimit** të breshkës...Dranja, f. 13); (...sëmundjes që prunë i thoshin/**lëngim**... Nema, f. 140); (...dhe hurp gur të shkrimë e mazën e tokës në **vlim**...Buelli, f. 157); (...përplasje thikash/ndër dhambë,pa gjuhë ishte një gur mullini në **rrotullim**...Buelli, f. 168); (...tue i fry në fytyrë **dysrimi**... Pishtarët e natës, f. 9); (...ia shkoqitën ata **skajimin** (...e quente **zbunim**, përgdhelshëm, rrasatik, në përfytyrimin e tij...Pishtarët e natës, f. 42); (...një motiv **përçojimi** tirret...Pishtarët e natës, f. 17); (...kthente **përjetimi** i kohës...Pishtarët e natës, f. 51); (...**përjetimet** kthejnë kujtime në çerdhen e vjetër... Loja e mbasdrekës, f. 68); (...në te përmbledhej thelbi i **përjetimeve** të një vjeti...Djella, f. 53); (...ato shtonin edhe **përvlimin** që kishte marrë vrull bashkë me zgjimin...Shkundullima, f. 112); (...e mbeti mallëngjimi i shkurtë \ mbi krahët e fluturës së thame \ -melodi përvlimi mushknish...Njeriu për vete e për të tjerë, f. 209), (...a ka ndoj **përfitim** nga përvoja e ndalun pezull...Djella, f. 53) etj.

222 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 116.

thënies. “Semantika e veçantë e këtyre emrave, që buron nga konteksti, kërkon që ata të përdoren në numrin shumës dhe nuk është numri shumës që ua jep atyre këtë kuptim.”<sup>223</sup> Ja disa shembuj të vjelë nga krijimtaria e Camajt:

**kundrime** (...Gazulli edhe u argëtue vetmevete në **kundrime** njerëzish...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 269); **përjetime** (...si ato **përjetime** të ishin tretë në mue si metali i pafaj...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 57); **shpërgojime** (...me i lanë këto kuvende e **shpërgojime**...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 119).

Tabela nr. 4

### Formimet emërore me anë të ndajshtesës -im



#### 3.1.2.13. Formimi i fjalëve me prapashtesën -isht

Studiuesi shqiptar K. Ashta shprehet, se “ndajshtesa -isht, është e vjetër ajo gjindet që tek Buzuku: xhurdhisht e gërqisht e lëtinisht LIX bis (LXIX), I; ligjishtë LXXV

223 L. Buxheli, *Emrat e veprimit me prapashtesat -im dhe -je në gjuhën letrare shqipe*, SE, 4, Tiranë, 1981, f. 62.

(LXXXV),I.”<sup>224</sup> Ky mendim do vazhdojë të trajtohet edhe nga Xhuvani e Çabej, ata shkruajnë, se “*prapashtesa -isht u bë produktive në gjuhë të shkrimit, duke formuar me të ndajfolje mënyre prej emrash e mbiemrash*”.<sup>225</sup> Gjuhëtarët shqiptar duke e trajtuar këtë fenomen theksojnë, se: “*Ndajshtesa -(i)sht është prapashtesa ndajfoljore më prodhimtare në shqipen e sotme letrare. Ajo lidhet kryesisht me tema jo të parme që mbarojnë më -i, duke dalë kështu prapashtesa -sht. Për analogji me këto janë formuar ndajfolje edhe nga tema fjalëformuese që nuk mbarojnë më -i, duke u zgjeruar prapashtesa në -isht*”.<sup>226</sup>

Me këtë prapashtesë tek Camaj janë formuar *ndajfolje* nga tema me -(ë)si, -ri, -im, të cilat janë leksema të mbarë shqipes, si: *mirësisht, rastësisht, qetsisht, egërsisht, gjerësisht, imtësisht, trimnisht, besnikërisht, parimisht, qëllimisht, gabimisht, shkurtimisht etj.*

a) Në veprat letrare të Camajt kemi përdorimin e disa trajtave ndajfoljore pasi, siç “*dihet ndajfoljet me prapashtesën -isht përbëjnë në gjuhën e sotme shqipe një tip të pasur e prodhimtar e në letërsinë artistike përdoren më të përgjithshmet, të tjerat përdoren për qëllime stilistike.*”<sup>227</sup>

Nga tema të emrave abstraktë të gjinisë femërore të formuar me prapashtesën -(ë)si, kemi ndajfoljet, si: *mirësisht, rastësisht, qetsisht, egërsisht, gjerësisht, imtësisht etj.,*

**mirësisht** (...drodhi shikimin përsëri kah grueja, i buzëqeshi **mirësisht**, jo ma me mrekullim në sy ...) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 277).

Nga ana semantike kjo ndajfolje është e zbërthyeshme në togun: parafrjala me + emrin mbi semantikën e të cilit është formuar ndajfolja.<sup>228</sup> (mirësisht - me mirësi).

Këtë ndajfolje e gjejmë të përdorur edhe tek bashkëkohësi e miku i tij E. Koliqi.<sup>229</sup>

**rastësisht** (...ishte ndeshë **rastësisht** në këtë Bibliotekë...) (“Palimspesht”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 179).

**qetsisht** (...simjet për të parën herë mimozat në dorën e një vashe i pashë, **qetsisht** tue marrun frymë si në degë...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 94).

224 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I, Shkodër, 2000, f. 215.

225 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “*Vepra I*”, Tiranë, 1980, f. 501.

226 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.373.

227 J. Thomai, *Rreth ndajfoljeve me prapashtesën -isht në gjuhën e sotme shqipe*, Gjuha jonë, 1/1991, f. 49.

228 E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, SF, 1, Tiranë, 1970, f.115.

229 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Gjergj Fishta, 2007, f. 923. “Mirësisht ndajf. (prej mirësi). Mirësishtëm. “...t’i shprehnin mirsisht miradijen...” (E. K.oliqi, Shija..).”

a) Në materialet e vjela kemi ndeshur ndajfolje të formuara zakonisht nga emra abstraktë të gjinisë femërore të ndërtuara me ndajshtesën **-(ë)ri, -(ë)ni**, si p.sh.: *trimnisht, besnikërisht*.

**trimnisht** (...*ishte mirë me u shkri ashtu trimnisht*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.24); (...*Jera barte trimnisht peshën e erës*...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 172).

Kjo ndajfolje mund të zërthehet semantikisht nga lidhëza si + emrin me kuptim përmbledhës mbi të cilin është formuar ndajfolja.<sup>230</sup> (trimërisht - si trimat).

c) Ndajshtesa -isht haset e përdorur tek emrat abstraktë të gjinisë mashkullore të formuar me prapashtesën **-im**, si: *parimisht, qëllimisht, gabimisht, shkurtimisht* etj.

**parimisht** (...*parimisht nuk ashtë gabim*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.40).

Ndajfolja *parimisht* është e zërthyer semantikisht në togun: parafjala nga e emrin pikëpamje ose ana + mbiemrin mbi semantikën e të cilit është ndërtuar ndajfolja.<sup>231</sup> (parimisht - nga pikëpamja, nga ana parimore).

**qëllimisht** (...*shkollari ushtronte qëllimisht duresë* ...) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 211) etj.

ç) Formohen ndajfolje nga një numër i kufizuar emrash të parmë të gjinisë femërore e mashkullore, si:

**letrarisht** (...*don të bindish letrarisht gjithë ata që s'i kanë mendt tua*...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 87).

Në Fjalorin e vitit 1954-ës e Fjalorin e gjuhës shqipe të 2006-ës kemi të shënuar trajtën mbiemërore *letrar*, ndërsa ndajfoljen: *letrarisht* nuk e kemi të pasqyruar, pra vihet re përpjekja e autorit për ndërtimin e fjalëve të reja, duke zgjeruar kështu çerdhen fjalëformuese.

**hajnisht** (...*ia ngjiti me gojë e iku hajnisht*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.49); (...*me marrë dele e dhena të hueja, shpesh edhe hajnisht*...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 270).

Fjala *hajnisht* është një fjalë e dialektit gegë që është bërë pjesë e standardit.

**zakonisht** (...*mishnimi i qetësisë bie zakonisht*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 145); **metodikisht** (...*ndërlidhte fijet e ngjarjeve njena për tjetrën metodikisht*...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 265) etj.

d) Më të pakta janë ndërtimet ndajfoljore që vijnë nga tema **mbiemërore**, si: *letrar*,

230 E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, SF, 1, Tiranë, 1970, f.116.

231 Po aty, f. 115.



*ironik, simbolik*, duke dhënë ndërtimet: letrarisht, ironikisht, simbolikisht.

**ironikisht** (...*m'a qashin hallin ironikisht*...) ("Djella", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 97).

**simbolikisht** (...*simbolikisht paraqesin ligjin e ri*...) ("Loja e mbasdrekës", në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 48).

\* "Në gjuhën e sotme letrare është zgjeruar mjaft sfera e përdorimit të kësaj prapashtese e kjo dukuri lidhet edhe me gjallërimin e formimeve prapashtesore në përgjithësi e në mënyrë të veçantë me rritjen e prodhimit të formimit të emrave abstraktë me prapashtesat *-(ë)si, -(ë)ri, -i dhe të emrave me prapashtesën -im*. Si rrjedhim, janë krijuar e po krijohen për analogji edhe një numër i madh ndajfoljesh, të formuara edhe nga tema të tilla që nuk ekzistojnë të shkëputura nga prapashtesa *-(i)sht*."<sup>232</sup> Një dukuri të tillë e vëmë re edhe në shembujt e mëposhtëm të përdorura nga Camaj, si:

**shpirtnisht** (...*pas disave, fytyrë-imët, hije bujare hebrejsh të stërholluem shpirtnisht prej dijes*...) ("Palimspesht", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 179); (...*shpirtnisht e ke shkatërrue edhe ti*...) ("Loja e mbasdrekës", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 72). Në gjuhën letrare kemi përdorimin *shpirtërisht*.<sup>233</sup>

**fuqimisht** (...*vuloste përjetë një kontratë ma fuqimisht se çdo nënshkrim noterial*...) ("Pishtarët e natës", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 60).


Në leximin e veprave të Camajt vihet re një pasuri e pashoqe fjalësh të formuara me ndajshitesën *-shëm*, në krahasim me atë me *-isht*, arsyeja është, se "kjo mënyrë fjalëformimi është më e gjallëruar në gjuhën e shkrimit, kryesisht në publicistikë, në letërsinë shkencore e didaktike e më pak në letërsinë artistike. Por në krahasim me prapashtesat e tjera ndajfoljore të shqipës letrare ajo ka një produktivitet më të gjerë".<sup>234</sup>

232 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.374.

233 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1042.

234 E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, SF, 1, Tiranë, 1970, f.119.

### Formimet ndajfoljore me anë të ndajshtesës -isht



#### 3.1.2.14. Formimi i fjalëve me prapashtesën -je

“*Ndajshtesa -je*, është e lashtë në gjuhën shqipe, ajo formon emra abstraktë veprimi. Lidhur me burimin e saj do shënuar se, sipas H. Pedersenit dhe N. Joklit, kjo prapashtesë ka dalë nga prapashtesa -lë, që përdoret në të folmet jugore të Shqipërisë me të njëjtin funksion të -je-së”<sup>235</sup> Sipas një studimi të bërë veprës së Buzukut, L. Xoxe shprehet se “*prapashtesa -je nuk del te Buzuku*”<sup>236</sup>

a) “*Prapashtesa -je bashkohet zakonisht me tema fjalëformuese foljore të pjesores*

235 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 529.

236 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 116. Shih L. Xoxe, *Rreth formimit të fjalëve te Gjon Buzuku*, (temë diploma, dorëshkrim), Tiranë, 1978.

ose të kohës së tashme të dëftores, për të formuar emra abstraktë të gjinisë femrore që përfshihen në lakimin e tretë, temat e këtyre foljeve janë zakonisht të parme dhe të prejardhura.”<sup>237</sup>

Gjuhëtarja L. Buxheli thekson, se “foljet nga të cilat formohen këta emra janë të zgjedhimit të dytë e të tretë, por rrallë mund të jenë edhe folje të zgjedhimit të parë”.<sup>238</sup> Tek krijimtaria e Camajt hasim këto ndërtime: *thurje*, *sosje*, *prekje*, *shpërndamje*, *përvuajtje* etj.

Camaj duke qenë njohës i mirë i pasurisë leksikore të shqipes, shfaqet mjeshtër i vërtetë edhe në përdorimin e antonimisë e sinonimisë emërore. Shkrimtari përsërit një mendim a një ide brenda atij konteksti, për të përforcuar shkallën e intensitetit, si në dy shembujt e mëposhtëm:

**thurje, çthurje** (...*acarohet në vete gjithashtu hutohet me orë e orë ndër thurje e çthurje ngjarjesh...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 70.)

**sosje** (...*kishte marrë vesh se mbarimi i qindvjetes do sillte dhe sosjen e pushtimit turk...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 72).

**prekje** (...*mbas prekjes së bletës në shkamb...Rrungoja në mars*, f. 189); (...*thymjen e bletës në gurë...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 190).

**shpërndamje** (...*e posaçme në këtë shpërndamje fjale...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 17).

Në standard kemi përdorimin: *shpërndarje*.

**përvuajtje** (...*Zoteshë, dy krena gjarpjish ndër vllaj / gjij tú, qyshse vetdijse / për hijeshinë tande sadeji / përbuze përvuajtninë e vjollcës...*) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 60).

Khs. me FGJSSH (2006) *përzierja*, *përvuajtje*.

Përpjekjet e një gjuhëtari e shkrimtari për një afrim të gegërishtes me format e standardit del mjaft qartë në krijimtarinë e tij. Ai arriti të gërshetojë mjaft bukur lemat dialektore me ato të standardit, si: *përplasje*, *mburrje*, *heshtje*, *përleshje*, *përkulje*, *skuqe*, *ndalje*, *ardhje*, *ndarje*, *këqyrje*, *lodhje*, *ecje* etj., që janë forma të mbarë shqipes.<sup>239</sup>

237 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa*, Tiranë, 2004, f. 117.

238 L. Buxheli, *Emrat e veprimit me prapashtesat -im dhe -je në gjuhën letrare shqipe*, SF, 4, Tiranë, 1981, f. 58.

239 (...*përplasje* thikash / ndër dhambë, pa gjuhë ishte një gur mullini në rrotullim...Buelli, f. 168); (...*kishte edhe theksim mburrje*...Pishtarët e natës, f. 17); (...*para kësaj heshtje* dhe gjumesie ndiente shtangim...Shkundullima, f. 93); (...*e kapi shortia e heshtjes* dhe e paqes...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 245); (...*zemrat e fyeme paqoheshin dhe mënjanoheshin përleshjet*...Gjon Gazulli, f. 271); (...*me një përkulje* kreje, denjueshëm...Rrungoja në mars, f. 286); (...*skuqjen* e mollzave...Loja e

**përplasje** (...*përplasje thikash / ndër dhambë, pa gjuhë ishte një gur mullini në rrotullim...*) (“Buelli”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 168); (...*i ngjallej përndjekja e ogurit të zi...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 98).

Edhe figuracioni i Camajt duket se mbështetet në ligjërimin e popullit (përsëritja *gur mullini*, epiteti *ogur i zi*) që shoqërojnë fjalët e lartpërmendura, e vërtetojnë një gjë të tillë. Ky është një fenomen i njohur dhe e dëshmojnë edhe gjuhëtarë të njohur. “*Figura*, - shkruan gjuhëtarë Sh. Rrokaj, - është një formë ligjërimi, realizimi i së cilës në një tekst mund të jetë origjinal ose konvencional, dmth., ajo mund të përdoret për herë të parë ose të kemi një rimarrje të një figure të krijuar nga folës të tjerë më parë”.<sup>240</sup>

b) Prapashtesa -je u ngjitet edhe disa *temave emërore* për të formuar *emra*,<sup>241</sup> si p.sh.:

**forcaje** (...*sa për ta kërkuar se çfarë forcaje kishte rakija...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 32).

Ky ndërtim që ka kuptimin fuqi, nuk del e dhënë në fjalorë, kurse në FGJSSH (2006) kemi pasqyrimin e disa ndërtimeve të tjera.<sup>242</sup>

**nënbarkje** (...*veshë me lëkurë delje të vjetër e të tymosun, ngjyrë-gështenje si lesh nënbarkje berry të paqethun me vjet...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.12).

**vëllamje** (...*përziemja e gjakut të vet me atë të egërsinës i kujtonte vëllamjen...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 78).

Mënyra e fjalëformimit me ndajshitesën -je në krijimtarinë e Camajt nuk na del e larmishme, megjithatë formimet me -im e -je u trajtuan pranë njëra-tjetrës, pasi “*emrat e veprimit me prapashtesat -im dhe -je janë emra, abstraktë foljorë të cilët emërtojnë veprime të ndryshme, sipas kuptimeve të foljeve përkatëse*”.<sup>243</sup>

### 3.1.2.15. Formimi i fjalëve me prapashtesën -o

Lidhur me origjinën e kësaj ndajshitesë, mendohet se kemi të bëjmë me një prapashtesë të brumit të shqipes, e cila, sipas Xhuvanit-Çabejt, “*në thelb, është prapashtesa e*

---

mbasdrekës, f. 92); (...*në pikën e ndaljes së dritës...*Njeriu më vete e me të tjerë, f. 169).

240 Sh. Rrokaj, *Probleme të stilistikës gjuhësore: kuptimi, ndërtimi dhe përdorimi i disa figurave stilistike*, në “Çështje të gjuhës shqipe” II, Arbëria, Tiranë, 2009, f. 11.

241 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa*, Tiranë, 2004, f. 121.

242 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 287. “1. forcërisht ndajf. 2. forcim em. 3. i forcuar mb. 4. forcues mb.”

243 L. Buxheli, *Emrat e veprimit me prapashtesat -im dhe -je në gjuhën letrare shqipe*, SF, 4, Tiranë, 1981, f. 55.

*thirrores dhe dokumentohet që në ilirishte, në emra burrash, si: Bato, Testino*”.<sup>244</sup> Studiuesi K. Ashta shkruan se: “*Kjo ndajshesë dëshmohet që në veprat e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe. Kështu te Fjalori latinisht-shqip i Bardhit jepet një listë e tërë pjesorësh të foljeve me këtë prapashtesë nga emra.*”<sup>245</sup> Gjuhëtarët shqiptarë duke e trajtuar këtë fenomen shprehen, se: “*Prapashtesa -o është ndajshesa më prodhimtare në sistemin foljor të shqipes. Me të janë formuar një numër i madh foljesh nga tema: 1) emërore 2) mbiemërore 3) foljore 4) ndajfoljore*”.<sup>246</sup>

a) Në krijimtarinë letrare të Camajt prodhimtarinë më të madhe kjo ndajshesë e ka kur bashkohet me tema emërore duke krijuar folje. Vendin dytë e zënë foljet e prejardhura nga tema mbiemërore, e më pak prodhimtare paraqitet kjo parashtesë në ndërtimin e foljeve nga tema foljore.

*“Foljet me prapashtesën -o kanë një strukturë kuptimore shumë të pasur, - shprehet L. Buxheli,- kur ato bashkohen me tema emërore, kuptimisht ndahen në folje veprimi, në folje gjendjeje dhe në folje faktive.”*<sup>247</sup>

Nga tema fjalëformuese emërore në krijimtarinë e Camajt kemi ndërtimin e foljeve, si: **qëllimoj, lajmoj, mrizoj, luloj, andrroj** etj., veçojmë dy foljet e para, të cilat nuk i gjejmë të pasqyruara në fjalorët e marrë për krahasim me forma të tilla, e ndoshta mund të jenë krijime të autorit ose variante dialektore.

**qëllimoj** (...*Vitoi qëllimonte me përlligjë dështimin e vet...*Shkundullima, f. 156); (...*largazi, po thom qëllimoni* të nënçmoni gjuhët popullore...Gjon Gazulli, f. 260); (...*i ashtuquejtun Shtrigan ngurronte me përgjegjë. Ky nuk ishte mësue me sjelljen e njerëzve jugorë që kur kanë ndonjë problem vetjak, pyesin edhe gjindjen e panjohun për këshilla, hapin zemrën dhe rrëfëhen. Sandrit nuk i rrihej pa folë edhe në emën të huejit, sidomos kur u kujtue se ky e humbi sigurinë në vete; nga ana tjetër qëllimonte edhe t'i bindte* të pranishmit se jo ai, por Shtrigani ishte që gabohej në kohë...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 252).

Në fjalorët e marrë për krahasim kjo lemë nuk del e pasqyruar, ndërsa M. Elezi Në Fjalorin e tij ka shënuar disa ndërtime.<sup>248</sup> Ajo na vjen si neologjizëm i autorit, por s’dimë të jetë përdorur në krijimtarinë letrare të autorëve tanë. Folja **qëllimoj**

244 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 521.

245 K. Ashta, *Leksiku historik i shqipes*, III, Shkodër, 2000.

246 Akademia eShkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.344.

247 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008, f. 193.

248 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1220. “1. Qëllimas ndajf. “...njeri qe punon qellims...” (Gazulli kur shtjellon qellimtar, -e).2. Qëllimshëm ndajf. 3. Qëllimtar, -e mb. 4. Qëllimtë (i,e) mb.”

ka forcë më të madhe shprehëse se shprehja foljore: *e bëj me qëllim*. Këtë folje gjuhëtarja L. Buxheli e motivon me *perifrazën folje + emër në kallëzore që lidhet me temën fjalëformuese*.<sup>249</sup>

**paqoj** (...*Fjalët e fundit e binin në mend Nikën dhe paqohej. Rrugës për në Gurra, pendohej, mallkonte veten dhe ndeshtrashat e jetës, edhe ditën kur kishte lindë e ra për të parën në lesh të delmjes. E ndiente veten të mundun...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 23)

Fjala “paqoj”, si një formim prapashtesor, krahas “paqësoj” (pasqyruar të dyja në FGJSH, 2006), është leksemë tipike e gegërishtes, formuar nga emri “paqë” + prapashtesën - o-j”

**lajmoj** (...*Qe, telegram që ke nisë. Tashti erdhi, para teje, ndoshta një orë. Këtu mandej nuk thuhet se kujt do t’i lajmoj ardhjen tande...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 96); (...*lajmon në sheje kushtrimi...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 68).

Leksema *lajmo* është një variant i parapëlqyer i të folmeve veriore e cila është shfrytëzuar edhe nga Camaj, sot përdoret forma e standardit: lajmëro.

**mrizoj** (...*me dysy sa lythi mbi hundën delikate Dranja e mati udhën, shtrive në kokërdhokë gurësh prej çubës ku mrizonte në vapë deri te sheu me ujë...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.32).

Foljen *mrizoj* e gjejmë të përdorur edhe tek Fishta me fomën geqe: *me mrizue: “Tash këndojn bari e blega:/ Blegat mollzat kuq si shega:/ E un e ti prapdora-dora,/ dora-dora bardh si bora / mriz e m’mriz bashkë me mrizue,/ Gurrë em’gurrë bashkë me u freskue...*”<sup>250</sup>

Camaj me intuitën gjuhësore që e karakterizonte shfrytëzoi mjaft fjalë e shprehje dialektore, e me të drejtë I. Kadare në parathënien e vëllimit të parë shprehet: “*Vepra letrare e M. Camajt i kumton lexuesit “variantën geqe”, të lëvruar e të sprovuar në rrethet letrare shkodrane të kohës, të cilën shkrimtari ynë në gjallje të vet nuk reshti së përpunuari dhe pasuruari në formë dhe leksik.*”<sup>251</sup>

Camaj në krijimtarinë e tij shquhet për aftësinë e gërshetimit të elementeve dialektore<sup>252</sup> me ato të mbarë gjuhës, një gjë të tillë e kemi të pasqyruar edhe në

249 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008, f. 193.

250 Gj. Fishta, *Lahuta e malcis*, TOENA, Tiranë, 2000, f. 383.

251 M. Camaj, *Vepra I*, Onufri, Tiranë, 2010, f. 6.

252 (...ajo **dimnonte** aso here në tokë...Dranja, f.51) **dimëroj**; **andërro** (...**andërrova** dhe u thashë... Dranja, f.53); (...**gjithkush e çdo send andrron** në këtë dhe si ledhet e ujëpërçuesave të vjetër...Loja e mbasdrekës, f. 90); **marro** (...për të shënue diçka të palejueshme ato **marroheshin** dhe heshtnin...

shembujt e dhënë për ilustrim.<sup>253</sup>

c) Me anë të kësaj prapashtese janë krijuar **folje** duke u shtuar kryesisht *temave të mbiemrave cilësorë e të nyjshëm, si: i rrallë, i thartë, i hollë, i lire, i ligësht, i thellë* etj., kemi ndërtimet: *rrallo, tharto, hollo, liro, ligështo, thello* etj.

“Foljet me prapashtesën -o nga tema mbiemërore janë kryesisht folje faktitive dhe folje që tregojnë një ndryshim të tiparit ose të gjendjes së kryefjalës. Ndërsa foljet e veprimit janë të pakta.<sup>254</sup>” Leksemat e përdorura në këtë grup i hasim të përdorura gjithandej në letërsinë artistike.

**rralloj** (...**rrallohet** në vargun e reptilëve...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.55); (...**Gazulli vetë i rralloi** ravgionet e pacak...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 271); **tharto** (...**ashtu si thartohet** edhe vena e re...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 39); **hollo** (...**ec e hollohet** kambësh...) (“Palimspesht”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 200); (...**hollohet** si shtrigë...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 170); **liro** (...**nuk e lirojnë** breshkën dritë-shkurtër...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 13); **ligështo** (...**ligshtohen** fuqish...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 70); **thello** (...**për të mundë të thellohem** në kundrimin e fushës...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 60) etj.

ç) **Foljet** me prapashtesën -o nga tema foljore janë, si p.sh.: **heshto, shtango, përdoro, ndalo, ngjaso, zbardho, shtjello** etj. “Shumica e foljeve të prejardhura në këtë mënyrë janë folje veprimi me kuptim intensive<sup>255</sup>.” Në këtë grup fjalësh duam të veçojmë leksemën foljore **heshto** e cila nuk del e pasqyruar as në Fjalorin e 1980<sup>256</sup> e as të 2006,<sup>257</sup> aty gjenden trajtat emërore e ndajfoljore, por jo lema foljore me ndajshitesën -o. “*Kjo lemë,- shprehet studiuesja M. Priku,- ndeshet në krijimtarinë*

---

Rrungoja në mars, f. 169); **lulo** (...**kur kumbullat lulojnë** mbi kodër...Loja e mbasdrekës, f. 35); (...Nji rrëke krisi nëgim, / mandej ra një rig shiu / mbi dhena ku **lulon** bajama...Legjenda, f. 187).

253 (...**Dranja i merr anën e mrekkullohet**...Dranja, f.49); (...**ky bindej e mrekkullohej**...Pishtarët e natës, f. 28); (...**po mrekkullohem** në vete...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 248); (...**atë e acaronte** kundrimi i rrashtës...Dranja, f. 89); (...**varrohej** për së gjalli me atë natyrshmëri prej bujku...Dranja, f.18); **mjegullo** (...**vetëdija gjithnjë në mue mjegullohej**...Dranja, f.34); (...**zani i tingëlloi** kumbonë...Nema, f. 124); (...**u tingëllonte** të gjithëve në vesh...Pishtarët e natës, f. 16); (...**kur i tingëlloi** si lojë e pabukur thirrja e grues...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 248); (...**më tingëlloshin** veshët dhe tretsha nëndrime...Djella, f. 54); (...**lodroshin** në tarracën mbi krye...Palimspesht, f. 191); (...e rrezja **të lodrojtë** me valë...Djella, f. 58); (...**fjalët e fundit e binin në mend Nikën dhe paqohej**...Pishtarët e natës, f. 12); (...**zemrat e fyeme paqoheshin** dhe mënjanoheshin përleshjet...Gjon Gazulli, f. 271) etj.

254 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008, f. 201.

255 Po aty, f. 203.

256 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 673. (heshtim “heshtje, qetësi” si emër)

257 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 2006, f. 382. (Këtu kemi ndërtimet: hesht, heshtas, heshturazi.)

*e disa shkrintarëve jo vetëm veriorë, por edhe nga pena të njohura të shkrintarisë në gjuhën shqipe si I. Kadare.*”<sup>258</sup>

**heshtoj** (...po qe se ndokush i lypte shpjegim për shprehje të tilla të errëta, ai qiste shemblesia edhe ma të paqarta dhe **heshtonte**...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 29); (...**heshto** të lutem...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 83); (...*A thue din lulja çka ndijemë për të? / Heshtojmë! Ajo krye-ulun andrron...Loja e mbasdrekës, f. 24*); (...mori shkas nga fjalët e së motrës së madhe të egërsohet edhe kundër të tjerave që **heshtonin**, secila me ndonjë punë dore ndër thoj, për pajën e nosisë...) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 171).

**shtangoj** (...e **shtangonte** zani i tij...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 121) etj.

d) Prapashtesa -o zakonisht u shtohet edhe *temave ndajfoljore*, duke ndërtuar **folje**. “*Shumica e foljeve të prejardhura kanë si temë fjalëformuese një ndajfolje mënyre, pas tyre vijnë ndajfoljet e vendit e të sasisë, më pak janë ndajfoljet e kohës.*”<sup>259</sup> Ndërtimet e këtij grupi janë leksema të përdorura në gjuhën shqipe, si: *prapoj mjaftoj, largoj, dyshoj, përgjysmoj, rrotulloj, bashkoj, krahasoj* etj.

**prapoj** (...*Nika heshtoi pse u kujtue se të bijtë flitnin për punë e sende që i kandeshin atij, ndërsa ata me mend rëmonin diçka tjetër. Edhe atë mbasdite vuni re se ata atje mbrendë, mes shkambijve, e ndienin veten si të tretun, si germat e shkrintit në tru të tij, dhe mezi e pritnin muzgun për të marrë rrugën e kthimit për në vërri. Përpiqej të praponte dyshimin se ata s`do të ishin mësue kurrë me jetue të vetmuem ndër Gurra...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 86).

Prurja camiane këtu, mendoj se është tek fjala “prapoj”, që nuk ndodhet në Fjalorë të shqipes, një formim nga ndajfolja “prapa”, e cila mund të merret si neologjizëm i autorit, ajo ka kuptimin largoj.

**mjaftoj** (...**mjafton** një fluturim blete / përkrye...) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.145); **largoj** (...e grueja hollake **largohet** tue shkelë mbi mija tingujsh që shuhen kadalë...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 56); **shumoj** (...*merrte frymë me turr e shumonte me të tana mushknitë si fyll i plasun...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 131); **rrotulloj** (u çue në kambë, bani dy hapa përmbas, dhe me një të shtyme rrotulloi shkambin...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 62) etj.

258 M. Prik, *Një vështrim rreth përdorimit të disa leksemave në letërsinë artistike, si prirje drejt variacioneve gjuhësore*, në “Studime albanologjike”, Tiranë, 2011 / 1, f. 185.

259 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008, f. 203.



**Formimet foljore me anë të ndajshtesës -o**



**3.1.2.16. Formimi i fjalëve me prapashtesën -ore**

Për prejardhjen e kësaj ndajshtese po mbështemi tek mendimi i J. Koles ku ai shprehet, se: “...është e vështirë të vendoset nëse kemi të bëjmë me një prapashtesë -ore, që del në fushën e emrave si e tillë, me emërzime të mbiemrave apo, më në fund me një prapashtesë -or që bashkohet me prapashtesën e mocionit -e. Sidoqoftë

me rëndësi është fakti që ka në gjuhën e sotme shqipe një prapashtesë -ore, e cila vepron në fushën e emrave dhe që ka zhvilluar një prodhimtari relativisht të gjerë.”<sup>260</sup>

Ndërsa gjuhëtarët Xhuvani- Çabej theksojnë, se: “Kjo prapashtesë është bërë shumë produktive në gjuhën e shkrimit, duke formuar me të: 1) terma shkencorë e më tepër gramatikorë, 2) një gjë konkrete e abstrakte, 3) vendin ku gjindet sendi që tregon fjala primitive. Prapashtesë -ore paraqet trajtën femërore të prapashtesës -or.”<sup>261</sup>

1. Në krijimtarinë e Camajt me prapashtesën -ore zakonisht nga tema emërore të parme janë formuar **emrat**, si: *gungore, hamullore, lotore, mortore, krypore, fletore, avullore, thekore* etj. që gjinden të përdorura gjithandej në letërsinë shqipe.

**gungore** (...për të mos i ra kambëve **gungoret** e mureve në rrënim...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.20).

**hamullore** (...**hamulloret** e djeguna andej- këndeje gardhit qitnin të fikuna krahë fluturash shkrumb: *zjarmia ishte tue i shkue*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.37).

**lotore** (...ajo i ndenji sy-kokërr: si mund të qante i pari i Dranjes mbi kurrizin e vet as me qenë **lotore** dheu ...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.74).

**krypore** (...edhe pse anash tehu i ashtit të Dranjes ishte grimcua ndër dhena të hueja **krypore** dhe djegë prej gurit shkrepës...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 69) etj.

2. Me këtë prapashtesë janë formuar **mbiemra** nga tema emërore.

Dora e mjeshtrit të gjuhës na shfaqet në çdo moment, nga tema emërore festë autori na ka dhënë ndërtimin mbiemërore: *festore*, e cila nuk del e pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim. Kjo leksemë ka kuptimin për petkat që vishen për festë. Sot në përdorim trajtën mbiemërore: *festiv, -e - me kuptimin: atmosferë festive*.

**festore** (...*veshë e mbathë me petka festore*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 27).

Shfrytëzimi i trajtave dialektore si veçori e punës së Camajt shfaqet edhe tek leksemat mbiemërore, si: *mungullore*, ku autori e ka përdorur në kuptimin: e veshur prej mungut. Në fjalorët normativ kemi trajtën: *mugullore*. Edhe tek ndërtimet: *vashnore, burrnore, mjeshtrore* autori ka ruajtur ndërtimet dialektore, pasi në standard, në FGJSSH (2006), pasqyrohen leksemat: *vashërore: kënga vashërore; burrërore: tipare burrërore; mjeshtërore: puna mjeshtërore*.

**mungullore** (...ajo shtresë **mungullore**, herë e nxehtë, herë e akullt, e shqetësonte të zotin

260 J. Kole, *Rreth emrave të prejardhur me -ore*, në “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, Tiranë, 1975, f. 104-140.

261 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 529.

e Gurrave...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 79).

**vashnore** (...*atyne që e takonin Lenën rrugës u binte në sy edhe siguria e lëvizjeve të gjalla vashnore në të, një lulëzim rinie që nuk veshket kurrë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 52); **burrnore** (...*as në gjumë nuk bërtiti ma, as nuk ndëgjoi në derë trokitje grash të hueja që vinin me i përthithë të mbramen forcë burrnore...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 79).

**mjeshtrore** (...*mbas çdo pune mjeshtrore...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 80).

Ndërtimet: *gazmore, qumështore, zhurore, lindore* etj. janë pasqyrim i ruajtjes së formës të standardit.<sup>262</sup>

### 3.1.2.17. Formimi i fjalëve me prapashtesën -osh

Nga tema mbiemërore i madh + ndajshitesën **-osh** kemi ndërtimin *madhosh* me kuptim zmadhimi.

**madhosh** (...*ndër ta zbulonte edhe ndonjë shpend madhosh, ndonjë gjel mali...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 82).

### 3.1.2.18. Formimi i fjalëve me prapashtesën -shëm

“*Prapashtesa -shëm është e kohëve të reja të gjuhës së shkrimit, te shkrimtarët e vjetër të Veriut e gjejmë me trajtën -shim, dhe tek Jugu me trajtat -shim, -shëm, e -çim; p.sh. te Buzuku i durueshim; te Budi të goditshme; te Bardhi e depërtueshime, i padurueshim; te Bogdani i lëngueshëm, te Naimi i përjetëshëm.*

*Gegërishtja përveç mbiemrave, ka edhe ndajfolje të formuar me këtë prapashtesë, që tregojnë një gjendje a një mënyrë. Kjo mënyrë formimi haset që tek Buzuku: etshëm, gëzueshëm; Budi: rrëmbyeshim, argëtueshim; Bogdani: mënijsim e në gjuhën popullore: flet kuptueshëm, rri mendueshëm etj.*”<sup>263</sup>

Camaj në krijimet e tij ka aktualizuar një pasuri të madhe e të larmishme të ndajfoljeve të shqipes, sidomos të atyre me treguesit dialektorë e të moçëm. Ndajfoljet e përdorura shprehin pasurim edhe nga aspekti fjalëformues, pasi mjaft prej tyre mund të themi që ka të ngjarë të jenë neologjizma të autorit.

Gjuhëtari E. Hysa për problemin e formimit të ndajfoljeve në gjuhën shqipe, shprehet:

262 (...*kangëtare gazmore...*f.58); (...*kur sheh çdo shtazë qumështore...*f.72); (...*energji lumore, thashë, por feksin e rrymës s’ishte punë...*Djella, f. 58); (...*toka zhurore në pus...*Pishtarët e natës, f. 26); (...*tue mbajtë një vesh hapët edhe kah dhëlpnia lindore...*Pishtarët e natës, f. 29) etj.

263 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “*Vepra I*”, Tiranë, 1980, f. 540

“Në shqipen e sotme vihet re një prirje për zgjerimin e një kategorie të veçantë ndajfoljesh, që, me sa duket shkojnë paralelisht me ndajfoljet me prapashtesën -(i) sht. Është fjala për ndajfoljet që vijnë nga mbiemrat përkatës me prapashtesën -shëm. Këto ndajfolje me burim nga gegërishtja po kristalizohen edhe në gjuhën letrare shqipe, e cila i ka bërë të saj dhe ka ngritur në normë shumë elemente të gegërishtes.”<sup>264</sup>

Gjatë analizës së bërë kësaj mënyre fjalëformimi kemi vënë re që Fjalori i 2006-ës përmban mbiemrat përkatës e jo ndajfoljet si, p.sh.: *kujtueshëm, bindshëm, dëshirueshëm, mpishëm, preshëm, marrshëm etj.*, në raste të tjera përmban ndajfoljet me të njëjtin kuptim (këto ndajfolje janë të variantit dialektor), po të pasqyruara me prapashtesa të tjera, si: *ngathshëm-ngathtësisht* (në FGJSSH, 2006), *mpishëm - mpitas* (FGJSSH, 2006), *preshëm - prerat* (FGJSSH, 2006) etj.

b) Në krijimtarinë e Camajt me anë të ndajshitesës -shëm kryesisht nga *tema foljore* ose pjesore, pak *emërore e mbiemërore* janë krijuar **ndajfolje**, të cilat nuk u përgjigjen mbiemrave me temë me -shëm. Me të drejtë studiuesi J. Thomai për një dukuri të tillë, shprehet: “Mund të pranojmë që në shqipen e sotme është veçuar një prapashtesë -shëm për formime të mirëfillta ndajfoljore...Grupi i ndajfoljeve me këtë prapashtesë po zhvillohet e pasurohet dita-ditës.”<sup>265</sup> Në fillim po listojmë ato ndajfolje që s’ dalin të pasqyruara në Fjalorët e marrë në shqyrtim me këtë formë e ata kanë shumë mundësi të jenë krijime të M. Camajt duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes, ose janë lema dialektore të shfrytëzuara nga autori për gjallërimin e tyre e më pas për përfshirjen në leksikon aktiv të gjuhës së sotme shqipe. Kështu për fjalët, si: **përpishëm, mpishëm, përkundshëm, mjegullueshëm, mejtueshëm, pusishëm etj.**, studiuesi M. Elezit në fjalorin e tij shprehet, se *ato janë lema të përdorura kryesisht në krijimtarinë e Camajt.*

**përpishëm** (...*fryma e vjetve tona / i bani shkrum ato dy foshnje / e sikur thith plasa e shkambit ujin / gopi i s’amës, skelët, / gëlltiti / pluhnin e t’bijve, përpishëm, / që të lindin përsëri...*) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 127); (...*terri i territ me zemër në mur / hajnisht gëlltitej përpishëm...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 119).

Sa i takon kësaj fjale mund të themi se në FGJSSH (2006) nuk e kemi ndeshur trajtën ndajfoljore *përpishëm*, por kemi përdorimet si *folje: përpij*: e përpiu errësira (nata), e si *emër përpirje*. E gëllti përnjëherësh. Në shembullin e mësipërm përsëritja e

264 E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme*, SF, 1, Tiranë, 1970, f. 119.

265 J. Thomai, *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 132.

ndajfoljet e njëpasnjëshme krijojnë ngjyrimë të veçanta, por shërbejnë për t'i dhënë frazës edhe një intensitet më të lartë. Lidhur me këtë dukuri gjuhëtari Xh. Lloshi shkruan: “Ngjyrimet janë konotacione stilistike të stilemave, kundrejt të cilave qëndrojnë denotacionet ose vlerat shenjuese të mjeteve gjuhësore, të përpunuara në organizimin parësor”.<sup>266</sup>

**drojshëm** (...*Po aty ku delte avull shkova e çova një nga një / librat e i vuna mb'anë dhe në fund të fundit doli / një zile, varë për një dredhë, sa një sy dhie. / Drojshëm i rri<sup>sha</sup> përpara dhe pyet<sup>sha</sup>: / ç'kuptim ka? Çfarë kuptimi ka As me qenë ajo / një fjalë...*) (“Palimpsest”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 200); (...*arsyetonte i hueji drojshëm që të mos fyente Florën ...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 244).

Fjalori i Gazullit ka të shënuar lemën mbiemërore: *i, e druejshëm*,<sup>267</sup> kurse Fjalori i vitit 1954 ka ndërtimin foljor: *drashtë, druaj* (f. 92), ndërtimin mbiemëror: *i, e drashtun*, e gjejmë të përdorur tek shkrimtari Gj.Fishta.<sup>268</sup>

**përkundshëm** (...*lëvizte në ritëm sikurse me qenë tue ecë ashtu si përhera përkundshëm, pingul teposhtë...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.19).

Këtë ndajfolje mund ta zëvendësojmë me togun: ecte *duke u përkundur*. Në Fjalorin e vitit 2006 kemi të listëzuara këto përdorime: *përkund* (folje), *përkundje* (emër), ndërtimi ndajfoljor nuk del i dhënë e mund të themi që kjo fjalë ndoshta është krijim i Camajt, ose pjesë e ligjërimit të vendlindjes së autorit.

**mpishëm** (...*Vitoi e Ntonia i këqyrnin mpishëm, të bindun se ata vetë e degradonin aq idenë e urës sa të dukej edhe ndër sytë e tyne lojë fëmijësh...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 108); “...*ai iu avyt disi mpishëm dhe e kapi kutinë...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 84).

Në standard ndeshim këto përdorime: *mpij* (folje), *mpirje* (emër), *i, e mpirë* (mbiemër).<sup>269</sup> Shkrimtari duke qenë një njohës i mirë i gjuhës shqipe, ishte i ndërgjegjshëm për ekzistencën e lemës mpitas<sup>270</sup>, por ai për të rritur forcën shprehëse të kësaj ndajfolje, shfrytëzon trajtën dialektore mpishëm.

**mjegullueshëm** (...*atëhere i priren mjegullueshëm ndërmend bij e bija...*) (“Dranja”, në

266 Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 27.

267 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010, f. 115. “ lat. Terribilis; grek. Foberos. Ishte të druejshëm m'u pa me sy.”

268 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 369. “Jam kenë i drashtun / Sepse i padashtun...” (Gj. Fishta, Anzat e Parnasit).

269 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 647.

270 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 940. *mpitas*: u çue kadalë, mpitas.

*Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.76).

Nga lema *mjegull* në Fjalorin e 2006, kemi të pasqyruara këto ndërtime: *mjegulli*, *mjegullinë*, *mjegullim* (si emra), *mjegulloj* (folje), *i mjequlluar*, *mjegullor*, *i*, *e mjequllt* (si mbiemra), vendosja e kësaj leme në fjalorë do të pasuronte çerdhen fjalëformuese, ndërsa M. Elezi në Fjalorin e tij ka shënuar edhe lemën ndajfoljore *mjegullueshëm*, e cila del e përdorur kryesisht në krijimtarinë e Camajt.

**mejtueshëm** (...ndalet e këqyr përpara hundës dhenë **mejtueshëm** e gjallnesa tjera si veten e vet tue rrëshqitë nëpër gjeth...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.21).

Temën foljore mejtoj që është e toskërishtes apo e arbërishtes autori e shfrytëzoi për ndërtimin e ndajfoljes: mejtueshëm, për qëllime stilistike, sepse ai në një kontekst tjetër arrin të përdorë edhe formën e standardit.

**mendueshëm** (...Dranja mat ngrohtësinë me gjuhë e rrin **mendueshëm**, nëse qenka shty vjeshta aq fort e paska ardhë koha me zbrit shkallave...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 39).

**nynyrueshëm** (...heshtuen të tanë posa e kapi fjalën një plak: fliste **nynyrueshëm**, ftohtas, e një cope, pa modulacion zani...) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 208).

Në Fjalorin e Gazullit hasim trajtën foljore: *nunukue* - rrinte tue nunukue, pra flas nëpër dhëmbë, murmuroj, nynyroj, ndërsa në Fjalorin e M. Elezit kemi përdorimet foljore, emërore e mbiemërore,<sup>271</sup> ndërtimin me ndajshitesën -shëm nuk e përmban asnjë fjalorë, prandaj përdorimi i saj plotëson çerdhen paradigmatiche. Për të rritur shprehësinë e kësaj lekseme autori ka përdorur rrethorët e mënyrës të shprehur me ndajfoljen: *ftohtas* e grupin emëror të shoqëruar me pjesëzën mohuese pa: *pa modulacion zani*.

**përkueshëm** (...*koka* përputhet për kokë **përkueshëm**, *pa u vra aspak sendi për send...*) (“Rrunqaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 167).

Kjo fjalë tregon mënyrën e veprimit që shpreh folja përkoj: puqem me një tjetër në mendime, në veprime etj. (FGJSSH 2006) Camaj shfrytëzoi këtë temë foljore për ndërtimin e ndajfoljes *përkueshëm*. Shkrimtari për t’i dhënë sa më forcë shprehëse ndajfoljes së krijuar përdor edhe përsëritjen e fjalëve një element ky i stilistikës.

**spetullueshëm** (...vetëm tregtarët e lundruetit nëpër detna kanë aq raste, të panjehuna, të njohin fytyra të shumta dhe t’i harrojnë, por zotnia nuk ashtë i kësaj zeje, apo

271 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1016. 1. Nynyroj (folje): nynyrojnë grethat. 2. Nynyruet, -i, e (emër): Ai që flet me vete, që nynyron. 3. Si mbiemër sipas kuptimit të emrit.”

*jo?* - *Pyeti **spetullueshëm** tue e shikue filozofin anash...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 278).

Ndërtimi ndajfoljor *spetullueshëm* nuk del i pasqyruar në fjalorët e marrë në shqyrtim e mund të jetë ndërtim i autori. Një veçori stilistike që përdor shkrimtari është edhe modifikimi zëvendësues, që përftohet me këmbimin e një sekuence strukturore me një tjetër, kështu zëvendësimi i një bashtingëlloreje me një tjetër është shfrytëzuar nga autori për qëllime stilistikore.

**shumueshëm** (...ngase i dukej se se po i mbaronte fryma, zbërthente këmishën dhe përdishej **shumueshëm**, as me qenë tue u mbytë në ujë...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 172).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 kemi të listëzuara këto përdorime, si: *shumoj* (folje), që ka kuptimin shtoj shumë, ia rrit numrin; *shumim* (emër), *i shumuar* (mbiemër). Me vlerë stilistikore përjetohen pothuajse të gjitha ndajfoljet me -shëm në krijimtarinë e Camajt, edhe në shembullin e mësipërm kjo leksemë krijon një kuptim të ri e përdorur me vlerën e ndajfoljes *shpesh*, e cila fiton vlera në kontekstin e dhënë.

**turbullueshëm** (...*Ishte grindje ernash mes tyne, luftë mendimesh të kundërta. Ernat përziheshin rrath-rrathë, **turbullueshëm** mbi curra, tue u murrë si qe, njena kundër tjetrës, dhe i sillnin gjuetarit amën e egërsinës në lëvizje në flegrat e hundës ...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 75).

Në fjalorin normative të vitit 2006, kemi përdorimin vetëm të ndajfoljes *turbullt*: në mënyrë të turbullt. Rigjallërimi i lemave dialektore fiton në krijimtarinë e autorit vlera stilistikore të realizuara edhe mes përsërijës së fjalëve.

**vështrueshëm** (...(Shkrimtari) *Tue e shikue* të shoqen **vështrueshëm**. Unë e Besa po dalim pak në kopsht. Mjaft e pati kuvendi...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 89).

Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006, shënon foljen: *vështroj* e emrin *vështrim*. Camaj është mjeshër edhe në përdorimin e përkryer të sinonimisë, përsëritja e një mendimi a ideje brenda një konteksti të ngushtë shërben për të përforcuar shkallën e intensitetit. Nëse do të vëmë përballë dy foljet e mësipëme do vëmë re se të dyja shikojnë diçka a dikë, por tek folja e dytë ajo ka kuptimin e të shikuarit me vëmendje e për një kohë të gjatë. Një dallim i tillë është shfrytëzuar nga autori për ndërtimin e lemës: vështrueshëm që mbart mbi vete ngjyrim stilistikor.

**ngulshueshëm** (...*kur lumi villte **ngulshueshëm** brigjeve...*) (“Rrunggaja në mars”, në

*Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 171); (...*zogjtë marrim frymë ngulshueshëm...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.47).

**acarueshëm** (...*Nanë, s’ të kam ndëgjue kurrë tue folë kështu acarueshëm...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 96).

Fjalori i vitit 2006 ka të shënuar ndërtimet: acar, acari, acarimë, acarim (si emra), acaroj (folje), i acartë e acarues (mbiemra), përdorimi i kësaj ndajfolje të gegërishtes do të pasuronte leksikun e shqipes.

**shlirshëm, hijshëm, mallëngjyeshëm** (...*sytë në të lëviznin shlirshëm dhe shkëlqejnë hijshëm e mallëngjyeshëm si me qenë të mbushun me ndiesi bujare...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 100).

Camaj është i veçantë, në llojin e tij, ajo që e bën të dallueshëm është stili i tij personal, mënyra e ndërthurjes së lemave që ai krijon me ato që janë në gjuhën letrare. Një dukuri stilistike që ndeshim në gjuhën e këtij autori është përdorimi i disa lemave me ndërtim të njëjtë, të cilat rrisin shprehësinë e fjalës së krijuar. Në FGJSSH 2006 vihet re kjo paradigmë: çliroj (folje), çlirim (emër), çlirues (mbiemër) e *ndajfolja çlirët*, lema *shlirshëm* është ndoshta krijim i autorit, ose një lemë dialektore.

**drithshëm** (...*kengjat mbas gardhit e këqyrën shtremët atë send të gjallë për bind, dhe nga frika blegëruen drithshëm...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 51).

Në FGJSSH (2006) ndeshim këto përdorime: *drithëroj* si folje, *drithërimë* si emër, e *i drithëruar* si mbiemër, por lema ndajfoljore nuk del e shënuar e ka gjasë të jetë krijim i autori ose variant dialektorë.

**ngathshëm** (...*ecte ngathshëm e pendueshëm se kishte dalë atë ditë për gjojë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 78).

Grupimi i ndajfoljeve me ndajshitesë të njëjtë brenda një konteksti të ngushtë i shërben autorit për theksim të lemës së krijuar. Mbiemrin *i ngathshëm* e gjejmë të përdorur në Plavë e Guci,<sup>272</sup> ndërsa si ndajfolje del e përdorur kryesisht nga pena e M. Camajt.<sup>273</sup> Në krijimtarinë e A. Demaçit kjo leksemë del e përdorur ndajshitesën *-as*: *ngathtas*,<sup>274</sup> ndërsa me prapashtesën *-isht* del e përdorur nga L. Stani<sup>275</sup>: *ngathtësisht*,

272 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 995. “ngathshëm (i), -me (e) mb. (prej ngath). i mpitë, ngathç.”

273 Po aty, f. 995.

274 Po aty, f. 995. “...I drejtuar prej do gishtave që lëvizin ngathtas...” (A. Demaçi, Gjarpërinjtë e gjakut).

275 Po aty, f. 955. “...ia zgjatët ngathtësisht dorën njëri-tjetrit...” (L. Stani, Feniksi i kuq).



por edhe në FGJSSH (2006): *ngathtësisht*, me ngathtësi, ngathtët.<sup>276</sup> “Ndërtimi i këtyre ndajfoljeve që janë karakteristikë e ligjërimin popullor të gegërishtes,- siç shprehet prof. F. Agalliu,- e zgjerojnë sinoniminë fjalëformuese të shqipes”<sup>277</sup>.

**nënkuptueshëm** (...*tue ecë mbas të jatit, të bijtë u shikuen ndër sy nënkuptueshëm: qe, si po na u qet syve pluhën, e na vë në rrabush tue u tallë me ne...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 68).

Në FGJSSH (2006) kemi të listëzuara këto përdorime: *nënkuptoj* (folje); *nënkuptim* (emër); *i, e nënkuptuar* (mbiemër), po ashtu kemi ndërtimet: *i kuptueshëm* (mbiemër) e *kuptueshëm* (ndajfolje) - *flet kuptueshëm*. Përdorimi i ndajfojes: *nënkuptueshëm* do të ndihmonte në zgjerimin e çerdhes fjalëformuese, por edhe do të pasuronte leksikun e gjuhës shqipe. Këto ndërtime tregojnë edhe njëherë që Camaj përveçse shkrimtar i madh, është edhe një gjuhëtar i përgatitur mirë.

**pusishëm** (...*rana e lagun që i humbaste pusishëm nën kambë...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.70).

Fjalën pusi e gjejmë në shprehje si: *e zuri në pusi, i zuri pusi*, ndërsa ndërtimi me ndajshitesën -shëm është më tepër tipar i letërsisë artistike. Në FGJSSH (2006) e në fjalorët e tjerë që kemi marrë në krahasim kjo fjalë nuk është e pasqyruar, por M. Elezit në Fjalorin e tij shprehet, se *kjo lemë e përdorur nga Camaj e me kuptimin: si në pusi; papritmas*.<sup>278</sup>

**vrullshëm** (...*djega për burrë që kishte mbërthyer, në fillim vrullshëm, te Ntonia, zbutej ngadalë; tue u tëhollue, dukej si dru i thatë i djegun përgjysmë...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.160)

b) Camaj në krijimtarinë e tij ka aktualizuar një pasuri të larmishme të ndajfoljeve të gegërishtes, që mbartin mbi vete shënjes stilistikë e krijojnë kështu shkallë të lartë shprehësie. Në shembujt e mëposhtëm kemi një grup ndajfoljesh me -shëm, të cilat janë përdorur nga Camaj e që u përgjigjen mbiemrat me të njëjtën ndajshitesë pasi në FGJSSH (2006) kemi këto ndërtime, si: *i kujtueshëm, i dëshirueshëm, i shoqërueshëm, i mistershëm, i depërtueshëm, i ndërrueshëm*. Në lidhje me përdorimin e këtyre lemave si ndajfolje dhe si mbiemra, gjuhëtari J. Thomai i shpjegon me gjerësinë e semantikës leksikore të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe.<sup>279</sup>

276 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 685.

277 F. Agalliu, *Formimet e tipit kompozitiv + prapashtesë në gjuhën shqipe*, SF, 2, Tiranë, 1987, f. 34.

278 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1198.

279 J. Thomai, *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004,

**kujtueshëm** (...prej vrojttimeve të tilla Nika mori me nxanë mend mos me u ngutë dhe me veprue **kujtueshëm**, tue ndjekë ngapak edhe rrjedhën e natyrshme të sendeve...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 11).

**dëshirueshëm** (...përnjimend e qita cekën me e rrahë magjypin, së paku atë, ndonëse edhe të tre tjerët pritnin pritnin **dëshirueshëm** në kambë t’ua kallëzoja...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 51).

**mistershëm** (...kazani magjik në gjysmësterri vlonte **mistershëm** mbi unët e zeza...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 39).

**marrshëm** (...poezia niset **marrshëm**, kinse tue u endë...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 75).

**depërtueshëm** (...edhe cicrrimi i zogjve hynte ma **depërtueshëm**...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 77).

**ndërrueshëm** (...vjeshta po kalon **ndërrueshëm** me vapë e fortunë... ) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.23).

Ndajfoljet e përdorura më lart e pasurojnë edhe nga aspekti fjalëformues gjuhën shqipe, prandaj përfshirja e tyre në fjalorë do të ishte një ndihmesë e madhe për pasurimin e leksikut të saj.

c) Camaj arriti ta pasuronte leksikun e krijimtarisë së tij me mjaft fjalë të ligjëritimit të gegërishtes, duke treguar kështu potencialin e madh që mbart ky dialekt. Autori tek ndajshitesat që formojnë ndajfolje përzgjedhi ndërtimet me prapashtesën **-shëm**, pasi ato shprehin ngjyrime të ndryshme kuptimore, fitojnë vlera stilistikore të rëndësishme në të shprehurit letrar. Kështu kemi ndajfoljet, si: **preshtëm** - *preras*; **denjueshëm** - *denjësisht*; **rrëmbyeshëm** - *rrëmbimthi* etj. Në lidhje me përdorimin e shpeshtë të formave paralele të ndajfoljeve që ndërtohen me të njëjtën rrënjë po me prapashtesa të ndryshme studiuesi E. Hysa “*i sheh si forma që nuk mund të zëvendësojnë gjithmonë njëra-tjetrën në çdo kontekst. Në stile të caktuara ato kanë shpesh nuanca kuptimore, që nuk lejojnë përdorjen e njëres për tjetrën në të njëjtin kontekst*”.<sup>280</sup>

**preshtëm** (...*tha preshtëm* i hueji, tue ia ngulë sytë edhe ma mirë, si në pyetje...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 232); (...*rrinte preshtëm* si ta kisha zanë në faj...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 102).

---

f. 15.

280 E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, SF, 1, Tiranë, 1970, f. 114.

Një lemë të tillë e gjejmë të pasqyruar në Fjalorin e Gazullit: ishte prëshëm.<sup>281</sup> Ndërsa në fjalorët normativë ndeshim përdorimin me ndajshitesën -as: *preras* (*prerazi*). Përdorimi i ndajfoljes së mënyrës me anë të ndajshitesës -shëm e rrit forcën shprehëse të saj në kontekstin e përdorur.

**idhshëm** (...*ashtu gjarpni i rrek pa grat / tambël për me nxjerrë / në gjijt e Ledjes vashë / deri sa helmi idhshëm / i kulloi nëpër dhambë...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 186).

Kjo leksemë del e përdorur edhe nga shkrimtarë të tjerë.<sup>282</sup> Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 e 2006 ndeshim ndërtimet me ndajshitesën -as, -az: *idhtas*, *idhtazi*.

**pëshpëritshëm** (...*këtë zjarr e ruen pëshpëritshëm, grueja, plaku sy-trim ibrikun në dorë shtrëngue...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 39).

**denjueshëm** (...*ata e nderuen Gazullin që e pritnin ndenjün me një përkulje kreje, denjueshëm...*) (“Rrongoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 286).

Në këtë kontekst autori e ka përdorur ndajfoljen me kuptimin “me e denju”, me e begenis, me e përfill.

**rrëmbyeshëm** (...*hingëllonte buzëshpërvjelun e kërcente rrëmbyeshëm...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 149).

Në FGJSSH (2006) kemi përdorimin e ndajfoljes: *rrëmbimthi* me prapashtesën -thi. ç) Camaj është një pasardhës i denjë, i korifejve të kulturës kombëtare shqiptare, si: i Mjedës, Fishtës, Koliqit etj., kështu që në krijimtarinë e tij gjejmë mjaft leksema të përdorura nga këto figura të ndritura të letërsisë shqiptare, por edhe asaj kosovare. Ndërtimet ndajfoljore të mëposhtme i ndeshim të përdorura jo vetëm nga Camaj, por edhe nga shkrimtarë të tjerë, bashkëkohës të tij, gjë që vërteton mbështetjen tek tradita, si p.sh.:

**kokërrueshëm** (...*kjo ishte mënyrë përgdhelëse e të jatit; kështu e kuptonte Jera që qeshte kokërrueshëm me i plas krahnori...*) (“Rrongoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 165).

Tek veprat e Camajt ne kemi ndeshur edhe ndërtimin mbiemëror: *i kokërruem*, me kuptimin të ndara (... *thashethanat nuk ishin qenë të çrrajosura prej gojës së*

281 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010, f. 336. “prëshëm (SP) adv. i prëm: ishte prëshëm; germ. neidergeschlagen, neidergeworfen, it. abbattuto.”

282 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 607. “Millosi ia ka kthyer fort idhshëm” (M. Elezi, (Pa) koka), “Brofi ajo idhshëm si e shkelun n’gisht” (A. Pipa, Rusha), “Qet Behuri idhshëm e po i thotë...” (EK, Muji e Behuri).

*gjindjes të këtyre viseve me lagje të kokërrueme brinjash e luginash...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 17). Në Fjalorin e vitit 1954 kemi pasqyrimin e foljes: *kokrroj*, ndërsa në Fjalorin e M. Elezit hasim përdorimin e kësaj ndajfoljeje edhe nga shkrimtari i madh Gj. Fishta,<sup>283</sup> me të njëjtin kuptim si tek mbiemri, kurse tek Camaj ndërtimi ndajfoljor është përdorur me kuptim të figurshëm, duke rritur shprehësinë e fjalës.

**theksueshëm** (...aq ma **theksueshëm** e ndjenë hijen...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 98).

Këtë lemë ndajfoljore e hasim edhe tek miku i tij E. Koliqi.<sup>284</sup>

**lëmueshëm** (...Gjuri kishte shti ndër ara ujin që e sillte prej amës së lumit; edhe ky e trazonte me krismën e vet, edhepse rridhte **lëmueshëm**, tue gurgullue nëpër rranjë të e misrit...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 181).

Në FGJSSH (2006) kemi këto lema, si: *lëmoj* (folje), *lëmim* (emër), *i, e lëmuar* (mbiemër), *lëmuar* (ndajfolje). Camaj parapëlqen ndërtimin ndajfoljor me ndajshitesën -shëm, njëlloj si te shkrimtarët: E. Koliqi e M. Elezi.<sup>285</sup>

**pajtueshëm** (...Leka uli zanin **pajtueshëm** e tha: “Përsa kam vu unë re, ai s’ e ka kalue kurrë, maparë as tash, kufinin e Gurrave...”) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 30).

Këtë leksemë e gjejmë të përdorur edhe në krijimtarinë e A. Shkrelit.<sup>286</sup>

**urdhnueshëm** (...Pali që në zemër ishte pajtue me të jatit dhe nuk ia merrte ma për të randë që në një moshë të shtyeme kishte ngjitë Lenën, vërejt **urdhnueshëm** si zot shtëpie: “As mue nuk më ndien zemra mirë për të! Nuk do lanë asnjë ditë vetëm!” ...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 82).

Shprehësinë e gjuhës së Camajt e rrisin edhe përdorimi i figurave letrare. Në kontekstin e dhënë ndajfolja e mënyrës fiton vlera më të mëdha shprehëse kur pasohet nga krahasimi. Në standard gjejmë përdorimin mbiemëror: *urdhërueshëm*, ndërsa si ndajfolje del e përdorur edhe nga A. Demaçi.<sup>287</sup>

**ulurueshëm** (...gërthiti **ulurueshëm** mbi katund...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 152).

283 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 720. “Shpiat ishin kokrrueshëm në shpat (Plavë, Guci).”

284 Po aty, f. 1515. “Pse...theksueshëm ia shqyptoi emnin?” (E. Koliqi, Shija...).

285 Po aty, f. 818. “...më vezullojnë flokët e krehur lëmueshëm” (M. Elezi, *Kalendari i Noes*). “...krehjes së flokëve të shkurtë, të ujdusun lëmueshëm e përpishëm...” (E. Koliqi, *Tregtar flamujsh*).

286 Po aty, f. 1043. “I ati ...i pat thënë pajtueshëm:- Ani, bir. Rri këtu...” (A. Shkrelit, *Karvani i bardhë*).

287 Po aty, f. 1542. “...tha plaku si urdhërueshëm...” (A. Demaçi, *Gjarpërinjtë e gjakut*).

Përdorimi i ndajfoljes: *ulurueshëm* do të plotësonte çerdhen fjalëformuese të foljes *ulërij*, pasi në FGJSSH (2006), kemi këto ndërtime: *ulërij, ulëritje, ulërimë, uluritës*. Një ndërtim të tillë e hasim të përdorur edhe në krijimtarinë e M. Elezit.<sup>288</sup>

**zhbirueshëm** (...e pyeti ai i dyti të huejen *zhbirueshëm*, si me dashë të dinte diçka...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 232).

Në gjuhën letrare kemi të përdorur këtë paradigmë fjalëformuese: *zhbiroj, zhbirim, i zhbiruar e zhbirues*, ndërsa ndërtimin ndajfoljor e ndeshim edhe tek krijimtaria letrare e M. Elezit.<sup>289</sup>

**madhnueshëm** (...*Dranja nuk kishte pa kurrë qen të lidhun në hekura...Madhnueshëm shikonte baloshi dhenë me lot ndër sy, tue pritë durueshëm me fulqij përjashta që ryma e erës t'i sillte mizën...*) (“Dranja”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 60).

Këtë trajtë ndajfoljore e gjejmë të përdorur edhe tek krijimtaria e Gj. Fishtës e A. Demaçit.<sup>290</sup>

**shoqnueshëm** (...*Paret që i nxjerr ua japim Arrasve, shitësve që due me i hjek qafe, të mos u kemë asnjë borxh deri në Shëngjergj. - Këtu e preu fjalën për t'i pëshpëritë Kolës në vesh, tue kuvendë butë e shoqnueshëm si askurrë maparë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 54).

Përdorimi i njëpasnjëshëm i ndajfoljeve e i krahasimit brenda një konteksti të ngushtë rrit shprehësinë e ndajfoljes: *shoqnueshëm*. Ky ndërtim del i përdorur edhe në krijimtarinë e A. Istrefit.<sup>291</sup>

**përqëndrueshëm** (...*tash merrte vesh përqëndrueshëm edhe fjalët e tyre...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 61). Në FGJSSH (2006) kemi këtë paradigmë fjalëformuese: *përqendroj; i përqendruar; përqendrues*.

d) Camaj në krijimtarinë e tij arriti të rifuste mjaft fjalë “plaka” të harruara nëpër mote, duke i gjallëruar ato. Mbështetja dhe shfrytëzimi i këtij materiali të pasur gjuhësor na shfaqet natyrshëm në disa ndërtime që ne i kemi gjetur të pasqyruara në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 e të Gazullit, si p.sh.:

**idhnueshëm** (...*turfullonte idhnueshëm dhe e pyeste...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 12); (...*tue shikue të birin idhnueshëm...*) (“Pishtarët e natës”, në

288 Po aty, f. 1538. “Nën rrotat që u pëshollën ulurueshëm kërceu një copë dërrasë” (M. Elezi, (Pa koka).

289 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1642. “-Si, si, qysh\ thatë, pyeti zhbirueshëm, krejt gjakftohyë...” (M. Elezi, Varri i Fatit).

290 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 863. “...npërmjet t’hyjve bjen madhnueshëm...” (GJ. Fishta, Lahuta e Malsisë). “...duke ngërthye si madhnueshëm vetullat e trasha” (A. Demaçi, Gjarpërinjtë e gjakut).

291 Po aty, f. 1399. “Ashtu po,- ia bëri ai shoqërueshëm” (A. Istrefi, Argatët e dreqit).

*Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 75).

Në Fjalorin e vitit 1954 e ndeshim këtë ndajfolje.

**ngutshëm** (...mandej, **ngutshëm** e këputi kuvendin e stërhollë...) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 276).

Në Fjalorin e Gazullit hasim përdorimin: mbiemëror i ngutshëm e atë ndajfoljor ndajshitesën -as.<sup>292</sup>

dh) Në krijimtarinë e autorit nuk mungojnë trajtat dialektore, që përdoren nga Camaj me ngarkesë të veçantë emocionale. Ruajtja me fanatizëm e trajtave të tilla tregon se ai ishte i dashuruar me gjuhën e vendlindjes, e siç shprehet studiuesi

B. Kuçuku: “Vendlindja, është e pranishme ose e ndjeshme gjithandej, në trajta nga më të ndryshmet, konkrete e abstrakte, të dukshme e të padukshme...”<sup>293</sup> Përdorimi stilistik i leksemave dialektore ka bërë që fjalët të marrin një forcë të re shprehëse e duke bërë të mundur edhe gjallërimin e gjuhës. Lidhur me një fakt të tillë studiuesi J. Thomai shprehet: “Shkrimtarët e lidhur më fort me dialektin e vet...kur kanë qenë mjeshtrë të fjalës, dhanë ndihmesa të mëdha edhe për përpunimin letrar të këtij leksiku, për ta nxjerrë atë nga rrethi i ngushtë i një shtrese leksikore të kufizuar në përdorim në një rreth shumë më të gjerë dhe në një rrafsh gjuhësor siç është gjuha letrare kombëtare.”<sup>294</sup>

**shijueshëm** (...Nika tue folë për të shoqen, i shkokërronte fjalët **shijueshëm**. Jot amë, e di unë fort mire se ashtë grue e vyeshme për plang e shtëpi...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 32). Përdorimi figurativ i foljes *shkokërroj* bën që edhe ndajfolja *shijueshëm* të fitojë një ngjyrim të ri stilistikor brenda kontekstit të dhënë, pasi në standard kjo lemë përdoret me kuptimin: hante shijshëm. (FGJSSH 2006, f.1012).

**përgdhelshëm** (...copën e arit, pa marrë parasysh çfarë simbolesh e fytyrash kishte në sipërfaqe, e quente në zburim, përgdhelshëm, rrasatik, në përfytyrimin e tij, diçka si hajmali mrekullbamese që shpërthente edhe detin...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 42).

Në përdorimin e trajtave dialektore vihen re edhe dukuri fonetike, siç është rasti i mësipëm, ku kemi modifikimin zëvendësues: **k** në **g**, për efekte stilistikore. Në (FGJSSH, f. 792) kemi lemën: *përkëdhelshëm*.

292 Fjalori i gjuhës shqipe, *Fjalori i 54*, Botime Çabej, 2005-2010, f. 349. “1. Ngutshëm (i) - ngutshme (e) mb.: punë e ngutshme. 2. Ngutthi ndf. Ngutas.”

293 B. Kuçuku, *Gjurmë të jetës dhe individualitetit letrar të M. Camajt*, SF, 3-4, viti LXII (XLVII), Tiranë, 2008, f. 151.

294 J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 165.

**zashëm** (...nga vërejtje të pëshpërituna kinse vesh më vesh, po me qëllim që të ndëgjoheshin *qartë nga Jera, thanë mjaft zashëm, acarohet edhe ma tepër dhe nëse ishte moti i mirë, ikte e merrte malin...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 165). Ndajfolja e mënyrës *zashëm* e fiton shprehësinë stilistikore jo vetëm kur përdoret në shkallën sipërore, por edhe kur shërben për të theksuar një ndajfolje të thënë më lart, duke krijuar një sinonimi kontekstuale. Ndërtimin e standardit: *zëshëm* e kemi të pasqyruar tek Fjalori i M. Elezit.

e) Në veprat e Camajt bashkëjetojnë fjalë e forma të shqipes letrare të përbashkët me fjalë e forma të gegërishtes, madje edhe trajta me karakter arkaik, kjo për të dhënë konceptin e autorit për marrëdhëniet midis gjuhës letrare e gjuhës dialektore. Gjatë vjeljes së materialit na kanë dalë një grup ndajfoljesh që gjejnë një pasqyrim edhe në ligjërimin e sotëm e në letërsinë artistike.<sup>295</sup>

Mendojmë se përdorimi i dendur i shumë leksemave me prapashtesën -shëm, vende-vende kur denduria e tyre është në largësi të shkurtra sintagmatike, sikur e rëndon stilin e shprehësinë e tekstit në mjaft pasazhe gjuhësore e sekuenca narrative.

Për ta thyer këtë pasojë stili që lidhet me nënsistemin e fjalëformimit, disa krijues, këto formime i japin në një pjesë të mirë me parafjalën “me”, pa ndryshuar natyrën ndajfoljore; p.sh.: shijueshëm-me shije, përgdhelshëm-me përkëdheli etj.

295 (...në qelq e kullueme zbardhet /dhe flutur /nis flatrimin **lakmueshëm**...Nema, f. 114); (...çue nalt **kërcënueshëm**...Nema, f. 126); (...shumë vjet ma vonë, **pakujtueshëm**, iu dha të vizatojë...Pishtarët e natës, f. 24); (...fliste **bindshëm**...Pishtarët e natës, f. 30); (...këqyrte ashtu përreth, **hutueshëm**...Pishtarët e natës, f. 48); (...rrëfen **pendueshëm** Nika...Pishtarët e natës, f. 68); (...ajri i pastër tringllonte **harmonishëm**...Djella, f. 77); (...Djella ec **ngurrueshëm**...Djella, f. 82); (...kemi me kuvendë **përmallshëm** për katundin e lanun...Djella, f. 100); (...dridhi zanin **hareshëm**...Dranja, f.79); (...e pyeti ai i dyti të huejen **zhbirueshëm**, si me dashë të dinte diçka...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 232) etj.

**Formimet ndajfoljore me anë të ndajshtesës -shëm**





### 3.1.2.19. Formimi i fjalëve me prapashtesën -tar

“**Prapashtesa -tar**, është e lashtë, atë e gjejmë që te autorët e vjetër të Veriut, si te Buzuku: burgëtar, gojëtar etj., te Budi: sqimëtar, shortëtar, etj., te Bardhi: derëtar, furrëtar, etj., te Bogdani: detar, luftëtar etj. Prapashtesa -tar ka formuar në gjuhën shqipe një numër të shumtë emrash nga tema fjalëformuese të ndryshme.”<sup>296</sup>

a) Nga tema emërore të parme e jo të parme janë formuar **emra**, si: tryestar, vetmitar, rrugtar, gojëtar, pendestar, rojtar, tregtar, dijetar, ngatrrëstar, gjamatar, shërbëstar etj. Nga ky grup fjalësh po shkëpusim lemën: tryestar, e cila pasqyrohet me trajtën emërore tryezë te: Fjalori i vitit 1954, Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1980 e 2006. Camaj e ka shfrytëzuar këtë leksemë për të formuar emrin: tryestar.

**tryestar** (...*Tashit e mbrapa, na të dy jemi besëlidhun! Hyp përmbi pullaz e fshehu mbas dritës: prej andej i sheh të gjithë tryestarët në dhomë e ndëgjon gjithçka flasin. Një ditë, kuedi nxen edhe të shkruesh dhe i qet në letër fjalët e tyne!...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 36).

**gjamatar** (...për gjamatarë e vajtoje u shtruen tërvesa...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 87).

Shkrimtari leksemën gjamatar e ka përdorur për ndërtimin e një çifti sinonimik. Kjo lemë në FGJSSH (2006) del e pasqyruar me ndajshitesën -tor: gjamator.

**shërbëstar** (...*shërbëstari kryesor i tempullit...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 108).

Trajtën emërore: shërbesë - ceremoni fetare, e ndeshim që te Fjalori i Gazullit e ai i vitit 1954, më pas Fjalori i 2006<sup>297</sup>-ës do ta zgjerojë çerdhen leksikore edhe me lemën: shërbesëtar - që i shërben dikujt me përlje.

**shpotëtar** (...*por shpotëtar, ishte, burri i malësisë...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 39).

Leksemën shpotëtar Camaj e ka përdorur në variantin dialektor, me të njëjtin kuptim që është te Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006, tallës. (shpotar)

**rrugtar** (...*Qesh rrugtari i pluhnuem / S’dij njimend a për lojë...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 157).

Leksema rrugtar bën pjesë në ligjërimin popullor, pasi në standard<sup>298</sup> përdoret trajta emërore: udhëtar.

Përpjekjet e vazhdueshme të Camajt për një afrim të gegërishtes me gjuhën letrare,

296 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “*Vepra I*”, Tiranë, 1980, f. 546.

297 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1009.

298 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 480.

shfaqen natyrshëm tek çdo mënyrë fjalëformimi. Në krijimtarinë e tij gjejmë të gërshetuara format dialektore me ato të standardit.<sup>299</sup>

c) “*Ndajshtesa -tar shërben për të formuar mbiemra që tregojnë marrëdhënie përkatësore të sendit të karakterizuar ndaj një sendi tjetër.*”<sup>300</sup>

Mbiemrat e formuar me këtë prapashtesë janë të paktë në krijimtarinë e Camaj, si: *pusitar, damtare, vetmitare* e ndonjë tjetër.

Formimi *pusitar* te Fjalori i Gazullit nuk del i pasqyruar, ndërsa Fjalori i vitit 1954 e Fjalori i gjuhës shqipe të vitit 2006 ka të pasqyruar trajtat emërore: pus e pusi. Camaj duke shfrytëzuar këto lema krijon mbiemrin *pusitar* me kuptimin: një shpend (një njeri) që i bën pusi dikujt.

**pusitar** (...*Për nën korba dy bij kryezotash, / “krah për krah, shih si rrinë!” / “Shpend i poshtër e pusitar!- / Tha kryezoti i parë: / “Gjergj, ndalu një herë, pashë Zotin! - ...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 167)

**damtare** (...*bariu krah-thatë te ura e zjarmit lodhet / nërmend / për dhitë damtare përjashta...*) (“Njeriu me vete e me tjerë”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 182).

Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006, ka trajtën mbiemërore *dëmtare*, kurse Camaj ka ruajtur të folmen e gegërishtes.

Edhe tek kjo mënyrë fjalëformimi kemi të pasqyruara leksema të standardit, si: **kufitare** (...*në tregun e dy-tri katundeve kufitare...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 122); **vetmitare** (...*kishte mjaft orë vetmitare...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 154); (...*xhaketa eme ka ngjyrën e trungut / të lisit vetmitar, në mal...*) (“Lirika mes dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 100); **kundërshtare** (...*i delte tash e parë fjala kundërshtare kundrejt të shoqit...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 11) etj.

d) Me anë të ndajshtesës -tar janë formuar pak **emra** nga *tema foljore*, si: *korrtar*:

**korrtar** (...*nji kangë nga zemra e korrtares iu ngjall...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 48).

Krijimi i një përftese të tillë është i rrallë në gjuhën shqipe, saqë çdo interpretim do

299 (...**vetmitari** i Gurrave e humbë sigurinë në fjalë... Pistharët e natës, f. 21); (...në vargun e **shtegtarëve**...Rrunggaja në mars, f. 164); (...Për nën Fezë në shkamb / Asht një grykë e madhe: / i thonë Shpella e **Vetmitarit**... Legjenda, f. 169); (...**gjyqtar** dhe ndëgjues marrim shkas nga kjo imtësi të tregohemi njerëzor... Loja e mbasdrekës, f. 50); (...mjeku i Prushit ashtë **gojtar** i pashoq... Loja e mbasdrekës, f. 63); (...ndaj **dijetari** paraardhës në këtë Institut...Pishtarët e natës, f. 201); (...për të huejt e kujtueshëm, Nika ishte njeriu fatal, **rojtari** e zoti i asaj treve, udhërrëfyesi në labirint, me sjellje të njerëzishme, tipi i mikpritësit të lashtësisë... Pistharët e natës, f. 65); (...po më dukesh si **lajmëtare** e dërgueme... Kandili i argjandit, f. 99) etj.

300 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f. 189.

të ishte i pafuqishëm për të rrëfyer forcën shprehëse të saj. Forma analogjike e saj është korrëse.<sup>301</sup>

ç) “*Formimet me prapashtesën -tar nga tema foljore me -im janë relativisht të rralla në ligjërimin popullor. Këto formime dallohen për një shkallë më të lartë abstraksioni, e i gjejmë të përdorura gjerësisht vetëm në një rrafsh të ligjërimin, në ligjërimin libror, sidomos në atë që ka të bëjë me stilet e letërsisë artistike. Gjatë formimit të këtyre emrave emri prejfoljorë me -im e ruan kuptimin e veprimit si proces, kuptim i cili trashëgohet edhe në fjalën e re që krijohet.*”<sup>302</sup>

Me anë të kësaj ndajshtese tek krijimtaria e Camajt kemi ndeshur formimet emërore: *pushimtar, kërcimtare, cikërrimtar, andërrimtar* etj.

Kjo mënyrë fjalëformimi ju ka shërbyer shkrimtarëve për krijimin e neologjizmave. Camaj duke njohur lemat e shqipes: pushoj, pushim krijon fjalën e re me prapashtesën -tar: pushimtar, ndryshe nga forma e standardit: pushues.<sup>303</sup>

**pushimtar (...pushimtarët do të ishin nisë...)** (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 127).

**kërcimtar (...mendoni vdekjen ajo ashtë kërcimtare e pashoqe...)** (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 85); (...në mbarim i prune **kërcimtares** / një tubë lule / me krena gjarprijsh jetpruesa / ndër fletë...) (“Lirika mes dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 52).

**cikërrimtar (...cikërrimtar si im atë...)** (“Rrungaaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 294).

**andërrimtar (...tek më keni edhe mue, andërrimtar bjerraditës të hutuem shpesh, por rrallë herë fjalmadhe punëvogël...)** (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 75). Forma e standardit: ëndërrimtar. Semantikisht këto lema mund të zbërthehen: “ai që kërcen”, “ai që ëndërron” etj. Me anë të kësaj ndajshtese janë krijuar edhe **mbiemra**, të cilët njëlloj si emrat kanë fituar një ngarkesë stilistike të qëndrueshme, duke u bërë një veçori e leksikut të prozës artistike e të poezisë.<sup>304</sup>

**fitimtar (...mënyrat e njerëzishme të njeriut fitimtar... Shkundullima, f. 100); ngatërrestar (...ai ishte njeri i pashpirt, ngatërrestar...)** (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 49) etj.

301 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 487.

302 A. Vehbiu, *Emrat e mbiemrat më -tar nga tema prejfoljore më -im në shqipen e sotme letrare*, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, Tiranë, 1988, f. 546.

303 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 862.

304 A. Vehbiu, *Emrat e mbiemrat më -tar nga tema prejfoljore më -im në shqipen e sotme letrare*, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, Tiranë, 1988, f. 545.

### 3.1.2.20. Formimi i fjalëve me prapashtesat: -th, -thi, -z, -z(ë)

“Prapashtesat zvogëluese: -th, -thi, -z(ë), -z janë të moçme ato i gjejmë që tek autorët e vjetër të veriut, si te Buzuku: *tfurkthi, njomëzatë, barkëzë, pakëzë*; te Budi: *dalëth, qirith, i vogëlith, kafshëzë, arkëzë, napëzë, copëzë*; te Bardhi: *birth, mikth, mikeshëza, bletëza, shtëpiza, gjuhëza*; te Bogdani: *barithi, i vogëlith, konopëz, delezë, punëzë*. Për prapashtesën -ëz, -z, -zë Xhuvani e Çabej shprehen se ajo ka qenë produktive në gjuhën e shkrimit të së kaluarës, kurse sot produktiviteti i saj është pakësuar në gjuhën e shkrimit.”<sup>305</sup> Në tekstin e *Morfologjisë* kemi të shprehur mendimin se “prapashtesat -th, -zë kanë një denduri përdorimi në gjuhën letrare, sidomos në krijimet poetike”.<sup>306</sup> Edhe në veprat e Camajit vihet re një ringjallje të këtyre mjeteve fjalëformuese dhe një përdorim të dendur në kontekste të ndryshme. Përdorimi i prapashtesave zvogëluese -z për gjininë femrore e -th për gjininë mashkullore, e ndihmon autorin për të përqendruar vëmendjen e lexuesit pikërisht tek emri të cili i prapavihet, gjithashtu i jep mundësi për të dhënë ngjyrimet stilistike mjeteve shprehëse. Autori kur do të tregojë diçka të zvogëluar në vend të sintagmës emër + mbiemrin *i vogël* që përdoret rëndom sot, përdor emrin me këtë prapashtesë. Pra kemi leksemat: *njomëzë, rrymëz, vashëz, lodrëz, bishtajzë, gropëz*, etj. E njëjta gjë përse i përket përdorimit e aktivizimit të këtyre ndajshitesave ndodh edhe me prapashtesën tjetër të zvogëlimit -th. Autori përdor: *zogth, djalth, katundth* etj. Me ndajshitesën -zë, -z janë krijuar **emra** nga *tema emërore, foljore ose mbiemërore*. Në formimet me këtë prapashtesë në fillim po veçojmë ato fjalë të cilat nuk kanë fare kuptim zvogëlimi a përkëdhelie, ose ky kuptim te këto njësi është një kuptim i dytë që i bashkohet kuptimit themelor e kryesor të njësisë së re.<sup>307</sup> Kështu kemi emrat:

**njomëzë** (...era ia përgdheli mishin e fortë: e gzhati me dhambë e trup **njomëzën** dhe u shkarravend ndër fletë...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 18).

**hejzë** (...nisi me u rritë krandi që deri atëherë nuk ishte dallue prej kokërrizave të krahnjerrit, **hejzëve** të akullit ndër degë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 79).

**mjegullazë** (...lëvizjet e sendeve të gjalla nëpër **mjegullazë**...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 33).

305 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 555, 576.

306 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f. 144.

307 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 182.

**bebëz** (...*Kur e vranë, barijtë i hapen qepallat / e i pane ndër bebza / shumë drejt tue pi currila uji...*) (“Njeriu më vete e të tjerë”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 209) etj.

Me prapashtesën -z, -zë janë formuar emra me kuptim zvogëlimi ose përkëdhelie si: lodërz, gockëz, rrymëz, fletëz, rrugëz, frymëz etj., që vijnë përkatësisht nga temat emërore të gjinisë femrore: lodër, gockë, rrymë, fletë, rrugë, frymë etj. Leksemat e formuara me anë të këtyre ndajshitesave fitojnë vlera stilistikore kur përdoren nga dora e mjeshtrit të gjuhës shqipe M. Camaj. Shumica e tyre kanë ngjyrimë të forta shprehëse - emocionuese, si në ligjërimin poetik e atë rrëfimtar.

**lodërz** (...*nuk asht i lumtun pse trupi / i rri atje mbi Drin, / te gropa e tij vorrue / me gjithçka pat: / lugë e mashtrapë ari / grunë e venë uthullue ndër shekuj, / eshtnat e grues së vet / dhe një lodërz fëmije...*) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 119);

**gockëz** (...*atje në ranë më ra dora në një gockëz deti...*) (“Palimspesht”, në *Vepra 3*,

Tiranë, 1996, f. 202); **pasqyrëz** (...*Dy sy - pasqyrzat e mija te votra - / janë thye prej grijës dimnore / e fëtyrën teme s’do ta shoh kurr ’ma...*) (“Lirika mes dy motive”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f.26); **rrymëz** (...*fshehtë, nën kapakët e syve / në labirint / një rrymëz uji pa valë, e qetë / gjuhë e vetmueme...*) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë,

1996, f. 125); **gropëz** (...*në fund mbeti aty vetëm një gropëz me pluhun të imët...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 19); **dromëz** (...*në tjetrën mbi det leverdhet reja e shprishun si dromëza kulloshtre...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 16);

**rrugëz** (...*g gjithçka asht për ne: / rruzat e fshehuna / mes muresh secila me erën / e shekujve të vet...*) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 136); **fletëz, bishtjazë** (...*ndër fletëza e në çdo bishtjazë tringëllonte një shpirt i thamë...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 85) etj.<sup>308</sup>

Në krijimtarinë e Camajt nuk mungojnë edhe ndërtimet me ndajshitesën -th, që tregojnë emra me kuptim zvogëlimi a përkëdhelie, si: *djalth, thimth, gurth, vëllath* etj.

Tek kjo mënyrë fjalëformimi po veçojmë lemën **zogth**, e cila është e zhveshur nga kuptimi i zvogëlimit a i përkëdhelisë dhe formon fjalë me kuptim të ri leksikor e cila ndryshon nga ai i fjalës prej së cilës është formuar.

**zogthi** (...*mbërrinte bimësia deri në zogthin e kambës...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë,

308 **furkëz** (...*me një furkëz tridegëshe...*Rrungaja në mars, f. 165); **frymëz** (...*frymëza të vogla ajri...*Rrungaja në mars, f. 192); **dritëz** (...*para se të nisesh nga dheu / i andrrës së vokët / e andej udhtimi hijeve për ty / truerrët, me një dritëz të ndezun / mbi vorrin e kalesës...*Loja e mbasdrekës, f. 67); **gurëz** (...*bebzat e vogla dridhen: / gurzit mozaikë të tokës / pëlqejnë si sheqerleme...*Loja e mbasdrekës, f. 69); **puçërrizë** (...*prandaj, kur na sheh, sado lëkurë murmë të jemi e të parruem, s’i ngjethet shtati puçërrizë nga frika...* Dranja, f. 48) etj.

1996, f. 16)

**djalthe** (...*djalthe* i mjerë don me ditë gjithçka...Loja e mbasadrekës, f. 10); **thimtha** (...*fluturova mbi flatrat e mallit / me bletë në rrezet e para n'ajr / e zemra m'u dridh e dora / si thimtha zogze n'gjinin e lules, / n'aroma, kur pin nektar...*) ("Loja e mbasadrekës", në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 13) etj.

"Prapashtesa -thi bashkohet me tema emërore jo të parme të formuara me prapashtesën -im dhe tregon që veprimi kryhet në mënyrë të shpejtë e të menjëhershme."<sup>309</sup> Këtu kemi përdorimin ndajfoljor **qëllimthi**.

**qëllimthi** (...*as me i pas ndezë dikush pesë minuta maparë, qëllimthi për të shikue...*) ("Katundi me gjuhë të fshehtë", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 248).

### 3.1.2.21. Formimi i fjalëve me prapashtesën -s

"Prapashtesa -(ue)s, (-uese). Kjo prapashtesë del e dokumentuar që tek autorët e vjetër, me trajtën -uos, te *Buzuku*: munduos, penduos, shkruos etj.; te *Budi*: krijuos, penduos, shkuos etj.; tek *Bardhi*: lakëmues, pajtues; *Bogdani*: krijues, ngushullues etj. Në gjuhë të shkrimit mbizotëron sot kjo trajtë e gegërishtes, që në shumë rase është përgjithësuar në gjuhë. Kjo prapashtesë morfologjikisht nuk është veçse një formë e prapashtesës -(ë)s. Ajo ka dalë nga foljet me -oj, e pikërisht nga trajta e shkurtër -ue, -ua (uo) e pjesores."<sup>310</sup>

a) Kjo prapashtesë është shumë prodhimtare në gjuhën e sotme të njësuar letrare. "Me anë të saj formohen mbiemra përkatësorë nga tema foljore në -o, -ua, që tregojnë marrëdhënie ndaj një veprimi."<sup>311</sup> Nga tema foljore tek Camaj janë krijuar mbiemrat: *mëkatnues, avullues, psherëtues, lëngues, randues, vëzhgues, gjurmues, qortues* etj. Në ndërtimet e mësipërme po veçojmë lemat: **mëkatnuese, avulluese, psherëtues** për të cilat është i vështirë përcaktimi nëse janë lema të krijuara nga autori, apo janë fjalë dialektore.

**mëkatnuese** (...*me krye vepra mëkatnuese pa i ra synit qepallë...*) ("Shkundullima", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 115).

Në Fjalorin e Shoqërisë "Bashkimi" kemi të pasqyruara disa trajta, si: *mkat, mkatnoi, mkatnuem, mkatnuer*.<sup>312</sup> Tek Fjalori i gjuhës shqipe të vitit 1954 hasim

309 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.375.

310 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në "Vepra I", Tiranë, 1980, f. 478.

311 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.188.

312 *Fjaluer i Ri i Shqypes përbâam prei Shocniet t'Bashkimit*, Shkodër, 1908; Prishtinë, 1978, f. 270."

ndërtimet: *mëkat e mëkatar (emra), mëkatnoj e mëkatoj (fint.)*, ndërsa në FGJSSH (1980) e (2006) janë shtuar edhe mbiemrat: *mëkatar dhe i mëkatueshëm: veprim i mëkatueshëm*. Camaj duke u mbështetur tek tabani i shqipes përpiqet të sjellë forma të reja, por duke ruajtur të njëjtin kuptim.

**avulluese** (...*Frymë avulluese* dridhej në ajër po aty / ku ngjiten dy skaje raftash me libra n'skutë: / tue i vrojtë ti ngulmas kishe ndie afshin e ngrohtë / si me qenë tue dalë vera e dheut nën libra...) ("Palimpsest", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 200).

Fjalori i Shoqërisë "Bashkimi" dhe Fjalori i vitit 1954 shënojnë lemën emërore: *avullore-avullorja*, ef. shm. -vapor, anije që lëviz me fuqi t'avullit, por edhe trajtën mbiemërore: *i avullueshëm*, që avullon shpejt (në Fjalorin e '54). Ndërsa në FGJSSH (2006) ndeshim mbiemrat: *avullosh: simite avullosh dhe i avullueshëm*, që mund të avullohet, Fjalori i vitit 1980 e zgjeron çerdhen fjalëformuese me trajtën mbiemërore: *avulluese*, me kuptimin: Që lëshon avull nga të nxehtë, që ka të bëjë me avullimin. Toka *avulluese*. Nga dora e mjeshtrit kjo lemë merr një ngjyrim të ri semantik duke u bërë pjesë e një metafore.

**psherëtues** (...*duhanin e Fundinës, këtë fjalë e shqiptonin me tingull psherëtues të gjithë ata që kishin mbështjellë ndonjë cigare nga qesja lëkure dhie e Nikës...*) ("Pishtarët e natës", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 24).

Në Fjalorin e vitit 1954, në FGJSSH (1980) e (2006) kemi të pasqyruar trajtën foljore: *psherëtij* (pshertij edhe në Fjalorin e "Bashkimit") e trajtën emërore: *psherëtim* (pshertime në Fjalorin e "Bashkimit"), ndërsa tek krijimtaria e M. Elezit kemi përdorimin e formës së standardit: *psherëtitës*.<sup>313</sup> Krijimi i kësaj lekse merr ngjyrim stilistikor duke u përdorur si pjesë e figurave letrare (metaforës).

**lëngues** (...*lene vargun lëngues e më thuej / cili jë ti në këtë palimpsest...*) ("Palimpsest", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 205).

Në standard kemi përdorimin e mbiemrit: *i lënguar, me kuptimin: i njomur, i stërpikur*, kurse Camaj e ka përdorur këtu me kuptim metaforik. Këtë lemë shprehet M. Elezit tek Fjalori i tij e gjejmë të pasqyruar kryesisht tek krijimtaria e Camajt.<sup>314</sup>

**randuese** (...*Shih, shih, si Kola po don me ma dhanë vejen pa të kuq! Dhe vendosi me e marrë vesh deri në fund, durueshëm, i cili përmendi, pa fjalë randuese e vumje*

---

1. mkat (mekat), i, vm. shum. mkaté, t. peccato. 2. mkatnoi, on, ova, me mkatnue, ftas. peccare. 3. mkatnuem (t'), persh. as. il peccare. 4. mkatnuer, ori, e mkatnoré, ia, vm. evf. Peccatore, trice."

313 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1185. "Psherëtitës, -e mb.. Që psherëtin. "Ajo e tund fort te supi. Ai mezi zgjohet, psherëtitës" (M. Elezi, (Pa) koka.)"

314 Po aty, f. 820.

*faji, se Nika vetë i paska lane shpesh mangut punët e veta në vërri...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 55).

**cingërues** (...si Nika qeshte ajo me një za **cingërues** si era e veriut...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 45).

Në Fjalorin e vitit 1954 kemi të shënuara trajtat: *cingëroj* (folje); *cingërimë* (emër). Ndërsa në FGJSSH (2006) kemi të pasqyruar edhe lemën mbiemërore: *cingërues*: *zë cingërues*. Përpjekja e Camajt për t’ju afruar sa më shumë formave të standardit duket qartë në mjaft fjalë të përdorura nga ai. Edhe në shembujt e mëposhtëm, vërejmë mbështetjen e shfrytëzimin e leksikut të shqipës.<sup>315</sup>

“Në gjuhën letrare po merr një shtrirje gjithmonë e më të gjerë, është shndërruar në normë ajo mënyrë formimi që është karakteristike për gegërishten, nga pjesorja *gege dhe prapashtesa -s*. Ky nëntip fjalëformimi, duke u përdorur kaq gjerë në gjuhën letrare shqipe, po shtrihet analogjikisht edhe në raste, të cilat gegërishjta nuk i ka.”<sup>316</sup> Ja disa shembuj të shkëputur nga krijimtaria e Camajt:

**vëzhgues** (...syni **vëzhgues** i kaluesit të vetmuem...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 110); **gjurmues** (...kjo sjellje me kohë shndërrohej në ritual, disesi bahej pjesë e pandame e rrjedhës **gjurmuese**...) (“Palimspesht”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 179); (...shikonte kah ai mes flokëve të zez, tue fshehtë sytë **gjurmues** dhe njëkohësisht si me qenë në faj të tij...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 241); **qortues** (...ia hodhi fjalën **qortuese**...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 122); (...tash tingulli fare i qartë e **qortues** e turbulloi Lenën e cila hyni mbas tij mbrendë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 38) etj.

\*Tek kjo mënyrë fjalëformimi duam të veçojmë ndërtimin emëror: **ravguese**, që nuk del e pasqyruar në Fjalorët e marrë për krahasim. Camaj duke shfrytëzuar trajtën foljore: **me ravgue**, me kuptimin me u endur poshtë e lart, ka dhënë lemën **ravguese**.


**ravgues** (...Fjalë abstrakte, / me tingull / **ravguese** mbi endire fytyrash / e ndjenja mbyttë/ ndër ujna ngjyrash...) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 114).

315 (...në vetëdijen tande rridhte ende rryma **vepruese**...Shkundullima, f. 126); (...ndër dyndje **mërguese** jug e veri...Shkundullima, f. 151); (...gratë **përgojuese** i ngacmonte puna...Shkundullima, f. 125); (...fjalët e pakuptueshme lanë përmbas, në dhomë, tytësi dhe heshtje **hutuese** ...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 243); (...shega **freskuese** avullin e lëshonte...Loja e mbasdrekës, f. 39); (...dhimba **mallëngjyese** binte me vete edhe shqetësim e kryengritje...Rrunga në mars, f. 190); (...mundet me u shijue edhe si tingull / **përshkrues** nëpër gojën e dragonit në / miniaturë mbrenda O-së nistore n’rresht ...Palimspesht, f. 189) etj.

316 A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 3, Tiranë, 1972, f. 62.



### Paraqitja skematike e prapashtesave sipas dendurisë së përdorimit



#### 3.1.3. Formimi i fjalëve me parashteso-prapashtesim

Në krijimtarinë letrare të Camajt ndeshim rrallë leksema të ndërtuara me mënyrën: *parashteso + prapashtesore*.

**përgojoj** (...”A e dini përse flitet kaq shumë për Nikën? - Tha dikush se e përgojonte ma së shumti para bjerraditësve që qysh se kishte fillue moti i keq s’i largoheshin hinit të votrës, gjithnjë tue qitë përralla e trillime...”) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 52). (...përgojoheshin edhe takimet e ndonjë sheti e shkurtë e atyne të dyve, mbramjeve, para syve të gjithëve...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 110).

Camaj ka krijuar një sinonimi kontekstuale, duke i dhënë foljes *përgojoj* ngjyrim stilistikore.

**përgojuese** (...*gratë përgojuese i ngacmonte puna...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 125).

**përmalloj** (...*Lena nuk përmallohej aq lehtë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 36); (...*tash përmallohesh...*) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 170).

**shmalloj** (...*të shmalloheshin me farefisnin...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 93).

**përrethshëm** (...*në pritje qëndroi përrethshëm mbas trinës...*) (“Karpa”, Romë, 1987, f.139).

\* \* \*

Shkrimtarët janë ato që mund të zbulojnë më së gjeri e më së thelli pasurinë e një gjuhe a një dialekti e një gjë të tillë arriti ta realizonte edhe M. Camaj. Në krijimtarinë e tij vihet re një leksik mjaft i pasur, ku ai zgjeroi e përpunoi fjalë të shqipes, fjalë dialektore e të vendlindjes, rigjallëroi fjalë “të harruara”, por edhe rikrijoi leksema të reja mbi bazën e fjalëve të njohura, të cilat e pasurojnë fjalorin e shqipes me njësi leksikore e semantike.

Gjithë këtë pasuri të pashterrshme arriti ta shfrytëzonte në mënyrë të përkryer Camaj, pasi siç shprehet edhe gjuhëtari Xh. Lloshi: “Çdo sukses i gegërishtes, p.sh., që tani disa, me të drejtë të plotë e kultivojnë në letërsinë artistike, është sukses i gjuhës shqipe. Domethënë, pasuria e gegërishtes, nuk është pasuria e një gjuhe tjetër, është pasuria e gjuhës sonë.”<sup>317</sup>

Formimi prapashtesor na paraqitet më i larmishëm në krijimin e fjalëve të reja. Përdorimi i dendur i ndajfoljeve me ndajshitesën *-shëm*, me burim nga gegërishtja, ka bërë që mjaft ndërtime të kristalizohen edhe në gjuhën shqipe. Lidhur me një fakt të tillë gjuhëtari Sh. Rrokaj, shprehet: “...*pjesorja gege nuk u pranua në standardin letrar, ashtu siç nuk u lejuan, për hir të kristalizimit të normës, edhe botimet në letrarishten dialektore. Në këtë mënyrë formimi i fjalëve me prapashtesën -shëm mbeti vetëm potencial. Fjalët që do të krijoheshin më vonë në shqipen standarde ishin produkt i nevojës që ka shqipja për këtë mënyrë fjalëformimi, e cila nuk kishte gjegjësen e saj në toskërishte. Ato i detyrohen kujtesës së freskët kolektive...*”<sup>318</sup>

317 Xh. Lloshi, Gazeta *Shekulli*, 2 qershor, 2013.

318 Sh. Rrokaj, *Fjalësi me prapashtesën -shëm në disa vepra të I. Kadaresë*, në “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007, f. 21-35.

Me anë të kësaj ndajshtese Camaj ka mundësi të ketë krijuar leksemat: *përngeshëm, ngathshëm, nynyrueshëm, përpishëm, përkueshëm, pusishëm, spetullueshëm, ngulshueshëm, zashëm, kokrrueshëm*. Përcaktimi nëse është fjalë e re e krijuar nga autori del mjaft e vështirë.

Me anë të ndajshtesës *-as* mund të themi që autori ka të ngjarë të ketë krijuar leksemat: *kryeneças, trashamanas, ngulmas, thuktas, thatas, rrebtas* të cilat fitojnë një kuptim intensiv përforcues në kontekstet e përdorura.

Shkrimtarët janë mjeshtër të palodhur të gjuhës, ato mbledhin me kujdes nektarin e shqipes, përpiqen të risjellin në krijimtarinë e tyre fjalë e shprehje të gurrës popullore, por edhe krijojnë fjalë të reja. M. Camaj është njëri prej tyre që u shqua për *novatorizmin gjuhësor, që shfaqet në krijimet e shumta të fjalëve e të shprehjeve*.<sup>319</sup>

Gjuha e Camajt ka një pasuri të madhe gjuhësore, të krijuara me mjetet e shumta fjalëformuese. Kjo provon njohjen që kishte gjuhëtari e shkrimtari për të, por edhe mundësitë e gjëra fjalëformuese të mbarë shqipes. Fjalët e formuara me anë të prapashtesave janë të mbështetura jo vetëm në leksikon e gegërishtes, por edhe në ligjërimin e mbarë të shqipes. Me anë të prapashtesave: *-isht, -o, -im, -ues, -ës, -ësi, -tar, -tor, -i, -ak* autori ka krijuar leksemat: *letrarisht, qëllimo, heshto, lajmo gjinim, gjygjim, erëtim, flakim, lëngues, ravgues, psherëtues, shtiratës, pikatësi, njohësi, tryestar, pusitar, thati, festore, pusak*. Vlen të theksojmë edhe njëherë mendimin se përcaktimi i autorësisë së këtyre leksemave del mjaft i vështirë, pas ata mund të jenë pjesë e ligjëritimit popullor, ose leksema dialektore që gjallërojnë në vendlindjen e autorit, e janë risjellë për qëllime stilistike.

#### **3.1.4. Problemi i sindajshtesave në gjuhësinë shqiptare**

Diskutimet dhe mendimet rreth sindajshtesave janë mjaft të ndryshme dhe shpesh herë kundërthënëse. Kjo duket edhe në temat e ndryshme që janë përdorur për emërtimin e këtyre elementëve. Kështu në literaturën e huaj gjuhësore hasim termat: pseudoafikse (pseudoprefikse e pseudosufikse), të tjerët afiksoide (prefiksoide e sufiksoide) etj., ndërsa në literaturën shqiptare hasen termat: gjysmëndajshtesa e sindajshtesa.

Në tekstin “Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia”<sup>320</sup>, ato shihen si pjesë e kompozitave tek të cilat njëra prej gjymtyrëve nga pikëpamja e funksionit dhe e

319 K. Topalli, *Vëpra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, Simpoziumi “Martin Camaj, Tradita dhe bashkohësia”, Shkodër, 1994, f. 92.

320 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 73.

kuptimit është duke marrë tiparet e një ndajshtese.

E. Hysa lidhur me problemin e ndajshtesave thotë: “*Edhe në gjuhën shqipe ka formime që kanë në përbërjen e tyre disa elemente, natyra e të cilave po afrohet gjithnjë e më shumë me ndajshtesat. Në strukturën e fjalës këto elemente paraqiten si morfema të tipit kalimtar janë quajtur shpesh ndajshtesa (afiksoide), sepse dalin në fjalët e përbëra dhe luajnë rolin e një ndajshtese.*”<sup>321</sup> Ai sheh tipare të një ndajshtese jo vetëm tek elementet e huaj: *auto-, bio-, aero-* etj., por edhe ato vendase, si: *gjithë-, gjysmë-, ish-, krye-* etj.

Ndërsa H. Shehu për këtë problem shprehet: “*Atëherë, meqë ndajshtesa është e ngjashme me mjetet fjalëformuese ndajshtesore, të tilla formime pritej të quheshin të prejardhura; ose përderisa ato janë gjymtyrë të fjalëve të përbëra në vend të ndajshtesave pritej emërtimi si temë.*”<sup>322</sup>

“A. Xhuvani dhe E. Çabej elementin bashkë- në njësitë e njëfjalëzuara e quajnë pjesë të kompozitës; kurse *para-, pas-, mbas-* i marrin si parashtesë. Ndërkohë që për *prapa-, mbrapa-* si elemente fjalëformuese nuk i identifikojnë as si parashtesa e as si pjesë kompozite.”<sup>323</sup>

Ndërsa S. Riza “*elementët para-, kundër-, tej-, keq- etj. i merr si parashtesa që ekzistojnë dhe si fjalë më vete*”.<sup>324</sup>

Këto elemente që mendohet të jenë ndajshtesa J. Thomai i fut në grupin e parashtesave: “*Një tog emrash e foljesh me kuptime të ndryshme janë formuar me parashtesat bashkë-, para-, pas-, kundrejt- etj., por ndërkohë ai thekson se ka një mendim, sipas të cilit bashkë-, para-, prapa-, kundër- etj. janë tema fjalësh dhe si rrjedhim fjalët e formuara me to janë të përbëra.*”<sup>325</sup>

Pra siç shihet problemi i ndajshtesave është trajtuar në gjuhësinë shqiptare, por nuk ka një mendim të njëjtë për atë se ç’janë ndajshtesat, cili është vendi i tyre në mjetet e fjalëformimit të shqipes.

“*Në gjuhën shqipe në funksion të ndajshtesave shihen mjetet fjalëformuese: drejt-, gjysmë-, ish-, krye-, vetë-plot- etj. Kalimi i tyre në funksion të mjeteve fjalëformuese parashtesore është bërë nëpërmjet kompozimit. Ndajshtesat, megjithëse kanë marrë një kuptim pak a shumë të përgjithshëm, abstrakt, mbeten elemente me kuptim*

321 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 59.

322 H. Shehu, *Rreth ndajshtesave (afiksoideve) në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 1989, nr. 2, f.145-153.

323 A. Xhuvani, *Vëpra I*, Tiranë, 1980 (në faqet përkatëse).

324 S. Riza, *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë, 1994, f. 298 - 300.

325 J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 155 - 165.

*leksikor, sepse përmbajnë një morfemë rrënjore dhe i kanë të qarta lidhjet semantike me të, kurse ndajshitesat, si të tilla, nuk mund të jenë morfema rrënjore.*<sup>326</sup>

#### **3.1.4.1. Formimet me sindajshitesën krye-**

Në materialet që kemi vjelë nga veprat e M. Camajt kemi ndeshur fjalë që përfshihen tek formimi me sindajshitesa. Le të shohim disa shembuj:

*“Sindajshitesa krye-, bashkohet me tema emërore që shënojnë veta sipas profesionit ose detyra që kanë ushtruar, por edhe jofrymorë.”<sup>327</sup> Të tillë janë formimet: kryemëzati, kryezoti, kryeplak, kryeshesh, kryeqendër.*

**kryemëzati** (...ky fill kuvendi s’i pëlqeu asaj; turpnohej dhe grindej në zemër tue u kujtue si ajo i hapte atij burri të huej, shpatullgjanë, **kryemëzati** të murmë dhe flokrupeç, derë e dritare dhe i fliste për sjellje e vese të trashëgueme...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 120).

Në FGJSSH (2006) kemi ndërtimet emër+emër, si: *kryebandit, kryekamarier, kryeministër* etj., mendoj se Camaj u mbështet pikërisht në këto ndërtime për të krijuar kompozitën *kryemëzati*.

**kryezoti** (...Për nën korba dy bij **kryezotash**, / “krah për krah, shih si rrinë!” / “Shpend i poshtër e pusitar!- / Tha **kryezoti** i parë: / “Gjergj, ndalu një herë, pushë Zotin!...) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 167).

**kryeplaku** (...plagosja e **kryeplakut** të Grykës së Madhe...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 68).

**kryeshesh** (...Prore kërkohet një pike \ që bie në sy \ Piazza Navona ose Marienplatz \ një ballkon në faqen e diellit \ buza e një kroni \ e humb njeriu në anatominë / e statues n’**kryeshesh**...) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 136).

**kryeqendrën** (...mbas dy ditësh, kur ai kthye mbas vorrimit të mbetunve në rrënoje, i thanë se Ntonia ishte nisë për në qytetin e madh, **kryeqendrën** e krahinës te farefisi i s’amës...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 153).

#### **3.1.4.2. Formimet me sindajshitesën bashkë-**

Në këtë grup kemi formimet me sindajshitesën **bashkë** + një emër foljor veprimi ose vepruesi. Ky tip shprehet, E. Hysa: “*duhet parë në kufirin midis kompozimit dhe ndajshitesimit. Bashkimi i një ndajfoljeje me një emër në gjuhën shqipe as ka*

326 Po aty, f. 74.

327 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 91.

qenë dhe as është e zakonshme. Formimet e këtij tipi në gjuhën shqipe shkojnë sipas gjedheve të huaja me *co-* e *con-*. Formimet me *bashkë-* nuk janë karakteristikë për gjuhën popullore, ato janë krijime të gjuhës së kulturës.»<sup>328</sup> Përdorimi i formimeve: *bashkëlojtarë*, *bashkëfajtorë*, *bashkëpunëtorë*, *bashkënxanës*, *bashkëfolës*, *bashkëvendas*, *bashkërrjedhja*, *bashkëpunim etj.*, vërtetojnë edhe njëherë përpjekjen e Camajt për një afrim me standardin.

a) Sindajshtesa **bashkë-** është bashkuar me tema emërore të prejardhura nga prapashtesat *-tar*, *-tor* si:

**bashkëlojtar** (...*tue pasë bashkëlojtarë dy vetë...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 108).

**bashkëfajtor** (...*e ndjen veten atë ditë si bashkëfajtorë...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 189).

**bashkëpunëtor** (...*i rritej shkathtësia para syve të bashkëpunëtorit...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 131).

b) Kjo sindajshtesë bashkohet me një emër vepruesi të prejardhur me prapashtesën *-ës*, *-ësi*:

**bashkënxanës** (...*tue përfytyrue bashkënxanësit e të birit...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 214).

**bashkëfolës** (...*për të ndëgjue nga bashkëfolësi...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 110).

**bashkëvendas** (...*si me ia pasë luejtë lojën bashkëvendasit të vet...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 234).

c) Sindajshtesa *bashkë* + emër abstrakt veprimi të prejardhur me prapashtesën *-je*, *-im*:

**bashkërrjedhja** (...*bashkërrjedhja e ngjarjeve të jashtme të mbrendshme...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 131).

**bashkëpunim** (...*Nikës ndonjëherë i kishte shkue mendja se ky bashkëpunim mes të bijve e vëllezënve qenka njëlloj besëlidhje...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 28).

### 3.1.4.3. Formimet me sindajshtesën gjysmë-

“Sindajshtesa **gjysmë-**, bashkohet zakonisht në gjuhën shqipe me tema emërore të

---

328 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 63.

*parme, duke dhënë përsëri emra.*”<sup>329</sup> Tek krijimtaria e Camajt duam të veçojmë ndërtimin *gjysmëterr*; ku autori paraqitet i lëkundur nga ana drejtshkimore, ai e ndërton këtë fjalë njëherë bashkë e një herë me vizë në mes. Fjala e prejardhur *gjysmëterr* ka kuptimin : gjendje mes dritës e territ, mendojmë të jetë një krijim i autori.<sup>330</sup>

**gjysmëterr** (...*ne krye të shkallave u lëshonte një sy shtyllave graniti të vjetrueme te dera e hymjes që, në gjysmëterr dukeshin si roje të shtangueme...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 109); (...*gjithçka përkonte me atë fantazmë në gjysmë-terr, lëvizja e çdo sendi, e çubave, përqethja e barit të rritun skajeve t’ujit...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 82).

**gjysmëfjali** (...*Vitot merrte vesh gjysmëfjalish me za të kumbueshëm...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 116).

#### 3.1.4.4. Formimet me sindajshtesën drejt-

“*Sindajshtesa drejt- vendoset zakonisht para temave emërore prejfoljore të formuara me prapashtesën -im.*”<sup>331</sup>

Formim të tilla te krijimtaria e Camajt janë të pakta, si:

**drejtpeshim** (...*lidhjet familjare e humbën fare drejtpeshimin...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 44); (...*aq sa me humbë drejtpeshimin...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 127); (...*në humbjen e drejtpeshimit...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 288); (...*a ka drejtpeshim mes pjesëve përbamëse...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 91).

#### 3.1.4.5. Formimet me sindajshtesën vetë-

“*Sindajshtesa vetë- bashkohet zakonisht me tema emërore të prejardhura me prapashtesën -im, -je.*”<sup>332</sup> Në shembujt e mëposhtëm kemi përdorimin e leksemave: vetëdije e vetëkënaqje, të cialt i përkasin leksikut të mbarë shqipes.

**vetëdija** (...*vetëdija ashtë një shkëputje e dhemb si ndamja e mishit prej ashtit...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 34); (...*me zgjimin e jetës në katund zbeheshin në vetdijen time përfitimet e natës ...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 54).

**vetëkënaqje** (...*ndreqja e një objekti në rrëzim jep vetëkënaqje, diçka si vetë shlirim...*)

329 Po aty, f. 90.

330 D. Luka, *Studime gjuhësore*, XIII, Shkodër, 2011, f. 193.

331 E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 89.

332 Po aty, f. 94.

(“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 100).

### 3.1.5. Formimi i fjalëve me mënyrat e përziera

#### 3.1.5.1 Formimi i fjalëve kompozim dhe ndajshtesim

Tek mënyrat e përziera studiuesit E. Lafe dhe F. Agalliu, përfshijnë edhe *ndërtimet: kompozim + ndajshtesim, ku prapashtesën e merr gjithë togfjalëshi dhe jo “tema fjalëformuese” e dytë*.<sup>333</sup> Ndërsa një grup gjuhëtarësh shqiptarë janë të mendimit, se “në grupin e fjalëve të përbëra, me interes janë disa ndajfolje të formuara sipas tipit kompozim + ndajshtesim ku bashkimi i dy temave ose fjalëve shoqërohet edhe me një prapashtesë”.<sup>334</sup> Prapashtesa më e parapëlqyer e Martin Camajt në ndërtimin e këtyre kompozitave është *-as* dhe më rrallë ajo *-ës*.

Në fillim po listojmë ato kompozita që nuk i kemi ndeshur të pasqyruara në fjalorët që kemi marrë në krahasim, si p.sh.: *ndjellakeqas, kambagjelas, mirakandas, kambë-sharavelas, gazakeqas*.

**ndjellakeqas** (...pyeste *ndjellakeqas*...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 164).

Në FGJSSH kemi të pasqyruar trajtën mbiemërore: *ndjellakeq, -e*, shenjë *ndjellakeqë*, ndërsa formën ndajfoljore nuk e kemi të pasqyruar, e ka shumë mundësi të jetë formimi i Camajt.

**kacagjelas** (...me krahë e bërryla të çuem *kacagjelas*...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 250); (...si rri *kacagjelas* me duer mbi gjuj...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 34); (...herë herë edhe i kapërcente *kambagjelas*...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 60).

Kjo leksemë del e përdorur më tepër në leksikun popullore, e cila si temë ka paraformën kaca- që ndeshet edhe në jo pak krijime elementare si: *kacarru, kacabu, kacadre, kacafiu* etj., të shpeshta në veri ashtu edhe në jug, e që do të kenë qenë edhe të hershme në shqipen, pra janë në të dy dialektet, ndonëse fjala *kacagjelas* mbetet deri më sot e trevës veriore. Mjafton të themi se, vetëm në Fjalorin e gjuhës shqipe të M.Elezit, radha e formimeve me kaca-, përveç *kacagjel* e *kacagjelas*, përfshin edhe trajtën mbiemërore i *kacagjelur*, si dhe mjaft të tjera.<sup>335</sup>

Një ndërtim të bukur duke iu përafuar fjalës së lartpërmendur është *kambagjelas* të përdorur tek proza “Djella”.

**kambagjelas** (...herë herë edhe i kapërcente *kambagjelas*...) (“Djella”, në *Vepra 1*,

333 F. Agalliu, *Formimet e tipit kompozitë + prapashtesë në gjuhën shqipe*, SF / 2, 1987, f. 11.

334 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, f. 151.

335 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 623-628.



Tiranë, 1996, f. 60).

Për analogji me fjalën kacagjelas autori ka krijuar fjalën kambagjelas që s' del e pasqyruar në Fjalorin e Gazullit e Fjalorin e vitit 1954 e FGJSSH të vitit 1980, 2006.

**gazakeqas** (...*ai nuk më mori vesh e qeshi gazakeqas...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 91).

Këtë ndërtim nuk e kemi ndeshur në Fjalorin e vitit 1954 e Fjalorin e Gazullit e FGJSSH të vitit 1980 e 2006, mund të themi që është krijim i shkrimtarit.

**mirakandas** (...*me kënaqësi, me ëndje, si në barkë.. që lundron mirakandas...*) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 298); (...*kundronte mirakandas gjakimin e pashëm të nobelistit...*) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 115).

Janë të njohura format mirakande si ndajfolje, që i kishte përdorë që herët A.Harapi.<sup>336</sup> Në prozën poetike “Dranja- Madrigale” e prozën “Rrungaja në mars” kemi formën *mirakandeje*, leksemë karakteristike e të folmes së Shkodrës. Këtë kompozitë e ndeshim në FGJSSH 2006: ha me mirakandje, por sot ajo ka dalë nga ligjërimi. Leksema me ndajshitesën -as, nuk del e dhënë në fjalorë e mendojmë që ndoshta është një krijim i autorit.

**mirakandes** (...*Dranja ashtë një breshkë që duket e zhduket simbas mirakandes së vet...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 68); (...*simbas mirakandes së vet...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 165); (...*e la me folë sipas mirakandes...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 243); (...*kur lundronte për mirakande...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 289); (...*për mirakandje shkruen ti...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 108).

**prishakandas** (...*tha nën za Bardhi prishakandas...*) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 227).

Fjalë nga më interesantet të Camajt, që shkon sipas gjedhes së njohur të veriperëndimit prishaqefas, porse nuk dimë të jetë përdorur kund tjetër kjo leksemë, ndërkaq dihen simotrat e saj: prishplang, prishasillë, që i ka edhe Fjalori i M.Elezit.<sup>337</sup>

Kompozitën *prishakandas* të përdorur tek romani “Rrathë” nuk e kemi të pasqyruar tek FGJSSH, ndërsa fjala e përbërë *prishaqefas* del e pasqyruar me trajtën *prishqejfas* tek “Djella”, kurse te vepra “Pishtarët e natës” na del trajta *prishakandun*. Edhe kjo kompozitë mendojmë që është një krijim i Camajt.

336 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 921.

337 Po aty, f. 1181.

**prishaqefas** (...mbet disi i premë sepse tue u kujtue se isha **prishaqefas**, dyshoi se nuk isha për ndoj vizitë të papritun...) (“Djella”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 86).

**prishakandun** (...ende të mrekulluem si ungi nuk ua dinte emnat të nipave që edhe ata e shikonin **prishakandun**...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 57).

**dorëjashtas** (...me sytë e tyre **dorëjashtas**...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 147).

**dijekeqas** (...tue qeshë **dijekeqas** e me qëllim për të më fye...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 110).

**ballafaqas** (...ra në katundin e Jerës **ballafaqas**...) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 193; (...të dalë **ballafaqas** e të thotë: nuk due shpagim e të ndjekë doket e shëmtueme të tjera kohëve...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 64); (...mbasi jemi këtu të dy **ballafaqas**...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 109).

**symbyllas** (...tue ecë pothuajse **symbyllas**...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 252); (...pleqtë e dinë rrugën **symbyllas** në terr e në dritë...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 262).

Gjithashtu edhe kjo fjalë del me gurrë popullore, po të kemi parasysh edhe emërtimin e një loje popullore të veriperëndimit: symshilaza (Malësi e Madhe).

Për tipin i kompozitave: *fatlumësi e fatbardhësi*, studiuesi A. Kostallari mendon se ndërtime të tilla janë formime morfologjike me sufiskale, pasi fjalori nuk ka të pasqyruar lemat: *lumësi e bardhësi*.<sup>338</sup>

**fatlumësi** (...kaq **fatlumësi** në jetë nuk do nënçmue...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 29).

Në FGJSSH(2006) kemi përdorimin si mbiemër *fatlum: njeri fatlum* dhe kompozitën: *fatlumtur*. Kjo leksemë ka të ngjarë të jetë ndërtim i autorit.

**fatbardhësi** (...fluturuen tue pru ndër krahë / nji **fatbardhësi** prej malit...) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 49)

### 3.1.5.2. Formimi i fjalëve me nyjëzim dhe prapashtesim

Në gjuhën shqipe mënyrat e fjalëformimit shpeshherë janë të gërshetuara me njëra-tjetrën. Më poshtë po paraqesim disa ndërtime mbiemërore tek të cilat kemi gërshetimin e nyjëzimit me prapashtesimin njëkohësisht. Duhet të theksojmë se deri tani kjo mënyrë fjalëformimi është parë së bashku me formimet thjesht prapashtesore, por roli fjalëformues i nyjes së përparme te ky tip është i pamohueshëm e po aq i

338 A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 108.

rëndësishëm sa ai i prapashtesës, prandaj ato analizohen më vete.<sup>339</sup>

Prapashtesat që marrin pjesë në këtë mënyrë fjalëformimi janë: *-shëm, -ueshëm, -(ë)t(ë), -(ë)më dhe -ë*. Ndajshitesa më prodhimtare në gjuhën shqipe e në krijimtarinë e Camajt është prapashtesa *-shëm*, me të formohen zakonisht mbiemra prej temash emërore, foljore e ndajfoljore.

Me anë të kësaj mënyre fjalëformimi tek Camaj ndeshim përdorimin e mbiemrave, si p.sh: ***i mbërrelshëm, i shkitshëm, i unshëm, i etshëm, i devotshëm, i dhimbshëm, i shkëlqyeshëm, i turrshëm, i burrnueshëm, i vetueshëm, i pushueshëm, i lavrueshëm, i nëndheshëm e i nënzashëm, të ndërshëm, i lëngueshëm, i erandshëm, i rrezikueshëm, i plleshëm, i mungulleshëm, i gëzhatshëm, i brohoritshëm, i lazdrueshëm, i andshëm, i murtajshëm, i mënershëm etj.***

“Me këtë ndajshitesë formohen mbiemra prej temash foljore, kryesisht prej temës së pjesores. Formimet që dalin nga pjesorja janë karakteristike të gegërishtes, në toskërishten popullore i përgjigjet formimi i thjeshtë me prapashtesën e pjesores.”<sup>340</sup>

Gjuhëtari A. Kostallari duke u bërë një ndarje më të hollësishme këtyre mbiemrave foljorë nga ana semantike shprehet, se: “Mbiemrat foljorë me *-shëm* i karakterizojnë sendet nga aftësia ose paaftësia, mundësia ose pamundësia dhe pashmangshmëria për t’ju nënshtruar një veprimi të caktuar ose për të shprehur një gjendje, një kryerje të veprimit.”<sup>341</sup>

Këtu po veçojmë ndërtimet: ***i mbërrelshëm, i shkitshëm***, të cilat nuk na dalin të përdorura në fjalorët e marrë për krahasim.

***i mbërrelshëm*** (...kurse Nika ***i mbërrelshëm*** në shikim...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra* 5, Tiranë, 1996, f. 28).

Fjalori i Gazullit ka shënuar leksemën: *i mbërrolët*.<sup>342</sup> Mendojmë që Camaj u mbështet tek ky ndërtim për të krijuar leksemën *i mbërrelshëm*, e cila nuk del e pasqyruar në fjalorët e marrë në krahasim, por si e tillë ajo mund të ekzistojë në ligjërimin popullor, ose në të folmen e vendlindjes së autorit. Kjo fjalë mund të jetë sinonime me : *i*, e vrenjtur: *fytyrë e vrenjtur*, e ngrysur.

***i shkitshëm*** (...ecte e shkëlqente nëpër bar ***të shkitshëm***...) (“Dranja”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f.74).

339 A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 3, Tiranë, 1972, f. 66.

340 A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 540.

341 A. Kostallari, *Formimi i fjalëve në gjuhën shqipe*, kurs special leksionesh, mbajtur në vitin akademik 1960-61, në Fakultetin e historisë e të filologjisë të USHT.

342 N. Gazulli, *Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010, f. 254. “mbërrol-e, lat. severus; germ. ernst, it. severo.”

Në FGJSSH (2006) kemi të listëzuara këto trajta: *shkas* (folje) me kuptimin rrëshqas: varka shket mbi ujë; *shkarje* (emër); *i, e shkarë* (mbiemër) i çmendur, i rrjedhur. M. Elezi në Fjalorin e tij shprehet se ky ndërtimi mbiemëror del i përdorur kryesisht në krijimtarinë e M. Camajt.<sup>343</sup>

**i shkëlqyeshëm** (...ç'andej kundronim fushën poshtë, malet në një anë, e në tjetrën larg detin në vlim *të shkëlqyeshëm, në skajin e qiellit...*) ("Dranja", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.79).

**i turrshëm** (...në të e pau dështimin: sa ma tepër shtyhej në luginë, kafsh e kalorës, të dy, gjatë sulmit *të turrshëm* përpara, merrnin me vete lojën e shpendëve...) ("Shkundullima", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 150).

**i thekshëm** (...ndërkaq Jera ndiente nëpër derën e hapun avullimin *e thekshëm* në hundë i cili vinte prej grunoreve në brigje dhe ndër ara nën shtëpi...) ("Rrunggaja në mars", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 171).

Ndërtimet mbiemërore: *i etshëm, i devotshëm, i dhimbshëm, i rrjedhshëm, i mërzitshëm, i mundshëm* etj. dalin të përdorura edhe në ligjërimin e sotëm.<sup>344</sup>

"Pjesorja është forma e pranueshme në gjuhë për formimin e mbiemrave foljor me -shëm. Ndër veçoritë kryesore të strukturës fonetike të shqipes së sotme letrare është edhe thyerja e kundërvënies dialektore midis dyzanoreve ua-ue, ku diftongu -ue ka fituar epërsinë, në mos zotërimin e plotë, në mbiemrat foljorë me -shëm e në formimin e nomina agentis nga tema e pjesores."<sup>345</sup>

Një dukuri të tillë e vëmë re edhe në materialin që kemi vjelë, si p.sh.:

**i burrnueshëm** (...greti me za *të burrnueshëm* si kurrë...) ("Dranja", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 23).

Në Fjalorin e Gazullit nuk e hasim të përdorur këtë leksemë, ndërsa në Fjalorin e vitit 1954 e FGJSSH (2006) kjo leksemë del e pasqyruar me prapashtesën -ishte, si mbiemër i panyjshëm: *burrërishte, burrënishte, veshje burrërishte* e si ndajfolje: qëndroi *burrërisht*. Trajtën mbiemërore: *i burrnueshëm* e gjejmë të përdorur tek krijimtaria e M. Camajt, e ka të ngjarë që ky ndërtim të jetë krijim i autorit.

**i vetueshëm** (...Zogjtë marrin frymë *ngulshueshëm* si me qenë tue dhanë shpirt nën hijen

343 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1380.

344 (...*i etshëm* është Mbigjarpni / e ujë kurr nuk pin...Legjenda, f. 185); (...*Xhinkalla* për shkoza t'hatata rrokë / Bërtet e bërtet e ndezet flakë / E dy copash plas e bjen për tokë / *T'etshme* si gëlqerja n'furr për ujë...Legjenda, f. 182); (...*vargun e shtrembët e të marrshëm*...Dranja, f.105); (...*rueju, se je i dhimbshëm* për të gjithë...f.24) etj.

345 A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, në "Shkencat shoqërore në shkollë", Tiranë 1967, f. 67.

e rranjëve si gjarpni dhe vështojnë tmerrueshëm krismën e kërcllatjen në kërcej të arave të djeguna nësa i përpin flaka. Nalt, mbi maje në avullin e vetueshëm sillet gjerza, zotesha e vapës; si e lidhun për laku shkon e vjen mes rrymës së ernave... Dranja, f.47).

Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 shënon foljen pavetore: *veton*, ndërsa M. Elezi shprehet se kjo leksemë del e përdorur kryesisht në krijimtarinë e M. Camajt, kurse ndërtimin ndajfoljor e ndeshim të përdorur në krijimtarinë e S. Buçpapajt.<sup>346</sup> Përdorimi i disa leksemave të formuara me të njëjtin mënyrë fjalëformimi është veçori e gjuhës së Camajt, me qëllim që të arrihet shprehësia në kontekstin e dhënë.

**i pushueshëm** (...I biri, si hapi derën, mbeti shtang: përmbi tokë shtrihej një cipë bore, e lëmuet, që binte me flokë **të njëshëm** dhe **të pushueshëm**. Loshi tue marrë me mend se çka shikonte i biri shtangueshëm, ia nisi shpjegimit: "Ajo bie mbi shtrojen e akullit dhe ku zë vend, aty mbetet ...") ("Rrunggaja në mars", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 204).

Nga tema foljore pushoj me kuptimin çlodhem, kaloj pushimet diku, Camaj përdor mbiemrin *i pushueshëm* me kuptim të ri leksikor: flokët e borës binin ngadalë e zinin vend për të pushuar (për të qendruar gjatë deri në pranverë).

**i lavrueshëm** (...dhe ke të drejtë sepse toka i përket atij që e gërryen me thoj të vet. Djerrin e bahen **të lavrueshëm** e dheun e zbutun, bukë!...) ("Djella", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 101).

**i shtërngueshëm** (...me za **të shtërngueshëm** ndër dhambë, por jo qortues...) ("Pishtarët e natës", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 38).

Përpjekjet e Camajt për t'ju afruar standardit, shfaqen edhe në ndërtimet e mëposhtme.<sup>347</sup> Camaj arriti të përdorë mënyrat e përziera edhe në ndërtimet: *i nëndheshëm* e *i nënzashëm*, *i ndërhundshëm*.

**i nënzashëm** (...kur tingujt **e nënzashëm** nisën të kthjelloheshin...) ("Rrathë", Mynih, 1978, f. 258); (...mjellma në një çast e ndali kangën **e nënzashme**...) ("Dranja", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 48).

Në Fjalorin e vitit 1908, Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 e atë të Gazullit kjo leksemë nuk del e pasqyruar, kurse në FGJSSH (2006) kemi ndërtimin mbiemëror

346 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1569. "...një Oh që shihet në Jug / dhe dëgjohet vetueshëm në Veri..." (S. Buçpapaj, Poezi).

347 (...për të shti në dorë sa më shumë kësi frymorëzish të kushtueshëm...Pishtarët e natës, f. 43); (...për të huejt e **kujtueshëm**, Nika ishte njeriu fatal, rojtari e zoti i asaj treve, udhërrëfyesi në labirin, me sjellje të njerëzishme, tipi i mikpritësit të lashtësisë...Pishtarët e natës, f. 65); (...Vitoi merrte vesh gjysmëfjalish me za **të kumbueshëm**...Shkundullima, f. 116) etj.

i zëshëm. 1. Që ka za të lartë, i zhurmshëm; që bëhet me zë: motor i zëshëm; votë e zëshme. Ndërtimi *e nënzashme* shprehet M. Elezi del e pasqyruar kryesisht në krijimtarinë e Camajt.<sup>348</sup> Kështu ne mund të themi që kjo fjalë mund të jetë një krijim i autorit, ose bën pjesë në ligjërimin popullor.

**i nëndheshëm** (...*Bardhyli ndërkohë kishte ndërtue një qytet të nëndheshëm* ...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 56).

**i ndërhundshëm** (...*ai kishte një za të ndërhundshëm dhe pëshpëritës* ...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 230).

Ndërtimi mbiemëror: **i ndërhundshëm**, ka mundësi të jetë ndërtim i autorit, pasi në fjalorët e marrë për krahasim na del me forma të ndryshme, si p.sh: në Fjalorin e Gazullit kemi trajtën *ndërhundëzue* si folje (mos hundorëzo), në Fjalorin e viti 1954 del e shënuar forma foljore *ndërhundëztoj*, në FGJSSH (2006) kemi ndërtimin *ndërhunshë* si mbiemër, pa prapashtesën -shëm, kurse në Fjalorin e M. Elezit kemi përdorimet, si folje: *ndërhund* (flas ndërhund), si mbiemër: *ndërhundç* (mezi merret vesh, asht ndërhundç), si: ndajfolje *ndërhundësh* (flet ndërhundshëm), përfshirja e kësaj lekseme në fjalorë do të zgjeronte çerdhen fjalëformuese të saj.

Nga tema emërore *uri* Camaj ka përdorur leksemën *i unshëm*.

**i unshëm** (...*me atë thjeshtësi të kërthinit të unshëm*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 115) ; (...*atëherë kur e pata ndeshë së pari, isha i unshëm e sy - kuq si zjarmi*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 85).

Leksemën *i unshëm* e ndeshim që tek Fjalori i vitit 1954,<sup>349</sup> ndërsa në standard kemi përdorimin: *i urishëm*.<sup>350</sup>

### 3.1.5.3. Formimi i fjalëve me nyjëzim dhe përngjitje

Një tip tjetër i formimit të mbiemrave është kur si temë fjalëformuese shërben parafjala pa + emër në rasën kallëzore të pashquar. “*Këta mbiemra që formohen me përngjitje dhe nyjëzim, mohojnë zotërimin e një sendi nga sendi i karakterizuar prej tyre.*”<sup>351</sup> Tek Camaj kjo mënyrë fjalëformimi gjen pak përdorim, mund të veçojmë fjalën: ***e parranjë*** që nuk del e pasqyruara në fjalorë e mund të themi që është krijim i autorit, një gjë të tillë e shpreh edhe M. Elezi: “Trajta mbiemrore *i, e*

348 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 989.

349 *Fjalori i gjuhës shqipe*, Fjalori '54, Çabej, 2005-2010, f. 591. “Unshëm (i) - unshshme (e) mb. i urëtuar, i urët”.

350 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1145.

351 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f. 196.

*parranjë* gjendet e pasqyruar kryesisht në krijimtarinë e Camajt.<sup>352</sup> Kjo leksemë ka kuptimin: *i ardhur, jo vendës*.

**i parranjë** (...*ashtë tokë e parranjë kjo e jona...*) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 178); (...*tue dashtë me i shkue deri në fund shkretisë shpirtnore të njeriut të parranjë...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 84).

**i pamort** (...*zemra e qindrueshme / rrok mallin e pamort / e pika shiu bien mbi rreshpe të pangishme...*) (“Njeriu me vete e me tjerë”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 178).

Përdorimi i këtij mbiemri vihet re që tek Buzuku: *i pamort*<sup>353</sup>.

“Në gjuhën shqipe përdoret rregullisht si fjala e formuar me parashtesën mohuese *pa-* ashtu edhe fjala antonim pa këtë parashtesë, ka raste kur nuk ekziston fare fjala pa këtë parashtesë. Kështu mbiemrat e formuar me nyjëzim të togut parafjalor *pa+emër* nuk kanë përgjegjëset e tyre antonimike pa parashtesë në gjuhën shqipe.”<sup>354</sup> Një dukuri të tillë e kemi ndeshur tek leksemat, si p.sh.: *i pashoq, i pafund, i pamasë, e pacak, i panjollë, i pashpirt, e paemër, e pakohë* etj.<sup>355</sup>

**i pavarrueshëm** (...*në sy e bahesh i pavarrueshëm ...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 81).

Në FGJSSH (2006) kemi përdorimin si *mbiemër*: *i varruar, i varrosur, i pavarrosur* ndërsa ndërtimi *i pavarrueshëm* nuk del i pasqyruar, ka mundësi të jetë ndërtim i autorit duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes.

Arti krijues i Camajt shfaqet edhe tek mënyrat e përziera. Ai përpiqet të ndërtojë forma të reja fjalësh duke u mbështetur tek tradita. Më poshtë po listojmë ndërtimet që ka shumë mundësi të jenë krijime të Camajt, si p.sh.: *i mbërrelshëm, i shkitshëm, i burrnueshëm, i vetueshëm, i nënzashëm, i ndër hundshëm, e parranjë, i pavarrueshëm, ndjellakeqas, kambagjelas, mirakandas, kambë-sharavelas, gazakeqas*.

352 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Enti botues “Gjergj Fishta”, 2007, f. 1063.

353 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I, Shkodër, 1996, f. 401. Pamort, i mbiemër, lat. Mors - mortis. i pavdekshëm “Zot, negji hi pamort, “ ty tek lus “XIX, II; “ HI PA MORT” LxxxIX C IX).

354 M. Samara, Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe, Tiranë, 1985, f. 111.

355 (...*një za i pashoq e i papërsëritshëm...*Nema, f. 132); (...pus *i pafund* dija...Pishtarët e natës, f. 69); (...*sy i pangishëm, shpellë e pafund, / ti smirzi e zemër-terr...*Legjenda, f. 172); (...*se ai shprehej ma rrjedhshëm se ata të pakulturë e arsim...*Shkundullima, f.101); (...*Gazulli vetë i rralloi ravgionet e pacak...*Gjon Gazulli, f. 271); (...*nuk të bahet me besue se ashtë shurdhac e i pagojë...*Loja e mbasdrekës, f. 14); (...*ta kundërshtosh thanjen e mjekut si gërgasje të pathemel ...*Loja e mbasdrekës, f.20); (...*s kam ardhë për keq në këtë kohë të pakohë...*Kandili i argjandit, f. 103) etj.

## KREU IV

### 4. FORMIMI I FJALËVE TË PËRBËRA

#### 4.1. Kompozitat emërore

*“Fjalët e përbëra dokumentohen që në monumentet më të lashta të gjuhës sonë të shkruar, tek veprat e Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit, Varibobës etj.”<sup>356</sup>*

Si përkufizim për kompozitat pranohet ai i A. Kostallari, i cili pohon: *“Fjala e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në shqipen është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy a më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj.”<sup>357</sup>*

Fjalët e përbëra në krijimtarinë e Camajt janë të shpeshta, edhe pse në mjaft raste nuk kanë zënë një vend të caktuar ato kanë vlerë të madhe për arsye se ato, duke qenë të formuara mbi baza të drejta e sipas modeleve ekzistuese të gjuhës shqipe tregojnë se shqipja kishte mundësi e mjete të mëdha shprehëse. *“Në klasifikimin e kompozitave kemi marrë parasysh përkatësinë leksiko-gramatikore të temave të fjalëve, pra nga ç’pjesë e ligjëratës janë formuar ato.”<sup>358</sup>* Në këtë mënyrë fjalëformimi mjaft prodhimtare na kanë dalë mbiemrat e përbërë me lidhje nënrenditëse që quhen ndryshe edhe *kompozita pronësore ose bahuvrihi*,<sup>359</sup> më të pakta janë kompozitat bashkërenditëse.

Më poshtë po listojmë disa nga kompozitat e përdorura në krijimtarinë e Camajt: *gojëplakë, vdekzotit, buzana, flokrupç, vdekje-krizëm, ora - gjarpën, kambë-qyqje, gojëplakë, flokrupç, sy-udhini, buzë-udhini, zemër-gur, gurzjarmi, shtegdalje, rrugëdalje, gju-fortë, zanalte, truerrët, buzëmprehtë, frymë-mirë, lëpush-gjanë, vith-gjanë, duerforta, truerrët, vesh mrehta, vesh-hollë, vesh-imët, plakshkreta, djalë-shkretë, shtat-naltë, shtat-hollë, bel-hollë, sy-kuqe, sy-trim, kambëshpejtë, qymegjatë, fjalëmadh, punëmadh, dritë-shkurtë, flakëligsht, syzbrazët, syqelë, symbyllë, lukth-shtjerrë, buzëshpërvjelun,*

356 A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 75.

357 Po aty, f. 83.

358 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.148.

359 A. Kostallari, *Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 141.



*ballëshpërvjelun, mrekuilibamës, fatlumësi, bestytës, ujëpërçues, jetprues, mësimdhanësi, mishngranësi, gjakpimës, gjellëbamësi, fshehtësiplotë, vështrimplotë, kuptimplotë, mirëtingëllim, marrfrumja, bjerraditës, mbushmendja, mbamendja, rrokaqielli, bakeqe, keqbamëse, shtirakeq, shumëvuajtun, shumëvjeçar etj.*

Kompozitat emërore në veprat letrare të Camajt na paraqiten të larmishme, ato janë të ndërtuara sipas temave të mëposhtme:

#### **4.1.1. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+emër prejfoljor vepruesi**

Kompozitat **emër + emër prejfoljor vepruesi**, (të formuar me prapashtesën - (ë)s), ato “*zënë fill që te Kristoforidhi: bukëpjekës, ligjédhanës etj., te Naimi: barngrënës, rrufeheqës etj., dhe kështu që nga Rilindja e deri më sot janë krijuar një varg neologjizmesh*”<sup>360</sup>. Nga krijimtaria e Camajt në fillim po listëzojmë kompozitat: **bestytës, ujëpërçues, jetprues** të cilat nuk na kanë dalë të pasqyruara në Fjalorin e vitit 1954 e Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH (2006), me forma të tilla e ka shumë mundësi të jenë krijime të autorit.

**bestytës** (...*dhe ai si realist e bestytës* që ishte...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.31); (...*ai tha se nuk e ka lanë me fjetë kërratja e një shpendkeqje në kopsht. Si ta ketë zgjue, s;e ka marrë gjumi, sepse ashtë bestytës...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 132); (...*iu kujtue Nika bestytnisë* së lashtë se grave nuk u tregohej si gjuheshin shqerr e dhelpna...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 42).

Kjo kompozitë vjen nga tema emërore: bestytni, kurse tek Camaj e kemi të përdorur si mbiemër (*paragjykime bestytëse*). Kjo fjalë mendojmë se ndoshta është krijim i autorit, pasi ajo nuk e pasqyruar në fjalorët e marrë në krahasim.

**ujëpërçues** (...*gjithkush e çdo send andrron në këtë dhe / si ledhet e ujëpërçuesave të vjetër/ mbi kambët e kualve të lodhun / në mes fushës, në mrrizim...*) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 90). Autori në ndërtimin e kësaj fjale të përbërë ka shfrytëzuar lemat përkatëse që gjinden të përdorura në Fjalorë.

Leksiku dialektor zë pjesën më të madhe të krijimtarisë së Camajt, gjë që pasqyrohet me anë të leksemave, si: *gjakpimës, mësimdhanës, gjellëbamës, ujëvarëse, udhëtregues etj.*

**gjakpimës** (...*gjakpimës të rrezikshëm...*) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 277).

360 A. Xhuvani, *Kompozitat*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 70.

Fjalë e njohur nga ana leksikore, por me formë të ndryshme nga e standardit: gjakpirës.

**gjellëbamës** (...*hapi sytë kah i hueji gjellëbamësi...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 250). Khs. me standardin: gjellëbërësi.

**rrufeprojse** (...*dy zemra bashkë janë ma rrufeprojse / se dy shpata tû për tû / me teha përjashta...*) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 116).

Kjo leksemë dialektore ka variantin e saj sinonimik në standard: rrufepritës.

**ujëvarëse** (...*ujëvrasja tue u ngjitë përpjetë, përmaal...*) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 166).

Ndërtimin ujëvarë e ndeshim të trajtuar tek libri i morfologjisë tek kompozitat e ndërtuara nga një emër + folje, kurse tek Camaj kemi leksemën: ujëvrasja, e cila i ka shërbyer autorit për të zëvendësuar fjalën e huaj katarakt.

**udhëtregues** (...*mue më jep shpresë një pullë poste / 33 centësh midis emblemash, / udhëtreguese dëshpërimi...*) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 144); (...*udhërrëfyysi në labirint, me sjellje të njerëzishme, tipi i mikpritësit të lashtësisë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 65).

Këto dy ndërtime janë sinonime me njëra - tjetrën e janë përdorur nga shkrimtari për larmi formash. Gjithashtu kemi edhe mjaft kompozitave që përdoren edhe sot gjerësisht në gjuhën letrare.<sup>361</sup>

#### 4.1.2. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + emër

Në ndërtimet e grupit të dytë **emër+emër** (i parmë a i prejardhur), kur “*ato janë leksema emërore tregojnë një qenie ose një send jo drejtpërsëdrejti, por duke treguar një tipar dallues, që ka qenia ose sendi, kurse kur është mbiemër shënon një cilësi që ka një qenie ose një send*”.<sup>362</sup> Tek kjo mënyrë fjalëformimi po veçojmë kompozitat: **vdekszotit, buzana, vdekje-krizëm, ora - gjarpën**, të cilat nuk i ndeshim të pasqyrura në Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e vitit 1954, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH (2006) dhe mund të themi që është përpjekja e autorit për ndërtime fjalësh të reja, ose janë fjalë dialektore.

**vdekszoti** (...*grindja në famijen e Pukajve nisi mbas vdekszotit të shtëpisë të jatit të*

361 (...*u gjetën ballë përballë në këtë vis të katundit të Lekës gjaks dhe gjakmarrës* ...Loja e mbasdrekës, f. 7); (...*ditën e krenjtjes sime, kam qenë mikpritës me plot të grishun*...Dranja f. 27); (...*as gurgdhendës nuk asht / im nip, tingull i kohës, / i veshun krejt në dritë* ...Nema, f. 116) etj.

362 A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipësisë si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 146.

vajzave...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 9).

Kjo leksemë mund të themi se është krijim i togut emëror= vdekja e zotit (të shtëpisë).

**buzana** (...e shikonte shtëpinë e saj nga të gjitha anat, hollësisht, për shembull, si dita ditës gjelbrohej bari mbi ndinollat guri mbi të cilat mbështeteshin pezullat e latueme, varg, si **buzana** kështjelle nën strehët e pullazit...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 103).

Camaj duke u mbështetur në pasurinë e madhe të leksikut të shqipës arriti të ndërtojë kompozitën: buzana.

**vdekje-krizëm** (...*Vdekje-krizëm* / e një gjethi të thatë, / ku të thom te skaj i dheut / pa krizantema në dorë më prit. / Prit, dallëndyshe e shtangun / me fletë mbi valë, frymën time / për t’u çue në ajër / me pendlat e korbit të bardhë...) (“Njeriu më vete eme tjerë”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 176).

Me temën emërore *vdekje* në FGJSSH (2006) kemi vetëm kompozitën mbiemërore *vdekjeprurës*, ndërsa kompozitën *vdekje-krizëm* nuk e kemi të pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim. Ajo është ndërtuar nga autori për t’i dhënë fjalës ngarkesë më të madhe emocionale: krisëm që të sjell vdekjen pas. Një element fonostilistikë që është shfrytëzuar nga shkrimtari është përdorimi i bashtingëllores së zëshme **z**, e cila e bën veprimin më të zhurmshëm.

**ora-gjarpën** (...*E ujë kurr nuk piu \ Sall tambël gjiu grueje n’gjumë. \ Ora-gjarpën s’pui kurr ujë! \ Tregojnë të vjetrit tonë \ Nji tjetër punë për mrekull: \ atje nalt në shkamb të gjalla...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 186).

Në FGJSSH (2006) kemi fjalën orë të përdorur në mitologji si figurë e besimeve popullore shqiptare ku kemi shembujt: *orët e bardha, orët e liga, ora e njeriut, ora e shtëpisë etj.*, por këtë ndërtim nuk e kemi të pasqyruar.

**kambë-qyqje** (...*zog i truem iu duk Mirit / Syka e veshun zi / që prej zjarmit kotej, / kryet e mbështetun në krah, / fytyra e rrudhun tutël, / letër e zhblueme, / kambëhapun ka prushi, / kambë-qyqje në ah...*) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 202).

Camaj në ndërtimin e disa kompozitave shfrytëzon ato lema që tregojnë pjesë të trupit të njeriut. Kështu me anë të temës emërore *këmbë* në FGJSSH (2006) vemë re 33 kompozita emërore, mbiemërore, ndajfoljore e foljore. Autori duke u mbështetur në këto ndërtime ka formuar kompozitat: *kambëhapun* (emër + pjesore) e *kambë-qyqje*, të cilat nuk dalin të përdorura në fjalorët e marrë në shqyrtim.

**babagjyshe** (...*Babagjyshe!- vasha ia ktheu- / Nji re si plaf i zi kaloi nën diell / E hija*

*e saj kaloi dhe në k'sollën tonë tash hyni. / Ishalla shi tash po bjen, bijo! / E tokën e rreshkueme zbut!- / Kam kenë e re, si kallzi i grunit shtalp / Dhe e lum me 'i mij dishire në gji. / Nji rreze m'nxeu në kët tokë si dielli / Nji burrë që m'dhanë për fat. / Un e nipeshja maje gishtash përjashta dolëm / Nësa gjyshja, përmallue në kujtime, / Flitte me vete nën za, e ngrata...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 233)

“Babagjyshe” është një neologjizëm nga “babagjysh”, nëse mund të bashkojmë semantikisht përbërësit “babë + gjyshe” (në vend të “nënë+gjyshe”)

**gurzjarm** (...*prap gur i zi, gurzjarm, andej përtej...*) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 57).

**shteg-dalje** (...*të gjente shteg-dalje prej nënvetdijes...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 239).

Kompozita shteg - dalje ngjan si dysor i rrugëdalje e liridalje, ajo është përdorur më tepër për larmi stilistikore, sesa nga domosdoshmëria shprehëse. Pasi në veprën “Djella” kemi të përdorur: shtegdalje njëlloj si në standard.

**rrugëdalje** (...*shpesh nuk gjesha rrugëdalje në këtë lojë fantazie që përsëritej...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 94).

Kompozitat: *pikëpjekje, veshlepuri, vendlindje, lulediell, kambë - kryq, ngjyrëgruni, ngjyrëgështenjë, gjakderdhje* etj., janë të përdorura gjithandej në ligjërimin e përgjithshëm.<sup>363</sup>

#### 4.1.3. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema ndajfolje+emër

Në ndërtimin e grupit **ndajfolje+emër**, ku “*tema e dytë e kompozitës është një emër me kuptimin e veprimit ose të vepruesit*”.<sup>364</sup> Camaj me këtë mënyrë ndërtoi kompozitat: **mirëtingëllim, mirëbesim, mirënjohësi, mirëkuptim, drejtpeshim, shkurtpamëse, largpamëse, keqkuptim**<sup>365</sup> etj.

**mirëtingëllim** (...*kakofomi e acartë dhe mbytëse e çdo shije mirëtingëllimi...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 286).

363 (...*vrapojnë ernat e vjeshtës \ nën mal në pikëpjekje \ me zotin e ujnave në lum...Legjenda, f. 194); (...u përhi veshlepuri mes hebeve të gurve e u poqën sherbelat përpara kohe...Dranja, f. 47); (...I erdhi - rrufe mbi lis - dëshira me kthye në vendlindje...Dranja, f. 69); (...me një varg vendbanimesh... Shkundulima, f. 102); (...e ajo tha:”Pushoji sytë në mue!” në gjithë mes krahe ngjyrëgruni / binjokë të lindun së voni / prehej edhe ndjesia amnore...Lirika midis dy moteve, f.64) etj.*

364 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f. 150.

365 (...*rrëfimi në mirëbesim i zonjës së pëllasit në krye të katundit mëndeshës së vet nuk mbeti fshehtësi e ndryme nën njëqind çelësa...Shkundullima, f. 124); (...ndiente ndaj saj edhe mirënjohësi që e kishte shty kuvendin aq gjatë...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 246); (...të kërkoni kaq mirëkuptim tek fshatarët...Shkundullima, f. 107); (...lidhjet familjare e humbën fare drejtpeshimin...Pishtarët e Natës, f. 44); (...humbi drejtpeshimin, u rrëxue e ra...Djella, f. 98) etj.*

Në FGJSSH (2006) me ndajfoljen *mirë* kemi ndërtimet: *mirëbesim*, *mirëkuptim*, *mirëtrajtim* etj., ndërsa kompozita *mirëtingëllim* nuk na del e pasqyruar, e ndoshta është krijim i autorit duke marrë si model ndërtimet e mësipërme.

Camaj ka arritur **të përdorë** artistikisht dysorin e kompozitës dritë-shkurtë, por edhe antoniminë e saj, duke i mveshur edhe ngarkesë emocionale.

**shkurt-pamëse** (...*breshka e vogël ende shkurt-pamëse e ndjeu rrezikun...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 8).

**largpamëse** (...*largpamës dukej kur hapte gojën...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 30).

#### 4.1.4. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema folje+emër

Në lidhje me këtë tip fjalëformimi studiuesi A. Kostallari pohon, se: “*Temat foljore nuk hyjnë në shqipen e sotme si komponentë i parë në asnjë nga tipat produktivë të kompozitave. Megjithatë ai pranon mendimin e A. Xhuvanit që formimet me temë foljore si komponentë të parë “janë formime të një zhvillimi të kaluem të gjuhës dhe jo të kësaj kohe”*.<sup>366</sup>

Në krijimtarinë e Camajt kemi ndeshur këto kompozita, si: *bjerraditës*, *mbushmendja*, *mbamendja*, *djegagur*, *rrokaqiellë* etj. tek fjala e përbërë *marrfrymja*, na ka rënë në sy ndërtimi me inversion, pasi në standard kemi përdorimin *frymëmarrja*. Ne mendojmë që është përpjekje e autorit për të dhënë forma të ndryshme të së njëjtës fjalë. Ky ndërtim nuk del i pasqyruar në FGJSSH (1980 e 2006), por e ndeshim te Fjalori i M. Elezit.

**marrfrymja** (...*marrfrymja e qetë, grue e mbështetunnë bar, në valën e parzmit tand m’ avyt...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 141).

Ndërsa ndërtimet: *bjerraditës*, *mbushmendja*, *djegagur*, *rrokaqiell* i ndeshim të pasqyruara në FGJSSH (2006), por sot kanë një përdorim të pakët në ligjërimin e përgjithshëm.

**bjerraditës** (...*tha dikush se e përgojonte ma së shumti para bjerraditësve...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 52); (...*vinin fqij e dashamirë të Loshit, njerëz bjerraditës...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 211); (...*tek më keni edhe mue, andërrimtar bjerraditës* të hutuem shpesh, por rrallë herë fjalmadhe punëvogël...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 75). Kjo fjalë ka

366 A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 87.

kuptimin e një njeriu që sillet tërë ditën pa punë, ai që e bjerr ditën.

Tek shembulli i mëposhtëm kemi përdorimin e kësaj kompozite si emër. (...*ta kish damtue bjerraditesia Përteqafës* ...) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 182).

**mbushmendja** (...*e ngacmonte mbushmendja*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 24). Khs. me FGJSSH *mbushmendja*.

**mbamendja** (...*si me dashtë të shlyente edhe nga mbamendja* çdo përfytyrim...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 84).

Kjo kompozitë është sinonime me fjalën kujtesë. Një formë të tillë ne e gjejmë të përdorur edhe tek H. Aliaj.<sup>367</sup>

**djegagur** (...*të kësaj moshe seme djegagure*...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 120).

**rrokaqiellë** (...*në nadje ra dielli e zbeu faqet e rrokaqiellëve*...) (“Njeriu më vete e me tjerë”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 169). Rrokaqiellë është një leksemë e cila është shfytëzuar edhe nga shkrimtari I. Kadare. Sot ajo përdoret nga shkrimtarët për qëllime të ndryshme artistike, në vend të kësaj kompozite ne përdorim fjalën: ndërtesë shumëkatëshe.

**4.2.** Kompozitat mbiemërore janë më prodhimtare në krijimtarinë e Camajt, ato i ndeshim në ndërtimet e mëposhtme, si:

#### **4.2.1. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + emër.**

Në ndërtimet e grupit **emër+emër**, kur “*ato janë leksema mbiemërore shënojnë një cilësi që ka një qenie ose një send*”.<sup>368</sup> Tek kjo mënyrë fjalëformimi po veçojmë kompozitat: **gojëplakë e flokrupç**, të cilat nuk i ndeshim të pasqyrura në Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e vitit 1954, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH (2006) dhe mund të themi që është përpjekja e autorit për ndërtime fjalësh të reja, ose janë fjalë dialektore.

**gojëplakë** (...*i andshëm për dardha të egra mëndafsh për Dranjen gojëplakë*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 12).

Në FGJSSH (1980 e 2006) kemi mjaft ndërtime me emrin gojë, si: *gojëgjarpër, gojëhelm, gojëkuti, gojënpërkë, gojëqersh* etj. Autori duke shfytëzuar modelet e

367 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Enti botues “Gjergj Fishta”, 2007, f. 884. “...guri i kësaj toke / në mbamendjen e vet i kish shënuar” (H. Aliaj, E ruaj një fjalë për ty).

368 A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 146.

gjuhës letrare, u përpoq të krijonte një kompozitë të re përcaktore.

**flokrupç** (...*ky fill kuvendi s'i pëlqeu asaj; turpnohej dhe grindej në zemër tue u kujtue si ajo i hapte atij burri të huej, shpatullgjanë, kryemëzati të murmë dhe flokrupç, derë e dritare dhe i fliste për sjellje e vese të trashëgueme...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 120).

Te fjala e përbërë: *flokrupç* elementi i dytë i kompozitës nuk del i pasqyruar në FGJSSH të vitit 1980 e 2006, ajo mund të jetë një fjalë dialektore e përdorur me kuptimin: flokërrufç, flokëkaçurrel.

Camaj duke shfrytëzuar fjalët e përbëra popullore, ose duke krijuar vetë përpiqet të tipizojë personazhet e tij.

**sy - udhini, buzë - udhini** (...*vashat sy-udhini e buzë-udhini /përballojnë vapën me hapa të ndezun / fryma e krahëve ka aromën e lule-trumzës së egër e fletnjomë...*) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 114).

Në krijimet popullore ne kemi dëgjuar këngët e dasmave: ...ma ka synin si udhini e buzët si qershia... Camaj shfrytëzoi leksikun popullor për të krijuar kompozitën *buzë - udhini*. Me temën emërore *buzë* kemi mjaft ndërtime, si: buzëhelm, buzëkuti, buzëlepur, etj., ndërsa kjo kompozitë nuk del e pasqyruar, e ka shumë mundësi të jetë krijim i autorit.

**zemër-gur** (...*prej burrit despot e zemër-gur...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 122).

Këtë kompozitë e ndeshim të shkruar me vizë në mes, e cila mund të jetë një veçori e gjuhës së Camajt, ose mund të jetë trajtë dialektore. Në FGJSSH (2006) kemi trajtën: zemërgur.

#### 4.2.2. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + mbiemër.

Në grupin e parë kemi përfshirë ndërtimet **emër+mbiemër**. Një studim të hollësishëm për këtë tip ka bërë gjuhëtari A. Kostallari.<sup>369</sup> Ai shprehet, se: “Në këto kompozita si element përcaktues shërben elementi i dytë, pra tema mbiemërore, ndërsa elementi i parë përbëhet nga një emër çfarëdo që emërton një pjesë përbërëse të sendit të karakterizuar nga kompozita e dhënë.”<sup>370</sup> Ky tip është mjaft prodhimtar për të krijuar mbiemra e më pak emra, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në krijimtarinë e Camajt. Në fillim po veçojmë kompozitat: ***gju-fortë, zanalte,***

369 A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 97.

370 A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 3, Tiranë, 1972, f. 76.

*truerrët, buzëmprehtë, frymë-mirë, (lëpush-gjanë)*, të cilat nuk i kemi ndeshur të pasqyruara me forma të tilla në Fjalorin e vitit 1954, Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH të vitit 1980 e 2006, e ka të ngjarë të jenë krijime të Camajt.

“Mbiemrat që kanë si komponentë të parë emra që shënojnë pjesë të organizmit të njeriut, shprehin veti a cilësi të karakterit të njeriut, të botës së tij shpirtërore e mendore, por ato përdoren edhe me kuptim të figurshëm metaforiko-metonimik.”<sup>371</sup>

**gju-fortë** (...grueja **gju-fortë** e gjeti / bërthamën nën gjuhë tue folë / me të bijën, jehonë...) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 141).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006, hasim mjaft ndërtime mbiemërore me emrin gjuhë, si p.sh.: *gjuhëlashtë, gjuhëmprehtë, gjuhëshkurtër, gjuhështhurur* etj., por kjo kompozitë nuk na del e pasqyruar. Ndërsa M. Elezi<sup>372</sup> këtë fjalë e shpjegon me kuptimin: Që ka gjuhë të fortë. Mendojmë se në këtë kontekst kjo leksemë ka kuptimin e një gjuhë të fortë.

**duer-forta** (...*Lulet kurm - këputuna me qafë sa peni / veshtojnë kuvendin e grave* **duer-forta** / që kthejnë prej së jashtit / e asnji s’e zen ngoje pranverën...) (“Njeriu me vete e me të tjerë”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 190).

Camaj duke u mbështetur tek kompozitat: *duarflori, duarngrirë, duarthatë* etj., ka dhënë ndërtimin: *duer - forta*, që nuk e ndeshim të përdorur në fjalorë.

Kompozitat *frymëmirë e frymëshkurtë* nuk i kemi ndeshur në fjalorët e marrë për krahasim, ndërsa M. Elezi<sup>373</sup> shfrytëzoi këto shembuj për të pasuruar ndërtimet e kompozitave me fjalën frymë.

**frymë-mirë** (...*Nga kjo ditë më ndoq ajo hije përmbas, roje* **frymë-mirë** e dheut të rrëpijtë pranë Lumit të Madh...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 14).

**frymëshkurtë** (...*në ishte mjaft* **frymëshkurtë**, sa e shkurtë rruga...Djella, f. 73); (...*ti që* **frymshkurtë** / pse guri në mal s’e ndjeu, / peshën e vargjeve tua...) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 51). (Këtu autori e ka përdorur si emër.)

**truerrët** (...*para se të nisesh nga dheu \ i andrrës së vokët \ e andej udhtimi hijeve për ty /* **truerrët**, me një dritëz të ndezun \ mbi vorrin e kalesës...) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 67).

Duke u mbështetur në ndërtimet e kompozitave: *trushkukur, truçartur, trumykur* etj.,

371 A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 116.

372 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 545.

373 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 540.



autori na ka dhënë ndërtimin: *truerrët*. Fjalë që sot ka kuptim leksikor të zbehur, pasi në standard përdoret leksema mendjeerrët.

Fjalët e përbëra: *zanalt e zamarrun* kanë temën emërore za: të përbashkët, ato nuk dalin të përdorura në Fjalorin e vitit 1954, Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH (2006) e mund të jenë krijime të autorit.

**krahthatë** (...bariu *krah-thatë* te ura e zjarmit lodhet / nërmend / për dhitë damtare përjashta...) (“Njeriu me vete e me tjerë”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 182); (...ai rresht i vjetër *krah-thatë*, / më rrin përpara me shkrola t’thyeme. / i prekun aty këtu shpesh me penë të kuqe / kullon gjak ...) (“Vargje të shpërndame”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 152); (...Fluturonte si zog rrëmbyes brijave, e zezë, pela e pambathun, me atë *krahthatë* Vitoit, kaluar, të cilin atypëratyshëm e rrejte mendja se po mbërrin në kohë me qitë kushtrimin...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 149). Mbështetja e autorit në leksikon popullor shfaqet natyrshëm në krijimtarinë e tij, leksemën emërore: *krahthati*, e ndeshim të përdorur edhe në Epikën Legjendare.<sup>374</sup>

**kryeshpatuk** (...u prini e ama, e zezë *kryeshpatuke*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 23 ).

Ky ndërtim nuk del i pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim, e mund të jetë krijim i shkrimtarit, pasi siç shprehet M. Elezi *ky ndërtim haste kryesisht në krijimtarinë e Camajt*. Një studim të hollësishëm i ka bërë gjuhëtari A. Kostallari kësaj kompozite dëshirore.<sup>375</sup>

**kryenaltë** (...inxhenieri *kryenaltë* e ndëgjonte...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 105); (...ishin njerëz të lirë e *kryenaltë* ...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 88).

**krye-ulët** (...*krye-ulët* nisi të tërhiqet rrëshqanë ...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 218).

Në një kontekst tjetër përdor kompozitën emër + pjesore: (...*shiko*, - *tha ajo*, *kryeulun* kah muret - këtë mrekulli...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 146).

Mbiemrat e përbërë: *veshmprehtë*, *vesh-hollë* e *veshë-imët*, temën emërore e kanë të përbashkët. Ndërtimet e dhëna janë sinonime, por secila prej tyre ka ngarkesën e vet emocionale e ngjyrim stilistikor në kontekstin e dhënë.

374 Po aty, f. 738. “Unë krahtyemi në këtë qiell / Ai krahtati n’shpinë e vet!” (EL. Rriti nana dy jetima).

375 A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 160.

**veshmprehta** (...u tregonte burrave mikpritës e grave **veshmprehta**...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 14).

**vesh-hollë** (...për humanistin **vesh-hollë** e folmja provinciale veneciane..) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 295).

**veshë-imët** (...ndëgjuesit **veshë-imët** mbyllën sytë ...) (“Njeriu me vete e me tjerë”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 171).

**zanalte** (...shpallja **zanalte** “dëshiroj të baj diçka për katundin tonë!” i egërsoi njerëzit...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 102).

**kambëshpejtë** (...turravrap u vu në të ikun përmes fushës as me qenë iriq **kambëshpejtë**...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 28). Në gjuhën letrare: këmbëshpejtë.

Në disa nga kompozitat e mëposhtme vëmë re disa veçori të gjuhës së Camajt, ku ai parapëlqen tek disa fjalë të përbëra drejtshkrimin e tyre me vizë në mes, si p.sh.

**shtat-naltë** (...drejtues, **shtat-naltë** nga viset nordike...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 25). Khs. me FGJSSH (2006): shtatlartë.

**shtat-hollë** (...e djali n’vrrri kundron me mall në shpirt: / Atje asht vajza **shtat-hollë**, e zeshkë . / Atja asht fryma e ngrohtë në tban - n’fierët...) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 10).

**bel-hollë** (...Ulet mjellma nëpër Dri e ndalet / Pendlat me terë te këmisha e nuses... / Pranvera shkoi e Drini u zbut si kingj / Drini asht vashë **bel-hollë** n’kalim plot naze...) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 155).

Bukurinë e lumit Drin autori përpiqet ta japë me anë të magjisë simbolike të poetikës së tij. Shkrimtari duke marrë për bazë ndërtimin *belhollë*, na ka dhënë kompozitën *shtat - hollë*, duke përdorur kështu larmi sinonimike.

**brijë-lëmuet** (...e s’deshti t’i mbulojë nën dushkun e butë ndër therra, jo nga frika mos me i lindë të mitunit kopila, por që të mos ia thyejë shlliga **brijë-lëmuet** dhe e qelbët...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 66).

Autori duke shfrytëzuar fjalën *brinjë* që tregon një pjesë të organizmit të njeriut, ka ndërtuar fjalën: *brijë-lëmuet*. Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 kemi të pasqyruara ndërtimet: *brinjëdalë- shumë i dobët nga shëndeti, kurse në gjeometri brinjëndryshëm, brinjënjëshëm*.

Camaj duke shfrytëzuar temën emërore të përbashkët sy që tregon pjesë trupi të njeriut ka arritur të përdorë kompozitat: *sy-zbrazët, sy-kuqe e sy-trim*, këtu duam të veçojmë leksemën: *sy-zbrazët* e cila nuk del e pasqyruar në fjalorët e marrë në krahasim.

**sy-zbrazët** (...dhe kur kalojnë ato përmes dheut të shthurun, pa prita e me erë të ngrime ndër degë, **sy-zbrazët** e pa mallin që kishte Dranja vetë për largësina të fshehta, ua lëshon gjithkush rrugën...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 62).

**sy-kuqe** (...bretkosa **sy-kuqe**...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 58). Në FGJSSH (2006) është e shkruar bashkë *sykuqe*.

**sy-trim** (...Plaku **sy-trim** ibrikun në dorë shtrëngue: / - Pini! - thoshte - vneshta kjoftë beku!...) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 39).

Fjalët e përbëra: *plakshkreta* e *djalë-shkretë* dalin më tepër si togfjalësha të lirë: plaka e shkretë dhe djali i shkretë. Këto ndërtime dalin sigurisht si mjete stilistikore të parapëlqyera edhe para M. Camajt, kompozita e parë ishte përdorur edhe nga poetë të tjerë veriore, sidomos nga N. Mjeda: *nanshkreta* (Afër vorrit tand *nanshkreta*, porsi bleta...I tretuni.). Njohësit më të besueshëm të veprës së Camajt kanë pohuar vazhdimisht se “*Martin Camaj dhe Ndre Mjeda janë të vetmit intelektualë shqiptarë, poetë e gjuhëtarë*” njëherësh.<sup>376</sup>

**plakshkreta** (...të ndëgjojë ankimet e **plakshkretës**...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 238).

**djalë - shkretë** (...si ai të lyp ndihmë ose me dhanë me kuptue se, ndonëse burrë në sytë e saj i fuqishëm e i pamposhtun, na qenka **djalë-shkretë**, shpirtnisht ndërdyzash mes ligështisë së fshehun dhe trimnisë krenare të rrejshme...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 121).

**dritë-shkurtë** (...nuk e lirojnë breshkën prej zanit të keq si parasite, e për ma tepër **dritë-shkurtë**...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 13).

Leksiku i autorëve të vjetër është shfrytëzuar nga autori, për të vërtetuar traditat e çmuara të shqipes. Kjo lemë gjendet e pasqyruar që tek Fjalori i vitit 1954.

**flakëligisht** (...që nuk je kandil **flakëligishtë** që e shuen një erë e lehtë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 107).

Në Fjalorin e vitit 1954, Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH (2006) kjo kompozitë nuk del e pasqyruar e mund të jetë krijim i autorit. Këtu ajo është përdorur me kuptim figurativ të një flake të zbehtë të dobët.

**vullnet - flakët** (...Mandej vijoi:- Burra të gjitha moshash...mbarë dashamirë të dijes e të mundimit gjurmues ndër karta të harrueme, ardhë të gjithë, të ditun dhe kandidatë për shkencë, rishtarë **vullnet -flakët**, prej katër caqeve themelore, miq të Republikës dhe...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 286).

Kjo kompozitë është ndërtuar nga lema vullnet dhe i flakët që shërben më tepër për

---

376 Gj. Gjonlekaj, *Disa kujtime për Martin Camajn*, botuar në “Tirana observer”, 17 korrik 2010.

të dhënë shkallën sipërore të emrit, studiues që kanë vullnet të zjarrtë për shkencën, pra janë shumë të vullnetshëm. Në FGJSSH të vitit 2006 kemi të pasqyruara këto kompozita: *vullnetdobët*, *vullnetfortë*, *vullnetmirë*, ky ndërtim ka shumë mundësi të jetë ndërtim i autorit.

**lëpushë-gjanë** (...*deri aty ku mbërrin fryma e paturbullueme e detit që këndell bimësinë mesdhetare, fikun, shegën e butë e pjepnin lëpushë-gjanë, janë troje breshke...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 12).

Kompozita *lëpushë-gjanë* shërben për të dhënë cilësinë e sendit. Në fjalorët e marrë për krahasim kjo fjalë e përbërë nuk del e pasqyruar, aty kemi të dhënë vetëm emrin *lëpushë*, ndërsa M. Elezi në Fjalorin e tij,<sup>377</sup> shprehet se kjo leksemë del e përdorur kryesisht në krijimtarinë e M. Camajt.

Në këtë tip kemi *mbiemra që cilësojnë njeriun nga pikëpamja e gjendjes dhe e zhvillimit të jetës së tij*,<sup>378</sup> si: *smirëzezë*, *fatkeq*, *fatzi*, *rrezikzezi etj.*

**smirëzezë** (...*Jera që para t’et s’guxonte me folë kundër s’amës dhe për këtë nuk e shtini atë në rresht me të motrat smirëzeza...*) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 170).

Kjo është një leksemë që është gjithandej e njohur dhe nuk besojmë se është krijesë e M. Camajt, por thjesht një rimarrje nga paravajtesit si dhe nga e folmja popullore, përderisa *smirëzezë* e *cmirëzi* ka qenë e janë edhe në dialekte.

Kompozitat *fatkeq*, *fatzezi*, *rrezikzi* janë përdorur nga autori për larmi formash e për të shprehur ngarkesa të ndryshme emocionale në kontekstet e dhëna.

**fatkeq** (...*ankohej se ai, i vetmi, paska lindë fatkeq, i ngujuem ndër male...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 30).

**fatzezësh** (...*çfarë fatzezësh paskemi qenë...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 265).

**rrezikzeza** (...*“Rrezikzeza unë! Rrezikzeza unë!” e preu kuvendin Djella dhe i plasi vaji për të parën herë mbas asaj zezone te Këneta...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 130); (...*sa rrezikzezëve iau ka marrë shpirtin me atë thikë...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 27). (Këtu është përdorë si emër.).

**kuptimplote** (...*shejet në psalm do t’ishin / sy kuptimplote sikur ju...*) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 144); (...*trillimet e fantazisë janë fort kuptimplote...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 132).

377 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 821.

378 A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 115.

**gjiplote** (...*Tash Dranja ia ndien amzën atij langu kur sheh çdo shtazë qumështore, pa qenë ajo pille ose gjiplote...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 72).

Gjatë vjeljes së materialit na kanë dalë mjaft kompozita që përdoren sot në ligjërimin e përditshëm, gjë që vërteton mbështetjen dhe shfrytëzimin e pasurisë leksikore të shqipes.<sup>379</sup>

**4.2.3. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+emër prejfoljor vepruesi mrekullibamëse** (...*diçka si hajmali mrekullibamëse që shpërthente edhe detin...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 42); (...*u qesin këtyre bimëve mrekullibamëse nga një pikë tamël gjiu...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 28).

Nga tema emërore *mrekulli* në FGJSSH (2006) kemi të pasqyruara vetëm fjalët e prejardhura: *mrekulloj* (folje), *i mrekulluar* (mbiemër), *mrekullisht e mrekullueshëm* (ndajfolje), ndërsa si kompozitë: *mrekullplotë* e *ndeshim* të përdorur nga A. Pipa.<sup>380</sup> Fjala e përbërë *mrekullibamëse* është ndërtuar nga *mrekulli* + *bâmës*, pra që bën *mrekulli*. Neologjizëm i krijuar prej vetë autorit.<sup>381</sup>

**mësimdhanës** (...*në pesë ose gjashtë shembuj me një përfundim mësimdhanës...*) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 88). Khs. me FGJSSH (2006): *mësimdhënësi*.

**mishngranës** (...*kryesisht barinj e mishngranës...*) (“Rrungoja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 168); (...*zgohej nga uja e egërsinës mishngranëse...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 82); (...*para tyre rrishin galuc roje / shpend mishngranës / me fytyrë njerëzore ...*) (“Vargje të shpërndame”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 161). Këtu e kemi të përdorur si mbiemër. Në FGJSSH (2006): *mishngrënës*.

**jetprues** (...*në mbarim i prune kërcimtares \ një tubë lule \ me krena gjarprijsh jetpruesa \ ndër fletë / e iku andrrimi i shkurtë...*) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 52).

379 (...*kushërij të parë, të gjatë, të thamë e lëkurë-remët...*Pishtarët e natës, f. 58); (...*Kola, fjalëmbarë e i kuptueshëm, don me thanë, prora gati për t'u bindë e pranue çdo pikëpamje...*Pishtarët e natës, f. 29); (...*si burrat e tjerë fjalëmëdhënj e buzagaz, si të kishin sosë kushedi çfarë pune me randësi...*Pishtarët e natës, f. 61); (...*përse të tregohemi shpirtvegjël në cikërrime...*Shkundullima, f. 129); (...*Tash Dranja ia ndien amzën atij langu kur sheh çdo shtazë qumështore, pa qenë ajo pille ose gjiplote...*Dranja, f.72); (...*Mitri, si dijekeq që ishte, shtoi...*Pishtarët e natës, f. 45); (...*Çka kujton kjo? Se e ka lehtë me luejtë si qeni me sukull me mue? Ani kush! Një floggjatë e mend pakë?...*Gjon Gazulli, f. 277) etj.

380 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 941. “E një prrallë / mrekullplotë për atë tregojnë” (A. Pipa, Rusha).

381 D. Luka, *Studime gjuhësore*, XIII, Shkodër, 2011, f. 196.

Po të shikojmë me vëmendje FGJSSH (2006) mund të themi që kompozita *jetpruesa* mund të jetë sinonim me fjalën e përbërë *jetëdhënës* që përdoret në standard.

**frytdhanës** (...*gjethi ndër degë / i pëshpëriti dheut në muzg / shushuritje frytëdhanse / e fryma e fjalës sate / në veshë t'atij që din me vargnue / bleron te toka e kambve tua...*) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 143).

#### 4.2.4. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+pjesore

Tek ndërtimi i fjalëve të përbëra **emër + pjesore**, kemi që “*pjesa e parë që merr veprimin, është një emër dhe pjesa e dytë, pjesa caktuese është që vepron është një pjesore e foljes*”.<sup>382</sup> Kështu kompozitat: **lukth-shtjerrë, këmish-shkyem, kryethijun, kryeshpuem, zamarrun, ballëshpërvjelun, kurrizlakuem** nuk i kemi ndeshur të pasqyruara me forma të tilla në Fjalorin e vitit 1954, Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH të vitit 1980 e 2006 dhe ka të ngjarë të jenë krijime të Camajt, ose shfrytëzim i leksikut popullorë a dialektorë.

**kurrizlakuem** (...*po Shini, kryeulë, kurrizlakuem si shumica e njerëzve të gjatë në plegni...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, 118).

Në FGJSSH (2006) kemi të pasqyruar kompozitën: *kurrizdalë* si mbiemër, ndërsa Camaj duke pasë parasysh një ndërtim të tillë arrin të krijojë fjalën e përbërë: *kurrizlakuem*. Kjo kompozitë shprehet M.Elezi,<sup>383</sup> ndeshet e përdorur kryesisht në krijimtarinë e Camajt.

**lukth-shtjerrë** (...*kaluan tri ditë qysh kur rrashta e breshkës lukth-shtjerrë, qëndron në shkretësinë druni përmbi librat e mi...*)(“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 86).

“Këtë kompozitë, - siç shprehet studiuesi D. Luka, - autori e ka ndërtuar në mënyrë të përkryer si kompozitë ekzocentrike me vlerë pronësore (që krahasohet me bahuvrihit indoevropiane) brenda strukturës së gjuhës shqipe, duke dhënë një fjalë të re që nuk e ka jo vetëm Fjalori 1980, po as vetë leksiku i gjuhës shqipe të sotme”.<sup>384</sup>

Camaj arrin të ndërtojë kompozita duke shfrytëzuar lemat e shqipes, tek ndërtimet: *buzëmprehtë, buzëshpërvjelun, ballëshpërvjelun, krahthatë, kurrizlakuem* elementi i parë i fjalës së përbërë tregon pjesë të trupit të njeriut, por vihet re ndërtimi i disa

382 A. Xhuvani, *Kompozitat*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 69.

383 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 783.

384 D. Luka, *Ndihmesa e Fishtës, Koliqit dhe Camajt për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe*, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2004, f. 281

prej tyre duke pasë edhe një lemë të përbashkët.

**buzëshpërvjelun** (...*Mbi sukë qëndronte në kambë një pelë. Hingëllonte buzëshpërvjelun e kërcente rrëmbyeshëm përpjetë a thue dashkej me u kapë në qiell...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 149).

**ballëshpërvjelun** (...*kjo ishte një tip vajze e hollë, buzëmprehtë, ballëshpërvjelun e tepër të gjanë për fytyrën që kishte...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 115).

Përdorimi i mbiemrave të njëpasnjëshëm, janë karakteristikë e gjuhës së Camajt, për të bërë portretizimin e personazheve. Ndërtimet e mësipërme nuk janë të përdorura në fjalorë, e ka të ngjarë të jenë ndërtime të autorit.

Fjalët e prejardhura: *krye - thijun, kryekëcyem, kryeshpuem* kanë elementin e parë të përbashkët: *krye*, **që tregon** një pjesë të trupit të njeriut.

**krye-thijun** (...*mos me u grindë me moshatarë krye-thijun...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 21).

Tek Fjalori i vitit 1954 kemi ndërtimet: *kryeartëz, kryekuq, kryezezë* etj., ndërsa në Fjalorin e M. Elezit, kemi trajtën *kryethimë: sjapi kryethim*. Kjo kompozitë nuk është e pasqyruar në këto fjalorë e mund të jetë krijim i autorit.

**kryeshpuem** (...*kryeshpuem, do ta shaj edhe gjyqtarin e hetimit. Do ta pyes: a ma ke dhanë ti këtë mantel?...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 24).

Ky ndërtim nuk del i pasqyruar në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi”, te Fjalori i vitit 1954 te Fjalori i Gazullit e FGJSSH (2006). Kjo kompozitë mund të jetë sinonim me ndërtimin: *kryebosh*.

**kryekëcyem** (...*Nika kryekëcyem bante mirë të veçohej për të mos pasë raste të ngatërrohej me botë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 29).

Këtë kompozitë autori e ka përdorur në kuptimin: një njeri që rrëmbehet shpejt; që punon në kokë të vet pa pyetur të tjerët. Kjo fjalë është përdorur jo vetëm nga Martin Camaj, por edhe nga Gj. Fishta te Kanuni i Lekë Dukagjinit.<sup>385</sup>

**kryeshtypun** (...*sigurisht të ka qëllue e ke ndeshë ndonjë, kryeshtypun të racës së Gazullit, ardhë në ato tregje nga viset andej detit...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 272).

Kjo kompozitë mund të jetë sinonim me fjalën kryeulur.

**syçelë** (...*dhe andrroi syçelë ngrofsin(diellin) që vjen nesër...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 20).

385 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 752. “E ka pa, një shkja krye-kcyem...” (Gj. Fishta, Lahuta e Malsisë); “Kryekcyemin me e da shpiet me pjesë qi i përket...” (Kanuni i L. D.).

Po ta krahasojmë këtë fjalë me atë të fjalorit ku kemi ndërtimet: *syhapët* si ndajfolje - rrinte syhapur, e si mbiemër figurativ që rri gjithnjë në përgjim; vigjilent, mund të themi që Camaj përpiqej të jepte dysorët dialektorë për të treguar larminë e dialektit të gegërishtes. Antonimi i kësaj fjale është *symbyllë* i përdorur në shembullin e mëposhtëm:

**symbyllë** (...çoi kokën e **symbyllë** bani kinse po ndien diçka...) ("Dranja", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 69); (...**symbyllë** ecte për së mbrapshti / koha në Pegaz...) ("Nema", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 123).

**qiellzana** (...shkallat me mure e **qiellzana**, gjithmbarë dukeshin si të reja...) ("Shkundullima", në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 113); (...në **qiellzanë** krejt nalt / ka mbetë trajta e klithmës...) ("Nema", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 120).

Camaj krijimtarinë e tij letrare e shkroi në gegërisht, prandaj edhe tek ndërtimi i kompozitave vihet re larmia e trajtave dialektore, si: *kambëzdathë, shtat-hjedhët, gojë-hapë, gojëleshueme, besëlidhun, këmish-shkyem, zamarrun, za-shtjerrun etj.*

**kambzdathë** (...I britte një plak tue nga mbas tij **kambzdathë** / - Skënderbeu foli haptas / "I kam njoftë të dy" ...) ("Legjenda", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 168). Në gjuhën letrare kemi trajtën: *këmbëzbathur*.

**shtat-hjedhun** (...arbreshja **shtat-hjedhun** / arbreshja parzëm-mjaltë / valë e zanit të pjekun...) ("Lirika midis dy moteve", në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 80). Në FGJSSH (2006) kemi trajtën: *shtathedhur*.

Camaj duke shfrytëzuar pjesoren *këputun* arrin që të ndërtojë leksemat: *kurm-këputun, shtatkëputun, qafëkëputun*.

**kurm-këputuna** (...lulet **kurm-këputuna** me qafë sa peni veshtojnë kuvendin e grave duer-forta...) ("Njeriu me vete e me tjerë", në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 190)

**shtatkëputun** (...ishte **shtatkëputun** e hollake...) ("Dranja", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f.125)

**qafëkëputun** (...me krye e bark jashtëzakonisht të madh, **qafëkëputun** e kambët i kishte të holla ...) ("Djella", në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 98).

**gojë-hapë** (...shtegtoi tri javë shkretisë nëpër pluhën e shkorre të djeguna, **gojë-hapë**, gjithnjë e unët...) ("Dranja", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 56); (...dielli i mbet i ngrimë / në sy. / **Gojë-hapë** iu derdhën / vija vija ngjyra ylberi në parzëm...) ("Nema", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 124). Në ligjërimin e përgjithshëm: *gojëhapur*.

**gojëleshueme** (...qenkje e njohur si grindavece e **gojëleshueme**...) ("Dranja", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 232); (...ata që vijnë për drekë, janë **gojëleshueme**...) ("Loja e



mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 36). Në FGJSSH (2006): *gojëleshuar*. **besëlidhun** (...*tashit e mbrapa, na të dy jemi besëlidhun...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 36). Në FGJSSH (2006) kemi trajtën *besëlidhur*.

**këmish-shkyem** (...*të bijtë, Gjergji e Marku, e këqyrnin të jatin këmish-shkyem, jo i veshun me tesha të mira si burrat e tjerë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 61).

Kompozita *këmish-shkyem* është e variantit dialektor, pasi në standard kemi leksemën: *këmishëgrisur*.

Gjuha e veprave të Camaj është e pasur edhe me kompozita sinonimike.

**zamarrun** (...*Mbasi mori atë çka lypte, nuk kthen mâ këtu: Zot ruej-na këtij mileti! mandej tingllimi zamarrun i plakës...*) (“Kandili argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 154).

Kjo është një leksemë dialektore, pasi në standard kemi kompozitën: *zëçjerrë* ose *zëngjirur*.

**za-shtjerrun** (...*jo si grethi za-shtjerrun...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 16).

Në FGJSSH (2006) është përdorimi i standardit: *zështjerrur* i shkruar bashkë.

**bark-rjepun** (...*dyshimi i tmerrshëm më kap: / atje në maje sillen rrethas / pllumba apo korba bark-rjepun...*) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 81) etj.<sup>386</sup>

#### 4.2.5. Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër+ndajfolje

Kompozita të ndërtuara nga tema **emërore + ndajfoljore**. “Tema emërore është gjithmonë një pjesë e sendit të karakterizuar nga mbiemri i dhënë, kurse elementi i dytë, ndajfolja, është edhe këtu elememti përcaktuesi i saj.”<sup>387</sup> Kjo mënyrë fjalëformimi është pak prodhimtare jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në krijimtarinë e Camajt. Tek ndërtimet: *fshehësiplotë, vështrimplotë e kuptimplotë* kemi leksemën e përbashkët ndajfoljore: *plotë*, ku duam të veçojmë kompozitën: *fshehësiplotë* e cila nuk është e pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim dhe mundet të jetë krijim i autorit.

386 (...*aty e nalt, gjithkah merr syni deri në bjeshkë e maje janë prona të hueja, dhe i ujkut me fulqij si dana dhe zgur-përgjakun...*Dranja, f. 12); (...*takim bixarr, pa fjalë, pa shpresë të një buzqeshje ose puthje, gojëmbyllë. S'jam më i zoti për tjetër, vetëm me njëhë marrëfrymjen e saj...* Djella, f. 92); (...*çoi dorën e përshëndeti tue buzëqeshë...Katundi me gjuhë të fshehtë, f. 237*); (...*shpresoj se kur të bijë bleta / në lule / kam me i buzëqeshë gjithkaf...*Lirika midis dy moteve, f. 109) etj.

387 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.200.

**fshehësiplotë** (...të marrin me mend se genësit **fshehësiplotë** ndër Gurra mund të ishin vetëm Zana e Orë ...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 33).

Camaj ka arritë të shfrytëzojë lemat *fshehësi* dhe *plotë* që janë të pasqyruara në FGJSSH (2006), për ndërtimin e trajtës mbiemërore *fshehësiplotë*.

**vështrimplotë** (...ky moment i lutjes asht për mue **vështrimplotë**...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 256).

Ndërtimin *vështrimplotë* e gjejmë të përdorur edhe tek Gj. Duka.<sup>388</sup>

**kryepezull** (...kur tallazi të bijë në pushim / e njimij bimë ujce **kryepezull** / të përshëndesin ngjyrat e agut / due me kthye në jetë buzë ujit / që e njoh si veten...) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 66). Tek Camaj me fjalën *pezull* kemi ndeshur edhe kompozitën: **zemërpezull**, e cila nuk na ka dalë e pasqyruar në Fjalorin e “Gazullit”, në Fjalorin e vitit 1954, Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e FGJSSH (2006), edhe ky ndërtim mund të jetë krijim i autorit. (...*Kaq mirësi, vërte, nuk e kam pritë! Unë jam zemërpezull, i përkujdesshëm për mirëqenien tuej!*...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 277).

**dorëjashtë** (...ndoshta vetëm një i huej, fare **dorëjashtë**, tue kundrue nga një naltësi këtë zgjim...) (“Shkundulima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 112); (...*unë do të rri dorëjashtë në çdo gja*...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 92). Në këtë shembull kjo leksemë është përdorur si ndajfolje.

#### 4.2.6. Formimi i fjalëve të përbëra nga numëror a përemër i pacaktuar+mbiemër

Kompozita të formuara nga një **numëror a përemër i pacaktuar** që tregon sasi dhe një **mbiemër**. “*Ku numërori ose përemrat e pacaktuar janë si element përcaktues, dhe një mbiemër çfarëdo si i përcaktuar.*”<sup>389</sup> Tek ky tip kompozitash të përdorura nga Camaj vëmë re se më së shumti mbiemrat janë të formuar me prapashtesën -sh.

**dhjetëvjeçare** (...ngjarjet e kohës **dhjetëvjeçare**...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 94); (...*një dhjetëvjeçar* që so ashtë gjashtëdhjetë vjeç...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 50).

**pesëkandësh** (...përmbas **pesëkandëshit** të larmë me shkrola të qarta...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 76).

**katërfish** (...**katërfish** e ndritun/krejt flake...) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 130).

**dykuptimesh**(...*fjalët dykuptimeshe*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.

388 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1574. “...merrshin kuptim ma të premë fjalët *vështrimplote të Filip Shirokës*...” (Gj. Duka, Parathanie...).

389 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f. 200.

112); (...*me shkathtësi fjalësh dykuptimesh*...) (“Katundi me gjuhë të fshehetë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 247).

**dyfaqesh** (...*e njoh unë këtë si njeri dyfaqesh*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 140).

**tridegësh** (...*me një furkëz tridegëshe*...) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 165).

**shumëkatësh** (...*kishin ndërtue një hotel shumëkatësh*...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 250).

\*Një mënyrë të veçantë ndërtimi kemi ndeshur tek kompozita: *i parilemë*: mbiemër marrëdhënior i emëruar + pjesore:

**i parilemë** (...*Kola, i vëllai i parilemë s’e qit në krye me Nikën*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 10).

#### 4.2.7. Formimi i fjalëve të përbëra nga pjesore+ndajfolje

Ruajtja e varintit gegë duket edhe në ndërtimin e kompozitave nga një **temë pjesoreje+temë ndajfoljore**.

Leksema emërore *bakeqe* është formë e shqipes popullore, besojmë e gegërishtes veriperëndimore, e cila paraqitet si sinonim i keqbërës të standardit, duke përmbysur rendin, e me shkurtësinë e nevojshme e të pëlqyeshme në pikëpamje të stilit letrar, e që tek “Dranja” na del pikërisht me këtë formë (por në variantin dialektor): **bakeqe** (...*si vetje e tillë bakeqe* për të mbetë gjallë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 112); (...*ne s’jemi bakëqij, as ndërshkues*...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 74).


**keqbamëse** (...*nisi me bulue bima e ndërgjegjes së breme, mrekullia keqbamëse*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 105).

Të dy kompozitat e mëposhtme gjenden të pasqyruara në FGJSSH (2006), por sot kanë një përdorim të rrallë.

**ndjellakeqe** (...*shihte në to sheje ndjellakeqe e ogurzeze*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 26); (...*u pëlqyen sepse nuk ishin ndjellakeqe*...) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 209); (...*marrja udhë me një plak të panjoftun qenkej diçka ndjellakeqe*...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 117).

**shtirakeq** (...*na dhambin sytë kur e shohim atë shtirakeq*...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 7).

## Paraqitja skematike e kompozitave



\* \* \*

Një prirje që vihet re në gjuhën shqipe, por edhe në mjaft gjuhë indoevropiane është formimi i fjalëve të përbëra, dukuri që është pasqyruar larmishëm edhe tek veprat e Camaj, duke përdorur strukturat, si: *emër+emër*, *emër+emër prej foljor vepruesi*, *emër + mbiemër*, *ndajfolje + folje* etj. Përcaktimi i autorësisë na del mjaft i vështirë edhe tek kjo mënyrë fjalëformimi, pasi ka të ngjarë që leksemat e paraqitura më poshtë mund të jenë krijime të autorit, ose fjalë dialektore, ose leksema të rralla të shqipes. Ja disa prej tyre: *gju-fortë, zanalte, truerrët, buzëmprehtë, frymë-mirë, lëpush-gjanë, gojëplakë, vdekzotit, buzana, flokrupç, vdekje-krizëm, ora-gjarpën, lukth-shtjerrë, këmish-shkyem, zamarrun, ballëshpërvjelun, kurrizlakuem, mrekullibamës, bestytës, ujëpërçues, jetprues, mirëtingëllim.*

Me të drejtë janë vlerësimet që i bëhen Camajt “*si gjuhëtar dhe sidomos si shkrimtar, pasi ai është një emër tepër i veçantë, ndërsa tekstet e tij letrare, të para veç e veç, po edhe si tërësi, janë një gurrë e rrallë, nga e cila mund të vilet një thesar sui generis gjuhësor, një thesar i mbrujtur me fjalë e shprehje frazoologjike që tashmë pothuajse kanë kaluar në pjesën pasive të leksikut të shqipes së sotme, por që te ky autor gjithnjë janë dhënë me një origjinalitet të theksuar dhe me një natyrshmëri të papërsëritshme*”.<sup>390</sup>

---

390 XH. Beqiri, *Stili dhe gjuha e Martin Camajt*, AIKD, Prishtinë, 2007, f. 16.

## KREU V

### 5. FORMIMI I FJALËVE TË PËRNGJITURA

#### 5.1. Veçori të përgjithshme të fjalëve të përngjitura

Një mënyrë tjetër fjalëformimi është edhe përngjitja. Mendimet për këtë mënyrë fjalëformimi janë të ndryshme. Edhe terminologjia nuk është e njëjtë. Kështu S. Frashëri flet vetëm për mbiemra të ngjitur si *syzi, syzezë, fatkeqe* dhe për përemrat *gjësendi, gjëkafshë* që janë formuar nga pjekja e pjesëve përbërese.<sup>391</sup>

I. D. Sheperi pohon, se “*bashkimi i një parashtesimi ose i një fjale me një fjalë tjetër përbën një fjalë të re, të cilat i quajmë të përngjitura*”. Fjalë të tilla janë si: *atdhe, kryeqytet, ujdhesë, ...kushdo, cilido, etj.*<sup>392</sup> O. Myderrizi shprehet, se “*fjalët e përngjitura mund të jenë emra: kryeqytet, paramendim, imzot...; mbiemra: fatkeqe, i pafat; folje: me zvogëlue, me përmend, me mkambë; ndajfolje: pardje, menjëherë, kurdo; paraafjalë: përmbi, përveç, përmes etj.; lidhëza: ose, apo, posa, përse ...etj.*”<sup>393</sup>

Ka gjuhëtarë që i përdorin të dy termat, “*fjalë e përbërë*” dhe “*fjalë e përngjitur*”, për të emërtuar të njëjtën mënyrë fjalëformimi. Kështu K. Cipo pohon, se fjala “*quhet e përbërë a e përngjitur kur del nga bashkimi i dy a më tepër fjalëve.*”<sup>394</sup> Ndërsa A. Kostallari jep këtë përkufizim për fjalën e përngjitur: “*Fjalë e pranëvënë apo e bashkëvënë ose fjalë e bashkëngjitur (juxtaposition) në shqipen është ajo fjalë me dy ose më shumë gjymtyrë që formohet nga afrimi i dy ose më shumë fjalëve në procesin e përdorimit të tyre të gjatë dhe nga ngjitja e tyre në një fjalë të vetme...*”<sup>395</sup>

Në ditët e sotme përngjitja nuk vlerësohet më si një nëngrup i fjalëve të përbëra, por si një mënyrë e veçantë në sistemin e mënyrave të fjalëformimit të gjuhës shqipe.<sup>396</sup>

Ndërsa studiuesja L. Buxheli pohon, se: “*Përngjitja është një mënyrë fjalëformimi jo morfologjike. Ajo është një mënyrë leksiko-sintaksore fjalëformimi, sepse me anë të saj krijohen fjalë të reja pa mjete të caktuara morfologjike.*”<sup>397</sup>

391 S. Frashëri, *Shkronjëtorë e gjuhës shqipe*, Bukuresht, 1866, f. 38.

392 I. D. Sheperi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sindaksa, Vlorë, 1927.

393 O. Myderrizi, *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë, 1944.

394 K. Cipo, *Rreth disa kompozitive*, në “*Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve*”, I, Tiranë, 1972, f. 62.

395 A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “*Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*”, I, Tiranë, 1972, f. 84-85.

396 *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1976, f. 49-50.

397 L. Buxheli, *Rreth fjalëve të përngjitura në gjuhën e sotme shqipe*, në “*Studime filologjike*”, 4, 1986, f. 59.

Studiuesit kanë vënë re se në shqipen e sotme mbizotëron prirja e qartë për t'i plotësuar nevojat e reja leksikore në të gjitha fushat me mjetet e sistemet e veta fjalëformuese. Në këtë rast mund të shohim edhe një dukuri interesante të shqipes së sotme që është sintetizimi. Një dukuri të tillë e vëmë re edhe në krijimtarinë e Camajt, ku autori në disa formime parapëlqen ndërtimet e fjalëve të përngjitura bashkë, të cilat më vonë tek autorët e tjerë do të na paraqiten edhe si togfjalësha të lirë, ende të papërngjitur.

Fjalët e përngjitura në krijimtarinë e Camajt do t'i shohim në këndvështrimin se çfarë pjese ligjërata ato formojnë gjatë bashkimit të elementëve.

### 5.1.1. Formimi i emrave

Më pak të përdorura janë fjalët e përngjitura që përdoren si **emra**, p.sh.: *përqumshti*, *thashethana*, *terramot*, *kamot*, *nëpunës*, *farefis* etj.

**përqumështi** (...se i dalin prej boçave / krena fëmijësh, / se qet në maje një gjuhë **përqumështi**, / të mprehtë e u mallkon tingullin / e ranës së ndezun t'yjeve / larg, / në Kashtën e Kumtrit...) ("Nema", në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 117).

Camaj për të ndërtuar këtë fjalë ka shfrytëzuar sinoniminë. Ai e përdor këtë ndërtim për të shënuar një fëmijë në moshë të njomë e një gjuhë që sapo ka lindur. Njëfjalëzimi i kësaj leme, si mjet gramatikor ndihmon në semantizimin stilistik të saj. Sipas themeluesit të stilistikës gjuhësore Charl Bali, stilistika merret me studimin e mjeteve të shprehjes në të folurit e një bashkësie gjuhësore nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre ndjenjësore, prandaj këtu mund të përfshihen jo vetëm shprehjet frazeologjike, por edhe format morfologjike, kategoritë gramatikore, ndërtimet sintaksore pa anashkaluar fonemat, pra në të gjitha nënsistemet e gjuhës. Camaj luan edhe me format e emrave, në këtë rast, për të krijuar nuancën ka shërbyer rrasa rrjedhore shumë me përjasjen e shquar - e pashquar (boçave- fëmijësh). Lemën *përqumshti*, nuk e kemi të pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim.

**thashethana** (...ia nisën **thashethanat** mbi takimet e tyre...Shkundullima, f. 109); (... që sillen këndeje tue mbledhë **thashethana** e përralla...) ("Loja e mbasdrekës", në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 20).

Kjo fjalë e përngjitur është përdorur me kuptim dialektor, në standard ajo del me formën: thashetheme, që ka kuptimin fjalë të shpifura, të thëna me qëllim të keq për të ngatërruar njerëzit.

Përdorimi i sinonimisë i shërben autorit për të përforcuar frikën ndaj kësaj dukurie: Shkundullimës, Lëkundjes së dheut apo terramotit siç e quan vetë shkrimtari.

Gërshetimi i fjalëve me burim nga shqipja me ato të italishtes është një veçori e gjuhës së autorit.

**terramot** (...*Shkundullima!*- *Gërthiti. -Kushtrim, bre terramoti! Lëkundja e dheut! Shkundullima!*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 148).

**nëpunës** (...*në marrëdhanye me nëpunës e qytetarë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 29).

**farefis** (...*të shmalloheshin me farefis...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 93) etj.

### 5.1.2. Formimi i përemrave

Ndërtime fjalësh të përngjitura që përdoren si **përemra**, nuk janë të shumta. Në këtë grup duam të veçojmë ndërtimet: **gjithçkafja**, **sendegja dhe faregja** të cilat nuk na dalin të pasqyruara në fjalorët e marrë në krahasim. Në FGJSSH (2006) kemi përdorimet: gjithçka (përemër) dhe gjasend, mendojmë se duke u mbështetur në këto ndërtime autori ka krijuar fjalët e mësipërme.

**gjithçkafja** (...*Mbas sa muejsh prap në qytet. Më dukej sikur në këtë ndërkohë të ishte përtrimë gjithçkafja; bardhësia e mureve më vriste sytë...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 112).

Autori për të krijuar leksemën **sendegja**, përmbys rendin e fjalës së përngjitur gjasend, e cila ka një përdorim të dendur në gegërisht.

**gjasend** (...*e ndjen veten rob e gjasend i tij...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 189).

**sendegja** (...*si t’ishite libri im një sendegja si lodër...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 69); (...*nuk ishin sendegja të trishta...*) (“Vargje të shpërndame”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 160).

Ndërsa tek fjala e përngjitur në FGJSSH (2006) kemi të pasqyruar vetëm ndajfoljen fare, kurse ky ndërtim nuk del i dhënë e mund të jetë krijim i autorit, mendoj që kjo fjalë është sinonime me ndërtimin asgjë.

**faregja** (...*s’lanë faregja për ty...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 122).

**asnjigja** (...*nuk je tue më kallëzue asnjigja të re...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 25). Në FGJSSH (2006) kemi ndërtimin: asnjë gjë.

Me anë të përemrit gjithë si element i parë kemi ndërtimet, si p.sh.:

**gjithëmbarë** (...*kinse qenkan ata gjithëmbarë burra...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 29); (...*i ngimë me pamje verash gjithfarë ...*) (“Djella”, në *Vepra 1*,



Tiranë, 1996, f. 118); (...*ata merrnin me zbritë gjithmbarë*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 150); (...*u çuen në ajër bletët e gjithmbarë u zhdukën*...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 107); (...*para djalit të vogël e meje bau gjithfarë shpotinash*...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 23); (...*binin me vete telashe e ngatërresa gjithfarësh*...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 289) etj.

**gjithkush** (...*gjithkush e çdo send andrron në këtë dhe si ledhet e ujëpërçuesave të vjetër*...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 90).

**askush** (...*askush nuk dinte gja*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 110).

Me anë të ndajfoljes **kurrë** si element i parë kemi ndërtimin e fjalëve të përngjitura: *kurrkund e kurrma*. Mendoj që ndajfolja *kurrma* është dialektore, ajo është sinonime me përemrin e pacaktuar asnjëherë.

**kurrnja** (...*kurrnja e re*...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 87); (...*kurrnja e keqe derisa ata enden poshtë e nalt*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 110).

**ndonjenës** (...*ndonjenës, edhe pa e pasë takue maparë, i ngulet në tru puna e Nikës*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 20).

### 5.1.3. Formimi i ndajfoljeve

Në gjuhën e Camajt përngjitja del me karakteristikat e sistemit fjalëformues të gegërishtes. Në këtë sistem mbizotërojnë **ndajfoljet** e kohës, të mënyrës dhe të sasisë, më pas përemrat e pacaktuar, lidhëzat etj.

Kështu nga temat, si: *dorë, krye, maje, ditë, jetë, dhunë, mal, tokë* etj., kemi përdorimin e fjalëve të përngjitura: *përdore, përkrye, përmajë, përditë, përjetë, përdhunë, përmal, përtokë* etj., “*të cilat janë formuar mbi bazën e një togu paraafjalor të tipit paraafjalë + emër, ku emri është gjithmonë në trajtën e pashquar*”.<sup>398</sup>

Në krijimet e veta ky shkrimtar futi në përdorim jo vetëm trajta e forma fonetike e gramatikore të kohës së tij, por edhe trajta e forma “të gjetura” nëpër mote. Kështu që tek autorët e vjetër ndeshim disa leksema me parashtesën *për-*, e tillë është edhe **përmal**, të cilën e gjejmë tek Fjalori i Bardhit. “*Ndajfoljet me këtë parashtesë, sipas studiuesit P. Geci, - dalin sidomos ndër perifraza e shprehje që autori i ka shtënë për ta dhënë të qartë kuptimin e fjalëve latine; me ndenjunë përmal “supersedere”*”.<sup>399</sup> Kjo

398 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002, f. 377.

399 P. Geci, *Derivatet në fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit*, në “Konferenca e Dytë e Studimeve

fjalë sikundër dihet edhe prej studimeve dialektologjike të zonave veriperëndimore, por edhe në gjuhën letrare të kohëve tona ekziston togfjalëshi i lirë për mal, krahas sinonimit të tij *nëpër mal* a *npër mal*, në bashkëvajtje me të autori ka përdor edhe formën *tërmal* që gjendet e përdorur që tek Buzuku<sup>400</sup>, ajo tashmë është vjetëruar, por që gjallëron sidomos në folklor: shkoj djali tërmal-e, tërmal-e tue qa.

**përmal** (...*ujëvrasja tue u ngjitë përpjetë, përmal, zvogëlohej e hollohej gjithnjë e ma tepër...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 166); (...*tue i ndjekë nëpër përrue, përmal e tërmal...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 185).

**përtokë** (...*Ndër vende të këqija karroca këcente maje gurve; as me pasë marrë kali në thue dhe po bie tash e parë me turij përtokë...*) (“Rrungaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 273); (...*la dy fëmijë zhag përtokë...*) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f.36). Edhe tek ky ndërtim vëmë re një përngjizje të përdhunshme, ashtu si tek shembujt e mësipërm. Ndoshta autori ka dashur të krijojë një sistem fjalësh të përngjitura të kategorisë ndajfoljore, që i përdor me ngjyrim figurativ. Në shembullin e mëposhtëm ndeshim variantin sinonimik: përdhe, pa ngarkesë emocionale.

**përdhe** (...*pisha Urania që ishte rrxue / përdhe u çue vetvetiu në kambë...*) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 117); (...*shpendët e vramë ashklash e gursh të flakruem në katër anët e qiellit, një nga një binin përdhe, para e mbas pelës së tërbueme...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 150-151); (...*Ata, të vëlleznit, kishin dyshim se, sikur ai të ishte përzie me njerëz, do të kishte plasë si vetima për së kthjellti, sikur me pasë vërejtë papritmas se qielli po i ulet ngadalë mbi krye për ta shtypë përdhë si zogun nën balt...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 29).

**përdore** (...*kam marrë përdore një vajzë, të paemën...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 92).

Po të khs. me FGJSHS (2006) kemi që për- është parafjalë, ndërsa dorë emër, këtu kemi ngjizjen kësaj parafjale me emrin dorë. Por sot ne arrijmë të përdorim format e tipit për doret, njëlloj si: për krejet, për buzet, për kamet etj. (në të folmen e Shkodrës). Në Fjalorin e Gazullit e të vitit 1954 nuk del e pasqyruar një fjalë e tillë, ndërsa në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” e kemi ndeshur me trajtën: *perdoresh*

---

Albanologjike” III, Tiranë, 1969, f. 155.

400 K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe, I*, Shkodër, 1986, f. 41. Përmal, ndajfolje, përpjetë, ka me votë për mal, “XIV, III”.

*e perduersh*, parf. Alla mano.<sup>401</sup> Një formë të tillë e gjejmë të pasqyruar edhe në Fjalorin e M. Elezit.<sup>402</sup> (I vjen përdorësh, me kuptimin e ka zanat.) Përdorimin e një rrjedhoreje të pashquar e vëmë re edhe tek shembulli i mëposhtëm, ku Camaj ka arritur të ruaj formën gege, sikurse vepron në shumicën e fjalëve, kurse përdorimin e standardit e gjejmë të përdorur tek A. Istrefi.<sup>403</sup>

**përduersh** (...në Romë pata mundësinë me pasë **përduersh** librin ma të vjetër...Pishtarët e natës, f. 179); (...E përfytyronin mes kartash në ndonjë qelizë kuvendi trapistësh apo katund malor, me një kashetë klasikësh **përduersh**...) (“Gjon Gazulli”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 272).

**përkrye** (...mjafton një fluturim blete /**përkrye**/ e bie përtokë/ ndër mija tjera fletë...) (“Nema”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 145); (...i dolën **përkrye** dy cica krye...) (“Buelli”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 164).

Kjo fjalë e përngjitur ka kuptimin përmbi, përsipër, më lart, por në ligjërimin e sotëm ajo ka dalë nga përdorimi. Këtë trajtë ndajfoljore e kemi të pasqyruar që te “Kanunin e Lekë Dukagjinit”.<sup>404</sup>

Fjalët e përngjitura: *përditë, përdhe, përfund, përjetë, përtokë* etj. përdoren dendur edhe në standard, ato dalin të pasqyruara në FGJSSH (2006), gjë që vërteton mbështetjen e shfrytëzimit të leksikut të shqipes.

**përditë** (...me shkue **përditë** në bibliotekë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 179); (...mëkati yt po të mbut **përditë** ...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.34).

**përfund** (...Ishte fundi i shtatorit, koha ma e bukur e vjetit anembanë malësisë, vendosë mes dy lumejve dhe me rrjedhën e Drinit **përfund**...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 33).

**përjetë** (...mandej, vëllaznoheshin përjetë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 78).

**përdhunë** (...si me dashë me e rrëmbye **përdhunë** dashuninë në mbramje përlligjej prej Ntonies...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 136); (...që martoheshin **përdhunë**...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 163); (...si me dashë me u dhanë ujë **përdhunë** në pusa...) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996,

401 *Fjaluer i Ri i Shqypes përbâam prei Shocniet t' Bashkimit*, Shkodër, 1908; Prishtinë, 1978, f. 331.

402 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1090.

403 M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1090. “...pse duhej të më rrëmbenin përduarsh...?” (A. Istrefi, Argatët e dreqit).

404 Po aty, f. 1103. “...peshkun e xanun do ta dajnë përshpi e jo përkrye” (Kanuni i Lekë Dukagjinit).

f. 171). Ndajfolja përdhunë në shembujt e mësipërm është përdorur me konotacion negativ.

Me anë të përngjitjes formohen fjalë të reja nga njëfjalëzimi i parafjalës pa- me pjesoret: *lëvizë, dashë, thanë*, kështu kemi ndërtimet *ndajfoljore: palëvizë, padashë, pathanë*.

Në veprën e Camajt gjejmë mjaft fjalë që mungojnë në fjalorët shpjegues kombëtar, por ato janë pjesë e leksikut popullor, pasi në lojërat popullore përdoret: një, dy, tre palëvizë nga vendi. Këto fjalë tepër të hijshme e tepër tingëlluese dhe paraqesin një ndihmesë të madhe në pasurimin e gjuhës shqipe. Kështu ndajfolja *palëviz* nuk del e pasqyruar tek Fjalori i Gazulli e i “Bashkimit”, por në FGJSSH (2006) e të vitit 1954 ndeshim përdorimin mbiemëror: i *palëvizshëm* e atë emërore: *palëvizshmëri*.

**palëvizë** (...një zezak i verbët / me një qen në mantel lëkure/ mjedis kalldremit në qytetin e madh / të USA-s / qëndrojnë **palëvizë** në kambë...) (“Njeriu me vete e me tjerë”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 197).

**padashë** (...i pakënaqun sepse i solli **padashë** në kujtesë...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 99).

Në Fjalorin e Gazullit kemi të dhënë trajtën mbiemërore: i pa dashtun: njeri i pa dashtun, qi s’ don, qi s’ joshë këndin m’ e dashtë, në Fjalorin e vitit 1954 e FGJSSH (1980 e 2006) hasim përdorimet *ndajfoljore: padashur, padashas, padashka e atë mbiemërore: i, e padashtun*, ndërsa leksema: *padashë* është një formë dialektore e cila mund të gjendet në arealin ku jetoj autori.

Në këtë grup kanë paraqitur interes edhe ndërtimet e ndajfoljeve të përngjitura: **gjithnatën, gjithëditën, gjithdimnin** të cilat në gjuhën letrare i gjejmë të përdorura në togun gjithë (përemër i pacaktuar) + emër (në rasën kallëzore), i kaluar me konversion në ndajfolje. Këto ndërtime vihen re si veçori e gjuhës së shkrimtarit për të dhënë forma të reja të formimit të fjalëve të përngjitura.

**gjithnatën** (...era e fortë fishkëlloi **gjithnatën** nëpër hepet e rrasave te pullazit...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 202); (...era e fortë fishkëlloi **gjithnatën** nëpër hepet e rrasave te pullazit...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 202); (...mbeti jashtë në terr e në të ftohtë tue pritë **gjithnatën**...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 61); (...si ganec shtrigash rri **gjithnatën** mbi libra...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 13).

**gjithditën** (...prej gojës e duerve të femnave, fjalë e shujtë, përnjihëri sosnin në krenat e katundësve të cilët **gjithditën** jashtë, në vetmi, kishin harrue me folë rregullisht...)

(“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 116); (...për mundimin e vjedhun **gjithditën** në pishë të diellit...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 133); (...i hueji mundet me folë **gjithditën** me vetvete...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 84); (...ke marrë malin si dhi e egër **gjithditën**...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 170).

**gjithdimnin** (...shoh orizontin:pesha e hapsive / që mbajta **gjithdimnin** në krah / shkrihet mbi bar...) (“Lirika midis dy moteve”, në *Vepra 2*, Tiranë, 1996, f. 109).

Gjithashtu kemi edhe ndërtimin e ndajfoljeve të përngjitura ku si element i parë shërben përemri *gjithë* dhe si element i dytë është një emër a një pjesë tjetër ligjërate, si p.sh.: *gjithmbarë*, *gjithkah* të cilat i hasim edhe në standard, si p.sh.:

**gjithkah** (...ai përvidhet si cub, **gjithkah**...) (“Rrunga në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 184); (...qesin thirrjen **gjithkah** për gjamë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 93).

Fjalët e përngjitura **njimend e përnjimend** kanë të njëjtin kuptim me *gjithë mend*, por tek ndajfolja *përnjimend* kemi forcë më të madhe shprehëse, të cilën ia jep parashtesa përforcuese për-: nga vërtet në me të vërtetë.

**njimend** (...S’*dij njimend a për lojë*...) (“Legjenda”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 157).

**përnjimend** (...a thua **përnjimend** paska dashë me e marrë me vete token...Pishtarët e natës, f. 86); (...due me e marrë këtë rol **përnjimend**...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 46); (...me ditë se ku gjindet, **përnjimend**...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 134).

**atëbotë** (...**atëbotë** më kaploi malli i ndryllun...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f.71).

**dalëngadalë** (...më dukej se **dalëngadalë** po humbeshja nëndhe...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 55).

Leksemat: *kurrma e kurrfare*, kanë ndajfoljen *kurrë* si pjesë të përbashkët, ato duken si sinonimike, por nuk mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën në kontekstet e dhëna.

**kurrma** (...qenka zhdukë fushës dhe askush se paska pa **kurrma**, as në Hardhi, as në Ndërsanë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 98).

**kurrfare** (...nuk mban idhnim **kurrfare** ha e flen si s’ç’ke me të...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 5*, Tiranë, 1996, f. 83).

Ruajtja e variantit dialektor duket edhe në shembullin e mëposhtëm, ku fjala e përngjitur ka herë sot është zëvendësuar me ngaherë.

**kurrkund** (...mendim që s’gjen **kurrkund** fjalë, i thotë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 71).

**dikund** (...papritmas kujtimet e pakënaquna mbijnë **dikund**...) (“Pasimpsest”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f. 177)

**askurrë** (...por tash e **askurrë** mos vë gojë kundër gjyqtarit...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra* 5, Tiranë, 1996, f. 55).

**kaherë** (...ardhja e një vetje të pritun qysh **kaherë** se vjen...) (“Djella”, në *Vepra* 1, Tiranë, 1996, f. 58).

**ndërmend** (...kur flasim për buej/ kemi **ndërmend** dhe njerëz...) (“Bueli”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f. 152); (...nuk e ke **ndërmend** e më lanë askund shteg...) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra* 5, Tiranë, 1996, f. 59), (...as **ndërmend** s’i shkonte...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 39).

Ky ndërtim duket edhe si ndikim i një tipi të hershëm popullor, prej togut ndër + mend, me anë të përngjitjes shkohet deri në formimin e një emri me kuptim abstrakt, ndërtim fort interesant për shqipen, si: ndërmend,-i “kujtim”, përfytyrim”: *kur më bjen ndërmend ti, me kenë në buk çohem pa ngi*”. Pra ky ndërtim haste në këngët popullore lirike të Malësisë së Mbishkodrës.

Shfrytëzimi i leksikut i autorëve të vjetër shfaqet natyrshëm në krijimtarinë e Camajt. Kjo fjalë del e përdorur që tek Gazulli: më ra ndërmendë.

Ndërtimi: *ndërsy* nuk del i pasqyruar në Fjalorin e “Bashkimit”, kurse në Fjalorin e Gazullit del me trajtën foljore: *ndërsy*nye: me qitë para sÿsh; në Fjalorin e vitit 1954 është trajta foljore ndërsynoj, në FGJSSH (2006) kemi trajtat: ndërsyes (emër); ndërsyese (mbiemër); ndërsyej (folje); kurse në Fjalorin e M. Elezit kemi edhe trajtën ndajfoljore: ndërsy: i foli ndërsy e atë parafjalore: flet ndërsy gjithkuj.

**ndërsy** (...zemër e zbulueme n’parzëm/e shihet si rritet **ndërsy**...) (“Bueli”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f. 153); (...të dy u shikuen me habi **ndërsy**...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra* 4, Tiranë, 1996, f. 30); (...u shikuen **ndërsy** mes tyre...) (“Shkundullima”, në *Vepra* 4, Tiranë, 1996, f. 97); (...nuk thamë gja që s’ia kishim thanë **ndërsy**...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra* 5, Tiranë, 1996, f. 95); (... e vëresha **ndërsy** me moskuptim...) (“Djella”, në *Vepra* 1, Tiranë, 1996, f. 89); (...Ripasit u shikuen **ndërsy**...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 88); (...zemër e zbuluem n’parzëm / e shihet si rritet **ndërsy**...) (“Bueli”, në *Vepra* 3, Tiranë, 1996, f. 153).

Forma e përngjitur ndërsy nuk është gjithandej zotëruese, përkundrazi janë më të gjalla format me togfjalësha të lirë parafjalor: ma mirë ma thuaj ndër sy.

Fjala *ndërdyzash* del e pasqyruar që tek Gazulli: jam ndërdyzash a me i a lá a mos me i a lá paret, pra me kuptimin “me dyshim”. Me të njëjtin kuptim e kemi të

përdorur edhe këtu.

Fjalët e përngjitura: *ndërduzash e tekembranja* janë fjalë të vjetëra dialektore, në ditët e sotme ato kanë dalë nga përdorimi, në vend të tyre kemi përdorimet: *dyschim*, *dilemë* dhe *tek e fundit*, më në fund.

**ndërduzash** (...qëndrim *ndërduzash* i njeriut shoqnisht të pashpresë...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 91); (...*tash unë dhe Dranja këqyremi ballë për ballë kokërr ndër sy, të dy të ngimë, por ndërduzash* si të huej mbi dhe nga se asnjëni nuk di kah me ia mbajtë përpara territ, në lindje apo në perëndim?...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 16); (...*matet e rri ndërduzash* a t’i tregojë apo jo kolegut të ri...) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 53).

**tekembranja** (...*ringjallja e botës së shueme në ndërgjegjen tij disesi ishte në kundërshtim me frymën përtrijse, të rindërtimit të katundit të ri. Tekembranja, tha me vete e në gjyqim me fytyrën e dashnores ashtu si ishte përpara shkundullimës, ose e mëkambi botën ashtu si ishte, ose la gjithçka dhe s’prek gurë ndërtues me këto duer!...*) (“Rrunggaja në mars”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 156).

**kamot** (...*ke përshtypjen e diçkaje të përjetueme kamot*...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 292); (...*e njoh kamot këtë vend*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.53).

Edhe kjo fjalë e përngjitur ka+mot del me gurrë të hershme popullore, në standard kemi ndërtimin ndajfoljor: *qëmoti*.

Një grup tjetër fjalësh të përngjitura që përdoren si ndajfolje kemi edhe ndërtimet që janë ndërtuar me anë të përsëritjes të së njëjtës fjalë dhe të lidhura me anë të zanores lidhëse. Në këto ndërtime vihet re një karakteristikë në drejtshkrimin e tyre, disa prej këtyre ndërtimeve autori i shkruan bashkë, ndërsa në gjuhën letrare i kemi të shkruara ndaras. Këtu duam të veçojmë ndërtimet: *malemal* dhe *krahekrah* të cilat nuk i gjejmë të pasqyruara në fjalorët e marrë për krahasim dhe mund të jenë ndërtime të autorit.

**malemal** (...*lumi i Vilës ishte i rritun malemal*...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 65).

**krahekrah** (...*hymja e dera e katoit ishin të hapura krahekrah*...) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 117).

Këto fjalë të përngjitura kanë kuptimin e ndajfoljes shumë.

**motmot** (...*aty e mbrapa, një motmot*...) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 134); (...*ajo motmotit i njeh dy stinë*...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 13); (...*janë të gdhendura*

*në fytyrën e motmotit...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 138).

Fjala e përngjitur *motmot* është tipike e gurrës popullore, e cila del gjithandej në të folmet veriperëndimore e më gjerë, me kuptimin vit i plotë, fundi i vitit: për motmot të ri. Camaj përpiket që në kontekste të tjera këtë fjalë të përngjitur ta përdorë edhe si emër.

Tek leksema *shpejtshpejt* vihet re një risi drejtshkrimore e Camajt, pasi këtë fjalë e ka shkruar bashkë, ndërsa në FGJSSH (2006) i kemi të pasqyruara ndaras: *shpejt* e *shpejt*.

**shpejtshpejt** (...*si me dashë ta mbyllë atë kuvend shpejtshpejt...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 20).

**anekand** (...*një burrë si Nika, i përmendun për pasha anekand, nuk lehet shëndosh prej grave...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 20).

Fjalët e përngjitura **kryekreje**, **fytafyty**, **turravrap** janë pasqyrim i shfrytëzimit të gjuhës letrare.

**kryekreje** (...*u zhyt në idhnime të frikshme e të pashpjegueshme. Ishte depresioni i natyrës malore që kalonte prej dheut e bimësisë së mbytun e të marrun fryme nën borë në ata njerëz si Nika, kryekreje barinj të cilët kishin përjetue ndër stinë çdo imtësi shndërrimi...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 70); (...**kryekreje** shkaku i arit e si përflitet...) (“Kandili i argjandit”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 132); (...*iu kujtue fytyra dhe kryekreje gazi në buzën e saj...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 237).

**fytafyty** (...*që i kacavaren fytafyty me rranjë krepit, shtrënguet, që asnjë guralet të mos shkoqet prej tij...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f.12)

**turravrap** (...*turravrap u vu në të ikun përmes fushës as me qenë iriq kambëshpejtë...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 28).

Ndajfolja e përngjitur *vetmevete* ka kuptimin “me veten e vet”. Kjo fjalë e përngjitur shprehet prof. D. Luka është neologjizëm i Camajt, i krijuar nga vetë me vete.<sup>405</sup>

**atypëraty** (...*shqarri atypëraty, përvështirësohej prej tymit...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 77); (...*aty për aty* dëshiroi ajo t’i këputet kurmi e t’i mbesë atij ndër duer sall ajri...) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 41).

Ndajfolja *atypëraty* paraqitet me dy varinate drejtshkrimore: njëherë e shkruar bashkë e njëherë si lokucion ndajfoljor: *aty për aty*.

**vetmevete** (...*Gazulli edhe u argëtue vetmevete* në kundërime njerëzish...) (“Gjon Gazulli”,

405 D. Luka, *Studime gjuhësore*, XIII, Shkodër, 2011, f. 202.



në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 269); (...bindej **vetmevete** si ata nuk e nuk e pyetnin përse thirret ashtu ai fis...) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 27).

Shpesh tek Camaj antonimia krijohet edhe me përballjen e një sintagme me një fjalë të vetme, si në shembullin e mëposhtëm:

**përmbys** (...*Ideja e anijes për së mbari apo **përmbys** nuk lidhet në det...*) (“Karpa”, Romë, 1987, f. 31).

**përmbas** (...*dikush i ishte qepë **përmbas**...*) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 83).

Kjo fjalë duket si leksemë e marrë nga standardi më i ri i shqipësisë, sepse përndryshe do të kishim fjalën mbrapa ose përmbropa.

**mbasdore** (...*i lanun fare **mbasdore** prej trashëguesvet...*) (“Shkundullima”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 99); (...*sa ma shpesh që Lena shtinte kajzit e pishës në zjarm, **mbasdorke**, aq ma tepër rritej legjenda e pishtarëve të natës...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 47). Një formë të tillë e kemi të pasqyruar në Fjalorin e ’54, pra vihet re ruajtja e dialektit gegë, këtu ruhet grupi i bashtingëllores: mb, ndërsa në standard kemi ndërtimet: pasdore, pasdreke.

#### 5.1.4. Formimi i lidhëzave

Tek ndërtimi i fjalëve të përngjitura një vend të vogël zënë edhe **lidhëzat**, të cilat janë po ato që përdoren gjithandej në krijimtarinë letrare, si p.sh.: *megjithëse, sesa, sikur, ngaqë, ndërsa, gjithashtu, derisa, meqenëse, teksa* etj. Këtu duam të veçojmë ndërtimin *edhepse* që Camaj na e shkruan bashkë ndërsa në FGJSSH (2006) del në formën e një lokucioni lidhëzor edhe pse.

**edhepse** (...*edhepse vetëdija gjithnjë në mue mjegullohej, shihej qartë çdo send...*) (“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 34).

**gjithashtu** (...*acarohet në vete **gjithashtu** hutohej me orë e orë ndër thurje e çthurje ngjarjesh...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 70); (...*ky fliste gjithnjë të folmen e të parëve gjithashtu binte kuvendi...*) (“Djella”, në *Vepra 1*, Tiranë, 1996, f. 87);

**asgjatë** (...*asgjatë, duket se Nika me ta ishte kënaq në kuvend dhe me ata i kishin ra fjalët ma mirë se me burrat e pleqnisë...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 65); (...*asgjatë sa ma shumë shtohet pjerrësia, aq ma tepër vështirësohet ngjitja...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vepra 4*, Tiranë, 1996, f. 235)

(...*asgjatë qeshin të gjithë, pos Zekës...*) (“Loja e mbasdrekës”, në *Vepra 5*, Tiranë,

1996, f. 56) .

**ndërsa** (...*ndërsa rritej çështja ndër njerëz e në shtyp, u mblo dh popullata e breshkave...*)  
(“Dranja”, në *Vepra 3*, Tiranë, 1996, f. 40).

Si përfundim mund të themi që nga Camaj janë bërë përpjekje të vazhdueshme për shfrytëzimin e leksikut të pasur të gjuhës shqipe, por pa lënë pas dore edhe pasurimin e saj me të gjitha mjetet fjalëformuese. Shkrimtari ka arritur të krijojë natyrshëm edhe fjalë të përngjitura, duke ndjekur gjithmonë modelet fjalëformuese të shqipes, si: ***gjithnatën, gjithëditën, gjithdimnin, gjithçkafja, sendegja dhe faregja.***

## KREU VI

### 6. NGJYRESAT LIGJËRIMORE NË VEPRAT LETRARE TË M. CAMAJT

*“Vepra letrare e Martin Camajt i kumton lexuesit ”variantin gegë”,  
të lëvruar e të sprovuar në rrethet letrare shkodrane të kohës,  
të cilën shkrimtari ynë në gjallje të vet nuk reshti së përpunuari dhe  
pasuruari në formë dhe leksik.”<sup>406</sup>*

Krijimtaria letrare e Camajt përbën një pasuri të madhe gjuhësore në mjaft rrafshë, që nga leksiku i rrallë, frazeologjia, formimi i fjalëve me brume të shqipes dhe sidomos për mënyrat e veçanta të ndërtimeve sintaksore sipas natyrës së gjuhës sonë. Pikërisht, krijimtarisë së këtij shkrimtari jo aq të njohur deri më tani, do t’i shkonte përshtat ajo që nënvizon një nga studiuesit e thukët të tij në planin letrar (të mitit, metaforikës dhe simbolikës), poeti dhe studiuesi i mirënjohur, K. Petriti, i cili nënvizon, se *Fjala është e njëjtë për të gjithë, shpriti i fjalës është vetjak*. Dhe është e vërtetë që me pasurinë e thesarit gjuhësor, nga standardi e prurjet dialektore, Camaj arrin të shprehë atë që e dëshiron dhe ashtu si dëshiron, atë që duhet dhe si e sa duhet me anë të përdorimit të fjalës si me magji, me anë të formanteve të shumta dhe të larmisë së pakundshoqe të idiolektit të tij.

Duhet vënë në dukje, se me veprat artistike të Camajt, kemi rastin e dy dukurive krejt të veçanta në letërsinë tonë: Shkrimtari operon në korpusin e përgjithshëm të veprave të veta me idiomën e variantit të shkrimtarëve më të përparuar të veriut, i cili ia ka arritur të përdorë leksema, grupe fjalësh e frazeologjisë të atij areali që përshkruan e për të dhënë mjedisin e koloritit jetësor të banorëve. Theksojmë, nga ana tjetër, se Camaj ndërkohë, është jo vetëm shkrimtar i spikatur i letërsisë sonë, por është quajtur gjithashtu edhe gjuhëtar i mirëfilltë, pasi për botën arbëreshe ai ka studime të drejtpërdrejta në fushë të dialektologjisë, leksikologjisë dhe etnografisë gjuhësore.

Duhet të theksojmë, se shpjegimi i fjalëve gjatë kësaj paraqitjeje stilistikore për shprehësi është bërë në fillim, duke u nisur nga fjalësi i vënë prej botuesit në fund të çdo vepre të shënuar më lart; por edhe duke u mbështetur në fjalorë të ndryshëm të shqipes, nga ai i vitit 1908 e deri tek më i fundit, i vitit 2006.

---

406 M. Camaj, *Vëllimi I*, Onufri, Tiranë, 2010, f. 6.

## 6.1. Ngjyresat ligjërimore në fushë të leksikologjisë

*“Me një leksik e një frazeologji të zhdërvjellun - me një siguri vizatimi tipash të ndryshëm, - me një gjallni djalogësh qi me premin plot veshtrim të tyne zbulojnë fundet e shpirtit të vetjeve - me një stil të rrasët e të ngjyrshëm ku hijet e dritat ternohen me mjeshtri të natyrshme, - Camaj në pak faqe krijon një botë të vogël qi vuen e gzon para syve t'onë.”<sup>407</sup>*

Camaj është një mjeshër i gjuhës shqipe. Në krijimtarinë e tij gjenden të gërshetuara fjalët “plaka”, me ato dialektore, ku autori kalon kufijtë me anë të përfshirjes së mjaft leksemave që i përkasin leksikut të botës arbëreshe. *“Motivet arbëreshe, me siguri, nuk kanë me u kuptue nga arbëreshët sepse ata kanë parasysht realitetitn, ndërsa unë mbështetem në përfytyrimet e mia; unë shfaq atë çka ndiej vetëm për këtë botë.”*- shprehet Camaj.<sup>408</sup>

Në fillim po paraqesim ato fragmente që pasqyrojnë botën arbëreshe, me anë të përdorimit të leksemave të arbërishtes. Këto fjalë nuk i kemi të pasqyruara në fjalorë, ato mund të jenë të pasqyruara tek “Kuvendi i Arbrit”. Prani më të dendur këto fjalë kanë gjetur tek vepra “Shkundullima”, pasi, siç shprehet studiuesi Sh. Sinani: *“Alternimi i mjedisit, prej ishujve etnografikë të Shqipërisë mbi Drin tek ishujt etnokulturorë në Italinë e Jugut, nga vendlindja te bota arbëreshe, është zgjidhja e qëllimshme e shkrimtarit për të kapërthyer Shqipërinë dhe shqiptarët nga skaji në skaj, por me një mbikalim elegant të emrit të saj.”<sup>409</sup>*

*(...Ky ndijim nganjëherë rrokte edhe ndonjenin asish që banonte në maseritë jashtë katundit, apo ata që delnin herët mënate ndër ara e vreshta përreth ose hypnin në mal me bagëti, dhe kthenin mbasdite vonë, si pahiri, si të kishin harrue një vegël dhe vinin me e marrë në shtëpi. Këta qëndronin në kambë midis sheshit dhe kujtoheshin papritmas se në katund nuk lëvizte asnjë fletë gjethi ndër fiq e pemë të tjera të vetmueme mbas mureve...)* (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f.114).

407 M. Camaj, *Veptra letrare 1*, Apollonia, Tiranë, 1996, f. 145.

408 M. Camaj, *Veptra letrare 4*, Onufri, Tiranë, 2010, f. 34.

409 M. Camaj, *Veptra letrare 3*, Onufri, Tiranë, 2010, f. 12.

Është pamja tipike e një katundi shqiptar, që ka mundur të ruajë pamjen e atyre fshatrave nga kishin ardhur ikanakët e shekullit XIV e më vonë nga Arbëri i tyre i dashur. Janë tablo sikur janë vizatuar me penelin e kujtesës së Dheut-Mëmë, të cilit i kishin kthyer krahët aq të brengosur. Fjala “ndijim” këtu merr kuptimin “dashuri”, “kujtesë e largët”, “dëshirë”, “vuajtje”, që lidhen me foljen “rrok-te”: shtrëngonte, përqafonte, gjithnjë në kujtesë pamja e gjallë e vendlindjes së të parëve, që kishin shekuj pa atdhe! Këta njerëz, “të huaj te ky dhe” (Serembe), mbushur me ndjenjë e dashuri për vendlindjen që kishin mundur ta përgjasonin me shtëpi, rrugë e pemë që veshin muret, atje ku i dërgoi fati, në Jugun italian, jetojnë me kujtime dhe këtë ide autori e shpreh nëpërmjet leksikut të veçantë e të zgjedhur. Kjo ndjenjë e ndjesi i çon ata “si pahiri” (si pa dashtë, pa dashje), në admirimin me shpirt të pamjeve aq të gjalla, që vetë i kanë gjallnue.

Përdorimi i fjalës “maseri-a” në këtë paragraf jep toposin e këtij përshkrimi bukolik, që nuk mund të jetë tjetër, veç i hapësirës arbëreshe; po kështu, brenda këtij areali rreshtojmë edhe fjalët më poshtë të pasazhit: *katund, ara, vneshta, fiq, pemë, mal, bagëti*.

Vendosja e fjalës “maseri-a” në fillim të paragrafit është përgjigje e pyetjes se ku zhvillohet ngjarja e ku bëhet përshkrimi i autorit.

Në fragmentin e mëposhtëm fjala “rrogje”, pa ngrakesë stilistike a stilemore, shërben vetëm për të shënuar koloritin leksematik të regjionit ku përdoret; duket se fjala vjen krejt e veçantë për botën arbërshe, përndryshe, të një fshati arbër. Vetë fjala “pëshpërit” këtu lë të kuptojë se fakte e ngjarje të së kaluarës nuk kanë nevojë të shqiptohen të plota: ato vijnë në kujtesë vetëm me një sinjal gjuhësor (fjalë a grup fjalësh), për të kuptuar një ndodhi, një fragment jete të plotë dhe të njohur nga bashkëbiseduesit, që këtu shfaqet me një segment vargu të nënvizuar.

(...“*Kanë pyetë shpesh për ty. - Thanë. - Na vizituen në vneshta dhe pimë venë në rrogje, si dikur. Kënduem dhe kangët e vjetra: lumi lartë e lumi poshtë. A të kujtohen këto kangët tona, Vito? “Mandej ata i pëshpëriten shokut të vjetër diçka në vesh e qeshnin, pa e pasë mbarue tregimin...*”) (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 117).

(...“*Atëherë - thanë ata tue plotësue me radhë, copa-copa, fjalitë- paske mjaft kohë të përkujdesesh pakëz për dhenat që të ka lanë yt atë. Sigurisht, hardhi, ullij e pemë nuk vehen ma përfije ngase kanë dalë punë dhe janë egërsue. Për t`i zbutë e*

*përtri duhen vjetë, po atë kasollen, atje jashtë, te dhenat, këtë mund ta ndreqësh. Aq turesë, të holla, për landë e punëtorë do kesh. Mandej inxhener je vete! Çka të mungon të mos bash një vepër të mirë? Këtë do të kishin thanë edhe prindët e tu sikur të ishin gjallë...*) (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f.118).

Leksema “dhe-nat” është përdorur në kuptimin e gjerë: tokë-at, arë-at, përndyshe “pronë”, “pasuri”. Antonimet “egërsue” - “zbutë”, përdorur në format analitike foljore (pjesore dhe paskajore), janë vënë pranë e pranë për të treguar edhe shkencërisht termat “i egër”/“i butë”, që shërbejnë për të shprehur kuptimet e këtyre fjalëve në fushë të bimësisë, si: fidan/bimë e egër dhe fidan/bimë e butë...ndërsa lokucioni “nuk vehehen ma përfije” - si frazeogramë - ka kuptimin “nuk kthehen mbarë, nuk ujdisen; vë për fije/vë për fille - në semantikë të parë lidhet me “rregulloj fjet/fillet e ngatërruara të një lëmshi a shkuli penjsh”, kurse këtu përdoret për “vë në rregull një punë, e kthej mbarë, ashtu si duhet”, etj.

Diku-diku shkrimtari ynë e ka ndier të nevojshme që për fjalët e caktuara (duke qenë me një përdorim fort të rrallë), të vërë pranë leksemës dialektore, edhe përgjegjësen e njohur, siç vepron më sipër me çiftin sinonimik “turesë/të holla”. Me foljen “përtri” autori arrin të japë një shkallëzim ngritës: egërsoj - zbus - përtrij. Për këtë të fundit, Fjalori i gjuhës shqipe, 2006 ka tri shpjegime: e bëj më të ri ose që të duket a të ndihet më i ri, rinoj; e bën që të dalë prapë a të rishfaqet siç ka qenë; e gjallëron; e lulëzon; fut pjesëtarë ose anëtarë të rinj në një organizatë, etj.

*(...Vitoit, vajza e pëllasit i mbeti në përfytyrim do kohë me parzëm pak të shpërvjelun, si martire e përdhunueme dhe e përgjakun, ashtu si paraqiten ndër freska kishash të vogla në fshate të lëshueme të rrethinës. Martiret në ikona të tilla duken si me qenë të shkyeme teshash, në të vërtet janë të damtueme dhe të zhgjyrosuna prej motit e lagështinës...Vëllimi 1, Shkundullima, f. 122).*

Freskë-a, shkurtime i fjalës së fjalorit arkeologjik (këtu religjioz), në vend të fjalës së plotë “afreskë-u”, duke ndërruar edhe gjininë nga mashkullore në femërore. Fjalori i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2006 e shpjegon si vijon: afresk-u, m.sh.-e (t) art. pikturë me bojëra uji mbi suva të njomë: afreske mesjetare. Si mbështetëse e fushës së përdorimit (religjioz) në këtë rast, shërben edhe leksema e

përdorur në segmentin e veçuar (nënvizuar prej nesh) “martire”. Gjithëmbare këto fjalë: *martire, freska, kishash, ikona* dhe aktivizimi i gegizmave “parzëm-i” (gjoks-i) dhe “teshë-a” (rrobe-ja”), e bëjnë krejt të veçantë fragmentin e sjellë më lart dhe zgjerojnë krahasimin midis vajzës së pëllasit dhe martirës besimtare, që martirizohet deri në dhunim e përgjakje nga stoicizmi në fenë e saj. Nëse ndalemi tek formimi i fjalës me prejardhje parashteso-prapashtesore “të zhgjyrosuna”, vërejmë që shkrimtari ynë - gjuhëtar - nuk përdor morfenën “ç”, e cila do të duhej si normative, por, për forcë e intensitet, sjell një tjetër morfemë “zh”, e cila shpreh masën cilësore të semantikës së vetë mbiemrit prejfoljor (të zh+ ngjyrë- os - ur).

Rrallëherë, në shkrimet e Camajt, do të gjejmë edhe leksema vetëm me vlerë etnografike, që, natyrisht, nuk gjenden në fjalorët e shqipes, por i ndeshim tek “Fjalori arbërisht-shqip” i Kolë Kamsit.

*(...Mbas shërbimeve në shtëpi, ato, të lame e të ndërrueme, tërhiqeshin skajeve të katundit dhe u delte gjuha një pëllambë tue kuvendë, jo vetëm mbi Ntonien (Vitoin, disi në nderim se ishte burrë nuk e zenin fort në gojë!), por edhe për ngjarje të tjera ma intime mes burrave e grave të martueme. Edhe të dy bujqit, moshatarë të inxhinierit, u kujtuen për këtë shndërrim edhe te gratë e veta të cilat përpusheshin tepër që çdo gja në shtëpi dhe në shtat të tyne të shkëlqente, e pastrueme. He, he! Banë ata me vete, kësaj here pa shpërrallime vesh në vesh, plot respekt ndaj grave të veta. Në shumicën e të rejave, mbas dy muejsh, niste frymja e gjijve dhe zente fill mrekullia e zgjimit që as veshja petepete e linjave dhe e cohës arbëreshe nuk mund ta fshehte. Andej u ngjall dëshira e granisë së katundit që mrekullia të ngjante dhe te Ntonia, me fejesë e dasmë të shpejtueme. Në atë rast, secila do të kishte pasë maje gjuhës fjalën: e dija se shurbisja sos ashtu!...) (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 134).*

Është një skenë interesante, jo e shprehur në thelbin e saj, por aq e qartë në aludimin e autorit: janë biseda, kuvendime dhe thashethana intime e moralizuese, që karakterizojnë më së pari jetën fshatarake, një atribut i njerëzve jo intelektualë, ndaj një ngjarjeje jo të vogël për një komunitet jo të gjerë, siç është fshati arbëresh: një vashë ka mbetur shtatzënë ! Fakti nuk thuhet gjuhësisht drejtpërdrejt, por autori na e bën të kuptueshëm me fjalë e grupe fjalësh, si: ngjarje intime, shpërrallime, e pastrueme, frymja e gjijve, veshja

petepete e linjave (me pala), nuk mund ta fshehte, grania e katundit (sinonim i fjalës “fshat” aq i përdorur në mjediset arbëreshe, sa ka edhe revistë me emërtimin “Katundi Arbëresh”), shumësia e grave, fjalët e tyre që enden deri në thana e thasha - përfundon autori përshkrimin e ngjarjes-skandal me segmentin “mrekullia të ngjante me fejesë e dasmë të shpejtueme”, me qëllimin për të ruajtur nderin e vashës !

*(...Rrëfimi në mirëbesim e zojës së pellasit në krye të katundit mëndeshës së vet nuk mbeti fshehtësi e ndryme nën njëqind çelësa. Atë ditë e mori vesh katundi mbarë se Ntonia jetonte me Vito në shkandull; ata, as të fejuem nuk mund të quheshin. Tash emni i saj, ma pak ai i Vitoit, përmendej vesh në vesh, gjithnjë me pëshpëritje, rreth zjarreve, rrugëzave e kandeve të katundit e deri në kishë, si nynyrim lutje. Ntonia u ndry mbrende si e ama e gjyshet, si e martueme, prore në pritje të burrit, Vitoit...)* (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f.148).

Del në këtë fragment jeta jashtë tradicionit, mbase bashkëjetesa e sotme, në atë fshat, ku Vita jetonte në shkangull (në përdalje, në mëkat, pa kurorë), prandaj dhe përflitej poshtë e lart vesh më vesh; bien në sy bashkimet sintagmatike: fshehtësi e ndryme, nën njëqind çelësa, katundi mbarë etj.

\*\* Gjuha e Camajt është e pasur me leksema dialektore, me fjalë “plaka” dhe *shprehje frazeologjike* të cilat gjejnë pasqyrim më së shumti në ligjërimin popullor. Disa prej këtyre leksemave dialektore gjallojnë akoma në të folmen e vendlindjes së autorit, pasi ato nuk janë të pasqyruar në fjalorët normative të shqipes. Ndërsa mjaft lema të tjera gjenden të pasqyruara në disa fjalorë të shqipes, por duke u përdorur nga gjuhëtari Camaj kanë fituar ngjyime stilistikore.

*(...Si anza - thonë - asht shpata / e mprehtë. / Dhe anzë asht vasha kreckare, / e egër e me trajtat e anzës / së egër në drunin e kreckës...)* (“Lirika mes dy moteve”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 99).

Fjala kreckë shpjegohet tek Fjalori i Xh. Lloshit.<sup>410</sup> Ndërsa tek Camaj vasha kreckare

410 Xh. Lloshi, *Fjalori i emrave të bimëve dhe të kafshëve, Shqip - Latinisht dhe Latinisht - Shqip*, Logos-A, Prishtinë, 2010, f. 162. (krecka Acer campestre &: krecka, krecka e butë, krecka, kreckëza, kreckëza e butë, kreckëza fletëmadhe; krecka e butë - krecka; kreckca - krecka; kreckca e egër - panja e malit; kreckëza - krecka; kreckëza e ashpër - kreckëza gjethevogël; kreckëza e butë - krecka; kreckëza e



- ka kuptimin: vasha krenare, kryenaltë, me kokën lart, falë bukurisë dhe virgjinisë së saj; krahasimi bukolik në gjiun e natyrës, aq më tepër që fjala bën homofoni me termin “krye”, “kryekëcyer”. Njëri nga kuptimet e figurshme të emrit të bimës, lidhet edhe me ashpërsinë, që rrjedh po nga krenaria.

*(...Fjalët e fundit e binin në mend Nikën dhe paqohej. Rrugës për në Gurra, pendohej, mallkonte veten dhe ndeshtrashat e jetës, edhe ditën kur kishte lindë e ra për të parën në lesh të delmjes. E ndiente veten të mundun...)* (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 23)

Lema ndeshtrashë nuk ka gjetur pasqyrim në Fjalorin e Gazullit e Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980, por atë e gjejmë të pasqyruar tek FGJSSH (2006)<sup>411</sup>, me të njëjtin kuptim që e ka përdorur Camaj - ngjarje a ndodhi e paparashikuar.

Nga dy folje: ndesh + t’ rashë (të dyja kalimtare), një përngjitje sot e vjetëruar e shqipes. Shprehësia e kësaj lekseme këtu ngrihet mbi një kuptim tjetër që japin fjalorët: të ndodhme, rreziqe, dallgë të jetës, peripeci, vuajtje, vështirësi, që gjejnë mbështetje edhe nga folja “mallkoj”, para saj; vetëm për këto ndeshtrasha njeriu mund të mallkojë.

*(...Edhe visi ku Nika jetonte veçohej, në lindje, prej një rreshti currash të thepisun, në perëndim e jug, prej humnerash që sosnin në lumë. Në veri, vetëm në atë anë dheu hapej si derë, vutas përtpjetë, pa pengesa të dukshme dhe soste në një maje, e quejtun Maja e Cilkokut. Mbas rreshtit të currave, në lindje, zbutej edhe toka ku përmbante botë e rreshpe, përzie aty-këtu me gur të bardhë e granit të kuq si mbarë rrethina e Gurrave. Përtej rreshtit të currave, ndër dhenat e buta, rronte vllaznia e Nikës dhe tejpertej shumë fise të tjera, tue u shtri prej lugine në luginë, për së gjani e për së gjati. Malësorët Gurrat i manin si dhé i askujt që përcaktonin kufijtë e natyrshëm me lumin e Vilës dhe katundin me të njajtin emën përtej atij, ashtu si për banorët e një ishulli ana e skajshme e tij, krejt shkamb që rrahet kurdoherë prej valëve të detit...)* (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 24-25).

---

egër - panja e malit; krekëza fletëmadhe - krekë; krekëza fletëvogël - krekëza gjethevogël; krekëza gjethevogël *Acer monspessulanum*, *A. trilobatum*- krekëza e ashpër, krekëza fletëvogël, makleni.)  
411 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 661.

Në Fjalorin e vitit 1954 fjala *vutas* nuk del e pasqyruar, ndërsa në Fjalorin e Gazullit hasim mbiemrin e parmë: *vûtë - i, -a* (i. e. SP) adj. 1. vend i *vûtë*: i fushët, plantë, po ashtu e kemi si variant dialektor edhe në FGJSSH (2006): 1. shtëpi e *vutë*. 2. fig. i bindur, kokulur; i *butë*: *djalë i vutë*; *fjalë të vuta*. Por ndërtimin ndajfoljor e gjejmë të pasqyruar në krijimtarinë e Gj. Fishtës.<sup>412</sup> Camaj, duke shfrytëzuar temën e parme mbiemërore të variantit dialektor, arrin që fjalës së prejardhur *vutas* si ndajfolje, t'i japë një ngjyrim të ri leksikor.

Veç kësaj, fragmenti që sjellim vizatohet si një pikturë peizazhi në gji të natyrës, realizuar prej autorit me anë të lidhjeve sintaksore me vlerë stilemore ngjyrash të ndryshme, si: *rresht currash të thepisun, humnera që sosin, hapej dheu si derë, vutas përpjetë, soste në një maje, përmbante botë e rreshpe (botë-a, tokë, dhe), gurë të bardhë e granit të kuq, dhena të buta, prej lugine në luginë*.

Është pamje e hollësishme e abitatit malësor me shkëmbinj e thepa, lugje e lugina, shumë gurë e pak dhe, humnera e ara të vogla për jetesën e vllaznisë së Nikës.

*(...Së pari kureshtia, mandej edhe gjelozia se i shoqi paska ngrehë miqësi me gra të hueja, si thoshin bota, apo me Zana, nuk e lenin të qetë. Vetëm krenaria e ndalte mos me hjekë rubën kreje e mallkue të madh e të vogël, Kolën dhe kunetnit që ia kishin të hueje të shoqin dhe ndry ndër Gurra. Mbasi i frenoi ndjesitë e irta, caktoi t'i avitet Nikës. Po si? E kishte pyetë veten. Mendo, shmendo, në fund iu duk se gjeti zgjidhjen: due një djalë prej tij! Tha. Duhet ta marri vesh malësia, kishte thanë me vete Lena, se unë nuk jam luk-shtjerrë si Zanat, unë jam dikush tjetër!...)* ("Pishtarët e natës", në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 50).

Lema e *irtë* ka kuptim figurativ këtu dhe krejt përshkrimi psikologjik bëhet në ndjesinë e një gruaje, burri i së cilës, Nika, kishte nisë ta tradhtonte, të shkelte kurorën e martesës. Është një tablo në fushë të etnografisë së të folunit: *me xhelozia, mallkime, ndjesi të irta*, luftë motivesh për të vepruar drejt "gjetjes" së një djali që do ta trashëgonte Nikën e të huejun prej Kolës dhe kunetënve; në fund të fundit, është dëshira e një gruaje për të lindur, për të mos mbetur si zanat shterpa! Lena vendos: do t'ia kërkonte djalin Nikës, që paska ngrehë miqësi me gra të hueja! Fjala e përdorur me vend e aq me kuptim këtu, është folja e përfutur nga përngjitja e nyjës mbiemërore "të + huaj" = të huaj, që merr kuptimin

412 M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 1594. "Vutas ndajf. (prej vutë). Jo shumë pjerrët, butë. Brija çohet vutas përpjetë."

“largoj”, “braktis”. Ngjyrimin e idiomës së vendit e sjell edhe kompozita luk-shtjerrë = beronjë (Fjalor i gjuhës shqipe, 1984).

*(...Toka e Nikës përreth kasolles ishte e përzieme me dhé të kuq e gur të zez zjarmi, pjellor - mbas fjalës së tij - po qe se ia ka marrë dorën dikush dhe di se çka ajo lyp: lëvrim të thellë, sepse në shtresën e gurve qenka tokë mjaft, dhe domosdo pleh dhish të imët si pluhën. Breznitë e hershme përtace kishin qitë fjalën se edhe po t'i bahej munda, Fundina qenka toke rrabe, qe nuk jep fryt, sepse qenkej dhe i shituem rrefeje dhe i zanun prej shpirtënsh të gjinisë femnore, nga Orë e Zana. Edhe të bijtë e Nikës kur u rritën e u bane të zotët me ia ngjitë t'et krahun në punë, sadopak të qitnin dhitë në kullosë ndër shkambij, ia përtonin të flenin në shtëpinë e gurit ndër Gurra. Nëse e zente nata Palin, djalin e madh, në Fundinë qiste lloj-lloj shkaqesh për të mos bujtë aty me të jatin. Jo, thoshte, jam me i madhi ndër bij e s'kam si ta la familjen vetëm. Nëse nata ishte tepër e errët, Pali shtinte një dorëz kajzish pishe në zjarm e kthente tue ndritë me to udhën deri te shtëpia e vendit...) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 25-26).*

Ka shumë bestytini në temat e rrëfimit të Camajt, sidomos në prozë: ku banon malësori Nikë, janë toka me dhe të kuq e gurë të zez zjarmi, por, sipas banorëve, janë dhera të shituem (të plagosun, të nemunr) nga rrufetë dhe të zënë prej shpirtërash të këqinj dhe prej Orëve e Zanave e toka ka mbetur rrabe . Autori u nxjerr burimin këtyre bestytinive, që vjen nga përtacia e njerëzve për ta lëvruar tokën thellë, tek dheu midis gurëve. Përshkrimi nis drejtpërdrejt me paraqitjen e përbërjes së tokës ndër Gurra, përndyshe, tokës që mban emrin Fundina, një formim gjuhësor i shkrimtarit, nga emri “fund-i” + parapashtesën -inë-a, që në dialektin gegë e të folmet e Dukagjint shërben për të shprehur edhe zvogëlim, arë e vogël, ngastër toke, sepse në atë masë është ajo në malësi. Kjo do të ishte sekuenca e parë, e dyta shpreh psikën e banorëve për Fundinën, kurse në të tretën, sekuenca vë në dukje mënyrën e jetesës së banorëve, ndryshe, familjes së Nikës, djalit të madh Palit, i cili ish ba i zoti me ia ngjitë t'et krahun në punë. Stilemat shprehëse dalin me çifte e grupe më të gjera fjalësh, jo rrallë edhe antonimike, si: *dhe të kuq e gur të zez, brezni përtace, tokë rrabe, dhe i shituem rrefeje, shpirtna* të gjinisë femnore; edhe frazeologjizma a mënyra së thëni: *ia ka marrë dorën* (ia arrin të bëjë një punë); *kishin qitë fjalën* (kishin përhapur lajmin, mendimin, opinionin); *me ia ngjitë krahun* (me e ndihmue, me i dhanë një dorë).

(...Edhe në shekullin e kaluem, si sot e kësaj dite, thashethanat nuk ishin qenë të çrrajosuna prej gojës së gjindjes të këtyne viseve me lagje e shtëpi të kokërrueme brijash e luginash si të kishte qenë secila sosh dikur fare e hjedhun prej një grushti e ma vonë të ishin rritë të mëdha aq sa ishin. Shpërgojimet delnin e zhvilloheshin ndryshe prej atyne që mbijnë ndër vende të thukëta banesash ku gjindja shkon e vjen tue u ndeshë disa herë në dite dhe secili i shton thanjes një fjale ose një shej me sy e duer. E posaçme në këtë shpërndamje fjale ashtë se, tue i shtue secili ngjarjes diçka çka i bie ndërmend, e paqenuna bahet e qenun brenda njëzet e katër orëve. Përkundra, atje nalt, një motiv përgojimi tirret e merr trajta të qarta në rrethana vetmie ku një njeri i vetëm e peshon atë nga të gjitha anët, e tëhollon e kullon çdo gjase e mundësi se ngjarja paska lindë e qenka zhvillue kështu e kështu dhe mandej, si punë fare të kryeme, e len me ra si prej qiellit, copë akulli në vend të kokërrës së breshnit, as me qenë thashethana një kangë kreshnike e treqind vargjesh...) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 29)

Në fillim po sqarojmë kuptimet e lemave të mëposhtme, pasi ato do shfrytëzohen nga autori për qëllime stilistikore.

- të kokërrueme - të bëra si kokrra; këtu: të shpërndara, të rralla, vendosur në brija maresh e lugina lar njëra-tjetrës;

- thashetheme: fjalë, zakonisht të këqija a për gjëra të paqena, që pëshpëriten e përhapen për dikë a për diçka.

- përgojim: 1. Veprim sipas foljes. 2. kryes. sh. fjalët që thuhën për dikë a për diçka kur e përgojohet; thashetheme.

I takon ky pasazh etnografisë së të folurit, ku del në pah një karakteristikë psikologjike e banorëve të krahinës: gjindja merret me thashetheme, term që autori e shkruan në idomën e vendit të tij thashethana, është formim interesant, sepse leksema e parë del si kompozitë me përbërës në numrin njëjës (unë “thashë” e “them” në dy kohë foljore: e kryer e thjeshtë dhe e tashme), kurse kompozita e Camajt ka në përbërje në emra thashë-a + thanë-a (-t) në numrin shumës. Thashethanat dalin këtu në përshkrimin e tyre si ujërat e disa burimeve, derisa shtohen e rriten e bëhen lumë, me përgojime e shpërgojime, duke marrë pamjen e një cikli kangësh, si ai i kreshnikëve të eposit tonë. Kjo dukuri jepet me një leksik të veçantë e grupe fjalësh shprehje që vetëm autori di t’i përshkruajë: *secili i shton thanjes një fjalë ose një shej me sy e duer* (me anë të të folurit verbal dhe joverbal), *e paqenuna bahet e qenun, përgojimi tirret, e peshon e tëhollon dhe e kullon fjalën* ( me

anë të shkallëzimit të veprimit drejt intensives), *e len me ra si prej qielli*, cope akulli në vend dhe zmadhimi del aq i madh, sa bëhet këngë kreshnikësh me qindra vargje.

*(...Pa lindë dielli në asnjë maje mali, Lena doli prej kasolles së Fundinës; ende përgjumshëm mori udhën për në vërrin. Zbulimi i andjes për burrë natën që shkoi, i shleu Lenës në ndërgjegje edhe brengën shpirtnore e çdo dyshimi pabesie ndaj të shoqit. Rrugës përkundej në lëvizje të këndellshme të femnës së re e të pangishme, pa i ardhë turp prej vetes se si amë gjashtë fëmijësh, nuk i paska hije ajo punë...)*  
(“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 58).

Në fjalorin e Gazullit këtë lemë e gjejmë të përdorur në të folmen e M. së Madhe me trajtë foljore: E këndelli pija. Me kuptimin me dhanë të gjallë. Kurse Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1980 e 2006 e zgjeron kuptimësin e kësaj folje: 1. Si folje - marr fuqi e gjallëri, përtërihem. 2. Marr ngjyrë të kuqe në fytyrë, skuqem. 3. Kuptim figurativ: Më gëzohet zemra, kënaqem.

Është një skenë makthi e epshi bashkë: gruaja Lenë kërkon të afrojë në marrëdhënie të shoqin që rrallë e shikonte lakmueshëm, sepse po hidhte sytë ndër gra të hueja. Andja për burrë i jep rrugën për vërrin Lenës-amë me gjashtë fëmijë, por që ka të drejtën njerëzore të mos ketë turp që kërkon burrë! Stina duket se e ka këndellë dhe i ka zgjuar ndjesitë epshore drejt asaj pune! Nga një lexim, del se mbi fjalët e nënvizuara dhe grupet e tyre, qëndron shprehësia dhe gjetjet gjuhësore të autorit.

*(...Lexosha i shtrimë një roman të pakrypë, një nga ata të shumtit që përktheheshin në atë kohë prej gjuhëve të huaja, kur më thirri te dera Curri: “A je aty!” thirri e më pyeti përse nuk ia kisha mbajtur dikah. Mbet disi i premë sepse tue u kujtue se isha prishaqefas, dyshoi se nuk isha për ndoj vizitë të papritun. “Pashë tymin në pullaz”, tha, “se përndryshe nuk do të disha a je këtu apo ke dalë dikah.”...)*  
(“Djella”, në *Vëllimi 1*, Tiranë, 2010, f. 86).

Grupet e fjalëve, si sintagma të përbëra, formojnë ngjyresën e së folmes së krahinës së autorit: *roman pa krypë* - roman pa shije, pa vlerë; *ia mbaj dikah* - shkoj diku, në një vend të pacaktuar; *mbes i premë* - mbetëm pa vepruar për ndonjë shkak a veprim të pamenduar; *dal dikah* - nisem për diku. Fjala “prishaqefas” formohet me metatezën “prish+qef+as”, të kompozitës “qejf+prishur”.

*(...Djalit nuk i doli kohë me ndëgjue as shungullimën, as dridhjen e maleve: gjithçka, bashkë me Dakun treti nën tokë! Shembja e borës me dhé e lisa në faqen e malit zgjoi njerëz e shtazë prej jermi dimnor në mbarë Përteqafën: kushtrim i tmerrshëm! Mbas shtangimit të parë, pleqtë u betuen në gjithçka u erdhi në gojë, për tokë e qiell! Bane be tue nemë edhe veten: “Rrufeja na gjoftë! - thanë - n`e paçim ndëgjue tash shtatë brezni se një rrungajë si kjo ashtë shkoqë kurrë këtij dheu! ”...)* (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 256).

Jerm-i, këtu: letargjia e dimrit. Është një copëz jete e banorëve të malit, një pamje aq e vështirë jetese, në gji të dimrit e maleve të egra, e njerëzve që bartin mbi vete edhe egërsinë e natyrës së ashpër, që i gjuan me rrufe dhe ortiqe (rrungaja) të papara asnjëherë! Përshkrimi del me ngjyrimë e hollësi të imëta dhe përdorime leksikore të pasura, si: *shungullimë, shtangim, rrungajë*.

*(...Mbasi që nuk e ndërpreu kush, blesi fliste tue ndjekë rrjedhën e arsytimeve të veta, pa marrë parasysh se ai do të kish në synim që të pranishmit ta kuptonin: shllimet i delnin për goje në atë varg e në atë mënyrë si i shkoqiste kur ishte vetëm, në krye të vet. Po ajo që e vështirësoi ma tepër kuptimin qe se Nika i lente përgjysmë fjalitë, ngase pa e sosë njenën i shfaqej një tjetër shllim, mbas hamendjes së tij, ma i vërtet e i bindshëm që duhej shprehë pa vonesë. Pra, mendimi i pathanë plotësisht, shkelej prej tjetrit, kështu ndëgjuesi birrte fillin e arsytimit të blesit...)* (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 75).

Është ky pasazh i shkurtër i autorit një shllim i vërtetë mbi gjuhën, që shpreh mendimet varg e varg e qartë, kur ato dalin natyrshëm dhe të pjekura, por janë me ngecje kur zënë e mbulojnë njëri-tjetrin, ashtu siç i ndodh Nikës para shitësit, kur bjerr fillin e gjuhës e mendimit njëherësh. Shpjegimi vjen si filozofi e thjeshtë e gjuhës gjatë ligjërimit, që vazhdon edhe në fragmentin vijues.

*(... “ Kuvendi ynë - ia priti ajo - po merr vërtet drejtim loje të pahijshme, gja që kur kam hy këtu mbrendë nuk e pata parashikue. Mace e mi, po, por jo thikë e brisk. Edhe sikur të ishte e vërtet ajo që thoni ju - vijoi grueja tue u çue në kambë - nuk e kam pritë që një Gjon Gazull të thotë diçka që t`i skuqet fytyra nga turpi një femne, vetëm e vetëm për t`u mbrojtë ai vetë në një gjendje të pështjellueme ku ka ra për faj*

*të vet. Çuemja e kuvendit prej jush, jo prej meje, në zgripin e zgripit, më zhgënjën! Pendohem që e shkela sonte këtë bujtinë.”...*) (“Gjon Gazulli”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 322).

Është përshkrimi i një gjendjeje skandali midis humanistit dhe një gruaje, në çastin kur kuvendi ka rëshqitur në një lojë të pahijshme, ka shkuar atje ku shkatërrohet, *në zgrip të zgripit* (në buzë të greminës, në fund të një diçkaje); gjithë peshën stilistike e mbajnë dy proverba “*mace e mi*” (shkojnë si macja me miun) dhe “*thikë e brisk*” (shkojnë ndër veti si thikë e brisk), që vijnë si kundërvënie morale me këshillat e besimit “të duam njërit-tjetritin si veten”.

*(...Dha e mori për të sendërgjue një mënyrë që ta gjente, të fliste me te nën rrezet e diellit që mbas ditëve plot lagështinë shndëriti përsëri mbi qytet. Ajri i pastër dhe i acartë i fillimit të dimnit e gjallnoi; mori forcë vullneti për të flakue me dispjek planin që ta kërkojë gruen e huej me anë detektivësh të paguem me të cilët ishte mbushë Republika ndër ato kohë të turbullta. E frenoi përvoja e mirëfilltë e vetëdija se zelli i tepruem, si në jetën e përditës, ashtu edhe në çështje teorike - si përpjekja me zberthye përdhunë të vërteta shkencore - s`kanë qitë askend në dritë. Një hap i nxituem i tillë mund do të kish sjellë edhe turpin e madh që Gjon Gazulli në atë moshë të bahej gazi i dheut...)* (“Gjon Gazulli”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, fq. 334).

Dispjek-u, shkak, inat, zemërim (Mehmet Elezi, Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.) Fjalë tepër e rrallë, midis krijuesve tanë, me sa dimë ne.

Autori u jep jetë fjalëve dhe togjeve të ndryshme, që në hapësirën e Temalit përdoren dendur dhe në mënyrë krejt të natyrshme; për shembull, folja “sendërgjoj” - përveç kuptimit të vënë këtu, ka edhe ngarkesë përkeqësuese për dikë që endë lloj-lloj fjalësh e mendimesh të pabesueshme, të papranueshme; kështu edhe emri “sendërgjimi”, si emër prejfoljor, mban në semantikë shprehësinë e foljes (ky është sendërgjimi juaj, mos sendërgjo etj.); forcë për të flakue (force për të ndritur, për të ndriçuar); për të flakue me dispjek - për ta ndiçuar me zemërim e inat, për të nxjerrë të vërtetën, këtu; e frenoi përvoja - u mat ngase kishte përvojë; jetë e përditshme - jetë e përditshme; qes në dritë - pohoj të vërtetën, them të drejtën; dha e mori (jap e marr) - përpiqem, mundohem fort, mbaj a bëj marrëdhënie me dikë.

(...Filozofi që vinte prej anës së tjetër të Alpeve ishte një spjerrak burri, me koca të mëdhej. Ashtu i thatë e pa shumë qime në mjekër e faqe të zbardhemët, kishte pamje asketi që ushqehet vetëm me barishte e pemë. Ndonëse lëvizte ngadalë si mos me e pasë faren e fuqisë në kurm, prej syve të tij rrezatonin qindresë, vullnet dhe kryekreje egërsi që vente në roje se ai kundërshtarin e prishte pa pikën e dhimbës po qe se ai nuk i nënshtrohej...) (“Gjon Gazulli”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, fq. 297).

Janë karakterizime të thukëta të shoqëruesit të humanistit Gazulli: një filozofi të dobët nga shëndeti, qose, i zbardhemët, me pamje asketi (njeri që heq dorë nga gëzimet e jetës, bën jetë të vetmuar, të rëndë fizikisht, etj. Fjalor i gjuhës shqipe, 1984), me qindresë, vullnet dhe kryekreje agërsi, i aftë të shkatërrojë kundërshtarin - pa e thënë - duket si një veprimtar aktiv i inkuizicionit të asaj kohe! Leksemat “*spjerrak*”, “*i zbardhemët*”, “*kurm*”, “*asket*”, kompozita “*kryekreje*” janë ngjyrimet stilistike të së folmes së autorit, janë fjalë që mund të shkrihen lehtë në shkrimtarinë e krijuesve tanë.

(...“Çka nuk të kandet ty! - Brofi e tha Pali. - Por yjet me dhenat e hueja nuk përzihen!” “Edhe fort përzihen, edhe fort! - I kundërshtoi të birit. - Në moshen time ka me t`u kujtue: yjet e dhenat e hueja janë larg prej nesh e këput e mbaro!” Dhe shtoi se ai në rini nuk donte me ditë për gja tjetër pos për tokën ku jetonte, për yjet mbi Gurra e llojet e gurve si, për shembull, rreshpen. Rrasat e gurit rreshp, pos se duhen për të mbulue pullazet e shtëpive, ishin për Nikën të përshtatuna edhe me shkruar mbi to. Para se t`i kishe takue të prekte femën me dorë, sidomos në kohën e shiut në mal, me thepin e një guri të bardhë vizatonte mbi rreshpe lisa mbas lisash, varg, si kreshta malesh ose përmbrenda një rrumbullaku te vrangullt, mbas gjase të qiellit ku ai shihte, shkëndija mbas shkëndijash-yjet. Ma vonë, ajo grueja, tue pa se çka vizatonte, e kishte shpotitë Nikën; i kishte thanë se ai shkarraviste mbi gur si fëmijë. Për do kohë ia largoi atë ves. Shumë vjet ma vonë, pakujtueshëm, iu dha të vizatojë mbi siprinën e hinit në rrasën e votrës germa të mëdha, mësue prej qytetarëve që kalonin andej. I kujtohej ajo grueja dhe i shlyente që të mos i shihte kush...) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 36).

Fjala *rreshp* përveç kuptimeve: petë-petë (shkëmb guri), (rreshpe, -ja: shist, shkëmb petë-petë që thërrmohet lehtë), ka edhe kuptimin vend improduktiv (joprodhues), vend i ashpër jetese, ku nuk mbin e as rritet asgjë.



Po kështu duhet shkruar edhe për fjalët e tjera: vrangull, i vrangullt, rreshp, shpotit dhe fraz. "këput e mbaroi", që ndihmojnë autorin të krijojë skena aq të veçanta jo vetëm të ambientit ku jeton Nika, por edhe të japë gjendje psikike të dëshirave të tij të brendshme, hove mashkullore, kur ndodhet pranë femrës, e cila e sheh me habi çfarë vizaton ai nëpër rrasa e gurë të reshpeve të malit dhe e shpotit (e tall), si lastare e dashurisë së saj kalimtare.

Pasuria leksikore vihet re në përdorimin e mjaft leksemave dialektore, të cilat në ditët e sotme kanë dalë nga përdorimi. Si fjala: rreshp dhe ndajfolja vrangull, janë të pasqyruara në Fjalorin e Gazullit e ato normativë me të njëjtin kuptim, por nuk gjendet ndajfolja pakujtueshëm - vetëm mbiemri është pasqyruar; e cila mund të lidhet në valencë me disa folje. Ruan Nika kujtime të grues që e kishte "shpotitë" për vizatime në rrasa, duke ruajtur vetë gurët. Ky imazh shpirtëror dhe idilik i të riut Nikë, realizohet me mjete të leksikut të mësipërm.

*(... "Të pyeta për diçka - i ishte idhnue Pali - e ti i lakon kuvendit. Ti, si bari berresh, sillesh majesh e currash e sheh ma mirë se na çka po ndodh atje në Fundinë. Plakut duhet me i ndenjë gati, pse tue hy ndër shtigje ku s' duhet, na e bie sherrin te shtëpia! Gra janë ato, gra burrash dhe plaku..." "Mos e gzhat punën e tij!- Ia kishte pre Leka.- Se çka ban ai ndër Gurra, ashtë punë për të!"...)* ("Pishtarët e natës", në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 44).

Këtu, në këtë fragment të shkurtër, na tërheq sintagma verbale (SV) i lakon kuvendit, e cila lidhet kuptimisht me disa bashkime semantike të tilla, si: i bën lak bisedës, i dredhon kuvendit, i ikën kuvendit, i del fjalës, nuk e mban fjalën, i largohesh linjës së bisedës - argumentit. Lidhur me leksemën "gzhat" përdorur këtu dhe shpjeguar ashtu më lart, mund të zgjatemi, duke shtuar se në mjaft zona (hapësira) të së folmeve veriake, ka edhe kuptimin "acaro - mos e acaro, mbart, pra, kuptimin e foljes "gëzhit", "gërzhis" - thaj fort aq sa mund të thërmohet (Fjalor i shqipës i vitit 1984); këtu, ana figurative gjuhësore përfshin edhe kuptimin që të grimcohet, thërmohet në dorë, të pëlset në dorë, ndërsa bëhet fjalë për ndonjë bëmë jo të hijshme të personazhit! Folja *gzhat* është një fjalë dialektore e cila nuk gjendet e listëzuar në fjalorë, ajo është shfrytëzuar nga Camaj me kuptim të figurshëm: *mos me e ngacmuar një çështje*.

(...Të gjithë vëlleznit e Nikës i përngjanin shoqi-shoqit edhe ngase ata nuk kishin ndryshim të madh moshe. Vendësit e largët nga fiset tjera i ngatërronin dhe ua përzinin emnat. Kurse Nika i mbërrelshëm në shikim, ma i gjati, me *mise* të ashpra fytyre, mbas gjase ishte përpjekë të tanë jetën që të mos dukej si të vëlleznit; as emnat nuk ua zente në gojë dhe, kur i shihte për së largu gjithnjë dy a tre bashkë, as ai vetë nuk e kuptonte se çfarë dreqi e shtrëngonte me sjellë kryet në anën tjetër dhe, pa ngurrim, t'u lente hijen e të zhdukej, pa ra në sy, mbas cubash e krepash. *Vëllazen, po, por ata jetonin si me pasë një oqean mes tyne e Nikës...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 40).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980<sup>413</sup> gjejmë të pasqyruar trajtën mbiemërore: i mbërrolët - mbërrol-e, lat. *severus*, it. *severo*, ashtu edhe lemën *mis-i*, e cila, ndër 3 kuptimet e dhëna, njëri do të thotë “tipar”, tipar i fytyrës; Camaj e rigjallëron në përdorim këtë fjalë në njërin kumtim të saj, për të shfaqë një anë të portretit fizik të malësorit me emrin Nikë, që dallon prej vëllezërve pikërisht prej niseve të ashpra të fytyrës; fjala tjetër e nënvizuar si mbiemër, i takon të folmeve më veriore të vendit, më ndryshe, në arealin kosovar, ku shqiptohet i mbërrolët, fjalë bisedore për të shënuar një pamje të vranët të fytyrës, por edhe në kuptimin figurativ për motin: bën kohë e mbrrolët, është koha e mbrrolët - kohë me re, kohë e ngrysur etj. Gjithashtu vijon nxjerrja në pah e shprehësisë së stilit me shprehje si: *përziej emnat* (ngatërroj emrat), *i mbrrelshëm në shikim*, *me mise të ashpra fytyre*, *zinte në gojë*, *sjell kryet*, *t'u lente hijen* (të largohej prej tyre). Fjalja e fundit jep një dezaj për marrëdhëniet midis Nikës, vëllait të madh, me të tjerët, më të rinj: si me pasë një oqean mes tyne.

(...Kola fjalëmbarë e i kuptueshëm, don me thanë, prore gati për t'u bindë e pranue çdo pikëpamje të huej e cila s'i sillte atij dam, e quante Nikën *arnyell* i vetmuem mes *ashtës*, pa arnej tjerë pranë. Me këtë përfytyrim, të afërt me atë të kangëve kreshnike, donte *me përlëvdue* Nikën, dhe njëkohësisht veten e të vllëznit, kinse qenkan ata gjithëmbarë burra me cilësi të zgjedhuna trupore, si arnej ma! e se mund t'u falej ndonje e metë, si *idhnia* e gjaku i nxehtë. Kola ishte edhe tinzar dhe i kandej te mburrej *tue qitë fjalën* e mirë për vete, larg e larg, *si shkëndijë në terr*. Po qe se ndokush i lypte shpjegim për shprehje të tilla të errëta, ai qiste *shembllesa* edhe ma të paqarta dhe *heshtonte*. Ky shumë kishte mësue nga pleqtë e moshuem

413 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 255.

*të tjera kohnave ndër mbledhje fisi, por disa veçori qendrimi e shprehjesh i kishte zhvillue vetiu, tue mbajtë një vesh hapët edhe kah dhelpnia lindore në marrëdhanye me nëpunës e qytetarë kur shkonte për shteg në Shkodër...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 42).

Leksemën arnyell e gjejmë të pasqyruar tek Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 me kuptimin: arne, molikë, por tek Camaj ajo ka fituar ngjyrim stilistikor, pasi fjala është përdorur në kuptimin e veçantisë së vendit të përshkruar midis *ashtës* (ahishtës) - shpat, bri, pyll me aha - pa pasur *arnej*, modele, shembuj midis të tjerëve nga vëllezërit apo nga fisi. Kështu dalin me vlerë të veçantë shprehësie edhe leksema të tilla, si: *me përlëvdue*, *idhni-a*, *shemblesha* (shembuj, modele), *dhelpni* (dinakëri), *heshtonte* (heshte, s’fliste); më tej edhe sintagmat: *prore gati*, *tue qitë fjalën*.

*(...Por ishte edhe e vërtet se Kola, burrë i peshuem në fjalë e në sheje, dinte të largonte çdo rrezik plangut e familjes. Për këtë, Nika kryekëcyem bante mirë të veçohej për të mos pasë raste të ngatërrohej me botë dhe të sillte anmiqësi deri në gjakderdhje në vllazni. Kola i cili përkujdesej që dikush prej të rinjve t’ia zinte vendin ndër mbledhje fisi, ia kishte vu synin Lekës, djalit të ndërmjemë të Nikës. Ky edhe Mitri, i katërti djalë i të vëllatë të veçuem ndër Gurra, kishin duken e malësorëve të vjeter dhe ecnin tue u përkundë si ata. Mitri përkujdesej për gjedhet e mëdha, kurse Leka ndiqte kambë për kambë majeve të bjeshkëve berret e imëta, dhe mbas muzgut, vonë, kthente në plang. Heshtonte gjithnjë pranë votrës si me pasë pengesa përpara, vetëm me një vesh kah kuvendi i vëllezënëvet. Shikon larg, me krye mbi tjerë, e shpotiste Pali, si me dashë mos me humbë sysh bagëtinë në kullotje. Fliste bindshëm dhe e përmbyllte kuvendin, tue mos lanë shteg që të mos bahej ashtu si e caktonte ai...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 42-43).

Përveç fjalëve “plang”, “berr”, “shpotis”, që janë mjaft të dendura në shkrimtarinë e Martin Camajt, sidomos në prozën e tij artistike, na bien në sy dhe krijojnë përshtypje për pasurinë e leksikut të Camajt edhe bashkime të tjera sintagmatike, të cilat përtakojnë me stilin e autorit tonë, si: *burrë i peshuem në fjalë e në sheje* (burrë që i peshonte fjala e sheji), *ngatërrohej me botë* (zihej me njerëz), *duka e malësorëve* (pamja e malësorëve), *me një vesh nga kuvendi* (me gjysëm vëmendjeje nga bisedat), *fliste bindshëm* (fliste i bindur, por edhe që të bindte), *përmbyll kuvendin* (përfundoj, e kryej bisedimin për të mos

e vazhduar më gjatë), *nuk lë shteg* (nuk lë mundësi që të bëhet diçka).

*(...Kjo ashtë një pikëpamje fort njerëzore, bujare në thelb, por jo argument. - U acarue mjeshtri, por e mori shpejt veten. Kërkoi me sy në terr fytyrën e humanistit për të gjurmue se çfarë përshtypje do t'i lenin fjalët që ish tue ia thanë: - Mos e merrni si cinizëm, ju lutem, këtë që po ju rrëfej, pothuej, si fajtor atit të vet shpirtnor. Po ju jap një këshillë: po qe se vjen dita që ju transalpinet mbarë të gaboni randë, tue iu shmangë rrugës së vërtetë...mësimi zyrtar, ju keni vetëm një rrugëdalje të shpëtoni, t'ia leni fajin e gjuhës suej, njohjes së përciptë të latinishtes. Andaj, po qe se e keni qitë cekën që për qëllimet tueja të caktueme ta shpallni veten heretikë, ia delni fort lehtë: shtini në punë gjuhën amëtare në shkoqitjen e idesë!...) ("Gjon Gazulli", në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 300).*

Qes cekën - vendos të bëj diçka, kam ndër mend të bëj diçka (Fjalor i gjuhës shqipe, 1984). Është një copëz diskutimi mbi çështje filozofike e teologjike, në fund të së cilës dijetari Gazulli mëson se duhej shtirë në punë gjuha amtare në zhdrivillimin e ideve, koncepteve dhe nocioneve abstrakte: ishte koha kur, mbi latinishten vulgare, po ngriheshin gjuhët popullore neolatine.

*(...Mbas rëmimeve të shumta, u bind se nga ligështia paska ngurrue të shlirohet përfytyrimin të saj. Kjo kishte ndikue të luhatej besojma në vetvete dhe në gjithçka kishte krijuar deri atë ditë. Nuk i kishte ma hije as fjala, as shkrimi mbi sistemin mendor të vet. Dukja e saj, si në vegim, herë tejet e bukur, herë shtiratëse, e lazdrueshme e tallëse që papritmas vrahej prej peshës së mendimit, ia preu Gjonit çdo vrull; ia hangri orën e autoritetin prej humanistit, qetë njerezish - punë e madhe - që mbaheshin po në këtë kohë si gjysmë - zotash, ma tepër se poetët e prijësit e ushtrive, si kurrë send! Edhe metoda gjurmuese që Gazulli e ruente si fshehtësi të rrallë, s'ia mbushi ma synin...)* ("Gjon Gazulli", në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 328).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 e 2006 kemi të listëzuar këto lema: shtiracak, shtirak, shtilan shtijak, shtirenacak. Ndërsa fjala "rënim-i" nuk gjendet në këtë formë në Fjalorët e shqipes, vetëm "rëmoj", midis kuptimeve të së cilës gjendet edhe "përpiqem të gjej diçka të fshehtë"; trajta pa geminacion "rëmoj" mund të përdoret për shprehësi në kontekste të ndryshme, siç është ky pasazh nga jeta e humanistit Gazulli,

i cili rëmon gjithë jetën mbi libra e shkrime të lashta, në kërkim të dijeve të thella, po kështu, përshtypje stili të edhe ndërtimi të shlirohet përfytyrimit të saj, në vend të “të çlirohet nga përfytyrimi i saj”, pa besuar se mund të jetë ndikim i serbishtes mbi idiomën e Camajt! Fjalën - si term bibliik “besojmë-a” autori e lidh me aksiomat matematike e fizike të shkencëtarit humanist shqiptar Gjon Gazulli, i cili vjen përherë në kërkime të reja gjatë rëmimeve të tija. Nuk gjendet në Fjalorët tanë lema “i /e lazdrueshëm-e” (“i lazdruar”, f. 596) dhe Camaj, me anë mjetesh leksikore jep gjendjen psikike të filozofit të madh shqiptar se, sa më tepër plakej, aq më shumë dyshon nëse ka arritur tek e vërteta.

*(...Më tha një arben vllaznisht, pa më njohtë: / “Gurt, eshtnat e dheut, kudo i kam kapë / Ndër duer e m’lanë përshtypje të ftohtë / Si prekja e gjarpnit kulaç në vapë, / Por guri i caranit n’votër tim et / Qe prore i nxehtë.”...)* (“Tregimi i Arbnit”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 67).

Ka edhe disa poezi Camaj, me temë atdhedashurinë, siç vjen kjo më lart. Duket se është kontakti i parë i autorit me vëllezërit arbëreshë, ku ai bëri shpesh eksplorime gjuhësore e etnokulturore; del në pah ai gur i caranit ( i vatrës), i paharruar asnjëherë për njeriun, se është guri atëror, që rri prore i nxehtë. Ndërtohet pasazhi me një fjali të autorit dhe pjesa tjetër është ndërgjegjja e zhuritur e arbërit që s’harron kurrë.

*(...Verën që shkoi shfletsova re t’bilurta / dhe faqet e tyne m’u shprishën ndër duer. / Tash nsa zotat ulen n’lumej për ujë, / nalt prej kodrave çohen balona t’larme...)* (“Kthimi i vjeshtës”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 128).

Një tablo me pamje romantike nga retë tek kodrat, nga lumi te balonat lart; duket sikur poeti shkruan mbi re që i shprishen në duar, ka ngjyra politeiste tek fjala “zotat”, janë idhujt e të parëve tanë të largët ilirë e më thellë në histori; ndërsa fjala “balona” zbret në fëmijërinë e heroit poetik. Vazhdimi, i papërfshirë këtu në këtë pasazh, ngrihet mbi një imazh kujtimi të pëflakët që jeton tek autori përjetësisht (e vetmja flakë e vojturtë që jeton n’ mue).

\* \* \*

*“Poezia e Camajt mbështetet fort mbi figurën gjuhësore, mbi frazeologjinë dhe idiomatikën popullore dhe mbi të gjitha mbi një fond leksikor të paranjësuar.”<sup>414</sup>*

Vështrimi stilistikor dhe *i shprehësisë së poetikës* së Camajt paraqet interes edhe për faktin se krijimi i poetit në këtë zhanër është bërë më tepër se para gjysmë shekulli, kështu që na shërben edhe për të njohur sistemin e mjeteve artistike të vjershërimit të kohës së tij, mjetet figurative e organizimin gjuhësor në shumë nivele të vargjeve camiane, sidomos sa i takon sintaksës poetike; por, nga ana tjetër, ky vështrim na vlen edhe për të njohur lidhjet e shkrimtarit-poet me idiomën popullore të vendlindjes e krahinës ku lindi dhe jetoi, në ç’masë i shërbyen ato në krijimin e poezisë dhe pasqyrimin e tablove të jetës në fëmijërinë e tij të vorfën.

*(...Pava npër qiellin e vrrinit dikúr / tue kalue shum rê / dhe lumejt e turbullt tue bajtun / gur e landë / Tue hy në t’shtatën vjetë / ujkun e pava n’ikje me bisht ndër kambë / e me veshë të çuem currek përpjetë. / Shkova me njerzit e mij / shtigjeve të ngushta t’malit / e pata û e èt. / Ndigjova ortiqet e bubullimën e motit / e fjalën ‘mos u tremb!’ tim èt...)* (“Tingujt e parë”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 13).

Vërri-a, Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 shpjegon: f.sh.—(të) vend i ulët e i ngrohtë që nuk e zë era, kullotë dimërore në vise të ngrohta; dimërishtë; emër ambigjen: vërri-ri (ni), ushqim i thatë, bar, jonxhë, kashtë për dimërimin e bagëtisë. Në variantin gegë, më së shumti, përdoret në gjininë mashkullore.

Është një vizion, si një pikturë natyre, që i ka mbetur në kujtesë e shpirt poetit nga mbresat e fëmijërisë: qiell me re sipër vrrinit, lumenj të egërsuar me valë që bartin lëndë sipër tyre, një ujk i uritur trembshëm, shtigje malesh me ortiqe e bubullimë moti - përballë kësaj tabloje të frikshme për një shtatëvjeçar - fjala që jep zemër e të jatit “mos u tremb!”. Gjithë peshën semantike autori e shpërndan si peshë nëpër disa kolona fjalësh, që janë:

*vrrri, re, lumej të tuerbullt, ujk me veshë currek, shtigje t’ngushta mali* (jeta e vështirë e malësorëve temalas), *me û e èt*, ( i uritur dhe i etur bri lumenjve).

Është një pasqyrë besnike, dhënë me pak fjalë e penelata si ngjyra peizazhi, mjete

414 Sh. Sinani, *Çështje të stilit në ligjërimin e Martin Camajt*, Studime filologjike, 1-2, Tiranë, 2007, f.30.

që i ka vetëm poezia dhe mjeshtëria e poetit të ri, pak më tepër se 25 vjeçar, Martin Camaj. Fjala “vërrini” e vargut të parë lidhet me jetën baritore, me fëmijërinë e vetë poetit, që duhet të ketë çuar një pjesë të viteve si bari nëpër mal e vërrin.

*(...Shkyenje qiellin, zurla, / e kaltërsija e sferave të nalta / le të bijë mbi ne si shi. / Kamba e tupani çajne tokën e me duer / virkllojmë na shpatate me duer sutat / në mal i kapim në pikë të vrapit...)* (“Valle Rrugove”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 24).

Ja dhe vazhdimi i tablosë më sipër, po kësaj radhe, jo e zyrtë dhe e frikshme, e mjeruar, por si antitezë e natyrës të së pares, gjë që na del nga termat e përdorur si stilema, me një atmosferë kaltërsie, që s’pyet për shi, me curle, topane e valle ku vringëllohen shpatat e vrapohet sa me zanë sutat (drenushat) në pike të vrapit. Folja “shkyenje” (shqyejeni) në urdhërore e pas saj, forma e lidhore - si urdhërore e zbutur - japin një gjendje ekstaze shpirtërore të një gëzimi njerëzor në gji të natyrës, mbështetur edhe në metaforat e qëlluara: “shkyenje qiellin”, “çajne token”, “vringëllojmë shpatat” dhe idioma “në pikë të vrapit”.

*(...Nën gazin e hanës / hijen e rremzit të pishës / ke pasë në ballë: / ajo nuk ishte hije turbulluese / në shpirtin tand të thjeshtë si era / që fryn vetëm në një drejtim. / Atëherë mbylla sytë e mbeta / në gjinin e errtë të drojes / pse ti je rrezja e diellit lojce / që puth gjethin / e vjeshtës së vonë një orë...)* (“Nën gazin e hanës”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 136).

Është një njisim i njeriut (femrës) me natyrën: me një rrembëz (degë) pishë në ballë, që të shtang, që s’mund ta shohësh nga droja (frika), nuk mund ta vështrosh gjatë, sepse është lodruese, joshëse kur puth gjethin, po që të ndal guximin, pasi vjen turbulluese për djalin që tërhiqet nga ajo bukuri femërore; peshën kuptimore dhe stilistike e mbajnë leskemat: *gaz, hije, ballë, turbulluese, shpirt, erë, sy, drojë, rreze, lojce, puth, vjeshtë - stinë* kur edhe mund të korret dashuria!

*(...Sytë nën vetullat e zeza / janë dy pusa të harruem / pse bota trimnit e heshtes së tij adhuron: / jo Dulçinenë në fundin e syve të tij! / Kalorsi në malbrezat e largët / e ngul shikimin, atje, / atje me e mbrrijtë...)* (“Kalorsi me fëtyrë të trishtë”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 115).

Është vijim i portretizimit të një kreshniku kalorës, që trimëritë i lë në heshtje, dhe për këtë bota e adhuron; nuk duket Dylqinja e Servantesit në sytë e tij, por shikimi për të ardhmen (në malbrezat e largët) e veprave që e presin. Formojnë stilema të goditura sintagmat “trimnit e heshtjes”, “pusa të harruem”, “fund i syve”, “ngul shikimin”, që e shtojnë shprehësinë e pasazhit të zgjedhur.

*(...Dy zemra bashkë janë ma rrufeprojsë / se dy shpata tu për tu / me teha përjashta. / Ideja e sosjes, Lule, / kur je ti pranë ik si shpend i egër / andej kah vjen terri...)*  
(“Koha e lules”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 121).

Është pjesa e ciklit “Koha e lules”, prej të cilit kemi shkëputur disa pasazhe; nis me simbole këtu: përfaqësuar me fjalët “vdekje” - “lule” (njëra simbol i humbjes, tjetra simbol i jetës. Poeti thërret për zemra të bashkuara që bëhen rrufembrojtëse, sinonim me rrufepritëse; ku është lulja - s’ka vdekje, as sosje (mbarim), ajo ikën kur ajo është pranë, ikën si shpend i egër andej nga errësira (terri). Fragmenti ngrihet mbi dy krahasime në vargun II dhe në vargun V.

*(...Kaun e vranë te shtegu. / Qershiat nga pema ranë / për nën hije ke shtegu. / Dielli asht i fortë e xhingallat / bërtasin ndër trungjet e qarrave: / “Kushtrim, kushtrim, kushtrim!” / Rrezet po zbardhen mbi rrasa / e gjedhet e larme byrlyken / tmerrshëm livadheve, / secila me një kumbonë në qafë, / secila me një frigë në sy...)* (“Për kaun e mbytnun në kohë të ujës”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 163).

Sido që të jetë zija e bukës, ndër malësi, kau nuk vritet, se duhet për arën vitin tjetër, por zija kishte qenë aq e madhe, sa njeriu, për bukë, e vret shpresën e fundit dhe pendohet për dëmin (“krimin”) që i sjell familjes. Kaq e madhe është dhimbja, sa menjëherë vjen betimi “Mish kau nuk ha simjet/ pse krahu m’u thye ndër ara”! Thirrjet e poetit “Kushtrim, kushtrim” vijnë si jehonë vdekjeje për një njeri dhe njeri është kau që lëron e mbjell arën! Me qershitë, diellin e fortë dhe xhingallat që vajtojnë në trungje qarrash (dru lisi të mëdhenj) jepet tabloja e dhimbshme e të zotit të familjes që vret një kafshë aq të çmuar sa kau i arës!

*(...Erdh kadalë si flanaxë / Te kapuliçi i kashtës / kur preku agimi malin. / Më prekte ajo me parzëm / kur më kalonte mbas shpine / pranë votrës së t’et...)* (“Bletët”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 168).



Është historia e një dashurie të porealizuar, historia e një burri që s'ka dashuruar kurrë dhe tashmë, kur e ka humbur atë përjetë, këndon melodinë që u drejtohet bletëve, kur lëshojë (dalin për te zgjoi i ri): “Priju-ma bijave, prift-u mbarë/ priju- ma bijavet!”. Me gojën e këtij të çmenduri poeti rindërton ngjarjen: takimet te kapa e sanës, bisedën me të jatin e çikës, zhdukjen enigmatike të saj! Camaj operon me simbole: zgjua-i - shtëpija, familja që nuk u hap kurrë e këtij çifti; blea e vjetër- vajza që nuk iu gjegj asnjëherë dashurisë së këtij djali që nuk ndien më vera, se çika u bë flutur (fluturoi pa e parë se ku). Ishte i çmenduri i fisit, që vijon melodinë e thirrjes së bletëve për në zgjua! Është dashuria e ndaluar për shkak të “moralit”.

*(...Për nën Fezë në shkamb / asht një grykë e madhe: / i thonë Shpella e Vetmitarit, / e vetmitarit të vramë. / Qe, si ndodhi puna! / Në mote t'largu u ndëgjue një za, / një pigrimë mbi Fezën me borë. / Thirrte Lum Brimzi: / “O grue, a po e ndien? / Nji zjarrm të madh me u ndezë / shulla e urë m'urë / se po vij me një mik!” ...)* (“Vrasja e vetmitarit”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 175).

Zhvillohet një ngjarje e rëndë gjaku, që i ka dhënë emrin edhe Shpellës së Vetmitarit; nis me një ambient mali e një mikpritje malësori prej një burri me emrin Lum Brimzi, që përbuen një lypës gjaku (një njeri që do të marrë hak, do të vrasë!). Autori i ka dhënë semantikë emrit dhe mbiemrit të tij: Lum (i lumi, i gëzuari, i lumturi) Brimzi (ai që lëshon britma, thërret me të madhe) për një të vërtetë të përjetshme: ai që ka vlarë, është i vlarë për jetë, s'ka çfarë e do jetën; shtegtari e mori gjakun të nesërmen, por edhe ai ngeli me zemër të zbrazët, si Shpella nën Fezë.

*(...Vjollca që nis me çelë / i ka fletzat e njoma e të zbardhemta. / Ashtu dhe buza jote e mëngjestë...)* (“Koha e lules”, Pjesa V e ciklit, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 124).

Krahasimi është i pazakontë, i gjetur poetikisht, që nga përcaktori nga të folmet geqe “të zbardhemta”, një poetizim i fjalës nga mbiemri “i bardhë”, një ngjyrim gjuhësor e stilematik; kurse sintagma emërrore (SN) “buza e mëngjestë” është krijim i Camajt, një mbiemërzim i emrit “mëngjes” kaq i goditur, që e ngre krahasimin në cilësi të lartë: buza e vajzës në një mëngjes vjen si lulevjollca që nis e çel gonxhe.

Poezia e mëposhtme nis me një klishe vargu popullor “Fryni era përmbas qafe/ ndër taraba” dhe i kushtohet një këngëtari të verbër me emrin “Beka”, ndoshta ka qenë gjamtar, autori s’e thotë, por gjatë vargjeve del se kur dëgjon atë tue këndue “thue se ndëgjon zogun e malit”. Fragmenti që kemi shkëputur është një tablo e thurur me kontraste ngjyrash e fjalë vendi, si: “sanë-a”, “karpë-a”, “krand-i”, “rryell-i”, “i malluem/i mallëngjyer, përmalluar”, të cilat dalin si vizatime të bukura stinësh, nga dimni që ulet (personifikim a shpirtëzim i emrit), krاند bul-madh, tretshin erën (përcillnin), deri tek pranvera me diellin që e ban bulën gjeth - para njerëzve që shikojnë gjithë mall për verën e shumëpritur atje, midis lisave të zhveshur, pranë të cilëve lari, rryelli e dëllinja dalin si flamuj të një ushtrie dimri, apo me krahasimin aq të goditur “si nuse ndër plaka”. Ka një ekonomi gjuhe, që rrallë gjendet në letërsinë tonë. Natyrshëm, duhet këndue deri në fund ashtu si duhet ndëgjue deri në fund dhe kënga e Bekës së verbër, që jehon në Bjeshkët e Nemuna e zanin ia marrin shpatijet!

*(Lari, rryelli dru-mirë / dhe dullija e blerë / tretshin erën nepër shkurre, / ndër shkurre e lisa të thatë / - sy të malluem për verë. / Lari, rryelli e dullija / mjedis lisave të zhveshun / flamuj mes ushtrie / - si nuse ndër plaka...)* (“Beka i verbët”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 198).

*(...Trupin te ura e vatrës / ia ruejshin dy miq të vjetër / dhe flitshin për te: / “Pat le ndër tbana, në verë, /mjesnatë, kur lurojshin ujqit!” / “Si ujk ishte edhe ky, / u suell maleve gjithnji / pa prekë punë me dorë” . / “Ishte trim i rrebtë!” / “Pse s’e vrave atëherë / kur i dole në pritë?” / “E kisha pushkën ngrehë / dhe e prita të avyret: / afër ishte sa një lis... / nuk e vrava pse m’u dhimb!” / “I pastë ba shpirti dritë!”..)* (“Guri i shpirtit”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 211).

Është poezi, kushtuar një bestytanie, sipas së cilës njeriun, sa vdes, e çmojnë të gjallët për veprat e mira; e ai ndërroi jetë një natë dimri ku ndrit vetëm bora në mal prej hënës që hyn e del prej mbas reve, gjetka një rrasë të bardhë me dy vrima përmjedis, e cila duhej varë në lis, pa qitë fjalë goje, se ashtu do të pushojë edhe shpirti endacak në atë gur! Që në vargun e parë të poezisë, autori hyn në marrëdhënie me lexuesin: “Mendo një natë dimni...”, që ta bëjë tekstin të hapur me marrësin. Te ura/una e vatrës, aty ku dhe vdiq, ia ruajnë trupin dy miq të vjetër: ai nuk ka as bir, as bijë, sepse nuk krijoi kurrë familje, veçse ishte trim dhe, sipas zakoneve, trimi i rreptë edhe duhej vrarë, por ishte sa një lis

dhe arma e ngrehur, nuk shtiu mbi të... një jetë endacaku që mbyllet me urimin fetar “I pastë ba shpirti dritë!”, megjithëse shkoi pa asnjë veprë të mirë! Dialogu i dy miqve që do ta varrosin të nesërmën, është jeta e këtij njeriu me fytyrë të zbehtë, me fytyrë të hajme e duert në parzëm! Është gur në shpirt jeta pa një vepër në të mirë të njerëzve!

*“...Unë flas n’emën të kryesisë, / n’emën t’alemit e polemit. / Kur të ngrehni rretat me peshk, / mos fshâni mundimshëm: / këndonni hymnat e zotave! / Kur ta qitni peshkun në breg, / çojeni te ajo flakë / e digjni në nderë të hyjnive: / ama e njalave të pjekuna / të përndahet brigjeve / në shej pasje e plotnive”...* (“Flaka e Zotave”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 214).

Ngjan me një motiv migjenian, por nuk ka ngjyresën dhe forcën e ateizmit të Poetit të Rinisë; ngjan gjithashtu me një fragment biblik të Dhjatës së Re, që ka në thelb kënaqjen dhe falënderimin e njeriut ndaj dhuratës së Perëndisë për të menduar përherë begatinë dhe plotësinë! Aq më tepër që ana stilistike këtu del në pah nga kombinimi i trajtave foljore në urdhërore/dëftore e lidhore; këtu emri “amë-a”, nuk lidhet me amësinë - si burim jete (Kujtojmë vargun e njohur të Mjedës “...dhe vështro ku i del burimit ama...”, por fjala mbart kuptimin “erë, duhmë, shije” - që janë leksema të së folmes veriperëndimore të Gegërishtes, për shembull: gjella ka amë peshku, amë mishi shpendi/berri/bagëtie eëjt. Duket sikur flet Hyjnia, me këshilla të prera: mos fshani, këndonni, çojeni, digjni, të përndahet! Edhe fjala fshaj-ni - merr kuptimin dënes, ofshaj, qaj me dënesë!

*(...Dy gjana print m’thanë kur ishin gjallë: / Po qe se shkel ti bukën gand, / Çoje prej dheut, puthë vene në ballë! / Ndëgjo, ti djal, pse na jemi pleq. / Kur t’rrijsh te votra mbështet tue pi duhan, / Mos pështyj në zjarm, mos pështyj në dritë, pse a keq!..)* (“Dy gjana print m’thanë kur ishin gjallë”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f.229).

Nga këshilla morale, respektin e thellë për bukën (që mban shpirtrat njerëzore), e që na kujton lutjen e përjetshme “Bukën tonë të përditshme, falna sot”, është kulti i adhurimit për diçka jetike, që ka qenë e pakët, është prodhuar aq pak në të paktat toka në gji të maleve; kalohet pastaj në bestytini, për të mos blasfemuar me kultin e zjarrit e të dritës, tek malësorët epikë, sipas të cilëve zjarri në vatër e drita në odë s’duhen fikur; kështu, ka ekzistuar para shumë viteve zakoni që zjarri nuk duhej lypur në kojshi; këndeje rrjedhin edhe mallkimet “t’u shkimtë drita, mori Hanë, t’u shkimtë drita, more Diell; t’u shoftë zjarri në votër” etj.

(...Ndodhi dikur, or burr, ke na nji store / Kur brin e that mbi shpija e mblonte lisi, / Kur ishte humnerja atje vetëm tërthore, / Ndoshta tri shpia sall na kishte fisi. / Binte n' male bora, male biluri / E qiella e naltë e thimt si leshi i derrit. / Druni i dullis në shpellë u ndezte nuri / Para dy vllazne, vesh' në lkura berrit...) ("Sytë e gjarpnit", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 246).

Nur-i, m. (ar. nūr - dritë; tur. nur)

1. shprehje e fytyrës, fytyra, duka;
2. hijeshi, bukuri, hir;
3. pamja e jashtme; hije, shkëlqim, dritë.

Store-ja, histori, kallëzim, rrëfenjë; fjalë bisedore, që shkon në harmoni edhe me sintagmën parafjalore "ke na/ne" - me kokën një parafjalë dialektore të idiomës vendëse.

Është një tablo tipike e jetës baritore në Malësitë e Veriut, që Camaj e njuh, e ndien dhe e vizaton aq bukur; pra s'ka rrëfim në kuptimin e stores, por një pikturë dimri, bërë me ngjyrat që jep vetë stina e egër që mbështjell banorët e maleve, ku brinë (shpatin e kodrës) e thatë e mbëlonte lisi, me humnerë e tërthore (rrethinë fshati a rrugë me dredha), vetëm 3 shtëpi të veçuara midis egërsisë së natyrës, mali i bardh si biluri me bore të ngrirë dhe qiella e naltë me re të thinjura, që paralajmëron përsëri mot të lig; ndërsa në shpellën-shtëpi ndriçon driri i dullisë si nur, kur digjet në oxhak para dy vëllezërve që mbijetojnë brenda banesës së tyre, të veshur me lëkura berri (dash/dele).

\* \* \*

Në krijimtarinë letrare të Camajt kemi venë re përdorimin e një numri të kufizuar fjalësh të huaja, të cilat autori i futur në ligjërimin e tij për të pasqyruar atmosferën e kohës e për të arritur shprehësinë e duhur.

(..."-Ti kalove natën në shtëpinë e Vitoit? Thuej se fjete me atë në shtëpinë e tij!"  
Mara kishte dy sy të mëdhenj, sa dy shpella në shkamb në faqet e rrudhuna. Me ata sy e këqyrte vajzën idhnueshëm e mënishëm, fare e zhgënjuese. "Përse më shikon ashtu? Çka të bana? E pyeti Ntonia. "Si të më kishe vjedhë petkun e jetës, ashtu më dukesh ti mue!" "Mos ke pritë që askush të mos bajë dashuri në katin e fundit të shtëpisë sime? As unë, jo?" "Pëllasi ashtë yti, ti je e zoja e tij...por shurbisja e tend atë me mue nuk ashtë si skapatat tua: unë s`doja e ai për një natë me shpori kurm

*e shpirt. Na ishim ma mirë se burrë e grue, të tanë jetën!”...)* (“ Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f.147).

Sapare (-to), italianizëm me kuptimin “i ikur, i larguar, i zhdukur” - sjellë me qëllim nga autori për të dhënë të vërtetën gjuhësore se në hapësirat arbëreshe, prej shekujsh janë përdorur e po përdoren shumë fjalë e mënyra të thëni italishte, në kushtet e gjata të diglozisë.

Është një lidhje, një marrëdhënie dashurore e fshehtë midis dy njerëzve: Ntonia dhe Vitoit, që jepet me një shkallëzim stilistik: kalove natën, fjetë me të; më tej, me stilema të dukshme “më vodhe petkun e jetës” (rrobën që vishet gjatë gjithë jetës: dashurinë , që jepet edhe me lidhjen si valence leksikore “kurm-shpirt” (trup-shpirt), siç janë të lidhura këto dy koncepte edhe në dashuri. Termi “kurm-i” ndeshet shumë dendur sidomos në këngët e dashurisë, në vend të sinonimit “trup-i”; vjen edhe me kuptimin e diçkaje që shijohet (një kurm peshk, për shembull).

*(...Prej kësaj salle po me bie në vesh vetëm ushtima para Pyrgut të Babelës. - Vërejtji humanisti ynë. - Grishje madhështore në tryezën e shtrueme me të gjitha të mirat shpirtnore, prej filozofisë e teologjisë e deri te dijet profane. - Heshti, në pritje që ndokush nga kolegët ta vijonte mendimin e tij. Mandej vijoi: - Burra të gjitha moshash, ndoshta ndër ta edhe ndonjë koleg prej Bizantit ose Toledos... mbarë dashamirë të dijes e të mendimit gjurmues ndër kartat e harrueme, ardhë të gjithë, të ditun dhe kandidatë për shkencë, rishtarë vullnet-flakët, prej katër caqevet themelore, miq të Republikës dhe...të kësaj alma mater, te Universitetit Patavian, si vëllezën e bij tanë! Andaj edhe kjo një nderë e madhe për ne, kolegjumin tonë që, njézani, korp i vetëm, u thotë atyne: mirëse vini, të grishun e të pagrishun, njëheri!” Gjon Gazulli u ndal dhe përsëri shikoi rrethazi dhe mbeti me sy te ngulun në dekanin e fakultetit, në ma të vjetrin, i cili e kapi aty kuvendin ku e la humanisti ynë...)* (“Gjon Gazulli”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, fq. 330).

Është një fragment ligjërimit i humansitetit tonë të madh, me famë europiane, Gjon Gazulli, i cili, vetëm me një fjali (nënvizimi ynë), arrin të japë idenë se sa të shumtë ishin pjesëmarrësit e një tubimi shkencor filozofik, aq sa, me gjuhët e tyre të ndryshme, krijojnë një “Pyrg të Babelit”, me teologë e filozofë nga Bizanti (Lindje) deri në Toledo (Spanjë-perëndim). Camaj e quan Universitetin Patavian (Padovian) *alma mater*, nënë

ushqyese e dijeve më të mëdha të kohës nga ato më të vëshirat deri tek ato profane. Mendimi i thellë e shkencor nis nga kartat e harrueme të lashtësisë, që presin të merren në dorë prej kandidatëve për shkencë, rishtarëve me vullnet të flaktë dijeje, apo miq të Republikës...Bie në sy çifti sinonimik si karakterizim për kolegjiun shkencor patavian “ njëzani - korp i vetëm”, çka do të thotë se komuniteti i dijetarëve vepronte si një trup i vetëm; lexuesi, gjithashtu, me anë të leksikut të veçantë, karakterizues të humanistit tonë, si: *Pyrg Babeli, grishje, të mira shpirtërore, filozofi, teologji, dashamirë të dijes, mendim gjurmues, vëllazen e bij tanë*, humanisti ynë - arrin të përfytyrojë figurën madhështore poliedrike në dijet humane e shkencore të humanistit shqiptar Gjon Gazulli.

Në pasazhin në vazhdim kemi një të folur të tërthortë të humanistit shqiptar, Gazullit, i cili aludon për dyndjet me luftra dhe plot plagë për kombet shkaktuar nga Lindja: vërshimi i dhunshëm i sllavëve në Europën Juglindore; ata qenë njerëz të travajuem (të lodhur kulturalisht). Profesori shqiptar, edhe si klerik, është, që gjendjen e rëndë që u krijua nga ato dyndje prej lemjes së diellit, ta shërojë dija, fjala e bukur, etja për të (*sitis atrium*), që të pushojnë pësimet, lëndimet dhe shtimi i varreve.

Nëse ndalemi tek fjala “zhaurrimë-a”, duhet shpjeguar se autori e përdor me dyfishim fonetik<sup>415</sup>, me “rr”; në Fjalorin e vitit 2006, zhurma e një sendi kur bie a kur rrotullohet; rrapullimë; zhurmë e madhe dhe e zgjatur: zhaurima e dallgëve (e ujit); zhaurima e luftës.

*(...Luftat, plagët e nacioneve, - kumboi zani i tij i thellë e i marrun pakëz - sollën ndër ne, sidomos prej lemjes së diellit, gjindje të travajueme. Ndër të dyndunit paska edhe asish me forcanë e mendjes, me etje dije, sitis atrium. - Tue e pre kuvendin, çoi gishtin tregues të dorës së majtë e dha shej të ndëgjohej zhaurrima e zaneve të tyne. - Dija, pra, e fjala e bukur le të jetë për ata ngushëllim në të ardhmen, shërim varresh e lëndimesh të pësue me deri në këtë ditë.)* (“Gjon Gazulli”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, fq. 331).

*(...Në ditët që ndoqën njëna-tjetrën, pa u kujtue se gdhin apo ngryset, gjithnjë me dritare të mbylluna, lexonte dalngadalë tue peshue çdo fjalë të fletores që kishte drashtë të përkiste. Me dritare të mbylluna ngase çdo dritë ia therte sytë si heshta, lexonte para flakës së njënjëshme të kandilit. Kur njëherë iu dha zojës së shtëpisë*

415 G. Belluscio - Sh. Rrokaj, *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë, 2011, f. 74. Dyfishim, 1. raddoppiamento o reduplicazione; raddoppiamento fonosintattico.

*me hapë dyert për të hy ajër, Gjonit i këceu kryt përpjetë dhe, si i zgjuem prej kllapisë, gërhiti me sa za kishte: “Jashtë! Jashtë! Mbylle, jashtë! Fora!Fora!...”* (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 338).

Karakterizimi gjuhësor i idiomës camiane, këtu, vjen nga grupet e bashkuara të fjalëve, si: lexonte tue peshue çdo fjalë, ia therte sytë si heshta, flakë e njënishme e kandilit (uniforme), iu dha për me hapë dyert (i erdhi për një çast, si në mënyrë instinktive), i këceu kryet përpjetë, si i zgjuem prej kllapisë, gërhiti (këtu: briti, thirri). Është pamja e gjendja e një njeriu të mbyllur në vetvete, mbi studime të thelluara, që s’arrin as të ndjekë ditët, të cilat gdhihen dhe ngrysen (përftesa me antonimi), pa u kuptuar prej tij.

*(...Më ka ra mall për mish fëllanzash. - Si të ishte me shtatzënë tregonte, me gjuhë të trashë nga langu i shijes, se fellanzat kishte ndërmend t`i gatonte kështu e kështu. - Drejt me të thanë - shtonte ajo - s`kam aq fort andje për mish të tyne, sa për të zie me lang salsën për tumac shtëpie...)* (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f.160).

Përsëri vazhdon aludimi i kërkesave të një gruaje shtatzënë për gjëra që nuk i ka dhe është vështirë të gjenden, siç është mish i fëllanzave në çdo kohë. Bien në sy, në mënyrë të veçantë togjet e lidhura: “më ka ra mall”, “s`kam andje” dhe “langu i shijes” - që aludon edhe shprehjen gege “më shkon/më lëshon goja lang”.

*(...“Unë jam grue me ganjun e burrë që shurben vetëm një gjysme moti e s`kam pajë e turrësë të blej çdo vjete rroba të reja.” Vitoi mbeti dy hapa prapa saj; e këqyrte lakmueshëm në heshtje. Katundësen e tmerroi heshtja dhe ndiente një zbrazësi në ajër, në hapësinë kah ecte Vitoi. Pa u sjellë ta shikonte, ajo thoshte qetësuese, tue e thirrë tash e parë, Vito këtu, Vito këtë dhe se fundi e këshilloi që të mos sillet si qot, meqenëse qekëshin edhe gjini...)* (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 158).

Në të gjithë fragmentin, peshën stilistike e mban leksema (ndajfolje mënyre) lakmueshëm, e cila, në valencë me foljen “këqyrte” përforcon kuptimin e foljes tjetër “lakmoj”, nga ka ardhur vetë ndajfolja, shpjeguar kështu në Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006: lakm/oj, kal. dhe jokal., -ova, -uar, kam lakmi për dikë a për diçka..lakmon gjënë e

tjetrit;..këndeje “lakmues”, “lakmitar”, i lakmueshëm” (f.522). Fjala zgjeron kuptimin deri edhe tek 10 Urdhëresat Biblike “Mos lakmo gjënë e tjetrit!” Mund të merret si neologjizëm i Camajt fjala “katundëse” = katundare (me ngarkesë asnjane, pa ngjyrim stilistikor)

*(...Asgjamangut, prapë, pritja e saj dallohej nga ajo e grave të katundit të zanuna me njëqind punë. Flente shumë dhe vetëm kur ndëgjonte krismën e trokllatjes në porton, zgjohej, ecte përgjumshëm, tue u përkunde kah dera. Nganjëherë nga pritesa, vononte derisa ulej prej katit të epër tue nynyruë një kangë të vjetër arbëreshe që fillonte: terimone, terimone...) (“Shkundullima”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f.148).*

Në krijimtarinë e Camajt nuk mungojnë edhe neologjizma, që autori i ka krijuar sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes, si: trokllat-je, në homofoni me një tingullimitim të krismës së një dera të madhe (porton-i); kështu edhe folja “tue nynyruë” - tue nanurisë, nga “nina-nana”, melodi qetësuese në këngët e djepit.

## 6.2. Ngjyresat ligjërimore në fushë të morfologjisë

*“Sistemi gjuhësor në krijimtarinë letrare të Camajt mbeti i gjallë, - shprehet studiuesi i parë i veprave të tij, A. Klosi, - sistem që s’mund të shkatërrohet përgjatë një breznie. Dhe gegnishtja është një sistem që shprehet me morfologjinë e fjalës, në sintaksën e fjalisë e fort dukshëm në fonetikën, në tingëllimin e gjuhës.”<sup>416</sup>*

Në pasazhet e mëposhtme do vërejmë sesi morfologjia shfrytëzohet nga shkrimtari për qëllime stilistikore.

*(...Kundro sot, kundro nesër, së mbrami iu dha me shikue nga dera e shtëpisë së vet edhe mbi kreshtën e malit që ndante katundin buzë lumit me Përteqafën. Me një shikim andej dhe u kujtue se i kishte kalue gati krejt acarimi kundër njerëzve për shkak të fatkeqësisë së dikurshme. Nisi me shijue prej moti në mot edhe ndërrimet e stinëve, hijet e dritat e ndryshme myseve, çdo fazë të rritjes së pemëve gjithnduersh, të mollës e të ftonit të fortë. Këqyr, këqyr! Thoshte ajo, deri fiku rritet këtu ndër ne, ndonëse rripa e murrllanit çan gurin, kaq është ajo e acarët...) (“Shkundullima”, në*

416 M. Camaj, *Vepra letrare I*, Apollonia, Tiranë, 1996, f. 17.



*Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 260).

Gjithë fragmenti sikur mbështillet me dy foljet e fillimit “kundro”, “kundro” dhe dy të mbylljes “këqyr”, “këqyr” - janë folje të idiomës geqe, të cilat autori i përdor dendur dhe në shkrimtarinë e tij, ato i tingëllojnë kaq normative, krahas fjalëve “mys-i”, mbiemri i përngjitur “gjithnduersh”, kaq i shpeshtë në prozën e shkrimtarëve të Veriut: të traditës dhe ata modernë; por ajo që krijon shprehësinë e vërtetë të silit të shkrimtarit këtu, janë format e pashtjella me pjesëzën “me”, nga të cilat njëra është në bazë të frazeologjizmit “*iu dha me shikue*” dhe “*nisi me shikue*” - si kallëzues i përbërë.

*(...I hueji kundroi tek antena për të zbulue atë që e kish sjellë me makinë. U habit s'deshi t'u zajë besë syve të vet kur e pau se ai hynte në auto për tu nisë: ai mezi kishte pritë të shihte se dikush po fliste me ardhacakun për t'u zhgarkue nga premtimi i bamë. I zhgënjyem rrinte ndërduzash përpara derës së hapun të grues që quhej Flora, para një labirinti apo hymje burgu, mue mbas dënimi shumëvjeçar. Tue prekë me kambë sqimthin e derës, mbylli sytë dhe njëkohësisht ndjeu ftohtësinë e mureve në fytyrën dhe la vapën e mjesditës përjashta...)* (“*Katundi me gjuhë të fshehtë*”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 276).

Na bën përshtypje përdorimi nga autori i fjalës “ardhacak-u”, në një kohë kur nuk ishin botuar Fjalorët normativë të shqipës, gjë që tregon se Camaj (gjuhëtar e shkrimtar) ndiqte zhvillimet gjuhësore në Shqipëri dhe aktivizonte fjalë që po fitonin qytetarinë në krijimtarinë tonë.

*(...Në votër flaka po del krandeve / e pika e shiut po bijnë mbi lum / veshët e mij janë lodhë prej zaneve / shpirti s'don dhimba e trupi lyp gjum. / Çdo gja që ngritet kah qiella / Toka e ngreh kah vetja / Pse toka asht amë, amvisë e kujdesshme / Dhe s'don me humbë asnji rraqe të vet... / Nëqese kam me pasë kohë do t'i thom / Dhe unë frymës seme para se me dalë prej goje: / Tash që po ndahesh prej meje, edhe ti / Prej qielli lëshojë hijen tande mbi dhe!...* (“*Çdo gja që ngrihet kah qiella*”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 135).

Ka shumë poezi që autori i ndërton me ndjenjën e humbjes, me ndiesinë e ndërrimit

të jetës, siç thotë ai. Vjersha ndërtohet mbi universin “Tokë-Qiell”, për çdo gjë që ngrihet dhe lë gjurmë në tokën-amë; qielli këtu është universi i pamatë, i përjetshëm, kurse Toka janë njerëzit, ata tek të cilët edhe Camaj dëshiron të lërë gjurmë, të bëjë hijen e veprave të veta që munda të bëjë dhe ai e kreu misionin e poetit e të shkrimtarit: vepra e Camajt është një përmendore letrare e gjuhësore njëkohësisht. Fjala “frymë” merr kuptimin e leksemës “shpirt” dhe bëhet prej tij sinonim i jetës. Vargu i fundit vjen si testament i shkrimtarit; vargu i strofës së fundit është *një e ardhme e largët* që e shpreh vetëm gegërishtja (*kam me pasë = do të kem dikur*, shumë larg së tashmes), kurse *urdhërorja “lëshoje”* del imperative, sikur autori e ndjen nga pranë humbjen!

*(...Shoh orizontin: pasha e hapsive / që e mbajta gjithdimnin në krah / shkrihet mbi bar. / Shpresoj se kur të bijë bleta / në lule / kam me i buzëqeshë gjithshkafes...)*  
(“Pranvera 1961”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 114).

Është pasazh poetik i ndërrimit stinor, përjetimi i autorit, që shprehet me parafrazën “Shpresoj se kur të bijë bleta / mbi lule/ kam me i buzëqeshë gjithshkafes”; e bleta bie mbi lule në pranverë e poeti shpreson ta presë atë ditë fatlume, megjithëse kjo kohë e ardhme e gegërishtes vjen mjaft e largët në krahasim me formën e së ardhmes sipas normës standard (do të vij).

*(...Spata Pepës i ndodh për bri / e kur ia ngjiti e shtrëngoi / sa e vogël iu ba n’dorë. / Kur ai rrebtas suell / pikë pikë shpatën t’vllat ia bani / e tehin ia ngul në krahnuer / e pa frymë e lëshoi n’ujë...)* (“Vada”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 179).

Ndoshta këtu është kulmi i poezisë “Vada”- Vadijtja, kur në malet me pak tokë e ujë vade, ziheshin vëllai me vëlla, deri në vrasje, ashtu si Voci e Pepa, që lëshon më tepër ujë në arë të vet, duke e shumëzuar me fije bari e... atëherë Voci nxjerr shpatën, por Pepa, vëllai i madh, merr sëpatën dhe e vret, gjakos gjaku i vëllait vijën e ujit e vllavrasësi, si i çmendur, vrapon “t’i marrë gjakun”, që s’merret, por hidhet në humnerë. E gjithë kjo skenë makabër zhvillohet para syve të dy nuseve, të cilat, mbase, janë kunata!! Ritmi i veprimit del nga foljet e dendura për çdo varg (*ndodh, shtrëngoi, iu ba, suell, bani, ia nguli, lëshoi*), që e përshpejtojnë ngjarjen sa hap e mbyll sytë!

(...-“Mikeshë? E fejuemja? ” Pyeti Nusha ngurrueshëm. / -“Ma tepër, shumë ma tepër!” / -“Ma tepër? Kush asht ma tepër se e fejuemja?” / - “Një vajzë, për shembull, e paarrishme!” / -“Përtej kufijve? Kam kujtue se je ma i urtë, por ti qenke me te vërtetë fantast i pashërueshëm!” / -“Si ta marrish: përtej kufijve mund të jetë andej lumit, për shembull, në Ripë.”) (“Rrathë”, Mynih, 1978, f. 50)

Nëpër skenat dialogjike, me të folurit spikatur të pjesmarrësve në bisedë, autori gjen vendin ku të bëjë përshkrimet dhe eksplorimet psikologjike të personazheve që trajton, ashtu si vepron brenda këtij dialogu të goditur, gjatë të cilit zotëron ligjërimi vetëm i Cubit, ndërsa Sosja më tepër hesht e flet me heshtjen, duke mbajtur qëndrimin e saj prej gruaje të zgjuar që parasheh thujse çdo gjë, parasheh edhe fundin e ilegalit, edhe ditën kur do të qajë. Shkrimtari ia del jo vetëm të kalojë nga njëra kohë foljore tek tjetra, por edhe të ndërrojë aq bukur format foljore, nga të shjelluara në të pashtjelluara, me anën e të cilave diku veprimi ecën përpara, diku merr pamjen e qetë e mbetet edhe në vend, për t’u zënë me hapësirat psikologjike, të folurit e brendshëm. Nga teoritë e interpretimit të teksteve, dihet se për narrativën letrare, tipike janë kohët e shkuara, kryesisht e pakryera, më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar, por në prozën epike të Camajt gjejmë një pasuri shumë më të gjërë të përdorimit të foljeve edhe në të tashmen, edhe në të kryerën e thjeshtë, prania e së cilës, me denduri të dukshme, në kuptimin përfundues, e çon më tej narracionin, duke prishur vazhdimësinë (vijimësinë monotone, plogështinë) e së pakryerës. Seria e gjatë -pa ndërprerje -e foljeve në të pakryerën shërben për të përshkruar protagonistët dhe për të dhënë njoftime të shkurtra mbi rrethana të ndryshme. Prandaj, mund të thuhet që tek ky shkrimtar i Veriut, foljet në kohët e pakryer, e tashme, e kryer e tejshkuar dhe format”duke+përcjellore”, japin skena statike ose përshkruese, ndërkohë që foljet në të kryerën e thjeshtë e të së tashmes historike shënojnë veprime e kështu shërbejnë të gjitha në çuarjen përpara të historisë.

### **6.3. Ngjyresat ligjërimore në fushë të sintaksës**

Teksti dhe hiperteksti i Camajt, sa i ngjyruar, hermetik dhe me oshëtimë, siç është në poezi, vjen i shtruar në prozë, me fjalën e gjetur e të qëlluar; me kombinime të përshkrimit të veprimit, me peisazhe të këndshme të përshkrimit e të veprimit, të gjitha këto autori i realizon me ndërtimet e drejta, ndjekur ose nga fjali të tjera drejtuese apo vargje fjalish të varura të cilat mund të dalin ose me parataksë, ose me hipotaksë apo me alternime të bashkimeve të para e të dyta, me ndërtime të shkurtra sintaksore, ku autori nuk shquan

për struktura disashkallëshe parataktike e hipotaktike, por përshkrimi vjen i shtruar dhe me fraza me disa përbërës predikativë, që për sintaksën janë ndërtime që nisin me fjali drejtuese ose kryesore etj.

Në lidhje me veçoritë sintaksore në veprën e Camajt studiuesi R. Ismajli shprehet, se “*sintaksa thellësisht shqipe, saktësia në përdorimin e fjalëve, eufonia në vjershat, janë elemente që e shquajnë këtë vepër*”.<sup>417</sup>

Në këtë çështje ne do të përqesim vlerat e tekstit të veprës së Camajt nga aspekti sintaksor duke u ndalur tek: “*1. Gjymtyrët përbërëse të fjalive. 2. Vendi i gjymtyrëve ose rendi i tyre. 3. Mjetet lidhëse. 4. Tipat dhe kuptimet e fjalive*”,<sup>418</sup> dhe më pas te përftesat që krijohen tek fragmentet e paraqitura.

Proza narrative (tregimtare) e Camajt karakterizohet nga ndërtime të shkurtra sintaksore, autori nuk shquan për struktura disa shkallëshe parataktike e hipotaktike, por këtu, ky përshkrim vjen i shtruar dhe me fraza me disa përbërës predikative, që për sintaksën janë ndërtime që nisin me fjali drejtuese ose kryesore; vetëm nga fundi ndeshim një rast kur bërthamat kallëzuesore dalin me marrëdhënie kushtore, bashkuar me mjetin lidhës jo aq karakteristik për të folmen e Temalit (Dushmanit) “nëse”, në këtë trevë, më tepër bie në sy përdorimi i lidhëzës “po”, që i përket sintaksës popullore. Gjejmë në këtë pasazh shprehjet: me dalë nuse ( me u martue), oksimoronin “tue folë si me vete të madhe”, i kandet të mburret (i pëlqen me u lavdue), ara nën ujë (ara që vaditen), pyeste tue heshtue (pyeste dhe heshtte), të vijnë punët për dore (të jepet mbarë, i vijnë punët për mbarë) e të tjera, që dëshmojnë pasurinë dhe shprehësinë e të folmeve të krahinës nga ishte shkrimtari ynë.

Mëngim a ka kuptimin pakësim në këtë fragment. (Tek FGJSSH (1980 e 2006) kemi foljen mëngoj me kuptimin ngrihem që me natë, ngrihem pa zbardhur drita.)

Leksema vjen nga folja mu(ë)ngo-j + parapashtesën - im = pakësimi; këtu antonim me fjalën “shtim-i”.

*(...Ndër këso raste takimesh familjare, sidomos kur u rritën djemtë dhe e bija përgatitej me dalë nuse, Nika ia gjeti shtegun të bëjë plane, tue folë si me vete të madhe, për shtimin ose mëngimin e berreve e të gjedheve, për mbjellje e korrje. U kujtuen të gjithë se i kandet të mburret tue thanë se në Fundinë, në një rrabe toke,*

417 R. Ismajli, *Gjuhë dhe etni*, Prishtinë, 1991, f. 32.

418 Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2012, f. 83.

*prodhonte ma tepër misër e patate, qepë e duhan se të bijtë ndër arat nën ujë, te shtëpia e vendit, në verri. “Si kështu kjo punë?” Pyeste tue heshtue për një copë here, në pritje të një lavdate ose njohje të punës së tij. Pyetja «si kështu kjo punë?» u tingëllonte të gjithëve në veshë si shprehje retorike, pyetje që ai ia vente vetes e jo atyne. Nëse ai të njëjtën pyetje e përsëriste edhe një herë, ajo i tingëllonte Lenës e djemve si qortim se ata punuekan pak. Vetëm me një rast Lena i tha atij: «Mos me iau zanë kryet femijëve se punojnë pak ose ma pak se ti vetëm. U muer vesh se ty të vijnë punët ma mirë për dore!»...) (“Pishtarët e natës”, në Vëllimi 3, Tiranë, 2010, f. 27)*

*(... “Po të ndëgjonte yt atë, çka kishte me thanë? Po të pau yt atë!...” Fliste ashtu sikur Nika të ishte zoti i ernave, atje nalt, mbi Gurra, te Maja e Cilkokut e se papritmas mund të zbriste me kokrrën e rrëfesë në dorë, apo si frymë e shndërrueme në shtërgatë, jo me përtrollë një anë jete, por me vu në vend të vet çdo gja që të bijtë s`e kishin vu përfije. Në fjalët e saj kishte edhe theksim mburrje e nderimi për të zotin e plangut. Të bijtë kishin kuptim për atë që thoshte e ama, ndonëse nuk kishin kurrfarë rreshku t`ia përngjanin t`et. Ndonjenit sish, maparë Palit e mandej edhe të tjerëve, u erdh dyshimi, mos e ama e paska ndeshë pak ma parë të shoqin, Nikën, tinëz, kur paska shkue për dru në mal e se tash me mendime e këshilla të freskëta ardhka e ua lëshonte atyne në vesh se çka duhej ba e kthye për së mbari në shtëpi...)*  
(“Pishtarët e natës”, në Vëllimi 3, Tiranë, 2010, f. 28).

Leksema: përtrollë (me): me shtrure përdhe është formuar nga “për + truall (troll-i), këtë fjalë Fjalori i Gazullit nuk a ka të pasqyruar, por atë e gjejmë të Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1980 e 2006, me të njëjtin kuptim si tek Camaj. Sot kjo leksemë ka dalë nga përdorimi. Rreshk-u, 1. Shtresë e hollë pak e përskuqur, që zë ena kur ziejmë qumësht a ndonjë gjellë; era që vjen nga gjella kur fillon të përskuqet: zuri rreshk kusia; i vjen era rreshk; 2. Edhe fig., etje; uri: e ka (e pi) me rreshk; e lexoi librin me rreshk. 3. zakon; ves; huq: i mbeti rreshk duhani. Plang-u, pasuri, mall: e ship, gjithë pasuria; iku nga plangu, la shtëpinë e vet e shkoi gjetiu.

Janë këtu dy-tri fraza të ngarkuara me bashkime me hipotaksë, në mënyrë sindete dhe me ndërtime të zhdrejta (kur njësitë predikative të varura i prijnë periudhës), por përshkrimin e karakterizon sintaksorisht fraza e drejtë: me fjali drejtuese në fillim, pastaj ato të nënrenditura, në përbërje të të cilave ndeshim shprehje të tilla, si: të ishte zot i

ernave, zbriste me kokrrën e rrëfësë në dorë, frymë e shndërrueme në shtërngatë, me përtrollë një anë jete, ve përfije, i zoti i plangut, kishin rreshk, ua lëshonte në vesh.

*(...Lena e ngarkoi Palin ta pyesë të jatin nëse paska ndëgjue ndër tana ato vjet, vetëm ndër Gurra, ndonjë za shpirtësh të papashëm ose ra në sy ndonjë sendegja, si Zana, për shembull. “Po dihet se mali e bjeshka mbajnë gjithçka - ia preu Nika ngutshëm, si me dashtë ta mbyllë atë kuvend shpejteshpejt, - por diçka të qartë, për shembull, si ky gurë që e shoh, e përkas e mund ta hjedh njaty e t’ia ndëgjoj krismën, jo!”...)* (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 32).

Një pasazh i shkurtër gjuhësor, ndërtuar, duke përshtuar fjalët e autorit (emetuesit), ndërsa ligjërtata e drejtë jepet e plotë e përfundon me një elipsë elegante prej shkrimtarit, me fjalën mohuese “jo” - s’kam ndëgjue. Ka bashkime interesante sintagmatike, si: za shpirtësh të papashëm, ra në sy, ia preu Nika (iu përgjigj), ka krahasime konkrete, p.sh.: si ky gur që shoh e përkas. Në planin sintaksor, shohim përshtatjen në numër të subjekteve homogjene me foljen-predikat (...mali e bjeshka mbajnë...).

*(...“Na këtu shëndosh e mire e ato të Lumet atje ku janë e këput e mbaro! Kështu ashtë puna.” “Ti flet me frikë për to si t’i kishe pa... Por fjetë me to nuk ke?” Brohu e tha Pali gjaknxehtë. “Mos u ban i marrë, or djalë! S’flitet për pushtedjen e tyne ashtu. Unë vetëm mirë do t’u baja atyne, pasha Zotin!” Vetmitari i Gurrave e humbi sigurinë në fjalë: iu dridhën rrudhat e ballit dhe mënyra si i jati e hante bishtin e mustakut me dhambë, gjithçka e shtini edhe ma në dyshim djalin se ai donte me fshehtë diçka...)* (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 32).

Në një kohë, sidomos ndër male e fshatra, emri “pushtet/pushtete-pushtetja”, përdorej në gjininë femërore, si: oksidentalizma, marksizma, orientalizma, etj. Pasazhi i dhënë duhet kënduar me dy-tre fragmentet më sipër, për të mësuar se për çfarë bëhet fjalë. Në aspektin psikolinguistik, sa i takon etnografisë së të folurit, na duhet ndalur tek termi “të Lumet” për të treguar se është një eufemizëm, që në Malësi përdoret për Orë e Zana jo vetëm në këtë formë, por edhe në bashkime të tjera sintaksore: të Lumet e Nates, të Mirat e Natës, të Bukrat e Logjeve, Të Bardhat e Natës e të tjera, sipas krahinave.

*(...Duhanin e Fundinës, këtë fjalë e shqiptonin me tingull pshertues të gjithë ata që kishin mbështjellë ndonjë cigare nga qesja lëkure dhie e Nikës. Në vjetët e para ndër*

Gurra, ai pruni nga vërrini fidana duhani dhe, për të mos ia ngranë dhinë, i mbolli në midis të qetës, në një rogë midis të shkambijve ku mund të ngjitej vetëm nepër një shkallë druni. Atje nalt, përmbi kasolle, në rrasë të gjallë, dielli e feksi i rrezeve në shkamb do ta kishin djegë bimën flakë, sikur Nika të mos e kishte ujitë tash e parë me ujë kroni, tue e bartë me kusi deri atje. S`dihet si qe puna si ai nxori një lloj duhani; dihet vetëm se ai e lëvroi nga padija në një mënyre tjetër: e mbolli farën e nxjerrun prej lules, ashtu tue e hjedhë si misrin në tokën e plehnueme me kakërdhi berresh. Mbasi u rrit bima, nuk e hoqi andej si rasat për ta ngulë fidan tjetërkund, por e la aty ku ishte, e rralloi dhe e la të marrin shtat filizat ma të shëndoshë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 38).

Na bie në sy në këtë pasazh gjuhësor endja e 5 frazave me disa përbërës predikativë të shkallëshkallshëm, ndër të cilët fjalia drejtuese është në fillim (ndërtim i drejtë i strukturës), që, nga ana e stilit, përtakojnë me sekuenca narrative përshtuese, dallojnë midis tyre krijimet e marrëdhënive qëllimore me trajta të pashtjella foljore (me paskajoren me “me”), njësitë kallëzuese me formën e përcjellores geqe me “tue”; por, në këtë shtrim të prozës, bien në sy plotësorë të ndryshëm si në strukturën e tretë: “Atje nalt, përmbi kasolle, në rrasë të gjallë...”. Në shikim leksiku tërheqin vëmendjen bashkime të tilla sintagmatike, me vlerë shprehëse, të cilat, me burim nga kjo e folme, mund të përfshihen edhe në thesarin e normës gjuhësore, si: qesja lëkure dhie (qesja e duhanit me lëkurë të dhirtë), feksi i rrezeve (fluksi i rrezeve, tufa e rrezeve), djeg flakë (djeg zhari, djeg fort), ujit tash e parë (ujit shpesh e shpesh), lëvroi nga padija (e lëroi nga mungesa e njohurive), (e la) të marrë shtat ( të rritet më).

(...Ujin për vete, bagëti e bimë të kushtueshme, si duhani e qepujka, e merrte prej kronit në fundin e arës. Në lagësinën, rranzë shkambit në lindje të Fundinës, rridhnin currila uji deri vonë në pranverë e mandej shterreshin. Ujë i shpërndamë si ajri ndër njëqind pikla ishte ai, por megjithatë ia delte ta mblidhte në shurrqe dhe ta sillte nëpër gurra druni deri në pusin, bri kasolles. E rrente mendja se do të kishte mblidhë aq shumë ujë sa të ujiste arën e misrit nën oborr, por këtij qëllimi s`ia doli kurrë! Toka zhurore në pus e pinte hellin e ujit si kurrjasend, ku në fund mbeste vetëm një cipë e hollë bote të kuqe që, kur dielli e terte fare, plaste dhe sajonte figura mozaike që ndizte fantazinë e Nikës që shihte në to shenje ndjellakeqe dhe ogurzezë...) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 38).

Lema shurrqele si fjalë dialektore del e shënuar vetëm në Fjalorin e Gazullit,<sup>419</sup> ndërsa në fjalorë të tjerë ajo nuk gjendet, kurse leksema “lagësinë-a” (lagësirë), gjendet në Fjalorë të shqipes, duke dalë këtu me shfaqjen e rotacizmit, si ngjyresë e idomës së të folmes krahinore nga është Camaj e më gjerë. Në rrafshin sintaksor, përcaktorët e vendosur varg para foljes - kallëzues e mbingarojnë fjalinë në përbërje fraze, ashtu si del edhe me vënien e vargut të plotësorëve të vendit në frazën II (Në lagësinën, rranzë shkambit në lindje të Fundinës...), edhe pas foljes “rridhnin”, që është qendra organizuese e njësisë përbërëse: deri vonë në pranverë e mandej). Vazhdojnë grupet e fjalëve me shprehësi gjuhe, si: bimë të kushtueshme, i shpërndamë si ajri, ndër njëqind pikla, gurra druni, e rrente mendja, s’ia doli kurrë, tokë zhurore, helli i ujit (rrjedhë në formë helli të ngrirë), cipë e hollë bote të kuqe (dheu, toke të kuqe), ndezte fantazinë, shenje ndjellakeqe (që parathonë keq).

*(...Me rregull të pashoq dhe amvise e mirë ashtë jot amë! - Ia priti i jati, tue shtrengue buzët dhe tue çue mjekrën e rrueme përpjetë si me pasë ndërmend të nisej për dikah, në festë apo dasmë. Nika tue fole për të shoqen, i shkokërronte fjalët shijueshëm. - Jot amë, e di unë fort mirë se ashtë grue e vyeshme për plang e shtëpi, e urtë tek s`vete ma, e bija e fisit të mirë...” dhe s`dinte ta soste kuvendin që zgjatej tërkuzë me shprehje të zgjedhuna. Por ma në fund u kujtue edhe ai vete se disa skajime i kishte përsëritë nja disa herë dhe e preu fjalën tue u ngritë e tue vu poçin e rakisë në vendin e vet, në ballin e votrës, në gëvoskën e punueme në mur...)*  
 (“ Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 45).

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 e 2006 gjendet e lema: shkokërroj, ndaj: 1. Shkoqet, shkokëlohet vetiu. Shkokërrohet gruri, misri etj. Në këtë kontekst ajo s’përdoret më me një kuptim të tillë. Skajim-i, pëdorur për fjalën “term”; kujtojmë “skajet gramatikore” të Komisionit Letrar të Shkodrës; autori i njeh mirë këto ngjarje madhore në jetësinë e shqipes, si nyje të Planifikimit të saj. Këtu, sintagma “shkokërroj fjalët” merr kuptimin që i shqiptoj fjalët duke i ndarë nga njëra-tjetra për t’i kuptuar mirë bashkëbiseduesi ynë; është me mjeshtri përdorimi i trajtave të pashtjelluara paskajore dhe përcjellore me pjesëzën “tue”, të cilat marrin vlerë predikati për njësinë kallëzuese ku bëjnë pjesë, duke krijuar marrëdhënie të ndryshme, si: kushtore e mënyrore, edhe kohore (Nika, *tue folë me të shoqen* = *kur po fliste me të shoqen...*)

419 Fjalori i Gazullit, Botime “Çabej”, Tiranë, 2005-2010, f. 416.



(...*Ishte fundi i shtatorit, koha ma e bukur e vjetit anembanë malësisë, vendosë mes dy lumejve dhe me rrjedhën e Drinit përfund. Ata që e vërenin trevën e Fundinës bashkë me dhenat e Gurrave, vendosë mes dy shkambijve, nga larg, tue qëndrua kundruell mbi Vile, shihnin si me pasë dy pashë larg sysh avullina të lehta gjithfare ngjyrash: në agim, deri kah mjesdita, visi mes shkambijve mbulohej prej një mjegullaze të ndezun; ma vonë kthjellej gjithnjë e ma tepër prej fekseve të rrezeve të diellit qe vareshin e kryqëzoheshin si fije pejsh të hollë mendafshi në avlimend, një herë për skithi e mandej drejtpërdrejt prej majeve e krepave. Vetëm për nja disa orë të masdites, mjegulla zbardhej në sytë e vëzhguesve të largët që dallonin silueta përbindëse lisash e sendesh të gjalla, bagëti apo njerëz. Prej perëndimit të diellit deri në muzg, avullina ndërronte dukje prej minuti në minut, derisa Fundina e mbarë Gurrat merrnin pamjen e ishullit te pambërritshëm mes ujnave...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 46).

Lemën *skithi* e kemi të pasqyruar si folje tek Fjalori i Gazullit dhe Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 me këtë kuptim: kajllue, kthise: kthisi qeni mbas ljepurit.<sup>420</sup> Ndërsa Fjalori i vitit 2006<sup>421</sup> ka shembullin: skithem - f. kuit - lëshon një zë të hollë si me të qarë - kuit qeni.

Më tej: *feks*-i, nuk ekziston si emër në Fjalorë të shqipes, por vetëm si folje; autori ynë e ka disa herë këtë leksemë, që, për mendimin tonë, ka kuptimin e fluksit (këtu), tufës së rrezeve të diellit. Përshkrimi i Camajt nis me një folje-kallëzues emëror (me këpujën “jam”), ku pjesa emërore përbëhet nga një SN, e cila ndiqet prej dy vargjeve të gjata gjymtyrësh të veçara: ndajshtimore dhe plotësore-vendore (nënvizuar prej nesh). Frazja vijuese vjen shumë “e ngarkuar”, që është realizuar me lidhje të largëta sintaksore, ose të ndërmjetuara në masë të madhe prej gjymtyrësh funksionale, midis subjektit e predikatit (nënvizuar më sipër): Ata - shihnin. Vijimi i frazës bëhet me lidhje të dobëta sintaksore, me tregues kohorë e vendorë. Stilemat me dy përbërës silueta përbindëse (që të hutojnë, që janë të përbindëse, të habitshme) dhe ishullit te pambërritshëm (që nuk mund të arrihet, që vjen i largët, ose s’ të lënë dallgatë a erërat t’i afrohesh), ka mbiemrin e formuar nga folja “mbërrij/arrij” i pambërritshëm (pa + mbërrij + shëm).

420 *Fjalori i Gazullit*, Botime “Çabej”, Tiranë, 2005-2010, f. 371.

421 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 970.

(...Qetësia e paturbullueme prej asnjë tingulli rrezatonte prapim, as me pasë Flora njëqind duer shtymëse, po aq sa kish rremba e gjethe përmbas karriges të cilës i kish ndërrue vend e vu gati në gjysmë të kopshtit për të kapë ma afër freskinë e tij. Sa ma tepër që avitej muzgu, aq ngjante se largohej, thellë e ma thellë mbrenda vetmisë. Jo vetëm ai, por kushdo në atë fill do ta kishte krahasue Florën me bimësinë e atij dhe e cila prej perëndimit e mbas merrte frymë e kërthnesej në jetë po si mushmolla dhe kurpnat rranzë murit, tue çue kryet me u ngjitë edhe ma nalt, deri në maje. Habitej si ajo nuk ngutej me i thanë se ishte ba vonë...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 286).

Në këtë sekuençë përshkruese (deskriptive) na shfaqen vargje gjymtyrësh funksionale, karakterizuese si caktuesorë të fjalëve që përbëjnë grupe të ndryshme sintagmatike, siç ngjet në frazën e parë (nënvizuar prej nesh), ashtu si krijon shprehësi përdorimi i formave të pashtjelluara geqe me paskajoren me “me” (nënvizuar më lart), në funksion të marrëdhënieve kushtore dhe qëllimore me vlerë predikative. Leksema kurpna-t lidhet me termin “kulpra-t”, gjethnajë e blertë.

(...I acaruem, trokëlloi në çdo portë me flegra të trasha dypalëshe druni të shtrëngueme me bullona çeliku dhe askush nuk ia hapi, as që doli në dritare për të pyetë se çfarë kushtrimi qenka...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 287).

Ka tri njësi kallëzuesore radhazi të bashkuara me parataksë në mënyrë sindete, të cilat e mbyllin frazën me njësinë kundrinore se çfarë kushtrimi qenka. Fjalja nr. 1 nis me një gjymtyrë funksionale të veçuar (determinant mbiemëror), kurse plotësori i dyfishtë “në çdo portë” (SP), karakterizohet tepër gjatë: me rende fjalësh që plotësojnë njëra-tjetrën në përshtatje gramatikore (me flegra të trasha dypalëshe druni të shtrëngueme me bullona çeliku), të cilat tregojnë se autori është përshkrues i hollë, deri në detaje të imëta.

(...Si gjithnjë, në shtator, mbrendë, në restorantin e hotelit, pritinin njerëz me tesha banje mbi tryezë apo në rrjeta, varë për krahe karrigesh, që të ulej era jashtë për t’u la në det. Mbrendë, mbas banaqeve, hapi sytë kah i hueji gjellëbamësi, një burrë i shëndoshë e shegan në fytyrë. Ky ngriti duert e përrjarguna me peshk e i thirri me za të shterrun: “Mirëse keni ardhë! ...) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 289).

Jemi para një ndërtimi interesant sintaksor: fraza e parë ka në përbërje, në mënyrë simetrike, dy plotësorë kohe dhe dy të tillë vendi - radhazi - po kështu, pas qendrës së foljes së njësisë predikative, vijën karakterizimet e subjektit-kryefjalë (S) me tesha banje mbi tryezë apo në rrjeta, varë për krahë karrigesh, të cilat bëjnë që marrëdhëniet n/r qëllimore të dalin në mënyrë të ndërmjetuar, jo drejtpërdrejt. Po kështu, vijon struktura jo e zakonshme: folja e bërthamës predikative të mëvetësishme “rrethohet” nga dy plotësorë para dhe pas saj ndiqet prej një ndajshtimi medy përcaktues homogjenë (Mbrendë, mbas banaqeve... një burrë i shëndoshë e shegan në fytyrë). Janë stilema sintagmat me duer të përjarguna (SP) dhe me za të shterrun (SP) - duar të lyera me lëngun vikoz të lëkurës së peshkur dhe me zë të marrë, me zë të ngjirur.

*(...Humanisti nga Përteqafa e Alpeve përcillte çdo mbramje Gjon Gazullin, tue u endë nalt e poshtë nëpër sheshe e portale pothuej të zbrazëta të Padovës. Së paku një gjysmë metri ma i gjatë se humanisti ynë, ai i leshonte Gazullit gjithnjë me nderim anën e djathtë, dhe, tue i ndejë një hap mbas tij, e thirrte tash e parë mjeshtër ose fort i nderuemi Gasulius, ashtu si emnohej prej të gjithë dijetarëve të vjetëve 1450 ky shqiptar i fisit të Mirëditës, lindë në Raguzë. Teutonasi vente pyetje dhe ndëgjonte, tue luejtë në mënyrë të përsosun rolin e dishepullit dhe nuk e hapte kurrë gojën maparë, edhe nëse mjeshtri heshtonte, të mos ia prishte këtij fillin e thellimit në mendime... (“Gjon Gazulli”, në Vëllimi 3, Tiranë, 2010, f. 298).*

Janë gjithë mbarë 3 fraza, të tria me strukturë të drejtë, por shprehësinë formale në rrafshin sintaksor e sjell periudha II, e cila nis me një varg të gjatë si përcaktues të subjektit (S) - ai (Së paku një gjysmë metri ma i gjatë se humanisti ynë...) - kurse fraza I dhe III kanë në nisje të tyre kryefjalët emërore (humanisti, Teutonasi). Ngjyresa e kohës e qatetit të vjetër universitar, Padova, jepet me fjalët “sheshe”, “portale”, “Përteqafa e Alpeve” (haësirë e dominuar nga gjermano-austriakët deri në fillim të shekullit XX); kurse heroi kryesor, humanisti ynë, paraqitet me karakterizime atributive, që i takojnë vetëm atij, si: humanisti, nderim, ana e djathtë, mjeshtër, Gazulius, dijetarë të kohës, shqiptar i fisit të Mirditës, filli i thellimit të mendimit (një varg emëror) - ndërsa shoqëruesi nga Alpet mban fjalët caktuesore teutonas, dishepull (në analogji me 12 apostujt që ndoqen Jezusin deri në kryqëzim).

(...*Vetmia ka thithë erën e bjeshkës / Dhe fije bari as fletë nuk lôt / Të mnershëm janë korbat e zezë / Në pushim mbi qarrat e vjetër / Maje mali në vapë. / Mendja e njeriut nën hije sheston / udhë gjaku / e sosjen e pagjës në mal e vrrë...*) (“Gjakmarrja”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 25).

Folja “thith” mund të lidhet në valencë me një emër të shpirtëzuar, jo emër abstrakt, sepse, si folje bivalente, kërkon dy argument: të jashtëm (S) e të brendshëm (O); kështu që, në bashkëvajtje me emrin “vetmi” krijon stilemën e figurshme, e cila shton shprehësinë e gjithë vargut; më poshtë gjejmë mbiemrin tipik të idioms gegërishte “të mnershëm”, kurse fund ii vargur përfiton stilemën me anë të sintagmës emërore (SN) “korbat e zez”, ku emir - kokë e sintagmës s’ka nevojë për caktuesorin mbiemër (e zez), pasi nuk mund të ekzistojnë determinantë të tjerë; e vërtetë kjo, sa, në regjistrin popullor kemi: i zi korb, korb i zi, si penda e korbit, u bë korb i zi, i zi sterrë si korb, korbi ai, korba ajo, korbën ç’e gjeti etj. Ndryshe qendron çështja e bashkimit sintagmatik “mendja sheston” (me lidhje mediate), pasi struktura foljore (SV) vjen në valencë të plotë midis përbërësve. Sintagma emërore (SN) “udhë gjaku” përmbledh në semantikën e saj edhe kuptimin e drejpërdrejtë, por këtu vjen me ngjyresën e jetës së vështirë: jetë gjaku, mundime të mëdha. Ndërsa sintagma “sosja e pagjes” ka dy përbërës leksikorë tipikë të idioms gegërishte (mbarim i pagjës), sepse vetmia, korbat, udhët e gjakut në mal e vërrë - nuk ndjellin paqë.

(...*Endje maranxhash* që quhen zagare / në gjuhën e vendit / ushqehen prej frymës së njelmët të detit. / *Kur veshken rrëzohen mbi krena murgjish / varg e varg ndejë mbi gur rrenojesh të vjetra...*) (“Marsi në gjinin e S. Eufemies”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 58).

Kemi një mikrotablo me maranxha, frymë deti të njelmët, krena murgjish, që rrinë varg në gurë rrenojash të vjetra, që nis me një fjali nominative me elipsë të foljes “janë”, topika e vargut të fundit fiton ritëm falë veçimit nga folja dhe lidhjes mediate që kanë me të, si qendër të organizimit sintaksor të fjalisë

(...*Zoteshë, dy krena gjarpjish ndër vllaj / gjij tu, qyshse vetdijse / për hijeshinë tande sadefti / për buze përvujtninë e vjollcës. / Dashnore e lilit të paçelun, / mëkati yt po të mbyt përditë / pse korpin tand të rrezitun / don me e pa në pasqyrën e hanës, / pse do me u ba sinor mes diellit / e njeriut...*) (“Zoteshë”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 65).

Poezia nis me një formim neologjizmi nga fjala “zot” në “zoteshë” - zoteshë e hijeshisë prej sadeфи, që del mbi përvujtninë e vjollcës, duke dashur veç lilin në gonxhe të paçelur ende; duket si motiv i narçizit koliqian për njeriun e dashuruar me veten, për t’u shndërruar në sinor (fushpamje) midis diellit e njeriut. Gjuhësisht, nga ana sintaksore, kumti ndërtohet me fjali njëshe vetore me vetë të caktuar, pasi subjekti lë gjurmë tek mbaresat vetore, por ato mund të perceptohen edhe si fjali përgjithësuese.

*(...Në fundin e syve të zez / flatra zogjsh mërguesë e me të dhanun / flet fjalë të harrueme shqipe e pyet: / “Kur piqen maranxhat buzë detit tonë?”...)* (“Kur piqen maranxhat”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 84).

Gjithë strofa organizohet brenda një fraze me 3 përbërës predikative, mbajtur tek 3 folje (flet, pyet, piqen); fjalia e fundit është dyshe, kurse dy të parat janë dykryegjymtyrëshe, por subjekti ndodhet larg, në fillim të strofës së parë (ajo çupë); fjalia përmbyllëse ose fjalia remë, siç quhet, vjen dyshe. Fjalët “s’pau vendin”, “kureshtje”, “fjalë të harrueme” tregojnë se çupa vjen nga jashtë, nga mërgimi, çka e mbështet sintagma emërore (SN) “zogjsh merguesë” = zogj shtegtarë- janë shqiptarët e bijtë e shqiptarëve që, edhe ashtu me gjuhë të “dashur”, kanë ende tërheqjen ndaj Atdheut.

*(...Të zit e synit tand nuk due / ta ndeshi në shtiqet e ngushta. / Flakën e synit ta due mes fushës / e zemrën tande mollë, / të ndemun në degë, në naltsin / e krahut prej tokës. / Mos bzaj para muzgut / të njerzishëm në fushë / e erës zemërgjanë / që përqaфон çdo maje bari. / Lule, hiqe pëlhurën e zbetë prej hanës / e shtroje për tokë...)* (“Koha e lules”, Pjesa II e ciklit, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 122).

Kjo pjesë e ciklit “Kanga e lules”, poezi simbolike që i këndon femrës së dashur, nis me l’enjambement krejt të natyrshëm në dy vargjet e para, mes dy foljesh që plotësojnë njëra-tjetrën, ashtu si përsëritet në vargjet 4/5 dhe vargjeve 5/6, për t’u rimarrë dukuria në fjalinë III (vargjet 7/8) dhe bëhet mbizotëruese nga ana sintaksore e semantike; shprehja poetike kalon në parafrazë: në vend të synit të zi - lexojmë “ të zitë e synit”, në vend të “ syrit të përflakur” që do të ishte një sintagmë poetike e Camajt, ndeshim “ flakë e synit” - përcaktim më konkret dhe i drejtpërdrejtë; hidhet figuracioni me elipsë të lidhëzës karahasuese “si”: në zmerën si mollë - zemrën mollë të ndemun në degë aq sa merr krahu i njeriut për ta mbërri; më në fund figuracioni abstragohet me pëlhurë të zbehtë hëne që

duhet të bëhet shtrojë e dashurisë - një shprehje jo e lehtë për t'u kuptuar, kur dashuria vjen "mollë e ndaluar" në shoqërinë ku jeton poeti.

*(...Ujë a ba gjethi e teshat e blegës / e pikat e shiut po bijnë mbi lum / dëshira e pjekun po bjen prej degës / shpirti s'don dhimba e shtati lyp gjum...)* ("Shiu mbi lum", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 133).

Është ndër të paktat poezi të Camajt me rimë e metër të rregullt (në 11 rrokësh), thurur me rend të drejtë (asnjanës) sintaksor (S + P + A + C + O); është përsëri një ndërthurje e natyrës me një gjendje shpirtërore femërore, siç do ta shohim në mjaft poezi të poetit; dy fjalë "shtat-i" dhe "blegë-a" ka përdorur Camaj nga vlerat leksikore të fjalësit vendës, që janë mjaft tingëlluese, stilemore dhe mundet të përfshihen në leksikon e përgjithshëm të gjuhës sonë; e dyta (blegë-a) është përdorur edhe nga krijues të tjerë para shkrimtarit tonë, si nga Prendushi e Koliqi). Shiu është simbol i begatisë, pjellorisë, që i shkon përshtat pjekurisë së femrës mbushur me dëshirë.

*(...Ushtima ktheu përsëri në lum, / Pranverë, e ndër sy tu kthej unë, / Tue mbajtë ndër duer gjahun e vramë: / Mëllija, shepka e piktha trazuesa zguresh...)* ("Asaj që i përngjante pranverës", në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 145).

Është vjershë e Camajt, që nis me rimë e metër e kalon në varg të lirë; një pamje peizazhi pranveror, me ushtimë lumi dhe një gjahtar me duart plot zogj që ka vlarë asaj stine. Folja - predikat në vargun e dytë, mban gjithë "peshën" kuptimore e sintaksore të dy vargjeve të fundit ngarkuar me gjymtyrë funksionale homogjene.

*(...Burri te ura e votrës pleqnon: / nji shpi me rrasa guri e kam / rranxë malit e buzë Drinit / dhe arën për nën. / Arën e punuem me vjet unë e uri / dhe era e verit korën e qitit rrah. / Andej ujit në karmë picak në terr, / thom, grueja lyp burrë! / E unë? Rrij tërthuer i ngathun, / mish i gjall në kupë i nxemë / pranë prushit. / E bërtet, i vramë vetmije: / përtej ujit andej, po kallen pishat flakë! / Po digjet druni, bajtë prej meje n'krah! / Si gjimon Lumi n' gavixh të tymit! / Si vlon mendimi i ngjuem në rrashtë! / Burri i malit pleqnon, nesër me ra / më not ndër Dri e sheh n'vegim / si akulli i kërcllat nën korp...)* ("Burri te ura e votrës", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 155).

Lumi (Drini), simbol i përhershëm poetik i Camajt, kësaj herë, kalon në skena më të rralla: shtëpia do ngritur, ara do punë, por edhe grueja lyp burrë, skena është përfytyruese për gruen picak (lakuriq) që pret në odën e errët. Në pikëpamje stili, zjarmin e dashurisë autori e bashkëshoqëron me zjarrin e prushit, zjarrin e pishave në flakë, djegien e drunit flakë, vala e mendimit nga epshi i dashurisë - të gjitha këto, dhënë me nevojën e ndërsjellë jetike të një çifti, nga zjarrmia e dashurisë! I pashembullt është vargu i 4-t, që mbyllet me parafjalën “nën”, me një elipsë të jashtëzakonshme të fjalës “Drin”, e cila, po të vihej, do të zbriste shprehësinë poetike të gjithë poezisë.

*(...Mjellmja ulet për Dri e ndalet / pendlat me terë te këmisha e nuses. / Nusja pranë zjarmit, në bigë, çoi dorën / me shtyllën e tymit e bzani: / “Mjellme, shpend-bardhe, / m’u kthye krahnin ndër flokë / kam nemjen në gojë, kam hy në mkat, / pështyna zjarmin e mallit / në parzmin e lëndurun gjak! / Burri i huej, ai hyni në mkat / e ngrohu shpirt e korp / n’gryckat e teshave t’mija! / Trungun e verrit të zi unë putha...)* (“Mjellmja e nusja”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 157).

Është një skenë e jetës baritore në malësi, pranë lumit ku ka mjellma, vjen si një ligjërim i brendshëm me këtë shpend të bukur, i një gruaje të re, nuse, që ka rënë në mëkatin e dashurisë me një burrë të huaj, ka thyer kurorën e martesës; ka lagur këmishën e korpit (trupit) të saj mëkatar që ia ngrohu në trup e shpirt! Gjithë kjo ngjarje “e ndaluar” në doket e moralin e vendit, jepet me pak fjalë pendimi - përballë të cilave rri mjellmja e bardhë, simbol i dashurisë së pastër. Katër vargjet e para janë kombinime rendi sintaksor që përftojnë shprehësinë e duhur stilistike.

*(...Era e krahnjerrit mbet e para dashni / n’fangjet e sukave verore n’muzg. / Gjumin ma qiti rrokja e shkambit n’Dri / dhe era e gurit t’shtypun më pëlqeu...)* (“Grue e pjekun”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 158).

Duket se është një skenë kujtimi që vjen vetvetiu në mendjen e një gruaje të pjekun (të moshuar), që me Drinin dhe ujët e tij ka lidhur jetën, herë me bukuri, herë me dëshpërim, skena që e kanë shtangur; është ndër të rrallat poezi të Camajt me rimë dhe metër. Ky Dri që i ka dhënë mjaft pamje gëzimi, të parat dashuri, por edhe ia ka shkatërruar jetën e të ardhmen, e ka izoluar, e ka lënë pa dije (analfabet). Rendi asnjans sintaksor në dy vargjet e para e të fundit, përthyeret me vargun III me rend emfatik (O + P + S + C).

(...Pranvera shkoi e Drini u zbut si kingj. / Kingjat u nginë me tambël e lodruen zallit / me plakën tue mbledhun coklat bregut: / Drini asht vashë bel-hollë, n'kalim plot naze. / E bija lexon prrallat e vjetra që i kish / e ama ndër sy dhe reciton: / “E shoqja e mjellmes pyeti, / Kush qe ai burrë në breg me flokë / të përthimë e tirq të bardhë e spik / të zi për gju? / Si nuk jam ujë - pritën t'ia za në va.” / Lokja n'gurgullimet e tingujve / të valave drinore ndien fjalën e gjakut / të vjetër, të marrun prej urave druni, / tue kërcllatë si n'djegje n'erë...) (“E bija e grues apo urat mbi Dri”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 159).

Përsëri temë e vrasjes e gjakmarrjes, që shkretton çdo gjë: një pikturë e vërtetë, skenë bukolike e gjeorgjike njëkohësisht; Drini i zbutur, pa valë e zemërim, natyrë e begatë plot bar sa qingjat ngopen me tambël e lodrojnë; lumi ka tashmë pak ujë (asht veshë bel-hollë) e rrjedh me naze: personifikim i natyrshëm, që jepet në tri fjalitë e para, shtruar me rend të drejtë asnjans (S + P); më pas, kujtimi i Lokës për një vrasje gjaku bërë po këtu në Drin, por kur lumi kishte valë dimri! Aktivizim i fjalëve të nënvizuara marrin vlerë shprehëse jo vetëm të idiomës geqe, por më gjerë.

(...Mbi pyrg u dridh i vrami / e për nën ledhe ra / si krahë të mos kish pasë, / si bie një petk i zi, / qitun n'mur me u terë. / “Shpend i poshtër e pusitar! - / Tha kryezoti i Parë. / - Epma shigjetën ta thaj / po në vend at përbindsh!” / “Jo! - Tha i Dyti dhe e ndali. - / Marre asht për një bujar / punë me i dalë me korba.”...) (“Dy korba”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 165).

Camaj ka shumë poezi kushtuar gjakut e gjakmarrjes, që ushtojnë me të madhe për ndaljen e këtij zakoni shkatërrimtar, që bënte kërdrinë në malësitë e tij. Fabula nis me paraqitjen e dy korbave mbi kështjell të Agripës së Gurit. Para tyre dy bij kryezotash, princër. Shohin skenën si njëri korb e vret tjetrin me sqep, si në pusi (pusitar) dhe nxiten pinjollët, njëi trim vret tjetrin dhe ia hedh trupin pa jetë në valët e Drinit... dhe mbeti qyqe vetëm, pa kushëririn! Korbi, një simbol i krijimi i poetit temalas personifikim të zezën, këtu krimin, vëllavrasjen! Krahasimi që del nga vargu II,III, bëhet me fjali, të cilat, megjithëse kanë të njëjtën lidhëz fonetike “si”, japin marrëdhënie kushtore e mënyrore.

(...Në liqe të vjetër të Prespës / Përpiqen dielli e hana / mbramjeve verore n'ujë. / Ai bashkim i rrezeve, / dashnija e dy palë duerve / me gishta të kapërthyem, / a



*shmallimi i peshqve / në ma të shkëlqyeshmin shtrat: / - hana rrin e dielli shkon...)*  
(“Liqeni i Prespës”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 194).

Duket se po shkruan Poradeci për liqerin e tij. Camaj ndalet para një peizazhi të rrallë, që i kalon për një çast para syve: mbrëmje vere, poeti-piktor i fjalëve, ka kapur një moment që shfaqet e zhduket, me ndërrim të rendit sintaksor të drejtë/të zhdrejtë, është si një lojë tastire gjatë prodhimit të joneve tingëllore, për diellin që fshihet e hënën që del, kur bashkohen dy palë rreze si një dashuri e vetme njerëzore me kapërthim duarsh në personifikimin e peshqve në një shtrat të shkëlqyer uji: hana rrin e dielli shkon! Po vjen nata, koha romantike e dashurisë, pranë liqenit të Prespes.

*(...Gjamën e motit për së largut ndëgjoj / e jashta bjen shi. / Pullazi lëshon pikat n'enë, pikat e mëdha / si kokrra e rrushit të zi / në vilën e varun në lëpozë. / Zjarrmi xen gjyshën te votra e shndrit / trollin e shtypun prej thembrash sona, / shtratin me tasha ngrofë prej zemrash sona / e muret e nxime prej syve tanë...*) (“Gjamën e motit për së largu ndëgjoj” në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 235).

Është loja me rendin sintaksor që përbën përftesën stilistike (O + A + C + P) në vargun e parë dhe të dytë, të cilët përftojnë një ritëm të pazakontë, sepse përbëjnë remën; për të vazhduar me vargun III (ngarkuar me fjalë determinante/përcaktuese), vijon me vargun I të strofës II - rendi asnjës - ku folja/predikat “shndrit” mban sintaksorisht 3 vargje që nisin me kundrina (O) me vargje atributësh të pandashme (SA, SP, SA). Bashkimi parataktik lidhëzor (vargjet I-II) shërben për asociacionin e pandashëm natyror “gjama e motit / shiu përjashta” e në mbyllje kryefjalët logjike në E5. (zemrash, syve), të cilat nuk kanë valencë me pjesëren “ngrofë” dhe mbiemrin prejpjesor “e nxime”, që përftojnë dy stilema stilistike të gjetura, pikërisht falë “thyerjes” së valencës, a përdorimit të bashkimit sintaksor pavalent.

*(...-Babagjyshe!- vasha ia ktheu- / Nji re si plaf i zi kaloi nën diell / E hija e saj kaloi dhe në k'sollën tonë tash hyni. / Ishalla shi tash po bjen, bijo! / E tokën e rreshkueme zbut!- / ...Kam kenë e re, si kallzi i grunit shtalp / Dhe e lum me 'i mij dishire në gj. / Nji rreze m'nxeu në kët tokë si dielli / Nji burrë që m'dhanë për fat. / ...Un e nipesha maje gishtash përjashta dolëm / Nësa gjyshja, përmallue në kujtime, / Flitte me vete nën za, e ngrata...)* (“Rrezet e diellit të ngrohta”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 233).

Nis fragmenti me një neologjizëm “babagjyshe” - nga “babagjysh”, nëse mund të bashkojmë semantikisht përbërësit “babë + gjyshe” (në vend të “nënë+gjyshe”; në gojën e një fëmije, e cila, mbase, e shqipton në atë formë jo me vetëdije dhe i kumton se një re e zezë (si mbulesë leshi e zezë), që lëshon hije mbi shtëpinë-kasolle; është shpresa që sjell shi mbi tokën e rreshkueme (të tharë)... dialogu “gjyshe-nipeshë” (mbesë - duket, përsëri neologjizëm i autorit, nga “nip-eshë), për të krijuar një sinonimi me fjalën “mbesë”, e çon plakën në kujtime rinie, kur ishte e njomë si kalliri “shtalp/b” i grurit dhe provon dashurinë e ngrohtë si dielli. Në vargun e tretë parafundit, vetë mbesa (nipesha) e quan veten siç e thërriste “babagjyshja” dhe vëren se si humbi e përmallueme në kujtime e ngrata (e mjera). Janë kombinuar tek ky fragment rendi i drejtë sintaksor (S + P + O + C + A) me rendin emfatik (P + S + O + C = A / O + P + S + C + A etj.)

*(...Në kalim po marr me vete / sall duert e mija prej mëndashit të bardhë / që të baj kunora rrajësh me hjekë merzin / atje ku shkoj. / Në zungthat e thatë te buza e kënetës / zanin tem po u la. / zanin tem, therra iriqi, / gerhatjen e këmishës së vjetër tue u shkyemun, / klithmen e qymeve të kalit në lahutë, / që në veri t’ushtojnë në ket vend / kundra bubullimave të motit në vjeshtë. / Ndoshta s’kam me vdekë njimend...)*  
 (“Zanin tem po u la”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 246).

Gjithë pasazhi poetik që po sjellim këtu, ndërtohet me fjali njëshe, pa subjekte (kryefjalët përkatëse), dukuri që e lejon shqipja, falë sistemit të zgjedhimit të saj të parrafshuar; mungesa e kryefjalëve referente lë gjurmët tek mbaresat vetore: janë 6 folje të shtjelluara, nga koha e tashme deri tek e ardhmja e veçantë e tipike vetëm në idiomën gege si formë analitike (kam me vdekë), me vlerën “do të vdes”. Është si një testament i autorit për vendin dhe njerëzit e vet, një rrugëtim në dy jetët, por që “kunorat”, “zungthat”, “zani”, “këmisha e vejtër”, “qymet e kalit në lahutë”, “oshëtimat” dhe “bubullimat” kanë për ta mabjtur gjallë ende! Pamja ka gjithë jetën e poetit, nga fëmijëria deri në sosje të saj, shprehur me një leksik të vendit të tij, ku lindi dhe vazhdojnë të jetojnë njerëzit e tij. Në planin sintaksor ka ngjeshje gjymtyrësh funksionale me rend të përmbysur, siç ngjet nga vargu 6-9 i fragmentit, ndërsa 5 vargjet e fundit, në mënyrë simetrike, kanë adjunctive (rrethanorë) të ndryshëm.

*(...Ky asht jo vetëm këshill, por edhe urdhnesë: / vetëm për kureshti / me ditë dredhitë mjeshtrorë përmbas Iterit t’hyjit / mos u nis për Delf, as për Dodonë: / ma mirë rri në shpi...)* (“Këshille të një prifti pagan”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 261).

(lter,-i: altar, lat. "alte" - i lartë + ara - therore; it. "altare") 1.ark. rrasë mbi të cilën në kohët e lashta u bëheshin flijime perëndive; 2. rlg., "tryezë në kishë" ku thuhet mesha dhe bëhen shërebesat e tjera fetare; 3. fig. simbol i sakrificës dhe i flijimit.

Këtu fjala "urdhëresë", pas asaj "këshillë" në shtie në mbretërinë hyjnore; vetë këshilla/urdhëresë zë 4 vargjet e fundit të fragmentit të sjellë këtu, për t'u përforcuar si leksik i fushës edhe me çiftin "lter/hyj", pastaj duke zbritur në botën politeiste (parakristiane) me mitin helen, që jepet me emrat e përveçëm: Delf/Dodonë, për të cilët gjejmë shpjegimet më poshtë:

D e l f -i, qytet i Greqisë së Vjetër, në Fokidë, në rrëzë të malit Parnas. Në kohën homerike (shek.XI para Krishtit), quhej Pito dhe konsiderohej si qender e globit tokësor, si kërthiza e botës. Ishte qendër fetare, e përmendur për orakullin e tij dhe faltoren e Aplonit...(Todi Dhama, Fjalor i Mitologjisë, Tiranë, 1987, f. 63);

D o d o n ë-a, orakulli më i vjetër, që, sipas historianëve të lashtë, ndodhej në vendin e molosëve (fis ilir i Shqipërisë së Jugut), 20 km në veri të Janinës, edhe qendër shumë e vjetër e pellazgëve. Herodoti shkruan se e gjithë teologjia pellazge rrjedh nga Dodona...Orakujt e faltores së Dodonës profetizonin duke shtënë fall me fluturimin e pëllumbave etj. Në Dodona oraganizoheshin lojëra për nder të Zeusit, që quheshin Naios. (Todi Dhama, Fjalor i Mitologjisë, Tiranë, 1987, f. 72).

Në pikëpamje sintaksore, vargu i parë ka dy kallëzues emërorë radhazi, të bashkuar me parataksë kundërshtie me anë të lidhëzës "por", por i dyti me elipsë të këpujës "është", që shton ritmin e leximit; kurse vargu 3 sjell në funksion formën e pashtjellë me paskajore gege "me ditë", e cila, në variantin e shkruar e të përpunuar të Veriut, mban shprehjen më tipike të marrëdhënieve qëllimore midis përbërësve predfikativë të njëpasnjëshëm dhe jo vetëm këtu, por edhe për marrëdhënie të tjera aq të spikatura, si janë ato kushtore.

\*\* Duhet të vemë në dukje se në ndërtimet sintaksore shkrimtari ynë duhet renditur si përdoruesi i *dukurisë së l'enjambement*.<sup>422</sup>

*(...Kishte ardhë për mik një njeri i hajshëm / e i zbehtë si letra / Thoshin se ai me dorë të vet kishte vra / tre vetë e tash asht pendue. / E më kujtohet si dje / qeleshja e tij e bardhë, / një sumbull e kuqe në kraholin e zi / e sjellja e përvujtë e ndeja e tij në shkam / pranë votre para një tryeze të vogël: / një të katërt bukë misri e 'i grusht*

422 T. Topalli, *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011, f. 276. L'enjambement / përkalim/ term që vjen nga një fjalë frenge që shënon hedhjen në fillim të vargut vijues të një a disa fjalëve.

*krypë / kishte përpara - si mbas dëshirës së tij. / Kojet e bukës krisshin nën dhambët e njeriut / që përtypte trishtueshëm, njerzishëm / e me shije...*) (“Kishte ardhë për mik”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 26).

Fjalori i gjuhës shqipe, 2006, lemën: *i hajshëm* e shpjegon: i hollë në trup dhe i hequr në fytyrë, por i shkathët; i thatë: djalë i hajthëm; me duar të hajthme.

Kurse fjala sumbull-a, ka këto kuptime:

1. kopsë e vogël si rruzull: sumbullat e jelekut; /rruzull ose rreth i vogël prej metali, që përdoret për stoli: parzmore me sumbulla prej tunxhi.
2. Bot. syth.
3. Bulë uji a lëngu tjetër: sumbulla lotësh (djerse).

Në këtë sekuencë gjuhësore, është gjendja psikike e një vrasësi: i zbehtë si letra, sepse nuk ka gjak në fytyrë, ai ka derdhur gjakun e një njeriu, prandaj është zbehur.

Ky pasazh ndërtohet mbi bazën e kontrasteve dhe krahasimeve, si: qeleshe e bardhë/sumbull e kuqe (gjaku i derdhur i njeriut), referim për sferën shpirtërore të njeriut pa mëkate e krime shoqërore si vrasësi i paraqitur këtu; atij i duhet të hajë me përvujtni dhe njerëzi bukën e dikujt, por pa iu hequr nga mendja vepra e kryer, prandaj dhe bie në trishtim - shfaqje që autori e jep me penelata leksikore, si me ngjyra. L’enjambement = (...kishte vra + tre vetë)

*(...Andej e këndej lumit shkambij / të bardhë e me rrasa të gjana. / Vetmija luente me rrezet e diellit / në pusat e ndritun t’ujit. / Atje vetëm vojta me gjuejtun shejin. / Kisha mazerren nën krah / e hija eme e vogel në mjesditë ecte për anë / e zemra eme e madhe matet me lisa. / Vuna pushkën në faqe: / gishti tregues ngrehte kamzën kadalë / e mandej fluturoi shkëndija /prej synit në thumbin e tytës / e në shkamb përtej plasi dingau! / Ushtuen humneret një mbas një: / me dy brijat e malit mirrsha frymë / e u ndala pa britë hiuhaa!...)* (“Andej e këndej lumit”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 62).

Nis fragmenti me fjali emërore në dy vargjet e para, vijohet me një fjali dyshe foljore, kurse më pas kalohet në fjali njëshe në 5 vargjet e tjera, përsëri alternime me fjali dyshe për t’u mbyllur me dy fjali njëshe foljore vetore të caktuara (I), rendi vjen përgjithësisht asnjans, sepse ka përshkrim të thjeshtë jo emotiv; dallojmë stilemat “marr frymë me brija mali”, “matet me lisa”; ka antonime si “hija e vogël”, “zemra e madhe”,

gjejmë këtu një të dhënë etnografike për shenjën që gjuhet kur njerëzit dalin nga kisha, në vendin ku dallohen shejtarët; pa harruar dukurinë e l'enjambement-it, si në vargjet 1/2, 10/11.

*(...Bota asht një rrotull që sillet rrethas / me turr. Ndoshta rrugës ajo humb sende / shum, pa u kujtue aspak. / Dhe na sillemi me njimij rruzullime / në parzëm rreth saj e ndezemi e digjemi / e me flakën tonë ushqehet koha / e shekullit XX - dy iks - / trajtue me tymin e zjarmit tonë...)* (“Bota asht një rrotull”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 75).

Gjithë poezia thuret mbi dukurinë l'enjambement, mjaft të thyera nga ana sintaksore, midis vargjeve 1/2, 2/3, 4/5, 6/7 dhe 7/8; janë 5 shfaqje të tilla në 8 vargje, të cilat kanë një ritëm të veçantë, duan një lexim tjetër, sepse 3 fjali janë gjithsej. Fjalitë dalin dyshe, të qarta në kumtim dhe përfshirëse, në numrin shumë.

*(...Nji, dy udhtarë në heshije / vrej në vendet që zhduken. / Dy udhtarë përtypin mendimet e vjetra / me ngjyra të reja mes andrrës e zgjimit, / prej malit në luginë, prej dheut në dritë. / Fishkllima e erës së detit / mbi maranxhet e verdha, / kanga e dashunisë mbi epshin / e shuem pardje ndrit fëtyrën e grues / së pashme në fillin e rrezeve / mes dy nëndheusave që mbulojnë / skuqjen e mollzave...)* (“Nji dy udhtarë në tren”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 97).

Bien në sy në këtë fragment stilemat “fill i rrezeve”, “përtypin mendimet”, “vende që zhduken”, dhe krahas këtyre dy fjale krejt të rralla: “maranxhë-a”, dhe neologjizmi “nëndheusë-a”, e cila, më tepër se “nëndhesë-a”, shpjeguar në Fjalorthin e opusit të Camajt, mund të merret si krijim i autorit për “metro” apo “tunel”, pa lënë jashtë bashkimet sintaksore me tejkalim (l'enjambement), si në vargjet 6/7, 8/9, 9/10, 11/12, besoj se shkrimtari ynë duhet renditur si përdoruesi më i madh i dukurisë që po vëmë në dukje (l'enjambement). Mbizotërojnë në këtë pasazh fjalitë dyshe, që e bëjnë më të qartë kumtimin e ligjërimin në përgjithësi.

*(...Ai shpend i natës, i lum / e di se asht nën gjethin milzës / e prët hanen e re. Kur vjen nata zanin ia njeh / i madh e i vogël dhe vajza që lyp fëmij / nepër barin e kopshtit. / Mbi degën e qarrit në terr / asht silueta e një peme së pjekun. /*

*Edhe kanga e tij asht e mungët. Mungar / i të gjitha kohnave shklet mbi rrenoje / monasteresh e pasha e kambës a e lehtë. / Bletët në zgjue lëvizin mija e mija fletë / të ngritun njana mbi tjetrën mbi krye. / Fryma e krahëve ka aromën e lule-trumzës / së egër e fletnjomë, / që dridhet ndër curra prej erës së muzgut...* (“Ai shpend i natës, i lum”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 120).

Vargjet 3/4 dhe 4/5, 9/10, 10/11, 11/12, 13/14, lidhen sintaksorisht me dukurinë e l’enjambement, që shmang pauzën midis vargjeve poetike, përshpejton ritmin poetik dhe përveçon një stil që formëson atë që quhet stili i shkrimtarit. Është pamje midis natyrës: me shpend e fletë milze, por edhe me fëmijë e vajzë në qendër të saj, si motiv i përjetshëm, ashtu si janë murgjit - banorë të monastireve rrenoje, që shkelin lehtë-lehtë.

*(...Ndjesitë e mija rrjedhin e humbin / në buzëqeshjen tande t’idhtë. / çohen njimij zane / - shpatza badrash të pjekuna - / kur dëshirave u thue jo / përmbrenda. Mandej vjen shiu / e majet e badrave zbuten. / Mes flokëve të zez e vetullave / e ndali shikimin / për të gjetun fillin e të vetmes poezi / të kësaj moshe seme djegagure...)* (“Koha e lules”, Pjesa V e ciklit, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 125).

Pasazhi vjen si fragment i ciklit të mësipërm, ku peshën semantike e mban fjala kompozitë “djegagur”, e cila, më shumë se për pikun e vapës së gushtit, ka lidhje me moshën e heroit, kur adoleshentit a të riut, i ndizen në shpirt dëshira të zjarra dhe shpërthen në poezi! Është një dashuri (dëshirë) pa përgjigje nga ana e vashës, që thotë përherë “jo”; dukuria l’enjambement që ndeshim këtu (në vargjet I/II, V/VI, VIII/IX, IX/X), sikur këput vijimin e mendimit poetik për të thurur të vetmen poezi të kësaj moshe që digjet e përvëlohet zhari.

*(...Gjerza, e vetmja njollë / në qiellin e ndritun të Jugut / zgjon në mue ndjenjen e hapsisë / që mata dikur me vargun / e korrlave n’udhtim. / Krizmat e kaçubave në erë / bri prronit të thatë / e jehonat e larga të zhumhurit / t’ujnave që ishin të turbullta / vejnë kufij mes qenjes seme tash e dje, / mes andrrës e gurit që e çoi prej dheut / dhe e tres në grumbullin e zhurit. / Marrfrymja e qetë, grue e mbështetun / në bar, në valën e parmzit tand m’avyt / prej majeve të bimve e ndër gishta / fjetet e indit / të një pëlhure t’unjishme...)* (“Grue e mbështetun në bar”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 146).

Ngjan kjo poezi e Camajt me një fragment proze migjeniane me titull “Puthja e Cubit”. Është pamja e një njeriu që, ulur në kurriz, me sytë nga qielli vështron hapësirën e pamatë, duke e kufizuar me vijën që bëjnë korrilat në kaltërsinë e pafund. Nga ky përshkrim në vetën e pare (sikur është vetë poeti), kalohet në rrethana zhurmuri të ujnave të turbullta, që vënë kufij tek një qenie endërrimtare aty, me shikim nga qielli; pastaj, papritur, neologjizmi “marrfrymja” (frymëmarrja) i vishet një gruaje, që, edhe ajo, shtrirë e me parzëm (gjoks) lart ëndërron, duke mbajtur fije bari midis gishtave, të cilat ngjajnë si inde të korpit të saj brenda një pëlhere në shtat! Ka edhe këtu dukuri të fenomenit l’enjambement, si në vargjet 4/5, 8/9, 13/14, 14/15 dhe në dy vargjet përmbyllëse; sigurisht, janë teknika jo të lehta të thurjes poetike, që aq saktë i zotëron Camaj.

*(...Erë e randë, amë drandofilleth / të veshkuna, shpërthen prej mureve / të klostrit / me një burim mjedis / në zemrën e pallatit mesjetar. / Marimangat matin me mija metër / skundillet e freskave të lashta / për ditë. Heshtimi mishnohet / në kambët e marimangave...)* (“Passio vestra pulchritudo”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 149).

Është zbërthimi i një maxime latine (Pasioni i bukurisë tuaj), një mjedis muzeal manastiri, me erë të rëndë, pasi trandofilat janë veshkun; në pamje stili, vargu I/II dhe II/III kanë një l’enjambement të goditur, ashtu si në ato 7/8, ku vargu “Merimangat matin me mija metër/skundillet e freskave të lashta/për ditë...” Është ajo dukuri sintaksore poetike, zakonisht, kur vargu vijues plotëson vargun e gjymtë paraprijës në rrafshin kuptimor. Përsëri këtu, autori operon me fjalën “amë” në kuptim “ere”, “duhme”, ashtu si përdor ndërkohë edhe leksemën “heshtim” - një emër prejfoljor nga folja e idomës gege “heshtoj”, në vend të emrit “heshtje-a”; po kështu elemente stili vijnë e bëhen edhe sintagmat: era shpërthen, në zemrën e pallatit, merimangat matin (personifikim me një folje që do të kërkonte subjektin “njeri”), skundille freskash, heshtimi mishnohet etj.

Si përfundim, mund të themi se shkrimtari-poet të gjitha e gjithçka i arrin me anë të gjuhës, përdorimit të saj me mjeshtri dhe me efekt të lartë shprehësie, të kursyer dhe me *fjalë-çelës*.

\*Duke tërrahur leksikon e Camajt, të bie në sy krijimi i vatrave leksikore me funksione të caktuara, për t’u dhënë thënieve a segmenteve ngjyresën e duhur e të kërkuar sipas synimeve të autorit; duke krijuar atë që për shprehësinë e kësaj fushe quhet *variacion*

*në rrafshin e përmbajtjes dhe variacion në rrafshin e ekspresivitetit.*

\*\* Në krijimtarinë e këtij shkrimtari-gjuhëtar gërshetohen në mënyrë të harmonishme trajta dialektore e tipit “ me punue” me atë të standardit “për të punuar”. Tek ky shkrimtar i Veriut gjejmë një pasuri shumë të gjerë të përdorimit të foljeve në të tashmen, të kryerën e thjeshtë, të pakryerën, të kryerën e tejkshuar dhe format perifrastike të ndërtuara me “duke + përcjellore’.

\*\*\* Teksti dhe hiperteksti i Camajt, sa i ngjyruar, hermetik dhe me oshëtimë, siç është në poezi, vjen i shtruar në prozë, me fjalën e gjetur e të qëlluar; me kombinime të përshkrimit të veprimit, me peisazhe të këndshme të përshkrimit e të veprimit, të gjitha këto autori i realizon me ndërtime të shkurtra sintaksore, me ndërtimet e drejta, ndjekur ose nga fjali të tjera drejtuese apo vargje fjalish të varura të cilat mund të dalin ose me parataksë, ose me hipotaksë apo me alternime të bashkimeve të para e të dyta etj. Ndërsa në krijimet poetike kemi vënë re se tek shkrimtari ynë gjejmë një përdorim të dendur të dukurisë së bashkimit sintaksore me tejkalim, siç quhet (l’enjambement).



## KREU VII

### 7.1. PËRFUNDIME

Martin Camaj është një emër i veçantë në letrat shqipe, ku bashkohen shkrimtari e gjuhëtari - madje, në këtë fushë që e kemi parë ne, ai lëvroi: historinë e gjuhës, dialektet sociale, etnografinë e të folurit etj. Ky gjuhëtar u bë objekt studimi i temës sonë të doktoratës.

#### I.

1. Gjatë punës sonë kemi vërejtur - dhe po e vemë në dukje si pikë të parë - se, krahas veprës monumentale, në prozë e poezi (fusha e letërsisë), Camaj ka ngritur edhe një monument për gjuhën shqipe; është fjala për prurjet e reja, në disa drejtime, të cilat dëshmojnë jo vetëm pasurinë e thesarit gjuhësor të së folmes së tij e më gjerë, por kryesisht për vlerat që përmban vepra e tij, sa i takon mbarë gjuhës kombëtare.

2. Këtë prurje të pashterrshme që na ofron opusi letrar i Camajt, do ta shohim në dy plane; për shkak të veçorive që ngërthen ai, të pangjashme me asnjë krijues tjetër shqiptar:

a. *së pari*, Camaj, megjithëse u formua kulturalisht në shkollat lindore e perëndimore (Beograd, Romë, Mynih) - arriti të ndjekë procesin e zhvillimit dhe lëvrimin të shqipes në atdheun mëmë.

b. *e dyta*, vepra e tij - si prurje gjuhe e veçantë - u njoh dhe u vu në kontakt me studimet shqiptare, jo gjatë krijimit të saj, por vetëm pasi ai e kishte mbyllur si cikël shkrimtarie.

3. Pikërisht për këto dy këndvështrime, na duket për mbarë, të nënvizojmë se është detyrë e studimeve tona, që kontributin e këtij shkrimtari - gjuhëtar ta shohim e ta studiojmë në mënyrë shumëplanëshe, sipas të gjithave niveleve të gjuhës, kështu jemi përpjekur ta kryejmë këtë në lëmë të morfologjisë, për ndryshe të fjalëformimit, dhe të shprehësisë stilistike, që vjen jo vetëm nga ky fjalëformim e neologjizmat e krijuara, por më së pari, për peshën e veçantë e valencën stilistikore, sintagmatike në përbërje tekstore e kontekstuale.

Për këto arsye ne u ndalëm në sistemin fjalëformues tek gjuha e Camajt, që përfaqëson jo vetëm idiomën e arealit të vendilindjes së tij, por edhe ato veçori që karakterizojnë një hapësirë më të madhe: të folmen VP të dialaktit gegë.

4. Në formimin *parashtesor* kemi arritur në përfundimin se parashtesa *për-* është mjaft prodhimtare në veprat letrare të autorit, duke ndjekur kështu prirjen kryesore të shqipes, sa i takon formimit të fjalëve të reja me ndajshtesa.

- Me anë të këtij formanti aq prodhues, në veprën e Camajt gjejmë një denduri të pazakontë përdorimi të ndërtimeve sipas kategorive leksiko-gramatikore: *emërore, foljore dhe ndajfoljore*, por më produktive vihet re kjo parashtesë tek ndërtimi i *mbiemrave*.

- E veçanta që sjell shkrimtari në fjalëformimin me anë të ndajshtesës *për-* janë leksemat e reja që ai përdori në krijimtarinë e vet letrare, si: *e përfrigueshme, e përndalun, i përkënaqun, e përलगun, të përलगштë, e përdhunshme, i përngeshëm, i përmoçëm, përvështirësoj, përndal, përngeshëm, përngadalë, etj.*, të cilat jo vetëm nuk gjenden në Fjalorët shpjegues të shqipes (nga 1908 - 2006), por në kontekste të caktura të shkrimtarisë së autorit tonë, marrin kuptime të reja dhe, sidomos, ngjyime të caktuara.

- Parashtesa *për-* përdoret me kuptim përforcues me idenë e një veprimi të zgjatur duke marrë nuanca stilistikore, edhe kur përdoret nga stilisti i gjuhës, Camaj, si:

► **e përfrigueshme** (...Përse *kaq ngut? A e di ndokush se kush ashtë? Qenka aq e përfrigueshme* fytyra e tij, përfytyrimi i të cilës do t'u kishte turbullue edhe gjumin?...Kandili i argjandit, f. 97). Ndajshtesa *për-* tek leksema **e përfrigueshme** intensifikon në shkallë më të lartë tekstin, por asaj i vijnë në ndihmë edhe elemente të fonostilistikës, si: përsëritjet e njëpasnjëshme të bashtingëlloreve **k** e **sh** e të zanores **u**, të cilat e bëjnë situatën edhe më të mistershme.

► **e përdhunueme** (...Vitoit, vajza e pëllasit i mbeti në përfytyrime do kohë me parzëm pak të shpërvjelun, si martire e përdhunueme dhe e përgjakun ashtu si paraqiten ndër freska kishash të vogla në fshate të lëshueme të rrethinës ...Shkundulima, f. 101). Leksemat e përdorura në segmentin e veçuar, si: *martire, freska, kishash, ikona* dhe aktivizimi i gegizmave “parzëm-i” (gjoks-i) dhe “teshë-a” (rrobe-ja”), e bëjnë krejt të veçantë frgmentin e sjellë më lart dhe

zgjerojnë krahasimin midis vajzës së pëllasit dhe martirës besimtare, që flijohet deri në dhunim e përgjakje nga stoicizmi në besimin e saj. Përqasjen e dy mbiemrave e **përdhunueme, e përgjakun** Camaj e ka shfrytëzuar për të krijuar sinoniminë kontekstuale.

5. Në krijimtarinë letrare të Camajt parashtesa **pa-** zë vendin e dytë për nga denduria e përdorimit.

- Ajo është produktive në formimet *emërore* nga tema emërore të parme e jo të parme, si: **pakujdes, pafaj, pabestar, papërndalje, papajtim, palëvizja, pauti, paburrni, pafajsi, padrejtësi, padurim, pasiguri, pavarësi, parregullsi etj.** Më pak prodhimtare kjo mënyrë fjalëformimi del në ndërtimet ndajfoljore: **pamjeshtrisht, pakujtueshëm.**

- Camaj përpiqet të ndërtojë leksema të reja duke ndjekur së pari prirjen fjalëformuese të shqipes, por edhe duke u bazuar tek ligjërimi popullor, si: **papërndalje, pafaj, pabestar, papajtim, palëvizja** (fjalët: *papajtim e palëvizja* i gjejmë të pasqyruara në fjalorë të ndërtimit me parashtesën mos-: *mospajtim, moslëvizje*).

6. Ndajshtesat *stër-, shpër-, mos-, nën-, para-, mbas-, sh-, zh-, ç-, xh-, a-, dis-, lë-* kanë gjetur një përdorim më të paktë nga pena e Camajt,.

7. Vlen të theksojmë se këto parashtesa edhe pse kanë një përdorim më të rrallë në krijimtarinë letrare të Camajt, përsëri autori përpiqet që në bazë të modeleve fjalëformuese të shqipes të krijojë fjalë të reja, si: **i stërpjekun, i stërkallëzuem, shpërgojim, mosbesueshëm, i shzemruem, e çshkujdesshme.**

- Shprehësi më të lartë arrijnë leksemat e formuara me ndajshtesat: *stër-, shpër-, sh-, ç-*.

► **shpërgojim** (...*shpërgojimet delnin e zhvilloheshin ndryshe prej atyne që mbijnë ndër vende të thukëta banesash ku gjindja shkon e vjen tue u ndeshë disa herë në ditë dhe secili i shton thanjes një fjalë ashtë se, tue i shtue secili ngjarjes diçka çka i bie ndërmend, e paqenuna bahet e qenun mbrenda njëzet e katër orëve.* Përkundra, atje nalt një motiv **përgojimi** tirret e merr trajta të qarta në rrethana

vetmie ku një njeri i vetëm e peshon atë nga të gjitha anët, e *tëhollon* e *kullon* çdo gjasë e mundësi se ngjarja paska lindë e qenka zhvillue kështu e kështu Pishtarët e natës, f. 17).

Thashethanat dalin këtu në përshkrimin e tyre si ujërat e disa burimeve, derisa shtohen e rriten e bëhen lumë, me përgojime e shpërgojime, duke marrë pamjen e një cikli kangësh, si ai i kreshnikëve të eposit tonë. Kjo jepet me një leksik të veçantë e grupe fjalësh shprehje që vetëm autori di t'i përshkruajë: secili i shton thanjes një fjalë ose një shej me sy e duer (me anë të të folurit verbal dhe joverbal), e paqenuna bahet e qenun, përgojimi tirret, e peshon e tëhollon dhe e kullon fjalën (me anë të shkallëzimit të veprimit drejt intensives).

8. Fjalët e prejardhura të formuara me *prapashtesa* janë të shumta në veprat e tij letrare, duke ecur kështu paralel me formimet e shqipes standarde. Numri i ndajshitesave të përdorura është relativisht i madh, por formanti **-shëm** paraqitet më i larmishmi dhe më prodhimtari në ndërtimin e ndajfoljeve.

- Në krijimtarinë e Camajt me anë të ndajshitesës **-shëm** kryesisht nga *tema foljore* ose pjesore, pak *emërore* e *mbiemërore* janë krijuar **ndajfolje**, të cilat nuk u përgjigjen *mbiemrave* me temë me **-shëm**, si: **përpishëm, mpishëm, përkundshëm, mjegullueshëm, mejtueshëm, pusishëm** (leksema të përdorura kryesisht në krijimtarinë e Camaj), *ngathshëm, nynyrueshëm, përpishëm, përkueshëm, pusishëm, spetullueshëm, ngulshueshëm, zashëm, kokrrueshëm* etj. Shkrimtari arriti ta pasuronte leksikun e veprave të tij duke përdorur leksema me prapashtesën **-shëm**, ndërkohë që në fjalorët normativë i gjejmë me ndajshitesat **-as, -isht**, si: **ngathshëm**-ngathtësisht, **mpishëm** - mpitas, *preshëm* - prerat, **idhshëm** - idhtas, *idhtazi*, **denjueshëm** - denjësisht; **rrëmbyeshëm** -rrëmbimthi etj.

- Autori tek ndajshitesat që formojnë ndajfolje përzgjedhi ndërtimet me prapashtesën **-shëm**, pasi ato shprehin ngjyrimë të ndryshme kuptimore, fitojnë vlera stilistikore të rëndësishme në të shprehurit letrar. Por mendojmë se përdorimi i dendur i shumë leksemave me prapashtesën **-shëm**, vende-vende kur denduria e tyre është në largësi të shkurtra sintagmatike, sikur e rëndon stilin e shprehësinë e tekstit në mjaft pasazhe gjuhësore e sekuenca narrative. Për ta thyer këtë pasojë stili që lidhet me nënsistemin e fjalëformimit, disa krijues, këto formime i japin në një pjesë të mirë me parafjalën “me”, pa ndryshuar natyrën ndajfoljore; p.sh.: shijueshëm - me shije, përgdhelshëm - me përkëdheli, hijshëm - me hijeshi etj.

9. Ndajshitesa **-(i)sht** është prapashtesa ndajfoljore më prodhimtare në shqipen e sotme letrare. Ndërsa në krijimtarinë letrare të Camajt kjo ndajshitesë zë vendi e dytë për nga përdorimi. Me të janë formuar *ndajfolje* nga tema jo të parme me *-(ë)si, -ri, -i, -im*, të cilat janë leksema të mbarë shqipes, si: *mirësisht, rastësisht, qetsisht, egërsisht, gjerësisht, imtësisht, trimnisht, besnikërisht, parimisht, qëllimisht, gabimisht, shkurtimisht, shpirtnisht, fuqimisht etj.*

10. Një ndajshitesë tjetër e përdorur në veprat e Camajt është edhe prapashtesa **-as**.

- Ajo del më prodhimtare në ndërtimin e **ndajfoljeve** nga tema *mbiemërore*, si: *vutas, thuktas, kryeneças, trashamanas, rrebtas* (këto ndërtime nuk dalin të pasqyruara në fjalorët e marrë në krahasim, por ato mund të jenë forma dialektore që gjallërojnë në vendlindjen e Camajt dhe përcaktimi nëse janë neologjizma të tij del mjaft i vështirë).

- Këto leksema të krijuara nga Camaj në kontekstin ku përdoren marrin një ngjyrim stilistikor.

11. Veprat letrare të Camajt kanë një pasuri të madhe formimesh emërore të ndërtuar me anë të ndajshitesës **-im**, si: *gjinim, gjygjim, erëtim, flakim, përgojim e shpërgojim, kundrim, rrugim, rrotullim, blerim, argëtim, durim, dimnim, drejtim, largim, harrim, kullim, frymëzim, ankim, kallzim etj.*

- Tek kjo mënyrë fjalëformimi duam të vëmë në dukje përpjekjen e autorit në ndërtimin e fjalëve të reja jo më nga tema foljore, por edhe nga ato emërore, si tek leksema *gjinim*, ku tema foljore *gjino* që mund të mendojmë se ka ardhur kjo fjalë nuk del e dhënë në fjalorë.

12. **Prapashtesa -ues**, është shumë prodhimtare në gjuhën e sotme të njësuar letrare. Në krijimtarinë letrare të Camajt me anë të kësaj ndajshitesë formohen **mbiemra** përkatësor nga tema foljore, si: *mëkatnues, avullues, psherëtues, lëngues, randues, vëzhgues, gjurmues, qortues etj.*

- Në ndërtimet e mësipërme po veçojmë lemat: **mëkatnuese, avulluese, psherëtues** për të cilat është i vështirë përcaktimi nëse janë lema të krijuara nga autori, apo janë fjalë dialektore.

- Këto leksema marrin ngjyrim stilistikor duke u përdorur si pjesë e figurave letrare.

13. Prapashtesat zvogëluese: **-th, -z(ë), -z** kanë denduri përdorimi në veprat e Camajt duke i ringjallëuar këto mjeteve fjalëformuese, por gjithashtu u japin fjalëve edhe ngjyrimet stilistikore, si: *njomëzë, rrymëz, vashëz, lodrëz, bishtajzë, gropëz, zogth, djalth, katundth* etj.

14. Përdorim më pakët kanë ndërtimet me ndajshitesat: **-ak, -acak, -ac, -an, -ash, -thi** të cilat veç kuptimit zvogëlues a zmadhues kanë edhe kuptimim pejorativ, si: *spjerrak, pjellak, pusak, përtac, shurdhac, endacak, erdhacak, shkjepan, breshkan, gojash*.

15. Në formimin e fjalëve me mënyrat e përziera, kemi vënë re se ndërtimi: *nyjëzim e prapashtesimin njëkohësisht* del më prodhimtari në krijimtarinë e Camajt, ku prapashtesa *-shëm* del më e përdorura, si: ***i shkëitshëm, i burrueshëm, i vetueshëm, i nënzashëm, i ndërhundshëm, i mbërrelshëm, i unshëm, i etshëm, i devotshëm, i dhimbshëm, i shkëlqyeshëm, i turrshëm, i pushueshëm, i lavrueshëm, i nëndheshëm, i kueshëm, i lëngueshëm, i erandshëm, i rrezikueshëm, i plleshëm, i mungulleshëm, i gëzhatshëm, i brohoritshëm, i lazdrueshëm, i andshëm, i murtajshëm, i mënershëm*** etj. Përcaktimi nëse fjalët e nënvizuara janë krijim i autorit del i vështirë, ato mund të jenë pjesë e ligjërimit popullor.

16. Më pas kemi përdorimin e fjalëve të përbëra të tipit *kompozim + ndajshitesim*. Prapashtesa më e parapëlqyer e Martin Camajt në ndërtimin e këtyre kompozitave është *-as* dhe më rrallë ajo *-ës*, si p.sh.: ***ndjellakeqas, kambagjelas, mirakandas, kambë-sharavelas, gazakeqas***.

17. Një mënyrë fjalëformimi mjaft prodhimtare jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në veprat letrare të Camajt është *kompozimi*. Më prodhimtare na është paraqitur kjo mënyrë tek ndërtimi i mbiemrave me lidhje nënrenditëse që quhen ndryshe edhe *kompozita pronësore ose bahuvrihi*,<sup>423</sup> më të pakta janë kompozitat bashkërenditëse.

● Camaj për krijimin e kompozitave (neologjizmave) mbështetet tek prirja kryesore e shqipes. Më prodhimtarë ai ka qenë në ndërtimin e fjalëve të përbëra të formuara nga temat: *emër + pjesore, emër+emër, emër + emër prej foljor vepruesi*,

423 A. Kostallari, *Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*, në "Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", Tiranë, 1972, f. 141.

*emër+mbiemër* si: *lukth-shtjerrë, këmish-shkyem, krye-thijun, kryeshpuem, zamarrun, ballëshpërvjelun, kurrizlakuem, gojëplakë, vdekzotit, buzana, flokrupç, vdekje-krizëm, ora - gjarpën, gju-fortë, zanalte, truerrët, buzëmprehtë, frymë-mirë, mrekkullibamës, fatlumësi, bestytës, ujëpërçues, jetprues etj.*

• Në krijimtarinë e Camajt kemi kompozita të ndërtuara nga tema *emërore + ndajfoljore, ndajfolje+emër, folje+emër, temë pjesoreje+temë ndajfoljore, numëror a përemër i pacaktuar dhe një mbiemër*, të cilat janë më pak produktive jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në krijimtarinë e Camajt. Këtu po veçojmë ndërtimet: *fshehësiplotë e mirëtingëllim, bjerraditës, mbushmendja, mbamendja, djegagur, rrokaqiellë, bakeq, shtirakeq, dhjetëvjeçar, dyfaqesh, tridegësh etj.*

**18.** Fjalët e përngjitura tek Camaj na dalin më prodhimtare në ndërtimin e *ndajfoljeve*, si: *përdore, përkrye, përmajë, përditë, përjetë, përdhunë, përmaal, përtokë etj.* Në këtë grup kanë paraqitur interes edhe ndërtimet e ndajfoljeve të përngjitura: *gjithnatën, gjithëditën, gjithdimnin* të cilat në gjuhën letrare i gjejmë të përdorura në togun gjithë (përemër i pacaktuar) + emër (në rasën kallëzore) i kaluar me konversion në ndajfolje. Këto ndërtime vihen re si veçori e gjuhës së shkrimtarit për të dhënë forma të reja të formimit të fjalëve të përngjitura.

• Më pak të përdorura janë fjalët e përngjitura që përdoren si *emra*, p.sh.: *thashethana, sendërtim, terramot, kamot, nëpunës, farefis etj.* (emra) dhe *përemra* më pak, si: *gjithçkafja, sendegja dhe faregja* të cilat nuk na dalin të pasqyruara në fjalorët e marrë në krahasim.

## II

1. Vepra letrare e Camajt shquhet edhe për ngjyresat ligjërimore. Shkrimtari operon në korpusin e përgjithshëm të veprave të veta me idiomën e variantit të shkrimtarëve më të përparuar të Veriut. Ai ka arritur të përdorë leksema, grupe fjalësh e frazeologjizma të atij areali që përshkruan e për të dhënë mjedisin e koloritit jetësor të banorëve. Por, gjithashtu, ai për të realizuar shprehësinë e duhur arriti të përdorte fjalë të leksikut arbëresh e ndonëse të rralla edhe të leksikut të huaj. Gjatë këndvështrimit stilistikor të tekstit gjuhësor të Camajt, kemi pasur para syve thënien e njohur të psikolinguistit Wittgenstein<sup>424</sup>, i cili shkruante që *fjalën të mos e shohim nga kuptimi, por nga përdorimi...*

424 L. Wittgenstein, *Filozofska istraživanja*, "Nolit", Beograd, 1980, f. 56.

2. *Gjuha e Camajt është një gegërishte letrare e kodifikuar me prirje afrimi ndër-dialektor*<sup>425</sup>, - shprehet gjuhëtari K. Topalli. Përpjekjet për një afrim të tillë duken edhe në sistemin foljor ku autori përdor trajta foljore të gegërishtes të tipit: me punue, por edhe ato të standardit: për të punuar. Denduri përdorimi ka edhe ndërtimi i së ardhmes me pjesëzën do, veçori më tepër e gjuhës letrare, por kemi ndeshur edhe format: *kam me pasë* me kuptimin e një të ardhmeje të largët, të cilat përshtaten këndshëm me mendimet që kërkon të pasqyrojë. Tek ky shkrimtar i Veriut gjejmë një pasuri shumë të gjerë të përdorimit të foljeve në të tashmen, të kryerën e thjeshtë, të pakryerën, të kryerën e tejshkuar dhe format perifrastike të ndërtuara me “duke + përcjellore”.

3. Në krijimet poetike kemi vënë re se tek shkrimtari ynë gjejmë një përdorim të dendur të dukurisë së bashkimit sintaksore me tejkalim, siç quhet (l’enjambement).

► (...*Kishte ardhë për mik një njeri i hajshëm  
e i zbehtë si letra.*

*Thoshin se ai medorë të vet **kishte vra**  
**tre vetë** e tash asht pendue.*

*E më kujtohet si dje  
qeleshja e tij e bardhë,  
një sumbull e kuqe në kraholin e zi  
e sjellja e përvujtë e ndeja e tij në shkam  
pranë votre para një tryeze të vogël:  
një të katërt bukë misri e ‘i grusht krypë  
kishte përpara - si mbas dëshirës së tij.*

...

*Kojet e bukës krisshin nën dhambët e njeriut  
që përtypte trishtueshëm, njerzishëm  
e me shije...* (“Kishte ardhë për mik”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 26).

---

425 K. Topalli, *Vëpra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, Simpoziumi “Martin Camaj, Tradita dhe bashkohësia”, Shkodër, 1994, f. 88.



► (...Bota asht një rrotull që sillet rrethas  
me turr. Ndoshta rrugës ajo humb sende  
shum, pa u kujtue aspak.

Dhe na sillemi me njimij rruzullime  
në parzëm rreth saj e ndezemi e digjemi  
e me flakën tonë ushqehet koha  
e shekullit XX - dy iks -

trajtue me tymin e zjarmit tonë...) ("Bota asht një rrotull", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 75).

Gjithë poezia thuret mbi dukurinë l'enjamement, mjaft të thyera nga ana sintaksore, midis vargjeve 1/2, 2/3, 4/5, 6/7 dhe 7/8.

4. Proza narrative (tregimtare) e Camajt karakterizohet nga ndërtime të shkurtra sintaksore, autori nuk shquan për struktura disashkallëshe parataktike e hipotaktike, por përshkrimi vjen i shtruar dhe me fraza me disa përbërës predikativë, që për sintaksën janë ndërtime që nisin me fjali drejtuese ose kryesore.

- Kemi vërejtur gjithashtu se në strukturën frazale të Camajt mbizotërojnë ndërtimet e drejta, siç quhen në sintaksë nisjet e periudhave me fjali drejtuese (për ndryshe QOS=qendër e organizimit sintaksor), ndjekur ose nga fjali të tjera drejtuese apo vargje fjalish të varura të cilat mund të dalin ose me parataksë, ose me hipotaksë apo me alternime të bashkimeve të para e të dyta.

(...Në bjeshkë e kan ndalë, e shtina në një tban, i hoqa armët, e lidha, kapa një hu të fortë dhe e kam rrahë mirë e mirë. Mandej e kam zgjidhë e i kam dhanë armët... Edhe i kam thanë qi mos t'i thojë njeriut të gjallë se as u s'i thom kuj për mos me shti në ngatrrasa as ai njerzit e vet as u njerzit e mij. Tue ecë rrugës, më suell pushkën me më vra...) ("Bestytunia" në *Vepra 10*, Tiranë, 2010, f. 83).

Me mënyrën e përzier kemi fragmentin e mëposhtëm:

(...Kola i lodhun prej punëve të ditës flente në atë kohë, por cubit iu ngjante se mbas çdo çube ase druni poe sheh tue dalë...) ("Bestytunia", në *Vepra 10*, Tiranë, 2010, f.85).

- Ndërsa ndërtimet e zhdrejta të cilat, më së shumti shërbejnë për abstraksion të mendimit, në raport me strukturat e drejta, janë më të pakta në prozën narrative të Camajt.

(...*Edhe pse ishte aq i unshëm, nuk e preku bukën...*) (“Bestytunia”, në *Vepra10*, Tiranë, 2010, f. 85).

- Po kështu, nuk janë të dendura ndërtimet sintaksore në veprat e Camajt strukturat me ndërkalje, që sa u takon përbërësve kallëzuesorë, dalin me relacione të largëta lidhjeje mediate (të ndërmjetuara), si në rastin e mëposhtëm:

(...*Zoga megjithëse e lirë, nuk iu dha të largohej: e ndiente veten si një copë dru, si njeriu që andërron se asht në rrezik dhe prap se prap s’mund të ndrrojë asnjë hap...*) (“Bestytunia”, në *Vepra10*, Tiranë, 2010, f. 85).

- Në veprën e Camajt kryesisht në prozë shpesh përbërësit frazalë vijnë e ngarkohen me rend gjymtyrësh, të cilat, edhe kur nuk janë funksionalisht homogjene, janë të një rendi si gjymtyrë të dyta.

(...*Ditën e mërkurë prej malevet të thata të veri-lindjes zbritnin malësorët tue ngrehë për laku lopë e dele, dhi e mushq të ngarkuem me djathë e tëlyen, lesh e lëkura, arra e lejthia, si dhe dru e qymyr, secili si mbas mundësisë e gjindjes së vet prodhuese...*) (“Jesminë”, në *Vepra10*, Tiranë, 2010, f. 94)

- Në një masë të caktueme ligjërimi i shkruar i Camajt vjen e ndërpritet nga dukuria e veçimit gjymtyrorë ose me fjalë të shkëputura, por edhe me fjalë e grupe fjalësh që kanë praninë e determinantëve (caktuesorëve), si p.sh.:

(...*Ata pesëdhjetë veta që ushtronin tregtinë edhe me katunde rreth kësaj qendre të vogël, si dhe hoxha në një anë e prifti në anën tjetër, bashkë me njëzet apo tridhjetë nëpunës, pjesa ma e madhe mësuese dhe edukatorë të shkollës fillore dhe të gjysmë-gjimnazit, vendosun në kazermën e vjetër të ushtrisë, sikur edhe tarikati i zejtarëve e quenin me andje këtë grumbull banesash qytet...*) (“Jesminë”, në *Vepra10*, Tiranë, 2010, f. 94).

Si përfundim, mund të themi që me anë të këtij studimi për fjalëkrijimin dhe shprehësinë ligjërimore të Camajt të kemi synuar të sjellim një ndihmesë sado të vogël për një nga gjuhëkrijuesit dhe lëvruesit më të shënuar të letrave shqipe. Kemi bindjen se te shkrimtari Camaj mund të gjejmë rastin e vetëm ku bashkohen në një emër gjuhëtari krijues dhe stilisti, i cili, përveçse ngriti një përmendore letrare, njëkohësisht pranë saj duhet të zbulohet edhe përmendorja gjuhësore.

## BIBLIOGRAFI

1. Agalliu, F.: *Formimet e tipit kompozitë + prapashtesë në gjuhën shqipe*, SF, 2, Tiranë, 1987.
2. Ajeti, I.: *Martin Camaj, Albanische Wortbildung. Die Bildungsweise der älteren Nomina, Vargu i edicionit: Albanische Forschungen, vëll. 6, Wiesbaden, 1966*, në “Gjurmime albanologjike”, 1, Prishtinë, 1968.
3. Alimhilli, Gj.: *Klasifikimi foljor sipas mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe*, Cosenza, 2009.
4. Altimari, F.: “Profilo bio-bibliografico di Martin Camaj, insigne figura dell’albanistica e della letteratura Albanese contemporanea”, *Albanica*, nr.2, 1991.
5. Ashta, K.: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I, Shkodër, 2000.
6. Ashta, K.: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1998.
7. Ashta, K.: *Leksiku historik i shqipes*, III, Shkodër, 2000.
8. Ashta, K.: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, V, Tiranë, 1998.
9. Belluscio, G. - Rrokaj, Sh. *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë, 2011.
10. Beqiri, Xh.: *Stili dhe gjuha e Martin Camajt*, AIKD, Prishtinë, 2007.
11. Boissin, H.: *Grammaire de l’albanais moderne*, 1975.
12. Breu W. / Sasse H.: *Vepra shkencore e Martin Camajt në fushën e gjuhësisë*, Hylli i dritës, Vjeti XXVIII, Nr. 3(258), Shkodër, 2008.
13. Buxheli, L.: *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008.
14. Buxheli, L.: *Emrat e veprimit me prapashtesat -im dhe -je në gjuhën letrare shqipe*, SF, 4, Tiranë, 1981.
15. Buxheli, L.: *Emrat foljorë me prapashtesat -esë, -më, -imë, -atë, -i*, SF, 1, 1984.
16. Buxheli, L.: *Rreth fjalëve të përngjitura në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 4, 1986.
17. Cipo, K.: *Rreth disa kompozitave*, në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve”, I, Tiranë, 1972.
18. Çausi, T. - Shkurtaj, GJ.: *Kadareja dhe fjala shqipe*, Tetovë, 2004.
19. Çiraku, Y.: *Martin Camaj si përcjellës dhe krijues i një tradite*, në : “Shqyrtime kritike nga historia e letërsisë shqipe”, Tiranë, 2011.
20. Demiraj, B.: *Jeta akademike e Martin Camajt*, në “Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu”, Studime shqiptare 17, Shkodër, 2011.

21. Demiraj, B.: *Albalogjia dhe gjuha shqipe*, www.Forumishqiptar.com.
22. Dodi, A.: *Gjuha letrare shqipe përballë rreziqeve që e kërcënojnë*, në “Letërsia shqipe dhe gjuha letrare”, Prishtinë, 1998.
23. Doson, A.: *Manuel de la lingua shqipe an albanese*, Paris 1879.
24. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (grup autorësh), Tiranë, 1973.
25. Dhrimo, A.: *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, në “Për shqipen dhe shqiptarët” 1, Tiranë, 2008.
26. Dhrimo, A.: *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 3, Tiranë, 1972.
27. *Fonetika dhe gramatika e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1976.
28. Fishta, Gj.: *Lahuta e malcis*, TOENA, Tiranë, 2000.
29. Frashëri, S.: *Shkronjëtoe e gjuhës shqipe*, Bukuresht, 1886.
30. Geci, P.: *Derivatet në fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit*, në “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, III, Tiranë, 1969.
31. *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Morfologjia, Tiranë, 2002.
32. Gjoka, B.: *Martin Camaj. Shkrimtaria e tij*, OMBRA GVG, Tiranë, 2010.
33. Gjonlekaj, Gj.: *Disa kujtime për Martin Camajn*, botuar në “Tirana observer”, 17 korrik 2010.
34. *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, (grup autorësh), Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1976.
35. Hahn, J. G.: *Beitrage zu einer Grammatik des toskischen Dialektes*. Albanesische Studien, Jena, 1854.
36. Haxhi, A., Topalli, T.: *Leksikon, Gjuhëtar shqiptarë dhe albanologë*, Fiorentina, Shkodër, 2012.
37. Hysa, E.: *Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*, SF, 3, Tiranë, 1973.
38. Hysa, E.: *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.
39. Hysa, E.: *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, SF,1, Tiranë, 1970.
40. Hysa, E.: *Parashtesat me kuptim mohues në gjuhën shqipe*, SF, 4, Tiranë, 1997.
41. Hysa, E. - Xoxe, L.: *Vëzhgime për formimin e fjalëve të “Meshari” i Gjon Buzukut*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 22/1, Prishtinë, 2004.
42. Kamarda, Dh. *Saggio di gramatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno 1864, f.157-168.

43. Klosi, A.: *Martin Camaj*, Vepra letrare 1, 1966.
44. Kole, J.: *Rreth emrave të prejardhur me -ore*, në “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, Tiranë, 1975.
45. Koliqi, E.: *Kritikë dhe Estetikë*, Apollonia, Fier, 1999.
46. Kostallari, A.: *Gjendja e studimeve albanologjike në Shqipëri. Probleme dhe detyra të reja*, në “Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 1965.
47. Kostallari, A. *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
48. Kostallari, A.: *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, në “Shkencat shoqërore në shkollë”, Tiranë 1967.
49. Kostallari, A. *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
50. Kostallari, A. *Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
51. Kostallari, A. *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
52. Kuçuku, B.: *Gjurmë të jetës dhe individualitetit letrar të M. Camajt*, SF, 3-4, Tiranë, 2008.
53. Lankshi, J.: Revista *Mehr Licht!*, nr. 29, Tiranë, 2006.
54. Luka, D.: *Ndihmesa e Fishtës, Koliqit dhe Camajt për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe*, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2004.
55. Luka, D. *Studime gjuhësore*, XIII, Shkodër, 2011.
56. Lloshi, Xh.: Çështje të stilistikës dhe kultura e gjuhës, në “Shqipja gjuhë e hapur dhe dinamike”, Tiranë, 2011.
57. Lloshi, Xh.: *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 2001.
58. Lloshi, Xh.: *Tipare të sistemit stilistik në gjuhën e sotme shqipe*, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, Tiranë, 1988.
59. Memisha, V.: *Emrat me parashtesën mos- në shqipen standarde*, në “Studime për fjalën shqipe”, Tiranë, 2011.
60. Memisha, V.: *Martin Camaj dhe leksiku i munguar*, në “Studime për fjalën shqipe”, Tiranë, 2011.
61. Myderrizi, O.: *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë, 1944.

62. Osmani, T.: *Martin Camaj dhe gramatika e shqipes. Pikëpamje për gjuhën letrare shqipe*, në “Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor”, 3, Shkodër, 2009.
63. Pekmezi, Gj.: *Grammatik des albanesische Sprache*, Eien, 1908.
64. Pipa, A.: *Poezia dhe poetika e Camajt*, në ”Gazeta shqiptare”, 1 korrik 2012.
65. Pipa, A.: Revista “Kritikë”, Tiranë, 1944.
66. Priku, M.: *Një vështrim rreth përdorimit të disa leksemave në letërsinë artistike, si prirje drejt variacioneve gjuhësore*, në “Studime albanologjike”, 1, Tiranë, 2011.
67. Riza, S.: *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë, 1994.
68. Rrokaj, Sh.: *Probleme të stilistikës gjuhësore: kuptimi, ndërtimi dhe përdorimi i disa figurave stilistike*, në “Çështje të gjuhës shqipe”, vëll. II, Arbëria, Tiranë, 2009.
69. Rrokaj, Sh.: *Fjalësi me prapashtesën -shëm në disa vepra të I. Kadaresë*, në “Çështje të gjuhës shqipe”, vëll. I, Arbëria, Tiranë, 2007.
70. Samara, M.: *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1985.
71. Samara, M.: *Vëzhgime për antonimet me prapashtesën shpër- në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1989.
72. Sepir, E. *Gjuha - Hyrje në studimin e ligjërimin*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
73. Sinani, Sh.: *Çështje të stilit në ligjërimin e Martin Camajt*, SF, 1-2, 2007.
74. Sinani, Sh.: *Parathënie*, Vëllimi III, Onufri, Tiranë, 2010.
75. Shehu, H.: *Rreth sindajshitesave (afiksoideve) në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 2, 1989.
76. Sheperi, I. D.: *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sindaksa, Vlorë, 1927
77. Shkurtaj, Gj.: *Ndikim gjuhësor i letërsisë në jetën e shoqërisë*, në “Pesha e fjalës shqipe”, UFOPress, Tiranë, 2009.
78. Topalli, K.: *Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor*, Simpoziumi “Martin Camaj, Tradita dhe bashkohësia”, Shkodër, 1994.
79. Topalli, T. *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011.
80. Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
81. Thomai, J. *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001.
82. Thomai, J. *Rreth ndajfoljeve me prapashtesën -isht në gjuhën e sotme shqipe*, Gjuha jonë, 1, 1991.
83. Thomaj, J.: *Rreth vlerave të fjalëve në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë, 2, 1989.
84. Thomai, J.: *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.
85. Vehbiu, A.: *Emrat e mbiemrat më -tar nga tema prejfoljore më -im në shqipen e sotme letrare*, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, Tiranë, 1988.

86. Xoxe, L.: *Rreth formimit të fjalëve te Gjon Buzuku*, (temë diplomë, dorëshkrim), Tiranë, 1978.
87. Xhuvani, A.; Vepra I, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, A. Xhuvani - E. Çabej, Tiranë, 1980.
88. Xhuvani, A.: Vepra I, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, A. Xhuvani - E. Çabej, Tiranë, 1980.
89. Xhuvani, A.: *Kompozitat*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
90. Wittengstein, L. :*Filozofska istraživanja*, “Nolit”, Beograd, 1980.



## F J A L O R Ë

1. *Fjaluer i Rii Shqypes përbâam prej Shocniet t' Bashkimit, Shkodër, 1908*; Prishtinë, 1978.
2. *Fjalor i gjuhës shqipe*. E punoi një komision i përbërë nga K. Cipo (Kryetar), E. Çabej, 3. M. Domi, A. Krajni, O. Myderrizi. Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë, Tiranë, 1954, Rishtypje: Botime Çabej, Tiranë, 2005.
4. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.
5. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.
6. Elezi, M.: *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
7. Gazulli, N.: *Fjalorth i ri. Fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010.
8. G. Belluscio - Sh. Rrokaj, *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë, 2011.
9. Xh. Lloshi, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve, Shqip - Latinisht dhe Latinisht - Shqip*, Logus-A, Prishtinë, 2010.

## LETËRSI E VJELË

1. Camaj, M.: *Karpa*, Roma, 1981.
2. Camaj, M.: *Rrathë*, München, 1978.
3. Camaj, M.: *Vepra letrare 1*, Apollonia, Tiranë, 1996.
4. Camaj, M.: *Vepra letrare 2*, Apollonia, Tiranë, 1996.
5. Camaj, M.: *Vepra letrare 3*, Apollonia, Tiranë, 1996.
6. Camaj, M.: *Vepra letrare 4*, Apollonia, Tiranë, 1996.
7. Camaj, M.: *Vepra letrare 5*, Apollonia, Tiranë, 1996.
8. Camaj, M.: *Vëllimi I*, Onufri, Tiranë, 2010.
9. Camaj, M.: *Vëllimi II*, Onufri, Tiranë, 2010.
10. Camaj, M.: *Vëllimi III*, Onufri, Tiranë, 2010.
11. Camaj, M.: *Vëllimi IV*, Onufri, Tiranë, 2010.
12. Camaj, M.: *Vëllimi X*, Onufri, Tiranë, 2010.